



CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS:

**“ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË
DREJTËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE
MAQEDONISË SË VERIUT”**

Kandidatja

MSc. Driola SUSURI

Mentori

Prof. Dr. Zemri ELEZI

Tetovë, Maj 2022

Titulli punues i temës:

“Roli i Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut”

Përkthim i titullit punues në gjuhën angleze:

“The role of Constitutional Court in strengthening the rule of law in the Republic of Kosovo, Albania and North Macedonia”

Përkthim i titullit punues në gjuhën maqedonase:

“Улогата на Уставниот суд во зајакнувањето на владеењето на равото во Република Косово, Албанија и Северна Македонија”

Unë, Elhame Arifi, me profesion Lektore, nën përgjegjësi morale dhe materiale, më datë 17.03.2022, jap këtë:

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lektoruar temën me titull: “Roli i Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut”, të kandidatës Driola Susuri.

Prishtinë, 17.03.2022

LEKTORE
EMRI DHE MBIEMRI
Elhame Arifi
NËNSHKRIMI




Nr. telefonit: 045 379 365

E-mail adresa: lekturim@hotmail.com



DEKLARATË E STUDENTIT PËR PUNË ORIGINALE

Me këtë deklaratë, unë Driola Susuri, me përgjegjësi të plotë, deklaroj se:

- është punim origjinal dhe punë individuale e imja nën mentorimin e Prof. Dr. Zemri Elezi;
- është rezultat i punës sime hulumtuese, kontribut origjinal;
- të gjitha burimet e shfrytëzuara në punim janë cituar konform rregullave akademike;
- punimi në tërësi apo pjesë të punimit nuk janë kopjuar nga punimet e tjera dhe njëherit as nuk është prezantuar dhe botuar deri tani nga ndonjë institucion tjetër.

Ky punim i diplomës vlen për ciklin e studimeve _____ dhe ka titullin:

_____.

Studentja/Nënshkrimi

Tetovë, më __/__/__

ABSTRAKTI

Shteti i së drejtës, si një nga parimet e rëndësishme të demokracisë kushtetuese, është bërë gur themeli i sistemeve juridike në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore, andaj mbrojtja e këtij parimi është institucionalizuar. Shtetet demokratike dhe ato në tranzicion në mënyrë eksplicite janë të detyruara ta sanksionojnë edhe Gjykatën Kushtetuese si organ të posaçëm për interpretimin dhe mbrojtjen e kushtetutës. Askush nuk mund ta mbrojë më denjësisht rendin kushtetues të një shteti se Gjykata Kushtetuese, e cila duke e mbrojtur atë krijon vlera aksiologjike për zbatimin e shtetit të së drejtës.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se Gjykata Kushtetuese manifestohet në jetën juridike përmes kontrollit kushtetues duke dhënë kontribut të rritja e përgjegjësisë së institucioneve drejt përmbushjes dhe respektimit të elementeve të shtetit të së drejtës.

Qëllimi primar i hulumtimit është që të qartësojë kuptimin e shtetit të së drejtës dhe elementet përbërëse që qëndrojnë në themel të tij përmes analizës së dispozitave normative si dhe përmes interpretimeve të dispozitave kushtetuese të cilat e sqarojnë rolin e Gjykatës Kushtetuese si një nga organet themelore që garanton shtetin e së drejtës dhe njëherit të evidentohen edhe interpretimet që ky organ i ka bërë elementeve të shtetit të së drejtës në rastin e shtetit të Kosovës në vështrim krahasues me atë të shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore.

Realizimi i këtij punimi studiues mbështetet në metodologjinë e kombinuar, respektivisht si metoda kryesore janë aplikuar metoda kualitative, kuantitative dhe ajo krahasuese. Meqenëse ndërtimi i shtetit të së drejtës varet nga kontributi i institucioneve shtetërore dhe nga ai i qytetarëve, atëherë grumbullimi i të dhënave primare është realizuar përmes anketës me qytetarë në Republikën e Kosovës dhe intervistave gjysmë të strukturuar me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë të drejtësisë kushtetuese.

Rezultatet kërkimore kanë hedhur në pah rolin dominant dhe kontributin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës në forcimin e shtetit të së drejtës dhe elementeve të tij.

Përfundimet e këtij disertacioni synojnë zgjerimin e njohurive sa i përket shtetit të së drejtës e ndikimit të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në konsolidimin dhe forcimin e tij dhe në nxjerrjen e mësimave pozitive nga Republika e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për shtetin e ri të Kosovës, njëherit duke kontribuar në këtë formë edhe në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese duke ndihmuar kështu në përmirësimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Fjalët kyçe: Shteti i së drejtës, Gjykatë Kushtetuese, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut.

ABSTRACT

The rule of law, as one of the important principles of constitutional democracy, has become the cornerstone of legal systems in the Republic of Kosovo, Albania, and North Macedonia, therefore the protection of this principle is institutionalized. Democratic and transitional countries are explicitly obliged to also sanction the Constitutional Court as an institution, as a special body for the interpretation and protection of the constitution. No one can defend the constitutional order of a country more earnestly than the Constitutional Court, which by protecting it creates axiological values for the implementation of the rule of law.

The importance of this paper lies in the fact that the Constitutional Court is manifested in legal life through constitutional control, contributing to increasing the responsibility of institutions towards fulfilling and respecting the elements of the rule of law.

The primary purpose of the research is to clarify the meaning of the rule of law and its fundamental constituent elements through the analysis of normative provisions as well as through interpretations of constitutional provisions that clarify the role of the Constitutional Court as one of the fundamental authorities guaranteeing the rule of law and at the same time to indicate the interpretations that this authority has made of the elements of the rule of law in the case of the state of Kosovo in a comparative view with that of the rule of law in the Republic of Albania and North Macedonia, showing the power of the Constitutional Court in this aspect.

The realization of this research work is based on the combined methodology, respectively the qualitative, quantitative, and comparative methods have been applied. Since the building of the rule of law depends on the contribution of state institutions and of citizens, then the collection of primary data was carried out by a questionnaire with the citizens of the Republic of Kosovo and semi-structured interviews with local and international constitutional justice experts.

The research results have highlighted the dominant role and contribution of the Constitutional Court in the Republic of Kosovo in strengthening the rule of law and its elements.

The conclusions of this dissertation aim to expand the knowledge regarding the rule of law and the influence of the jurisprudence of the Constitutional Court in consolidating and strengthening it and in drawing positive lessons from the Republic of Albania and North Macedonia for the new country of Kosovo, and at the same time contributing in this form to the implementation of the decisions of the Constitutional Court, thus helping to improve and advance and strengthen the rule of law.

Keywords: Rule of Law, Constitutional Court, Kosovo, Albania, North Macedonia.

АПСТРАКТ

Владеењето на правото, како еден од важните принципи на уставната демократија, стана камен-темелник на правните системи во Република Косово, Албанија и Северна Македонија, поради што заштитата на овој принцип е институционализирана. Демократските држави и оние во транзиција експлицитно се должни да го санкционираат и Уставниот суд како посебно тело за толкување и заштита на уставот. Никој не може подостојно да го брани уставниот поредок на една држава од Уставниот суд, кој со негова заштита создава аксиолошки вредности за спроведување на правната држава.

Важноста на овој труд лежи во фактот што Уставниот Суд се манифестира во правниот живот преку уставна контрола, придонесувајќи за зголемување на одговорноста на институциите кон исполнување и почитување на елементите на владеењето на правото.

Примарната цел на истражувањето е да се разјасни значењето на владеењето на правото и конститутивните елементи кои лежат во негова основа преку анализа на нормативните одредби, како и преку толкувања на уставните одредби кои ја појаснуваат улогата на Уставниот Суд како еден од основните органи. гарантирајќи го владеењето на правото и во исто време да ги истакне толкувањата што ова тело ги направи за елементите на владеењето на правото во Република Косово во компаративен поглед со оној на владеењето на правото во Република Албанија и Северна Македонија.

Реализацијата на оваа истражувачка работа се заснова на комбинирана методологија, соодветно како главни методи се применети квалитативни, квантитативни и компаративни методи. Бидејќи градењето на владеењето на правото зависи од придонесот на државните институции и граѓаните, тогаш прибирањето на примарните податоци беше спроведено преку анкета на граѓаните во Република Косово и полуструктурирани интервјуа со локални и меѓународни експерти за уставна правда. Резултатите од истражувањето ја истакнаа доминантната улога и придонесот на Уставниот Суд во Република Косово во зајакнувањето на владеењето на правото и неговите елементи.

Заклучоците од оваа дисертација имаат за цел да ги прошират знаењата за владеењето на правото и влијанието на судската пракса на Уставниот суд во консолидирањето и зајакнувањето на владеењето на правото и во извлекувањето позитивни лекции од Република Албанија и Северна Македонија за новата држава. на Република Косово, истовремено придонесувајќи во оваа форма во спроведувањето на одлуките на Уставниот суд, помагајќи на тој начин за подобрување и зајакнување на владеењето на правото.

Клучни зборови: Владеење на правото, Уставен суд, Косово, Албанија, Северна Македонија

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE.....	13
LISTA E GRAFIKONEVE	14
AKRONIMET	16
HYRJE	18
<i>1. Konteksti dhe parashtrimi i problemit</i>	<i>18</i>
<i>2. Rëndësia e problemit studimor</i>	<i>20</i>
<i>3. Struktura e punimit</i>	<i>21</i>
<i>4. Hipotezat e hulumtimit dhe pyetjet kërkimore</i>	<i>23</i>
<i>5. Metodologjia e punimit.....</i>	<i>24</i>
KAPITULLI I	27
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DREJTËSISË KUSHTETUESE	27
<i>1. Përkufizimi teorik i drejtësisë kushtetuese.....</i>	<i>27</i>
<i>2. Historiku dhe zhvillimi i drejtësisë kushtetuese</i>	<i>28</i>
<i>3. Modelet e gjyqësisë kushtetuese</i>	<i>30</i>
<i>3.1. Modeli amerikan i gjyqësisë kushtetuese.....</i>	<i>30</i>
<i>3.2. Modeli evropian (austriak) i gjyqësisë kushtetuese</i>	<i>32</i>
<i>4. Karakteristikat e gjyqësisë kushtetuese.....</i>	<i>33</i>
<i>5. Parimet e përgjithshme të drejtësisë kushtetuese.....</i>	<i>34</i>
<i>6. Doktrina e aktivizmit dhe vetëpërmbytjes gjyqësore</i>	<i>36</i>
KAPITULLI II	39
SHTETI I SË DREJTËS NË REALCION ME GJYKATËN KUSHTETUESE	39
<i>1. Historiku dhe evoluimi i shtetit të së drejtës.....</i>	<i>39</i>
<i>2. Kuptimi formal dhe përmbajtësor i shtetit të së drejtës</i>	<i>42</i>
<i>3. Evoluimi i konceptit të shtetit të së drejtës.....</i>	<i>43</i>
<i>3.1. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit gjerman “Rechtsstaat”</i>	<i>43</i>
<i>3.2. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit francez “Thé French État de droit”</i>	<i>44</i>
<i>3.3. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit anglo-amerikan</i>	<i>45</i>
<i>4. Shteti i së drejtës nga sfera ndërkombëtare</i>	<i>46</i>

<i>5. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut</i>	<i>47</i>
5.1. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës	47
5.2. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Shqipërisë	48
5.3. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut	49
<i>6. Roli i Gjykatës Kushtetuese në përforcimin e shtetit të së drejtës</i>	<i>51</i>
<i>7. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimi i saj në krijimin e praktikës gjyqësore</i>	<i>52</i>
KAPITULLI III	55
GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS NË NJË VËSHTRIM HISTORIKO-EVOLUTIV DHE NDIKIMI I SAJ NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS	55
<i>1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese në Kosovë</i>	<i>55</i>
1.1. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës së Lartë të Kosovës – Dega e Posaçme Kushtetuese-Gjyqësore nga viti 1969	57
1.2. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës Kushtetuese sipas Kushtetutës të KSAK të vitit 1974	58
1.3. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjyqit Kushtetues në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990	59
1.4. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës Supreme-Kolegjit të Veçantë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë të vitit 2001	59
<i>2. Themelimi i Gjykatës Kushtetuese dhe statusi i saj në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës</i>	<i>61</i>
<i>3. Përbërja, zgjedhja, mandati, imuniteti dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës</i>	<i>64</i>
3.1. Zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese	64
3.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës	69
3.3. Shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese	70
<i>4. Juridiksionet dhe palët e autorizuar në Gjykatat Kushtetuese Evropiane</i>	<i>71</i>
<i>5. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës</i>	<i>72</i>
5.1. Kontrolli kushtetues i amendamenteve	73
5.2. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare	74

5.3. Konfliktet kushtetuese për kompetencë ndërmjet organeve shtetërore	75
5.4. Shkeljet kushtetuese gjatë procesit zgjedhor në Kuvendin e Republikës së Kosovës.....	75
5.5. Praktikrat e gjyëqsisë kushtetuese në rastin e shkeljes nga Presidenti i Republikës së Kosovës	76
5.6. Format e ankesave kushtetuese në rastet e mbrojtjeve të të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi, si dhe në rastet e veçanta në Republikën e Kosovës	77
5.7. Disa nga rastet e cenimit të drejtave dhe lirive kushtetuese në Republikën e Kosovës ..	78
5.8. Mënyra e refermit incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës	79
6. Ndikimi i Gjykatës Kushtetuese në garantimin e parimeve të shtetit të së drejtës	80
7. Llojet e vendimeve kushtetuese, opinionet e gjyqtarëve, efekti juridik dhe zbatueshmëria e tyre	84
7.1. Llojet e vendimeve	84
7.2. Disa prej opinionëve të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës	85
7.3. Efektet juridike të vendimeve kushtetuese	88
7.4. Zbatueshmëria e vendimeve të Gjykatës kushtetuese.....	89
8. Historiku i themelimit të Komisionit të Venecias dhe anëtarësimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës	93
9. Kompetencat e Komisionit të Venecias dhe opinionet e dhëna për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës	94
10. Vendimet e GJEDNJ, efektet në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës.....	98
KAPITULLI IV	103
ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS .	103
1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë	103
2. Evoluimi i kompetencave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë prej miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016.....	104
3. Përbërja, zgjedhja, mandati, imuniteti dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës	105
3.1. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese dhe zgjedhja e gjyqtarëve	105
3.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve kushtetues	106
3.3. Përfundimi i mandatit dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë	107

<i>4. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë në vështrim krahasues me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>109</i>
4.1. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.....	109
4.2. Palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë në vështrim krahasues me palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës	111
<i>5. Llojet e vendimeve, procedura e vendimmarrjes, efekti juridik dhe ekzekutimi i tyre.....</i>	<i>114</i>
5.1. Llojet e vendimeve	114
5.2. Procedura e vendimmarrjes	114
5.3. Efekti juridik i vendimeve kushtetuese në Shqipëri	115
5.4. Ekzekutimi i vendimeve kushtetuese	116
<i>6. Roli i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë në forcimin e shtetit të së drejtës në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës.....</i>	<i>117</i>
<i>7. Ndikimi i jurisprudencës së GJEDNJ në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë në krahasim me Republikën e Kosovës.....</i>	<i>119</i>
KAPITULLI V.....	125
GJYKATA KUSHTETUESE E MAQEDONISË SË VERIUT - HISTORIKU, JURIDIKSIONI KUSHTETUES DHE RELACIONI I SAJ ME SHTETIN E SË DREJTËS	125
1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut.....	125
2. Përbërja, zgjedhja, shkarkimi, mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Veriore në aspekt krahasues me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë.....	127
2.1. Përbërja, zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë	127
2.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve kushtetues	129
3. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë	130
3.1. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë Veriore	130
3.2. Palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në aspekt krahasues me ato në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë	132
4. Llojet e vendimeve kushtetuese, procedura e vendimmarrjes, efekti juridik dhe ekzekutimi i tyre	134
4.1. Llojet e vendimeve kushtetuese	134

4.2. Procedura e vendimmarrjes	134
4.3. Efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	135
4.4. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut	137
5. Roli i Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë Veriore në forcimin e shtetit të së drejtës në vështirim krahasues me Republikën e Kosovës dhe të Shqipërisë	137
6. Ndikimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fuqizimin e shtetit të së drejtës në Maqedoninë Veriore në aspekt krahasues me Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë.....	141
7. Ndikimi i opinioneve të Komisionit të Venecias në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë Veriore	144
KAPITULLI VI.....	148
STUDIMI EMPIRIK.....	148
1. Instrumentet e hulumtimit.....	148
2. Rezultatet dhe analiza e të dhënave nga anketa me qytetarët e Republikës së Kosovës .	150
2.1. Analiza e të dhënave demografike nga anketimi i qytetarëve në Republikën e Kosovës	150
2.2. Gjetjet dhe analiza e të dhënave nga anketa e realizuar me qytetarët e Republikës së Kosovës	153
PËRFUNDIME.....	165
<i>Rekomandimet</i>	173
CONCLUSIONS	176
<i>Recommendations</i>	184
REFERENCAT.....	187

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Pasqyrim i shkarkimeve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë pas fazës së parë të vetingut.....	109
Tabela 2. Palët e autorizuara të përbashkëta dhe dalluese sipas Kushtetutës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë	112
Tabela 3. Palët e autorizuara sipas Kushtetutës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore	133
Tabela 4: Numri i kërkesave sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore në periudhën kohore 2010-2019	140

LISTA E GRAFIKONEVE

Grafikoni 1. Numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë Veriore për periudhën 2015-2019.....	136
Grafikoni 2. Gjinia e qytetarëve të anketuar	150
Grafikoni 3. Grupmoshat e qytetarëve të anketuar	150
Grafikoni 4. Shkollimi i qytetarëve të anketuar.....	151
Grafikoni 5. Vendbanimi i qytetarëve të anketuar	151
Grafikoni 6. Përkatësia etnike e qytetarëve të anketuar	152
Grafikoni 7. Profesione të qytetarëve të anketuar.....	152
Grafikoni 8. Përgjigjet e qytetarëve në pyetjen se a janë të punësuar	152
Grafikoni 9. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me përmbajtjen dhe qartësinë e ligjeve në fuqi	154
Grafikoni 10. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me implementimin e ligjeve në shtetin e Kosovës.....	155
Grafikoni 11. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor	156
Grafikoni 12. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë	157
Grafikoni 13. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive në Republikën e Kosovës	158
Grafikoni 14. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me mundësinë e tyre të referimit në Gjykatën Kushtetuese dhe ndikimi i këtij referimi në punën e organeve të tjera shtetërore.....	159
Grafikoni 15. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me procedurën e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues.....	160
Grafikoni 16. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me karakteristikat e procedurës së zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues në Republikën e Kosovës	160
Grafikoni 17. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës	161
Grafikoni 18. Përgjigjet e qytetarëve rreth ndikimit të grupeve parlamentare në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës.....	162
Grafikoni 19. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me publikimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese me një numër të kufizuar argumentesh	162
Grafikoni 20. Përgjigjet e qytetarëve sa i përket referimit të rastit në Gjykatën Kushtetuese lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive.....	163

Grafikoni 21. Përgjigjet e qytetarëve sa i përket rolit të Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës	163
--	-----

AKRONIMET

BE	- Bashkimi Evropian
CCRM	- Constitutional Court of the Republic of Macedonia
DUDNJ	- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EULEX	- European Union Rule of Law Mission in Kosovo (Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë)
EWMI	- Instituti i Menaxhmentit East-West
ECHR	- European Convention of Human Rights
ECTDL	- European Commission for Democracy through Law
ENNHHR	- European Network of Nation Human Rights Institute
MD	- Ministria e Drejtësisë
MPB	- Ministria e Punëve të Brendshme
KE	- Këshilli i Evropës
KEDNJ	- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDL	- Komisioni Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit
KSAK	- Krahina Socialiste Autonome e Kosovës
KKVPK	- Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë
KGJK	- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
LDK	- Lidhja Demokratike e Kosovës
ODIHR	- Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OKB	- Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PNC	- Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil
PSSP	- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RMV	- Republika e Maqedonisë Veriore
RSFJ	- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
RK	- Republika e Kosovës
RSH	- Republika e Shqipërisë
RSM	- Republika Socialiste e Maqedonisë

SFRY	- Socialist Federal Republic of Yugoslavia
UNMIK	- United Nations Mission in Kosovo
GJEDNJ	- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJKRK	- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
GJKRSH	- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

HYRJE

1. Konteksti dhe parashtrimi i problemit

Në punimin e disertacionit “Roli i Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut”, trajtohet nga pikëpamja historike, teorike, normative dhe krahasuese shteti i së drejtës dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në forcimin e tij. Veçanërisht këndvështrimi analitik dhe krahasues i rolit të Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës është i pashmangshëm, çka ofron një shumëllojshmëri analizash të problemeve konkrete me të cilat përballen shtetet si Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në zbatimin e shtetit të së drejtës dhe njëherit dalin edhe praktikatat më të mira që aplikohen për konsolidimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, ndonëse asnjë sistem politik nuk mund të trajtojë plotësisht të gjitha sfidat që sjell zbatimi i shtetit të së drejtës.

Drejtësia kushtetuese është një kategori jashtëzakonisht e rëndësishme në çdo sistem juridik demokratik. Nëpërmjet kapacitetit dhe cilësisë së mbrojtjes së drejtësisë kushtetuese, shteti vlerësohet sa e respekton shtetin e së drejtës dhe se sa i përkushtuar është për realizimin e standardeve evropiane në sistemin juridik. Supremacia e kushtetutës, si dhe respektimi i hierarkisë së akteve juridike, të brendshme dhe ndërkombëtare, është parakusht kyç për ekzistencën dhe funksionimin e drejtësisë kushtetuese në shtet.

Parimi i shtetit të së drejtës përbën themelin e çdo regjimi demokratik. Vendet me demokraci të konsoliduar kanë “evidentuar prej kohësh standardet kryesore të parimit të shtetit të së drejtës si dhe kanë përcaktuar mekanizmat përkatës për garantimin sa më të plotë e efektiv të elementeve të tij” (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 17). Eksperienca e tyre ka shërben si ndihmë për shtetin e Kosovës në udhën e tij për t’iu bashkëngjitur me dinjitet botës së qytetëruar.

Shteti i së drejtës bazohet kryesisht në respektimin, përkatësisht zbatimin e kushtetutës. Jo rrallëherë ndodh që pushtetet çekuilibrohen, çka vendos në pikëpyetje respektimin e kushtetutshmërisë dhe themelet e shtetit të së drejtës. Prandaj, kufizimi i pushteteve shtetërore si dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive kushtetuese përbëjnë garanci

parësore për ta vendosur kushtetutshmërinë nga Gjykata Kushtetuese. Andaj, Gjykatat Kushtetuese janë shndërruar në mekanizma të rëndësishëm në funksion të mbrojtjes së kushtetutës dhe vlerave të saj, por në dobi edhe të qytetarëve në përpjekje për të rivendosur drejtësi kushtetuese aty ku drejtësia e rëndomtë dështon ta ofrojë atë.

Qëllimi i këtij punimi të disertacionit të doktoratës është të shpërfaqë një kuadër shumëdimensional të kontrollit kushtetues në Republikën e Kosovës në vështrim krahasues me disa vende të tjera të Evropës Juglindore. Ky objektiv realizohet përmes analizës së vendimmarrjes kushtetuese, duke nxjerrë në pah zhvillimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në drejtim të kufizimit të pushteteve shtetërore, kompetencave kushtetuese të organeve shtetërore, garantimit të të drejtave e lirive themelore, sigurisë juridike, e parimeve të tjera të cilat përbëjnë themelin e shtetit të së drejtës.

Zhvillimet historike dhe politike në Evropën Juglindore e posaçërisht në Ballkanin Perëndimor, kanë lënë gjurmë edhe në sistemin e drejtësisë. Formacioni socialist ka zhvilluar një sistem unik dhe linear, duke i kompletuar ligjërisht të gjitha instancat e institucioneve të drejtësisë. Historiku i funksionimit të tyre është diferencial nga ato të sotshmet. Qasja jonë e trajtimit është e veçantë pasi edhe Gjykatat Kushtetuese ishin dhe janë kategori të veçanta për nga kompetencat e sanksionuara me kushtetutat e vendeve përkatëse.

Fokusi në këtë punim të disertacionit të doktoratës është roli i këtyre Gjykatave Kushtetuese si në aspektin historik dhe pragmatik, në veçanti në shtetin e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Roli i këtyre gjykatave gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të këtyre shteteve, nuk ishte parësor, pasi që sistemi politik funksiononte në baza autokratike ku një organ dominonte ndaj organeve të tjera të shtetit. Me kushtetutat e këtyre vendeve ishin të sanksionuara edhe Gjykatat Kushtetuese si institucione kushtetuese “të pavarura” si paradoks, në fakt edhe kushtetuta edhe gjykatat kishin karakter funksional fiktiv. Shpjegimi real ishte se këto gjykata ishin të dirigjuara nga oligarkitë politike të ish-Republikave Socialiste dhe Krahinave Socialiste Autonome.

Trajtesa thelbësore e punimit të doktoratës, lidhet me rithemelimin e këtyre gjykatave pas luftës dhe shpërbërjes të Jugosllavisë e rënies së sistemit komunist në Shqipëri, si dhe njëherit roli i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës. Kështu çlirimi i Kosovës nga Serbia, respektivisht periudha e pas çlirimit bëri që autoritetet e Kosovës në

bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, t'i vendosnin konturat e një shteti faktik, që më vonë do të shpallej i pavarur aty nga viti 2008, së bashku me të e kishin paraparë edhe themelimin e Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009. Gjykata Kushtetuese, përveç funksionit fundamental që ka ruajtjen e kushtetutës dhe të rendit kushtetues, konsolidon por edhe e forcon shtetin e së drejtës së një vendi duke u mbështetur te dispozitat e përgjithshme të kushtetutës. Prandaj, shteti i së drejtës kuptohet se ka lidhmëri me parimet themelore kushtetuese, duke filluar nga kushtetutshmëria, ndarja e pushteteve shtetërore, siguria juridike, parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mosdiskriminimin si dhe me parimet e tjera kushtetuese. Si rrjedhojë, konsiderojmë se kushtetuta dhe legjislacioni duke i sanksionuar parimet e mësipërme, krijojnë një bazë juridike të plotë e të qëndrueshme për njohjen dhe zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës në vendin tonë. Por, garantimi i shtetit të së drejtës nuk varet vetëm nga garantimi me akte juridike dhe në nivel institucional, pra një kushtetutë sado që mund të përmbajë rregullime themelore dhe të afirmojë shtetin e së drejtës në një vend, kjo e fundit nuk mund të garantojë de facto zbatimin e tyre nëse mungon vullneti i të gjithëve, përfshirë këtu organet shtetërore dhe qytetarët.

2. Rëndësia e problemit studimor

Gjykata Kushtetuese përveç funksionit fundamental për mbrojtjen e kushtetutës e të rendit kushtetues, njëherit konsolidon dhe forcon edhe shtetin e së drejtës të një vendi duke u mbështetur te dispozitat e përgjithshme kushtetuese.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka sanksionuar "Gjykatën Kushtetuese si autoritetin përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve dhe vendimeve të organeve të pushtetit shtetëror me Kushtetutën" (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Ajo përbën organ të veçantë kushtetues, të cilit i targetohet mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, funksione të njëjta ka edhe Gjykata Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore.

Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e një diagnoze fillestare për problemet e gjyqësisë kushtetuese te disa vende në Evropën Juglindore, konkretisht në shtetin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe të sugjerojë opsione për përmirësimin e

gjendjes. Analiza po ashtu shfaq edhe aspekte të tjera të gjyqësisë kushtetuese që kanë nevojë për studim më të thellë dhe pa anashkaluar edhe aplikimin e interpretimin e elementeve formale dhe përmbajtësore të shtetit të së drejtës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore.

Rëndësia e punimit konsiston njëkohësisht edhe në evidentimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës e cila përmes jurisprudencës kushtetuese ka arritur të identifikojë, përpunojë e mbrojë vlerat dhe parimet kushtetuese, përfshirë këtu edhe shtetin e së drejtës, kushtetutshmërinë, miratimin e ligjeve konform kushtetutës, ndarjen dhe balancimin e pushteteve shtetërore, sigurinë juridike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vështirësi krahasues si dhe në ngritjen e nivelit të transparencës së institucioneve të drejtësisë kushtetuese, të stimulojë gjyqësi të paanshme dhe më profesionale, shërbime më të mira, si dhe të stimulojë aktorët kyçë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Po ashtu, Republika e Shqipërisë, Maqedonisë Veriore dhe e Kosovës aspirojnë të integrohen në Bashkimin Evropian, integrim ky që kushtëzohet nga konsolidimi i shtetit të së drejtës në këto vende.

Nëse me këtë punim të disertacionit të doktoratës duket një realitet kryesisht negativ i gjyqësisë kushtetuese në vendet e Evropës Juglindore në veçanti në Kosovë, kjo sepse prioriteti ynë ishte identifikimi i pikave të fërkimit në sistemin ekzistues që kanë nevojë për përkujdesje urgjente duke sugjeruar përmirësime efektive të këtyre problemeve. Kjo assesi nuk nënkupton që nuk bëhet punë meritore ose nuk ka iniciativa pozitive në nivelin e gjyqësisë kushtetuese. Andaj, ky punim i disertacionit të doktoratës synohet që të shërbejë si kontribut për nxjerrjen e mësimave pozitive të gjyqësisë kushtetuese në shtetin e Kosovës, si shtet më i ri në raport me Republikën e Shqipërisë dhe të Maqedonisë Veriore në aspektin e forcimit të shtetit të së drejtës nga Gjykata Kushtetuese.

3. Struktura e punimit

Punimi ka strukturë të veçantë të trajtimit që lidhet me natyrën e veçantë të temës që konsiston në rolin e Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në tre shtete, konkretisht në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Punimi strukturën e përgjithshme e ka të organizuar duke filluar nga pjesa hyrëse dhe pjesa themelore e përbërë nga gjashtë kapituj të trajtimit të temës, të pasuara nga përfundimi dhe literatura.

Pjesa hyrëse paraqet përmbledhje të shkurtër të kontekstit dhe parashtrimit të problemit studimor, rëndësisë së tij, hipotezat e hulumtimit, pyetjet kërkimore dhe metodat shkencore me të cilat jam shërbyer për ta punuar këtë punim të disertacionit.

Në kapitullin e parë trajtohet vështirimi i përgjithshëm i gjyqësisë kushtetuese, si përkufizimi teorik, historiku dhe evolucioni i saj, duke vazhduar me modelet e gjyqësisë kushtetuese si dhe karakteristikat e parimet që e dallojnë gjyqësinë kushtetuese.

Kapitulli i dytë e përmban elaborimin e shtetit të së drejtës dhe gjykatës kushtetuese, ku fillimisht trajtohet lindja e zhvillimi i shtetit të së drejtës, kuptimi formal dhe përmbajtësor i shtetit të së drejtës, evoluimi i kuptimit të shtetit të së drejtës në botë dhe përkufizimi sipas modelit gjerman, francez dhe atij anglo-amerikan, përkatësisht shteti i së drejtës edhe në sferën ndërkombëtare. Duke qenë se Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore e kanë garantuar shtetin e së drejtës në aktin më të lartë juridik e politik të tyre kushtetues dhe atë duke filluar nga preambula, pastaj duke vazhduar në pjesë normative të kushtetutës ku garantohet si vlerë kushtetuese dhe parim universal, njëherit është sqaruar edhe shteti i së drejtës në këto shtete që janë edhe objekt i trajtimit në këtë punim të doktoratës. Po ashtu, është trajtuar edhe Gjykata Kushtetuese si organ që ka rol me vlerë në konsolidimin e forcimin e shtetit të së drejtës, dhe njëherë edhe roli i GJEDNJ në krijimin e praktikës gjyqësore të shtetet.

Në kapitujt në vijim, respektivisht kapitullin tre, katër dhe pesë, do të pasqyrohet në fillimisht historiku i Gjykatave Kushtetuese, aspekti kushtetues e ligjor i organizmit dhe funksionimit të gjykatave kushtetuese në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore. Njëkohësisht me theks të veçantë, analizohet jurisprudenca kushtetuese dhe ndikimi i saj në fuqizimin e shtetit të së drejtës në shtetet e mësipërme në aspektin komparativ.

Kapitulli i gjashtë përfshin studimin empirik të temës së trajtuar, pra përbëhet nga të dhënat primare.

Në fund të punimit, kam dhënë përfundimet, të pasuara edhe nga rekomandimet, si dhe kam paraqitur të gjithë literaturën të cilën e kam shfrytëzuar për të trajtuar këtë temë në mënyrë adekuate dhe me një qasje profesionale.

4. Hipotezat e hulumtimit dhe pyetjet kërkimore

Hipoteza kryesore e hulumtimit është: Një numër i madh i faktorëve të karakterit të brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në nxjerrjen e vendimeve të Gjykatave Kushtetuese dhe konsolidimin e forcimin e shtetit të së drejtës.

Hipotezat ndihmëse kanë të bëjnë lidhur me atë se:

1. Shteti duhet t'i përmbushë kërkesat e caktuara de jure dhe de facto në mënyrë që të cilësohet si shtet i së drejtës në përgjithësi dhe në veçanti në rastin e Kosovës;
2. Gjykata Kushtetuese konsiderohet mekanizimi më efektiv për konsolidimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës;
3. Ndikimi politikës në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, është i theksuar si rrjedhojë e mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve, në rastet e përfshirjes së organeve politike;
4. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe veçanërisht jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në konsolidimin dhe fuqizimin e shtetit të së drejtës, përmes përfshirjes në sistemet ligjore të shteteve vlerat e parimet evropiane, si mënyra e vetme për të shkuar në një demokraci të konsoliduar;
5. Opinionet e Forumit të Komisionit të Venecias, po ashtu ndikojnë në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, në veçanti në ngritjen e profesionalizimit, paanshmërisë dhe pavarësisë.

Pyetjet kërkimore të cilat janë parashtuar dhe trajtuar në disertacionin e doktoratës kryesisht kanë të bëjnë lidhur me atë se:

1. Cilat janë sfidat e gjyqësisë kushtetuese në vendet e Evropës Juglindore?
2. Cili është roli i politikës qendrore në drejtësinë kushtetuese?
3. A duhet të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës?
4. A duhet rritur kompetencat vetanake të Gjykatave Kushtetuese?
5. Si mund të eliminohet rreziku i subjektivizmit gjatë marrjes së vendimeve nga gjyqtarët e gjykatës kushtetuese?

6. Sa ka ndikuar jurisprudenca kushtetuese në evidentimin dhe garantimin e elementeve të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore?
7. A përbën Gjykata Kushtetuese mekanizëm më efektiv për forcimin e shtetit të së drejtës?

5. Metodologjia e punimit

Realizimi i këtij punimi do të mbështetet në metodologji të kominuar, respektivisht në metodat si mëposhtë:

Metoda e kërkimit doktrinar konsiston në ekspozimin sistematik të parimeve si dhe vlerave kushtetuese në bazë të së cilave është ndërtuar dhe zhvillohet drejtësia kushtetuese.

Metoda historike - përmes kësaj metode studimi paraqet aspektin historik të Gjykatës Kushtetuese që nga themelimi, duke vazhduar me organizimin, funksionimin e zhvillimin e saj në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni Veriore. Referuar në këtë metodë kam konstatuar etapat dhe sfidat të cilat i ka kaluar gjyqësia kushtetuese dhe shteti i së drejtës.

Metoda e analizës së legjislacionit - përmes saj mundësohet analizë e dispozitave kushtetuese, ligjore në nivel nacional e disa shteteve në Evropën Juglindore, në drejtim të garantimit të shtetit të së drejtës. Po ashtu janë analizuar edhe dispozitat e “marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare” sa i përket shtetit të së drejtës.

Metoda e kërkimit dhe analizës së jurisprudencës kushtetuese – konsiderohet një nga metodat më të rëndësishme të hulumtimit shkencor përmes së cilës kuptohet dhe krahasohet mënyra e interpretimit që i bën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, kushtetutës së tyre. Kjo metodë konsiston fillimisht në kërkimin e vendimeve kryesore dhe specifike të vlerave kushtetuese, me theks të veçantë vlerat që shërbejnë për konsolidimin e forcimin e shtetit të së drejtës, me rëndësi për interpretimin e çështjeve delikate apo problematikave të paraqitura nga subjekte të ndryshme, dhe më pas edhe në analizimin e efektshmërisë së vendimeve të secilës gjykatë të shteteve që janë në fokus të trajtimit, si dhe mënyrën e interpretimit dhe zbatimin praktik të tyre nga institucionet shtetërore. Krahas analizës së jurisprudencës kushtetuese, njëherit

analizohet edhe jurisprudenca evropiane sa i përket shtetit të së drejtës dhe impakti i saj në jurisprudencën kushtetuese nacionale.

Metoda e krahasimit - nëpërmjet metodës krahasuese synohet të evidentohen ngjashmëritë dhe dallimet e gjyqësisë kushtetuese në rastin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, në këndvështrimin juridik e kritik. Qëllimi i analizës krahasuese të sistemeve kushtetuese të lartcekura, krahas identifikimit të veçorive të tyre është edhe të kuptuarit e rolit të Gjykatave Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në secilin shtet në fokus. Gjithashtu, në plan të kësaj analize krahasuese qëndron edhe identifikimi i ndikimit që ka mundësi të ketë ushtruar sistemi kushtetues shqiptar dhe maqedonas dhe huazimet që mund të ketë marrë sistemi ynë nga këto dy sisteme kushtetuese më të zhvilluara e me përvojë. Por, ky studim i thelluar ka si synim dhe përshkohet edhe nga një shqyrtim në frymë kritike të sistemit tonë kushtetues, bazuar dhe në mësimet që mund të identifikohen nga përvoja kushtetuese e shteteve homologe që kanë një traditë më të gjatë të gjyqësisë kushtetuese. Kjo metodë vlen për të kuptuar më mirë gjithashtu nëse ka edhe dallime specifike për çështje të ngjashme, që mund të jenë paraqitur pranë secilës gjykatë kushtetuese.

Më tej, është aplikuar edhe metoda empirike të kërkimit sasior e cilësor.

Metoda sasiore - të dhënat primare janë gjeneruar përmes kësaj metode, e cila është realizuar përmes anketës. Anketimi si teknikë është përdorur për sigurimin e të dhëna primare, të cilat e plotësojnë punimin e disertacionit të doktoratës edhe me opinionin e qytetarëve për shtetin e së drejtës dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës në forcimin e shtetit të së drejtës, duke pasqyruar kështu realitetin ekzistues të zhvillimit të tij në shtetin e Kosovës, të cilin e kemi krahasuar me shtetet e tjera të Evropës Juglindore, respektivisht Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kampioni në këtë studim përbëhet vetëm nga qytetarët e Republikës së Kosovës, pra kampioni ka qenë i rastit. Po ashtu, punimi e pasqyron edhe jurisprudencën kushtetuese në rastin e trajtimit të elementeve të shtetit të së drejtës në Kosovë dhe në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut.

Metoda cilësore - si metodë joprobabilitare ku është përzgjedhur mostër e qëllimshme sepse tema kufizohet vetëm në institucionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, prandaj kam përzgjedhur aktorët institucionalë vendorë e ndërkombëtarë që kanë kontribuar në themelimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës, veprimtarinë e saj përmes së cilës është ndërtuar dhe forcuar shteti i së drejtës në

Kosovë. Kjo formë e aplikimit të metodës cilësore është bërë me qëllim që të sigurohen të gjetura sa më origjinale, që njëkohësisht konsiderohen edhe primare.

Të dhënat sekondare janë siguruar nga raportet e punës së Gjykatave Kushtetuese në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore, sikurse Raportet e Progresit, Raportet e Komisionit të Venecias dhe hulumtimet e instituteve e organizatave të ndryshme.

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DREJTËSISË KUSHTETUESE

1. Përkufizimi teorik i drejtësisë kushtetuese

Gjurmet e para të drejtësisë kushtetuese i hasim që nga koha antike greke nga aspekti pragmatik, ku zbulohen normat superiore që kanë fuqi më të lartë se ligjet e mbretit nga një rast gjyqësor i formuluar nga gjyqtari Edward Coke (Jr. Drake, 2016). Gjyqësia kushtetuese aktualisht paraqet sinonim të drejtësisë kushtetuese e cila ka të bëjë me sigurimin e procesit të kushtetutshmërisë e ruajtjen e rendit (Kryeziu, 2022).

Drejtësia kushtetuese është “një nga konceptet më themelore dhe më novatore të aparatit konceptual juridik modern” (Traja, 2000, f. 7). Drejtësia kushtetuese ka lidhmëri me supremacinë e kushtetutës pasi konsiderohet si nocion që i shpreh institucionet dhe teknikat përmes të cilave sigurohet supremacia e kushtetutës.

Etërit e drejtësisë kushtetuese konsiderohen Hans Kelzen, Karl Shmit e Sharl Ajzenman. Hans Kelzen njihet si një jurist kulmor, filozof i së drejtës, i shquar edhe në fushën e politikës, në teoritë sociale, në teorinë e demokracisë, etj. Ka marrë pjesë në hartimin e kushtetutës së Austrisë të vitit 1920, ishte edhe themelues i Gjykatës Kushtetuese Austri dhe njëkohësisht ka ushtruar detyrën e gjyqtarit kushtetues në Austri (Kelsen, H., & Urbinati, N., & Accetti, C. I., 2013, f. 1).

Drejtësia kushtetuese nënkupton kontrollin gjyqësor të ligjeve, respektivisht kushtetutshmërinë e ligjeve. Si prijës i këtij segmenti të drejtësisë ishte filozofi Hans Kelzen. Me qëllim të kontrollit dhe mbrojtjes së kushtetutshmërisë, pas Luftës së Parë Botërore, si rezultat i zgjimit të interesit për kushtetutshmëri dhe kushtetutë, disa vende me kushtetutë të fortë zbatojnë formën e mbrojtjes së kushtetutshmërisë nga ana e institucioneve të mëvetësishme të pushtetit gjyqësor, Gjykatave Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese si mbrojtëse e kushtetutës për herë të parë paraqitet në Austri me kushtetutën e vitit 1920 (Saliu, 2004, f. 112).

Gjyqësia kushtetuese realizohet nga ana e gjykatave të ndara nga sistemi i gjyqësorit të rregullt, ani se fillimisht ajo ka lindur dhe është zhvilluar në gjirin e gjyqësorit të rregullt si një aktivitet rutinor lidhur me interpretimin e kushtetutës me rastin e dhënies së drejtësisë

së zakonshme në çështjet penale, civile dhe administrative (Hasani, E., & Brahimi, M., 2021, f. 21).

Gjyqësia kushtetuese ndihmon në institucionalizimin e rendit demokratik, kufizimin e pushteteve shtetëror si dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, andaj edhe mision kryesor ka ta garantojë supremacinë dhe qëndrueshmërinë e Kushtetutës, të sigurojë ndarjen e pushteteve shtetërore dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë së të drejtave dhe lirive të njeriut (Sadushi, 2012).

Supremacia apo epërsia e kushtetutës është një nga premiset e ligjit, që së pari është vendosur nga kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve. Teorizuar nga Kelsen (1918), kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit arrihet përmes një organi juridiksional në sistemin amerikan dhe përmes një organi unik dhe të specializuar në atë evropian. Literatura specifike thekson se të dy modelet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve synojnë të njëjtin qëllim në kontekstin e rritjes së aktivitetit të juridiksionit kushtetues (Morosheș A.F., & Stoicu, N.M., 2017, f. 135).

Qëllimi i organeve kushtetuese është të sigurojnë epërsinë e Kushtetutës. Koncepti i epërsisë së Kushtetutës është kompleks, i përbërë nga elemente politike dhe juridike që pasqyrojnë pozicionin e mbikëqyrur të kushtetutës, si në sistemin ligjor ashtu edhe në atë politik dhe shoqërore të një shteti. Duke siguruar pozicionin garantues të epërsisë së kushtetutës dhe në kuadër të kompetencave të tyre në fuqi, Gjykatat Kushtetuese sigurojnë funksionimin e mekanizmit kushtetues të ndarjes së pushteteve shtetërore në shtetin e së drejtës.

Në analizën e tij mbi drejtësinë kushtetuese Mauro Cappelletti (Mario Kapeleti), drejtësinë kushtetuese e koncepton si “domosdoshmëri për kurorëzimin e shtetit të së drejtës” (Bajrami, A., & Shala, Xh., 2015). Epërsia e Kushtetutës përbën konceptin themelor të gjyqësisë kushtetuese por njëherit edhe parim kryesor për ekzistencën dhe funksionimin e shoqërisë demokratike e shtetit të së drejtës.

2. Historiku dhe zhvillimi i drejtësisë kushtetuese

Drejtësia kushtetuese është zhvilluar në disa etapa historike, duke filluar pas Luftës së Parë Botërore që përfshin themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Austrisë nga filozofi i së drejtës, Hans Kelzen duke vazhduar me Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë e cila sot

përbën model kryesor për Evropë, pastaj themelimi i Gjykatës Kushtetuese në Çekosllovakia, Spanjë, Rumani dhe Irlandë (Harutyunyan, 2009).

Duhet theksuar se kushtetuta austriake e vitit 1920 i solli dy risi të rëndësishme, e ndryshoi formën e qeverisjes dhe njëherit e transformoi Gjykatën Perandorake në Gjykatë Kushtetuese, si gjykatë e parë në Evropë e këtij lloji e specializuar në çështjet kushtetuese (Traja, 2000, f. 30). Roli i Kelzenit në krijimin e saj ishte i dukshëm dhe shumë domethënës sepse ishte hera e parë që Gjykata Kushtetuese kishte kompetenca për shfuqizimin e ligjeve e akteve nënligjore administrative që vlerësoheshin se nuk ishin në harmoni me kushtetutën. Njështu edhe vendimet e kësaj gjykate ishin të obligueshme për zbatim nga institucionet gjegjëse dhe nga të gjithë qytetarët e Austrisë (Traja, 2000, f. 30). Pra, modeli i centralizuar i kontrollit kushtetues ka lindur në Evropë pas Luftës së Parë Botërore, dhe është adoptuar fillimisht nga Austria dhe Çekosllovakia në vitin 1920, Lihtenshtajni në vitin 1921 dhe Spanja në vitin 1931.

Institucioni i themeluar sipas modelit austriak për kontroll kushtetues nuk funksionoi gjatë Luftës së Dytë Botërore, sa për ilustrim Austria nuk e ushtroi kontrollin kushtetues gjatë periudhës 1933-1945, po ashtu edhe Çekosllovakia veprroi njëllëj dhe nuk e ushtroi kontrollin kushtetues që nga viti 1938-1945 (Harutyunyan, 2009).

Kështu, etapa e dytë konsiderohet pas Luftës së Dytë Botërore, drejtësia kushtetuese në këtë fazë shtrihet në vendet perëndimore me një model të ngjashëm të ndarjes së gjyqësisë kushtetuese që praktikonte Austria, por dallonte në teknikat specifike të kontrollit. Praktikant nga kontrolli konkret u huazuan nga praktikant amerikane e zvicerane, kurse për kontrollin abstrakt praktikoheshin teknikat austriake, kurse kontrolli incidental praktikohesh sipas teknikës italiane (Traja, 2000, f. 32).

Kronologjikisht përballemi me etapën e tretë e cila ishte karakteristikë për ish-shtetet socialiste ku tre prej tyre themeluan Gjykatat Kushtetuese para se të binte sistemi socialist në Evropën Qendrore dhe në atë Jugore. Prej këtyre vendeve prinë Jugosllavia aty nga viti 1963, pastaj Çekosllovakia aty nga viti 1968 dhe Polonia nga viti 1982 (Traja, 2000, f. 34).

Për shkak të rirregullimit të skenës politike globale, tranzicionet post-sovjetike dhe post-komuniste evropiane morën një vëmendje të madhe ndërkombëtare, e cila u shtri edhe në gjykatat e reja kushtetuese. Për më tepër, kjo valë e madhe shkaktoj krijimin e një numëri shumë më të lartë të gjykatave kushtetuese sesa demokratizimi në Evropën Jugore

në vitet 1970. Gjykatat e reja u krijuan në mjedise shumë të ndryshme politike dhe historike (Sólyom, 2013, f. 137).

3. Modelet e gjyqësisë kushtetuese

Në varësi të sistemit të qeverisjes, shtetet kanë ndërtuar modele të ndryshme të ndarjes së drejtësisë kushtetuese, më të njohura janë dy të veçanta dhe një e përzier. Në shtetet e Evropës praktikohet modeli i centralizuar i kontrollit kushtetues, ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) aplikohet modeli difuz i kontrollit kushtetues (Morina, 2013, f. 33), por praktikat e gjyqësisë kushtetuese kanë krijuar një hipotezë se në botën juridike shpërfaqen dy e më tepër modele të drejtësisë kushtetuese, e para në kuadër të sistemit të drejtësisë kushtetuese amerikane dhe tjetra evropiane. Disa gjykata kushtetuese të vendeve të ndryshme të botës, e praktikojnë modelin e dy sistemeve që së bashku krijojnë një sistem të përzier. Edhe pse konsiderohen se funksionojnë dy modele të ndara, doktrinarët nuk arritën të gjejnë dallime radikale te këto sisteme.

Ndarja e tillë e modeleve të drejtësisë kushtetuese merret për bazë se kush prej organeve të drejtësisë e bën interpretimin e normës kushtetuese, a janë vetëm gjykatat e faktit dhe gjykatat e njësive federale p.sh. në Amerikë, po njashtu edhe Gjykata Supreme që kishte për t'u definuar si model amerikan, apo një Gjykatë e Specializuar siç është në vendet e Evropës, e që emërtohet si Gjykatë Kushtetuese e cila ekskluzivisht ka funksion mbrojtjen e kushtetutës së vendit, interpretimin përfundimtar të saj dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese (Morina, 2013, f. 42).

3.1. Modeli amerikan i gjyqësisë kushtetuese

Kur Thomas Jefferson u përurua si president i tretë i Shteteve të Bashkuara në 4 mars 1801, ai vuri në dukje se paraardhësi i tij John Adams kishte emëruar gjyqtarët e rrethit të Kolumbias, por ky emërim nuk ishte bërë efektiv, pasi presidenti i ri Jefferson udhëzoi sekretarin e tij të ri të shtetit, James Madison, që të mos i dorëzonte këto dokumente të emërimit, megjithëse ato mbanin nënshkrimin e ish-presidentit (Clinton, 1989). Për këtë, një nga gjyqtarët që nuk ishte emëruar, William Marbury u ankua në Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara. Sidoqoftë, më 24 shkurt 1803, Gjykata Supreme nuk e shqyrtoi

ankesën për shkak se e vlerësonte që nuk hynte në kuadër të kompetencës së saj. Megjithatë Akti Gjyqësor i vitit 1789 konstatoi se Gjykata Supreme ishte gjykata kompetente për raste të tilla, ky Akt gjyqësor që kishte formën e rregullores ligjore ishte në kundërshtim me kushtetutën, funksioni ekskluziv i së cilës ishte përcaktimi i kompetencave të Gjykatës Supreme, dhe për rrjedhojë nuk mund të zbatohet (Clinton, 1989).

Argumenti të cilin Gjykata Supreme e përdori në çështjen “Marbury kundër Madison” për ta nxjerrë vendimin e saj u bë i famshëm, sepse për herë të parë ishte parashtruar pyetja para Gjykatës Supreme se si të trajtohen ligjet në kundërshtim me kushtetutën (Olechowski, 2015).

Duke konstatuar pavlefshmërinë e ligjit kundërkushtetues, vendimi i marrë në rastin “Marbury kundër Madison” përgjithësisht etiketohet si origjina e modelit amerikan të drejtësisë kushtetuese.

Sigurisht, duhet të kemi parasysh se kjo origjinë ka një parahistori të gjatë, duke na rikthyer në Anglinë e shekullit të shtatëmbëdhjetë, kur në vitin 1766 një gjykatë e qarkut në Virxhinia kishte vendosur që një statut nuk e detyron popullin ta ybatojë nëse është kundërkushtetuese (Olechowski, 2015). Rëndësia e rastit “Marbury kundër Madison” është, sidoqoftë, që kësaj radhe ishte Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara që duhet të vendoste për rishikimin gjyqësor dhe që Gjykata Supreme gjeti një formulim për një parim, i cili ka mbetur praktikisht i pandryshuar deri në sot.

Modeli amerikan i rishikimit gjyqësor u akordon gjykatave amerikane një rol shumë të rëndësishëm politik, i cili së shpejti u bë temë diskutimi në Evropë.

Vetëm disa vende të tjera vendosën një lloj të ngjashëm të drejtësisë kushtetuese, megjithatë, njëra prej tyre ishte Norvegjia, ku Gjykata Supreme tashmë mori një vendim në sipas modelit amerikan në vitin 1814. Në Danimarkë parimi i rishikimit gjyqësor u njoh nga viti 1912, por gjykimi i parë që përfshin një vendim që kishte konstatuar se statuti i parlamentit danez ishte i pavlefshëm nuk u dorëzua deri në vitin 1999 (Olechowski, 2015). Më tej, Otto von Bismarck ishte një nga kundërshtarët e shumtë të shquar të rishikimit gjyqësor: në vitin 1863 gjatë krizës kushtetuese të Prusisë deklaroi se "e ardhmja politike e një vendi nuk duhet të varet në asnjë mënyrë nga një vendim i vetëm subjektiv i marrë nga një gjykatë" (Olechowski, 2015). Megjithatë, në fund të fundit, parimi i rishikimit gjyqësor u vendos në Gjermani. Gradualisht, duke filluar nga viti 1921, Gjykata Supreme për çështje

civile dhe penale, kishte vlerësuar se aktet kushtetuese kërkojnë që gjyqtarët t'i injorojnë statutet pasuese që janë në kundërshtim me aktet kushtetuese dhe ligjet.

3.2. Modeli evropian (austriak) i gjyqësisë kushtetuese

Në fushën e drejtësisë kushtetuese, një model i dytë i juridiksionit kushtetues që ishte i ndryshëm prej modelit paraprak, me origjinë më të vonë dhe që herë quhej “modeli evropian”, e herë si “modeli austriak” apo edhe si “modeli kelsenian” (Olechowski, 2015). Ky model i referohet Kushtetutës Federale Austriake të vitit 1920, që u zhvillua kryesisht nga Hans Kelsen, e cila parashikonte një juridiksion kushtetues të një natyre krejt të ndryshme nga modeli amerikan, me drejtësi kushtetuese të përqendruar vetëm në një gjykatë të vetme.

Nocioni i juridiksionit kushtetues, domethënë rishikimi i pajtueshmërisë së akteve juridike me Kushtetutën nga një gjykatë e veçantë, e specializuar, bazohet kryesisht në idenë që mosmarrëveshjet për interpretimin dhe zbatimin e kushtetutës nuk janë vetëm konflikte politike, por edhe juridike.

Studiuesi ligjor austriak Hans Kelsen, dikur deklaroi në shkrimet e tij se juridiksioni kushtetues është "mbrojtësi i vërtetë i kushtetutës". Rëndësia e saj është e madhe sepse sundimi i ligjit është përshkruar dikur drejtë në fjalën se: "Një kushtetutë pa një gjykatë kushtetuese e cila ka fuqinë të anulojë aktet e shtetit që janë antikushtetuese do të ishte e barabartë me një dritë që nuk ndriçon!" (Holzinger, 2016, fv. 64-65)

Sidoqoftë, është kundërshtuar që Kushtetuta Federale Austriake e 1 tetorit 1920 nuk është kushtetuta më e vjetër, pasi Kushtetuta e Çekosllovakisë e 29 shkurtit 1920 e kishte origjinën shtatë muaj më parë, dhe po ashtu kishte parashikuar një Gjykatë Kushtetuese, duke ndaluar që gjykatat e tjera që të ushtrojnë kompetencat e rishikimit gjyqësor (Olechowski, 2015). Dihet se shkolla e teorisë juridike e Kelsenit, “Teoria e Pastër e Ligjit”, kishte shumë adhurues në Çekosllovaki, veçanërisht në Brno, selia pasuese e Gjykatës Kushtetuese Çekosllovakiane. Por, rol thelbësor në krijimin e Gjykatës Kushtetuese në Çekosllovaki kishte Jiří Hoetzel, një kundërshtar i deklaruar i Kelsenit (Olechowski, 2015).

Këtu duhet përmendur tre gjeneratat e gjykatave kushtetuese evropiane që janë karakteristike sepse të gjitha u krijuan si rrjedhojë e ndryshimit të sistemit qeverisës, kështu (Sólyom, 2013, f. 135):

- Gjenerata e parë, përfshinë Gjykatat kushtetuese gjermane dhe italiane, të cilat u krijuan pas rënies së regjimeve fashiste, në fillim të viteve 1950;
- Gjenerata e dytë, përfshinë Gjykatat kushtetuese spanjolle dhe portugeze, që pasuan me rënien e regjimeve autoritare të Franco dhe Salazar në vitet 1970;
- Gjenerata e tretë, përfshinë Gjykatat kushtetuese në demokracitë post-sovjetike që u themeluan në vitet 1990, këtë herë shprehimisht si simbole të sistemit të ri, demokratik.

Tre gjeneratat e demokratizimit në Evropë nuk filluan të njerëzitet. Ndryshimi i regjimeve në shumë vende nuk ishte rezultat i një revolucioni të vërtetë, apo i trazirave popullore. Gjykatat e reja kushtetuese u krijuan nga mosbesimi i thellë për institucionet shumicë, të cilat vlerësoheshin si të keqpërdorura dhe të korruptuara në regjimet fashiste dhe komuniste, prandaj themelimi i gjykatave kushtetuese vlerësohej si institucione që përfaqësonin thelbin e ndryshimeve demokratike dhe gëzonin 'legjitimitet revolucionar' (Olechowski, 2015).

Gjykatat Kushtetuese të stilit evropian nuk janë një degë e gjyqësorit, por organe kushtetuese të veçanta, *sui generis*, me fuqi ekskluzive për të kryer rishikimin kushtetues të akteve legislative. Për më tepër, kontrolli kushtetues nuk është vetëm i centralizuar, por zakonisht merr formën e rishikimit abstrakt.

4. Karakteristikat e gjyqësisë kushtetuese

Karakteristikat e përbashkëta të gjyqësisë kushtetuese, pavarësisht nga sistemi, janë parimore dhe kompatible me mënyrën e krijimit të gjykatës, juridiksionin e saj dhe me procesin kushtetues. Emërimi i gjyqtarëve në shumicën e vendeve, bëhet nga institucionet shtetërore si parlamenti, qeveria dhe presidenti (Traja, 2000, f. 77).

Më tej, përderisa ekzistojnë dy modele të rishikimit kushtetues, amerikan dhe evropian, atëherë ekzistojnë edhe veçori për secilin nga këto modele.

Karakteristikat e mëposhtme e dallojnë modelin amerikan të drejtësisë kushtetuese (Harutyunyan, 2009, f. 3):

- Natyra gjithëpërfshirëse e kontrollit gjyqësor të akteve juridike;
- Kontrolli është i decentralizuar dhe kryhet nga secila gjykatë;

- Vendimi i gjykatës ka natyrë relative pasi vlenë vetëm për palët e çështjes;
- Ka efekt konkret pasi vepron *ex post*.

Kurse sa i përket modelit evropian si karakteristika veçuese janë:

- Përqëndrimi dhe
- Kontrolli abstrakt.

Përqëndrimi (Centralizimi) nënkupton që vetëm Gjykata Kushtetuese është e autorizuar të gjykojë që një ligj, statut, apo dekret është i kundërt me kushtetutën.

Karakteristika e dytë është kontrolli abstrakt që nënkupton se gjykata mund ta shqyrtojë një ligj, statut, dekret dhe nëse konstaton se është kundërkushtetues, e shpall si të pavlefshëm dhe kjo pavlefshmëri ka efekt të përgjithshëm apo *erga omnes* (Comella, 2004).

5. Parimet e përgjithshme të drejtësisë kushtetuese

Rregullat e përgjithshme të funksionimit të gjyqësisë kushtetuese gati se janë unike, në vendet me gjykatë të specializuar respektivisht me Gjykatë Kushtetuese dhe ligj të veçantë, konkretisht ligj për Gjykatën Kushtetuese.

Kërkesa, gjykimi dhe vendimi, janë parime përbërëse të procesit kushtetues si njëri prej tipareve apo karakteristikave të gjyqësisë kushtetuese, që hynë në domenin e Gjykatave Kushtetuese të merren me shpalljen e këtyre verdikteve (Traja, 2000, f. 93).

Vënia e Gjykatës Kushtetuese në lëvizje me anë të kërkesës, në disa vende të Evropës karakterizohet edhe si ankesë kushtetuese si p.sh në Republikën e Kroacisë, që ka të njëjtën peshë dhe karakter si akt material, të aktivizimit të Gjykatës Kushtetuese përmes subjekteve të parashikuara me Kushtetutë si organet shtetërore, individët, gjykatat e rregullta, respektivisht gjyqtari (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 163). Në bazë të praktikave gjyqësore në Gjykatat Kushtetuese kërkesave individuale, iu është kushtuar vëmendje e posaçme (Omari, L., & Anastasi, A., 2010, f. 45). Për atë se kjo është karakteristikë e shteteve ligjore dhe demokratike që nënkupton barazimin e vlerave në drejtësi. Kuptimi i saj është se ankesat kushtetuese parashtrohen duke supozuar se njëri prej autoriteteve shtetërore ka shkelur një apo disa të drejta kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është ajo që krijon barasvlerë mes individit dhe pushtetit të fuqishëm të njërit nga institucionet e shtetit.

Gjykimi apo çështjet kushtetuese në parim përfundojnë me një vendim, i cili është parim i përgjithshëm i gjykatave kushtetuese kur ndajnë gjyqësi kushtetuese. Zakonisht gjykimi bazohet në dokumente të formës së shkruar dhe gojarisht në seanca të hapura të cilat janë shumë të rralla dhe mbahen vetëm atëherë kur gjykata ka nevojë shtesë për t'u informuar për një rast që është në shqyrtim. Gjykata i fton palët në rrugë ligjore duke u bazuar në rregullore të brendshme të saj. Procesi është i hapur dhe transparent. Në rastet e kontrollit konkret, procesi zhvillohet njëloj si procesi civil, ku barrën e provës e ka pala, gjatë gjykimit të kërkesave individuale, gjykata nuk del jashtë asaj që është kërkuar nga individët në *ultra petita* apo *ultra vires* (Traja, 2000, f. 98).

Vendimi i gjykatave është parim universal se të gjitha Gjykatat Kushtetuese që ndajnë drejtësi kushtetuese japin përfundimin përmes vendimit, të cilat kanë emërtime të ndryshme p.sh. në ShBA quhen opinione, në Itali sentenca dhe kështu me radhë, por e veçanta e këtyre vendimeve është që janë të gjata dhe të argumentuara hollësisht, duke nënkuptuar vlerën e madhe të çështjeve që zgjidhin.

Procesi kushtetues është njëri nga parimet e rëndësishme të gjyqësisë kushtetuese por njëkohësisht është i ndarë në veprime dhe atë e shfuqizojnë ligjin, nëse ai është kundërkushtetues si parim i gjyqësisë kushtetuese në Evropë apo në sistemin amerikan që nuk e marrin parasysh ligjin apo nuk e zbatojnë fare.

Parim tjetër i rëndësishëm i gjyqësisë kushtetuese është *sigurimi i procesit të kushtetutshmërisë* dhe ruajtja e rendit kushtetues. Ky parim është përmbledhje e të gjitha veprimeve normative dhe atyre institucionale që konsistojnë në sigurimin për atë se çfarë përbën rregullsi dhe stabilitet kushtetues. Sipas Jutta Lumbach, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, koncepti i supermacisë së kushtetutës nënkupton bartjen e autoritetit më të lartë në sistemin juridik, tek akti i kushtetutës si akt fundamental (Kryeziu, 2022). Kushtetutshmëria në thelbin e vet përmban parimin e supermacionit (Azizi, A. et al., 2009, f. 125).

Më tej, koncepti i sigurisë juridike është njëri prej parimeve kryesore të gjyqësisë kushtetuese që është veçanërisht i rëndësishëm në rastin e hartimit të akteve normative, (ligjeve dhe akteve nënligjore në formë të rregulloreve, udhëzimeve administrative apo vendimeve) në një shtet të qeverisur nga e drejta (Morina, 2013, f. 16).

Parim tjetër i gjyqësisë kushtetuese është edhe *juridiksioni kushtetues* (Dedja, 2013) që përfshinë konfliktet kushtetuese të cilat korrespondojnë me (Traja, 2000, f. 90):

- a) shprehjen e vullnetit të popullit përmes demokracisë direkte ku përfshihet referendumi dhe llojet e tij, apo përmes demokracisë indirekte-përfaqësuese dhe verifikimin e mandateve, përfundimisht nga Gjykata Kushtetuese;
- b) parimi i konflikteve të pushteteve është njëri prej parimeve të juridiksionit kushtetues, që i atribuohet gjyqësisë kushtetuese, si arbitër neutral për zgjidhjen e konfliktit mes pushteteve;
- c) konflikti i cili lidhet me ndarjen e pushtetit në nivel qendror dhe atij lokal që në gjyqësinë kushtetuese e mbanë epitelin e ndarjes vertikale të pushtetit, vepron në të gjitha shtetet si në ato unitare dhe në ato federale. Gjykimet për të drejtat dhe liritë kushtetuese të njeriut hyjnë nën juridiksionin e gjyqësisë kushtetuese, në rastin e shkeljes së tyre.

Juridiksion i gjyqësisë kushtetuese janë *konfliktet e drejtësisë kushtetuese*, kur këtu flitet për drejtësi politike që lidhen me sanksione ndaj subjekteve politike dhe autoriteteve të shtetit, si p.sh. çregjistrimi i subjektit politik nga Gjykata kushtetuese nëse konsiderohet se ka program dhe akte të tjera me ngjyrë raciste, diskriminuese, etnike, gjuhësore, etj. dhe për autoritetin e shtetit si masë ndëshkuese nga Gjykata kushtetuese shkarkimi, imponimi i dorëheqjes, abrogimi apo tërheqja, për shembull në Austri mund të shtrohet çështja e përgjegjësisë penale në Gjykatën Kushtetuese e Presidentit, anëtarëve të qeverisë, njëherit këtë e parasheh edhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë e cila është merret si model i ndarjes së drejtësisë kushtetuese.

6. Doktrina e aktivizmit dhe vetëpërmbytjes gjyqësore

Aktivizmi dhe vetëpërmbytja gjyqësore janë mënyra të ndryshme të vështimit të kushtetutës dhe metoda që burojnë nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Doktrina e aktivizmit dhe vetëpërmbytjes gjyqësore janë politika jurisprudenciale, që të dërgojnë te termi qeverisje e gjyqtarëve. Vetë fakti se drejtësia kushtetuese është e pakontrolluar nga asnjë pushtet shtetëror, e që i nënshtrohet vetëm kushtetutës, të bënë të mendosh për frikën e shpërdorimit të pushtetit. Nga ky kontekst lindin shumë pyetje, si munden gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ta shfuqizojnë ligjin i cili është votuar nga përfaqësuesit legjitim të popullit, më pastaj duke nxjerrë rregulla dhe vendime detyrues të pranuar nga institucionet e shtetit (Traja, 2000, f. 122).

Në thelb, vetëpërmbytja gjyqësore është shprehje e vullnetit të gjyqtarit kushtetues, për të mos ndërhyrë në sferën e ligjvënësit i cili përfaqëson vullnetin e popullit (Traja, 2000, f. 123). Ndonëse gjyqtari kushtetues ka të drejtë të kontrollojë, të shfuqizojë, kur atij i sugjerohet nga subjektet politike parlamentare që mos ta shfuqizojë vetëm në rastet e domosdoshme. Ka raste të veçanta kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese krijojnë turbulencë te ushtrimi i pushtetit efektiv, këtu përmendim rastet në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me dy presidentë të saj kur është konsideruar se është shkelur kushtetuta gjatë mandatit të tyre, duke i detyruar të japin dorëheqje nga funksioni.

Vetëpërmbytja gjyqësore mund të shfaqet në shumë forma por më të njohura janë refuzimi për të gjykuar, interpretimi minimalist dhe interpretimi mazhoritarist. Refuzimi për të gjykuar korrespondon kur gjykata e shpallë veten jokompetente për rastin. Interpretimi minimalist për shumë arsye normat kushtetuese mund të interpretohen gjerësisht apo ngushtësisht, kjo varet ekskluzivisht nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese. Interpretimi mazhoritarist është qëndrim i gjykatave i përcaktuar nga vlerësimi dhe respekti i opinionit të shumicës. Kongresi mund të bëjë ligje të marra ashtu si dhe ligje të urta dhe nuk u takon gjykatave të deklarohen se cilat hyjnë në kategorinë e parë dhe as t'i rishkruajnë ato (Traja, 2000, f. 130).

Aktivizmi është shprehje e një interpretimi dinamik dhe e implikon më shumë çështjen e legjitimitetit të Gjykatave Kushtetuese. Aktivizmi më së shumti mundohet që ta ruajë frymën e kushtetutës së një vendi. Pozicionin më të qartë të aktivizmit e ka shprehur Xhon Marshall, i cili thoshte se “duhet konsultuar kushtetuta që është prapa kushtetutës” (Traja, 2000, f. 134).

Përmbledhje - Në këtë kapitull është trajtuar një vështrim i përgjithshëm i gjyqësisë kushtetuese, duke filluar nga përkufizimi teorik i drejtësisë kushtetuese, që është sinonim i gjyqësisë kushtetuese, e cila përfshin veprimet normative e institucionale në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së rendit kushtetues.

Funksion themelor i gjyqësisë kushtetuese konsiston në institucionalizimn e rendit demokratik, kufizimin e pushteteve shtetëror si dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe mision kryesor ka të sigurojë epërsinë e kushtetutës. Pasi, duke garantuar epërsinë e kushtetutës, Gjykatat Kushtetuese sigurojnë funksionimin e mekanizmit kushtetues të ndarjes së pushteteve shtetërore në shtetin e së drejtës.

Sa i përket historikut të gjyqësisë kushtetuese, ajo daton që nga koha antike greke dhe është zhvilluar nëpër tri etapa, ku dallohet etapa e tretë e cila përfshin edhe krijimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me status politik të një autonomie territoriale.

Njëherit janë sqaruar edhe modelet më të njohura të gjyqësisë kushtetuese siç është ai amerikan, evropian dhe modeli i përzier. Më tej janë sqaruar karakteristikat dhe parimet e përgjithshme të gjyqësisë kushtetuese që janë unike për vendet me gjykatë të specializuar respektivisht me Gjykatë Kushtetuese që është i sanksionuar me ligj të veçantë.

Krejt në fund është elaboruar edhe doktrina e aktivizmit dhe vetëpërmbajtjes gjyqësore të cilat janë politika jurisprudenciale, ku vetëpërmbajtja gjyqësore është shprehje e vullnetit të gjyqtarit kushtetues, për të mos ndërhyrë në sferën e ligjvënësit i cili përfaqëson vullnetin e popullit, ndërsa aktivizmi është shprehje e një interpretimi dinamik dhe e implikon më shumë çështjen e legjitimitetit të Gjykatave Kushtetuese. Aktivizmi më së shumti mundohet që ta ruajë frymën e kushtetutës së një vendi.

KAPITULLI II

SHTETI I SË DREJTËS NË REALCION ME GJYKATËN KUSHTETUESE

1. Historiku dhe evoluimi i shtetit të së drejtës

Ideja e shtetit të së drejtës i ka rrënjët e lashta në mendimin politik evropian. Ajo u shfaq si një rregull në ushtrimin e pushtetit politik të përmbajtur duke ia nënshtruar atë disa parimeve abstrakte, ku një "horizont i kuptimit të shtetit ligjor" u përpunua nga filozofët e lashtë grekë të cilët ishin të shqetësuar për potencialin e një qeverie demokratike për t'u degjeneruar në një tirani, si rrjedhojë e kësaj, ideja ishte vënë tashmë në praktikë në Athinë gjatë shekullit V para erës sonë ku magjistratët e polisit, komuniteti politik demokratik, mund të akuzoheshin për shkelje të ligjit nga qytetarët. Kështu, Platoni synonte që, kodi ligjor i përfshirë në veprën e tij "Shteti", të ishte i natyrës së përhershme dhe këmbëngulte që qeveria të ishte e detyruar t'i zbatonte këto ligje (Bono, 2010, f. 231).

Pra, teorinë e parë racionale për shtetin juridik e ka dhënë Platoni në veprën "Shteti", ku ndërtimin dhe rregullimin e shoqërisë, sundimin e së drejtës e shikonte në analogji me gjithësinë si botë të rregulluar. Platoni (2016) theksonte se kur në shtet mbretëron "drejtësia, urtësia, guximi dhe arsyeja e qytetarëve", atëherë ai bëhet i përsosur dhe i drejtë në aspektin politik (f. 24). Sipas tij, drejtësia, si virtyt i katërt i njeriut, pas urtësisë, guximit dhe maturisë apo arsyes është mjet që siguron harmoninë shpirtërore mes shtresave kryesore të shoqërisë.

Sundimi i së drejtës është përparësi absolute e ligjit në të gjitha veprimtaritë shtetërore e shoqërore (Pajaziti, 2009, f. 702).

Kurse Aristoteli te vepra e tij "Politika" (Tamanaha, 2004, f. 234), ngre shumicën e pyetjeve themelore që kanë shoqëruar diskutimet e historisë evropiane mbi idenë e shtetit të së drejtës, duke filluar me çështjen e vetëqeverisjes në situata të barazisë politike, të nënshtrimit të zyrtarëve qeveritarë ndaj ligjit dhe identifikimi i ligjeve në fuqi me qëllim që ta mbrojnë legjislacionin nga abuzimi nga ata që mbajnë pushtetin.

Në fund, "forma më e pjekur e shtetit të së drejtës e realizuar në Athinë ishte ajo që siguroi barazinë e qytetarëve para ligjit; parimi që ligjet duhet të hartohen në terma të përgjithshëm; që këshilli në Athinë, magjistratët dhe asamblëtë legjislative ishin të detyruar

t'i nënshtroheshin ligjit, dhe se qytetarët ishin të lirë të vepronin sipas ligjit, me kusht që veprimet e tyre të mos ishin të ndaluar me ligj" (Bono, 2010, f. 234).

Kurse, romakët sollën elemente pozitive e negative në idenë për shtetin e të drejtës, ku si element pozitiv ishte puna e Ciceronit, i cili vazhdoi traditën greke të Platonit dhe Aristotelit në kryeveprën "Mbi Shtetin" (Bono, 2010, f. 234), të botuar në shekullin I para erës sonë. Aty, Ciceroni komentoi se mbreti që nuk i përmbahet ligjit është një despot, "krijesa më e ndyrë dhe më e neveritshme që mund të imagjinohet" (Bono, 2010, f. 234). Sipas Ciceronit, statusi i ligjeve ndryshonte në varësi të përputhshmërisë së tyre me ligjin natyror. Ligji natyror ishte rregulli i arsyes, dhe sipas rregullit të arsyes, ligji duhet të jetë për të mirën e komunitetit, i drejtë, të ruajë lumturinë e sigurinë e qytetarëve. Kjo ide e së drejtës natyrore qëndronte mbi ligjin pozitiv dhe njerëzor, ishte një ligj që ishte në përputhje me drejtësinë, prandaj ishte suprem (Tamanaha, 2004, f. 11).

Për më tepër, si grekët, ashtu edhe romakët kishin rënë dakord se ekzistonte një ligj natyror që ishte më i lartë se ligjet njerëzore. Këto mendime u bartën dhe u zhvilluan më vonë nga studiuesit në mesjetë (Brzostek, 2018).

Nocioni i shtetit të së drejtës vazhdoi të pasurohej edhe në mesjetë. Burimet e kontributeve në konceptin mesjetar të shtetit të së drejtës janë: "kontesti për epërsi midis mbretërve dhe papëve, e drejta zakonore gjermane dhe *Magna Carta Libertatum*, kjo e fundit mishëronte përpjekjet e fisnikëve për të përdorur ligjin për të vendosur kufizime për sovranët" (Bono, 2010, f. 8).

Definimi i shtetit të së drejtës është zhvilluar nëpër periudha të caktuara ku juristi austriak Hans Kelsen këtë koncept me origjinë gjermane në fillim të shekullit XX e ka ripërkufizuar si "një shtet në të cilin normat juridike, janë të hierarkizuara në mënyrën që pushtetet e tij të jetë e kufizuar" (Kelsen, General theory of law and state, 2007, f. 31). Konkretisht Kelsen theksonte se "e drejta është rend i sjelljeve njerëzore, është sistem i rregullave apo tërësi e rregullave të cilat kanë ato lloj të bashkimit të cilën ne e kuptojmë si sistem, është e pamundur ta kuptojmë natyrën e së drejtës në qoftë se në vëmendjen tonë e kufizojmë vetëm në një rregull" (Kelsen, General theory of law and state, 2007, f. 31).

Sundimi i së drejtës bën pjesë ndër parimet dhe vlerat më fundamentale të demokracive moderne kushtetuese (Morina, 2013, f. 18). Shteti juridik apriori duhet kuptuar si shtet demokratik mirëpo jo çdo shtet juridik është edhe demokratik që nënkupton normat juridike nuk e bëjnë shtetin juridik.

Sot në literaturën juridike dhe politike përdoren dy terme, shteti juridik dhe shteti ligjor, të cilat shprehin lidhjen e shtetit me të drejtën (ShtetiWeb, 2021). Nga debati që zhvillohet mes termit shtet i së drejtës dhe shtet ligjor ka derivuar koncepti shtet juridik, që është i formësuar me norma juridike të cilat krijojnë rregull në shoqëri ku njëkohësisht rregullojnë një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore. Diskursi është te implementimi i këtyre ligjeve nëse shteti përmes pushtetit shtetëror i zbaton ligjet në praktikë, nuk lë zbrazëtira në jetën shoqërore e publike, rrjedhë si rezultat se kemi një shtet ligjor, andaj këto dy terme kanë kuptim të njëjtë.

Parimi i legalitetit paraqitet si rregull themelor i shtetit të së drejtës, garanci e bërthamës së lirisë së padhunueshme, pastaj parimi i përfaqësimit, ndarja e pushteteve shtetërore, barazia, karakterizojnë formën e shtetit juridik (Puto E. , 2008, f. 35).

Shteti i së drejtës mund të përmblihet sipas formulës, “askush nuk është mbi ligjin, është shumë i lidhur me respektimin e hierarkisë së normave juridike, ndarjen e pushteteve shtetërore, barazinë e subjekteve të së drejtës para normave juridike, juridiksionet e pavarura dhe garantimin e korpusit të të drejtave dhe lirive të njeriut” (Lee, 2000, f. 44).

Gjykata Kushtetuese e forcon shtetin dhe të drejtën, ku lidhmëria e shtetit juridik dhe Gjykatës Kushtetuese të dërgon në konkluzionin se Gjykata Kushtetuese përmes proceseve gjyqësore ndan drejtësi kushtetuese duke ia mundur shtetit të jetë sa më juridik në raport me të drejtat fundamentale të njeriut.

Gjykata Kushtetuese është garanci e rendit kushtetues juridik, përmes vendimeve që merr në bazë të kompetencave të garantuara me kushtetutë. Ajo kryen disa funksione të rëndësishme për shoqërinë dhe shtetin, por kryesore është që veprimtaria e shtetit t’i nënshtrohet epërsisë të së drejtës, duke kuptuar kështu jo vetëm ligjet dhe dispozitat e tjera normative, por në veçanti kushtetutën si bazë dhe kriter i legjitimitetit të gjithë rendit juridik. Si konkluzion del se arsyeja e ekzistencës së një Gjykate Kushtetuese është vendosja e një lloji shteti kushtetues të së drejtës (Omari, L., & Anastasi, A., 2010, f. 419).

2. Kuptimi formal dhe përmbajtësor i shtetit të së drejtës

Shumica e analizave identifikojnë dy kategori kryesore e dominuese të kuptimeve të shtetit të së drejtës, atë "formal" dhe përmbajtësor apo "thelbësor" me një sërë kuptimesh të tjera që në varësi të kërkesave të përmbajtjes, përfshijnë një vazhdimësi nga "kuptimi i ngushtë" në "kuptimin e gjerë".

Kuptimi formal i shtetit të së drejtës përbën version të avancuar, i cili i shtohet versionit minimalist¹ ku imponon kërkesa të rëndësishme procedurale mbi autoritetin e shtetit për të hartuar dhe administruar ligje të përgjithshme, që duhet të vlejë në të ardhmen dhe jo të kenë efekt retroaktiv, të jenë publike, të qarta dhe relativisht të qëndrueshme dhe se duhet të zbatohen nga gjykatat në mënyrë të pavarur dhe të drejtë. Ashtu si versioni minimalist, edhe ky version nuk imponon asnjë kufizim në përmbajtjen e ligjeve (Medecigo, 2016, fv. 11-15). Nga ky kuptim rezulton se nuk përcaktohet se me çfarë shumice të votave duhet miratuar ligji, dhe as se çfarë përmbajtje duhet të ketë. Kërkesat që një shtet duhet plotësuar për t'u konsideruar shtet i së drejtës janë gjyqësori i pavarur i përgjegjshëm para ligjit dhe jo para liderëve politik dhe një organ legjislativ i zgjedhur në mënyrë demokratike (Tunheim, 2021), çka në fakt ka lidhmëri me kuptimin formal.

Kuptimi përmbajtësor i shtetit të së drejtës shoqërohet me promovimin e mbrojtjen e të drejtave themelore, respektivisht një veprim i Qeverisë kategorizohet si në harmoni me "shtetin e së drejtës", ku ligjet në fuqi duhet të plotësojnë disa kërkesa minimale, këto janë, para së gjithash, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese (Roos, 2007).

Këto kuptime të shtetit të së drejtës, udhëhiqen nga parimi që synon parandalimin e ushtrimit arbitrar të kompetencave qeveritare (Andreopoulos G., Barberet R. & Nalla M., 2014, f. 3). Pra, Qeveria duhet të përmbahet nga abuzimi i pushtetit të vet që ndërlidhet me synimin të cilin e kanë të dy kuptimet e shtetit të së drejtës si dhe ligjet penale dhe civile duhet të jenë të artikuluar qartë, të jenë të kuptueshme dhe të detyrueshme për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, pa dallim kategorie, pushteti apo pozite dhe se duhet të respektohen të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i tyre (Allelo, 2021). Janë këto kërkesa që duhet t'i plotësojë një shtet si de jure ashtu edhe de facto në mënyrë që të konsiderohet shtet i së

¹ Versioni minimalist thjesht parashikon që shteti duhet të veprojë në përputhje me një ligj që është në fuqi pavarësisht nga cilësitë e tij procedurale dhe përmbajtësore. Me fjalë të tjera, shteti i ushtron kompetencat e përcaktuara nga ligji dhe nuk imponon kufizime në formën dhe administrimin e ligjeve e as në përmbajtjen e ligjeve. Kusht që të kemi shtet të së drejtës është që qeveria të veprojë në përputhje me ligjet që janë në fuqi, pavarësisht nëse ai ligj është i paqartë apo i padrejtë.

drejtës, kërkesa këto që në këtë rast vërejmë se asociojnë me kuptimin formal dhe përmbajtësor të shtetit të së drejtës.

Pra, ai duhet trajtuar si pushtet i cili kufizohet nga aktet juridike si kushtetuta dhe ligji, përmes së cilave vendoset shteti i së drejtës mbi bartësit e funksioneve shtetërore.

3. Evoluimi i konceptit të shtetit të së drejtës

Çdo përpjekje për ta sqaruar më shumë konceptin e shtetit të së drejtës përfiton nga një krahasim i shkurtër midis traditave të ndryshme juridike të cilat i kanë dhënë formë konceptit modern të shtetit të së drejtës, përkatësisht atij gjerman, francez dhe anglo-amerikan. Këto koncepte mbështesin të gjithë shtetin e së drejtës në kuptimin e ngushtë, por ndryshojnë dukshëm nga njëri-tjetri në adresimin e problemit të krijuar nga ngritja e shtetit modern: tensioni midis pushtetit të qeverisë dhe të drejtave individuale.

3.1. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit gjerman "Rechtsstaat"

Modeli gjerman i shtetit të së drejtës i njohur me emërtimin "Rechtsstaat", kishte zanafillën e tij në teorinë e Kantit, i cili parashikonte drejtpërdrejt një lloj simbioze midis ligjit dhe shtetit, ku ligji lidhej pazgjidhshmërisht me shtetin si i vetmi kanal legjitim përmes të cilit shteti mund të ushtrojë pushtetin shtetëror (Ferrioli, 2015, f. 96).

Një nga personat e parë që shpiku termin gjerman për "shtetin e së drejtës", d.m.th. "Rechtsstaat", ishte juristi dhe politologu gjerman Robert von Mohl. Vepra e tij më e njohur e titulluar "Shkenca e policisë sipas parimeve të shtetit kushtetues" (Die Polizeiwissenschaft nach den Grundsätzen des Rechtsstaats) (Roos, 2007, f. 3), bëri që ai ta përdorte i pari termin "Rechtsstaat" (shtet i së drejtës) ku në krahasim me shtetin aristokratik të policisë në të cilin pushteti ekzekutiv ishte i ngurtë dhe ushtronte kontroll shtypës mbi jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të popullsisë, shteti i së drejtës funksiononte dhe i nënshtrohej ligjit (Roos, 2007). Kështu, kuptimi tradicional gjerman i "Rechtsstaat" ishte gjithashtu një kuptim kryesisht formalist. Një shtet i së drejtës apo "Rechtsstaat" nuk ishte çdo lloj shteti siç e kemi parë, por një shtet që funksiononte në bazë të rregullave ligjore të konfiguruar në mënyra të veçanta (Krygier, 2015, f. 782).

Që një shtet të quhet "shtet i së drejtës" ose "Rechtsstaat", duhet të ekzistojnë disa elemente themelore, ndër to janë (Roos, 2007, f. 3):

- ndarja e pushteteve shtetërore;
- ligjshmëria e administratës;
- në veçanti parimi i sigurisë juridike dhe i unitetit, pjesë e së cilës janë, ndër të tjera parimi i besueshmërisë, ndalimi i efektit retroaktiv të akteve juridike, parimi i proporcionalitetit dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave e barazia para ligjit.

3.2. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit francez “Thé French État de droit”

Realisht, në kuptimin aktual në teorinë ligjore franceze “Etat de droit” nuk nënkupton "sundimi i shtetit përmes ligjit", por konsiderohet më shumë shtet kushtetues dhe garantues ligjor i të drejtave themelore (kundër shkeljeve që rrjedhin nga ligji i hartuar dhe miratuar nga parlamenti), ku ndryshe nga shteti i së drejtës sipas modelit gjerman ose “Rechtsstaat”, versioni francez nuk i referohet ligjit në tërësi, por të drejtave themelore që kanë forcën e ligjit (Ferrioli, 2015).

Ashtu si juristët gjermanë liberal, Carre de Malberg besonte se qëllimi kryesor i “Etat de droit” që në shqip nënkupton shtetin e të drejtës, ishte mbrojtja e të drejtave individuale kundër mundësisë së arbitraritetit nga shteti dhe për këtë qëllim shteti duhej të "vetë-kufizonte" pushtetin e tij sovran duke kërkuar të respektojë rregullat e vlefshme të cilat kishin një efekt të përgjithshëm, erga omnes (Bono, 2010). Sipas Carré de Malberg (2010) mbrojtja e të drejtave individuale kërkoj një rivlerësim të thellë të traditës kushtetuese franceze dhe revolucionit francez (f. 249). Siç e kishte parashikuar ai, shteti i të drejtës nuk mund të realizohej plotësisht deri në miratimin dhe aplikimin e rishikimit kushtetues të ligjeve parlamentare (një zhvillim që ndodhi në Francë në 1971 kur Gjykata Kushtetuese zhvlerësoi për herë të parë një ligj i cili cenonte një të drejtë të garantuar me Deklaratën për Drejtat e Njeriut të 1789), andaj referenca e Francës në “Etat de droit” si një kontroll mbi ligjet e nxjerra nga demokracia parlamentare është një zhvillim mahnitës në një kulturë të bindur prej kohësh se demokracia parlamentare do të shprehte më së miri vullnetin e kombit, por edhe do të mbronte të drejtat themelore të qytetarëve të saj (Ferrioli, 2015).

Republika e pestë franceze mbështeti dy idetë themelore të “Etat de droit” apo shtetit të së drejtës, përkatësisht (Bono, 2010):

- 1) rishikimi gjyqësor i ligjit nga Këshilli Kushtetues Francez, i cili ngriti statusin dhe rëndësinë e Kushtetutës dhe vendimmarrjen me bazë kushtetuese në jetën politike të kombit dhe
- 2) kufizimi i pushtetit ekzekutiv nga gjykatat në përputhje me standardet thelbësore kushtetuese.

3.3. Kuptimi i shtetit të së drejtës sipas modelit anglo-amerikan

Fillimisht, duhet theksuar se ndryshe prej Amerikës, Mbretëria e Bashkuar nuk ka një kushtetutë të shkruar dhe gjyqtarët e saj nuk kanë një mandat aq të qartë sa homologët e tyre amerikan për të siguruar një kontroll kundër pushtetit legjislativ. Sidoqoftë, tradita anglo-amerikane, duke iu referuar të drejtës zakonore, ka zhvilluar një ndjenjë të fortë të shtetit të së drejtës, përgjatë të cilit ky i fundit ka funksionon mbrojtës midis interesave të shtetit dhe atyre të shtetasve të tij, në vend që të varet ekskluzivisht nga shteti si i tillë (Ferrioli, 2015, f. 99).

Koncepti modern i shtetit të së drejtës është studiuar dhe popullarizuar si nocion nga juristi dhe studiuesi britanik i së drejtës kushtetuese, Albert Venn Dicey, përmes veprës së tij “Hyrje në studimin e ligjit kushtetues”, ku rrjedhë se intenca e konceptit të shtetit të së drejtës konsiston në faktin se ligjet duhet respektuar dhe zbatuar njëllë për të gjithë qytetarët përfshirë edhe autoritetet shtetërore, këta të fundit duhet t’i nënshtrohen ligjit pasi vetëm në këtë mënyrë kemi mirëfunksionim të shoqërisë dhe shtetit demokratik në tërësi (Dicey, A. V. & Wade, E. C. S., 1950, f. 194). Potencoj se mungesa e shtetit të së drejtës afekton edhe në drejtim të mungesës së shoqërisë demokratike.

Ajo çka duhet pasur parasysh është dallimi ndërmjet pranimi të shtetit të së drejtës si parim demokratik në aspektin teorik dhe në aspektin praktik zbatimin e tij nga institucionet. Në një shoqëri demokratike, shteti i të drejtës vendos kufizime në pushtetin e qeverisës në interes të të drejtave e lirive individuale dhe që kjo të jetë efektive ekziston nevoja për një gjyqësor të pavarur. Qytetarët i nënshtrohen shtetit të së drejtës ku pranojnë se sado në mënyrë indirekte, ata po i nënshtrohen vetes si hartues të ligjit. Kur ligjet

vendosen nga njerëzit që më pas duhet t'i binden, atëherë shteti i së drejtës dhe demokracia zbatohen.

Si përfundim, sipas kuptimit anglo-amerikan shteti i së drejtës përfshin tri parime, përkatësisht “parimin e supremacisë së ligjit, barazisë para ligjit dhe garantimi e mbrojtjes të të drejtave të njeriut”.

4. Shteti i së drejtës nga sfera ndërkombëtare

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përbën një nga traktatet më të suksesshme shumëpalëshe që inkurajon sistemet ligjore kombëtare që të sigurojnë mbrojtje të shtuar të drejtave të njeriut si dhe për të ndërmarrë hapat e parë për zbatimin kolektiv të disa të drejtave të garantuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ). Ndonëse Statuti dhe as KEDNJ nuk e elaborojnë konceptin e shtetit të së drejtës, ai konsiderohet një "parim" i lidhur ngushtë me demokracinë dhe të drejtat e njeriut të cilat rregullohen te këto dokumente themelore. Shteti i së drejtës ishte referencë sistematike e dokumenteve kryesore politike të Këshillit të Evropës, si dhe instrumenteve të shumta ligjore siç janë konventat, rekomandimet, etj (Ministers Deputies-Council of Europe , 2008, f. 2). Këshilli i Evropës ka ndërmarrë shumë iniciativa për të promovuar shtetin e së drejtës dhe në vitin 1990 themeloi “Komisionin e Venecias” (Bradley W. A., & Ewing D. K., 2007, f. 104).

Koncepti i "shtetit të së drejtës", së bashku me “demokracinë” e “të drejtat e njeriut”, përbën tri shtyllat e Këshillit të Evropës si dhe është miratuar në Preambulën e KEDNJ (Venice Commission, Report on the rule of law, 2011, f. 3). Neni 3 i Statutit të Këshillit të Evropës parashikon që “çdo shtet anëtar i Këshillit të Evropës duhet të pranojë parimet e shtetit të së drejtës e garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë personat brenda juridiksionit të tij”. Kërkesa që qeveria të udhëhiqet sipas ligjit (parimi i ligjshmërisë) përbën kusht për ekzistimin e shtetit të së drejtës por këmbëngulja vetëm për ligjshmërinë nuk siguron se pushtetet shtetërore janë në harmoni me vlera të tilla si liria dhe procesi i rregullt (Bradley W. A., & Ewing D. K., 2007, f. 99).

Garancia e shtetit të së drejtës përbën një nga kriteret e pranimit në Bashkimin Evropian (BE) të cilin kjo e fundit e përcaktoi në Këshillin Evropian të Kopenhagës në vitin

1993, ku specifikonte se pranimi do të ndodh atëherë kur një vend është në gjendje të përmbushë detyrimet e anëtarësimit përfshirë këtu kushtet ekonomike dhe politike të kërkuara këto të njohura si "Kritere të Kopenhagës" (Roos, 2007),

Ndërsa Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), respektivisht Sekretari i Përgjithshëm (2004) në raportin i tij, shtetin e së drejtës e përcakton si: “një parim të qeverisjes ku të gjithë personat, institucionet dhe subjektet publike dhe private, përfshirë vetë shtetin, janë përgjegjës ndaj ligjeve të shpallura publikisht, të cilat në mënyrë të barabartë zbatohen dhe janë në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” (United Nations-Security Council, f. 4). Ky koncept i shtetit të së drejtës përbën një ndër elementet esenciale të misionit të kësaj organizate. Ky përkufizim i shtetit të së drejtës nga OKB përmban kombinimin e elementeve të kuptimit formal dhe përmbajtësor të shtetit të së drejtës.

5. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut

5.1. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës përbën njërin nga shtetet e formura së fundmi në Evropën Juglindore e cila pasi e shpalli pavarësinë, aprovoi Kushtetutën në vitin 2008. Dispozitat themelore e përligjin dhe e afirmojnë sovranitetin e shtetit të ri, duke e trajtuar nga një këndvështrim bashkëkohor shtetin e Kosovës si shtet të së drejtës (Omari, 2004, f. 11). Kushtetuta e Republikës së Kosovës hynë në radhën e kushtetutave si akt themeltar i shtetit të ri, në këtë rast Republikës së Kosovës. Ajo është hartuar me parametrat demokratike, me të gjitha elementet e shtetit juridik duke i sanksionuar që nga dispozitat themelore e deri te institucionet e pavarura kushtetuese (Kryeziu, 2017, f. 113).

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shteti i së drejtës shfaqet prej konstruksionit të preambulës ku dominojnë katërçipërisht elementet esenciale të një shteti juridiko/ligjor, duke e trajtuar shtetin e Kosovës si “një vend i lirë demokratik dhe paqedashës, barazinë para ligjit, garancione të forta për të drejtat themelore të njeriut, barazinë e qytetarëve pa dallime kombi race gjinie dhe kulture”, e cila vazhdon me dispozita themelore nga neni 1-20, pastaj “korpori i të drejtave dhe lirive të njeriu” nga neni 21-56,

“të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”, që në mënyrë eksplicite e bën përgjegjës shtetin për krijimin e kushteve që t’i realizojnë të drejtat e tyre themelore pa pengesa të asnjë natyre, ky kapitull përfshinë nenet 57-62. Struktura e funksionimit të organeve të shtetit përcaktohet nga neni 63-111. Një kujdes të veçantë konstitucionalistët i kanë kushtuar Gjykatës Kushtetuese si institucion i pavarur e mbrojtës apo gardian i vet kushtetutës dhe të drejtave e lirive të njeriut nga nenet 112-118, kapitullin për qeverisjen lokale si parim i rëndësishëm i shtetit të së drejtës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka sanksionuar në nenet 123-124. Kështu, Luan Omari (2009), thekson se “Kushtetuta e Kosovës është një dokument bashkëkohor që plotëson parametrat e një shteti demokratik të së drejtës, e cila e zbërthen dhe konkretizon përmes neneve të saj gjithsej 162 dhe katërmëdhjetë (14) kapitujve” (f. 7).

5.2. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Shqipërisë

Detyra e parë dhe themelore e një populli qëndron në zgjedhjen e kushtetutës më të mirë që ekziston dhe që i përshtatet më mirë mjedisit. Sepse me zgjedhjen e drejtë të kushtetutës, populli vendos bazën për ruajtjen dhe përsosmërinë e tij (Gojar, S., & Fabr, R.S., 2010, fv. 27-29).

Edhe Republika demokratike e Shqipërisë hartoi dhe miratoi kushtetutën e vet që në përmbajtjen e saj sanksionon parimet esenciale të një shteti të së drejtës dhe atij kushtetues, në mesin e këtyre parimeve, përkufizon parimin e sigurisë juridike, parimin e barazisë, parimin e proporcionalitetit, parimin e shtetit social, lirinë ekonomike, të drejtën e pronës, parimin e vetëqeverisjes vendore dhe decentralizimin (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998). Siç e cekëm më lart, “parimi i shtetit të së drejtës është një nga elementet themelore të demokracisë si formë e qeverisjes, andaj garantimi përmes normave kushtetuese dhe akteve të tjera ligjore si dhe zbatimi i këtij parimi në jetën e përditshme janë kushte të domosdoshme për funksionimin dhe zhvillimin e një shoqërie të lirë, duke i garantuar të drejtat dhe liritë themelore me aktin më të lartë juridiko-politik” (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 17).

Në fakt shteti i së drejtës në Kushtetutën e Shqipërisë fillon prej preambulës si udhërrëfyese e kushtetutës së shkruar në frymën më demokratike duke e përmbledhur shtetin si një organizëm funksional me vlera njerëzore kombëtare dhe ndërkombëtare.

“Zotimi për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për t’i garantuar liritë dhe të drejtat themelore, tolerancën, bashkëjetesën fetare, që reflekton pastaj me një institucion specifik dhe të veçantë Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998). Neni 3 i Kushtetutës cakton bazën juridike të shtetit demokratik, pavarësinë e shtetit si vlerë të shprehjes së popullit, dinjitetin e njeriut si vlerë njerëzore, që shteti merr përsipër mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre vlerave, përmes akteve dhe mekanizmave institucional të tij. Ndërsa në neni 4 të Kushtetutës shprehet se “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”. Ka shumë dispozita të tjera kushtetuese që lidhen me parimin e shtetit të së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përveç të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet që përbëjnë thelbin e demokracisë në nenin 8 të saj paragrafi 1 “mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jetojnë jashtë kufirit të saj” dhe në paragrafin 2 se “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat themelore e shtetaseve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet”. Si konkluzion i kësaj dispozite krijohet bindja që reflekton frymën tepër pozitive që përveç garancionit kushtetues për të drejtat e qytetarëve të vet, del jashtë kornizës shtetërore për mbrojtjen e të drejtave e lirive kombëtare, që me këtë shquhet njëra prej kushtetutave të avancuara që sanksionon elementet fundamentale të një shteti të së drejtës dhe të një shteti ligjor. Sfidë të madhe përbën zbatimi i elementeve të shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë.

5.3. Përkufizimi i shtetit të së drejtës sipas Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut

Disa koncepte kyçe të rendit juridik janë të shpërfaqura qysh nga Roma e lashtë, si “për të jetuar ndershëm, të mos i bëhet dëm askujt, t’i jepet gjithkujt ajo që i takon” (Gojar, S., & Fabr, R.S., 2010, f. 58). Në këtë frymë edhe qytetarët maqedonë dhe shqiptarë, përmes përfaqësuesve të vet, pas shpalljes së pavarësisë nga Jugosllavia si shtet i ri sovran dhe i pavarur miratoi Kushtetutën demokratike në vitin 1991 me ndryshimet e vitit 2001, e cila u bazua në fundamentin e krijimit të një shteti ligjor me komponentë apo me elemente të shtetit juridik. Në këtë korrelacion të forcave politike dhe të interesave gjeostrategjike

derivoi me kërkesën e kohës që Maqedonia të konsolidohet si shtet juridik, pasi ishte përcjellë me ngjarje e sfida politike përafërsisht si të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë.

Me shtetin juridik nënkuptojmë kufizimin e pushteteve shtetërore që bëhet përmes normave kushtetuese e ligjore, ndërsa qëllimi konsiston në “afirmimin e sigurisë juridike të njerëzve dhe barazinë e tyre para ligjit, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre nëpërmjet gjykatave të pavarura e të paanshme” (Maksuti, 2010, f. 132).

Në fakt, qëllimi i shtetit juridik konsiderohet krijimi i sigurisë juridike të qytetarëve para ligjit, duke i garantuar dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Sipas Hans Kelzen, në hapësirën territoriale të një shteti ekziston një rend i vetëm juridik, legjitim dhe sovran, ai i shtetit. Të gjitha normat e shtetit burojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shteti dhe ato janë të vlefshme vetëm kur inkuadrohen në rendin e tij juridik, duke respektuar rreptësishtë synimet e tij. Shteti konsiderohet se është në tërësi rendi juridik që ka norma juridike me fuqi më të lartë (Kelsen, General theory of law and state, 2007).

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut si kushtetutë demokratike dhe liberale përbëhet nga nëntë pjesë duke filluar prej dispozitave themelore të cilat në total janë tetë (8) nene, një hapësirë të madhe i kushton lirive dhe të drejtave themelore të njeriut prej nenit 9-60, pjesa e tretë i kushtohet organizimit të pushtetit shtetëror nga neni 61-107, pjesa e katërt i kushtohet Gjykatës Kushtetuese një prej institucioneve më respektabile të shtetit e cila me veprimet e saj dhe vendimet e saj jep impuls forcimit të shtetit dhe të së drejtës duke u bazuar në fuqinë juridike dhe politike të kushtetutës që nga neni 108-113, në pjesën e pestë përcaktohen parimet themelore të vetë administrimit lokal dhe format e njësive të administrimit lokal neni 114-117 (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991).

Bazuar te struktura dhe përmbajtja e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, vërejmë që nga dispozitat themelore janë sanksionuar elementet themelore të shtetit juridik, siç është “respektimi i parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, ndarja e pushteteve të balancuar politikisht, gjykatat e pavarura, administratat e depolitizuar, si dhe respektimi i shoqërisë civile” (Maksuti, 2010, fv. 133-134).

6. Roli i Gjykatës Kushtetuese në përforcimin e shtetit të së drejtës

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese te shtetet demokratike mbanë barrën e kontrollit të gjerë të pushteteve shtetërore dhe mbron fuqishëm të drejtat dhe liritë e individit (Duhamel, 2004, f. 38).

Gjykata Kushtetuese hynë në kuadër të trinomit të postulatave që përbëjnë demokracinë e vërtetë të një shteti e përcjellë me zgjedhjet e lira demokratike dhe me pushtetet shtetërore të ndara. Parimi i sundimit të së drejtës korrespondon me pavarësinë dhe paanshmërinë në vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese të vendeve demokratike, duke qenë të njohur se shteti ligjor përfshinë në vete, tërësinë e parimeve juridike, politike me të cilën sigurohet sundimi i ligjit në shoqëri. Si parantezë e kësaj sundimi i ligjit përfshinë edhe kontrollin e tij nga një institucion i koncentruar e që është gjykata e cila ndanë drejtësi kushtetuese. Së këndejmi sundimi i ligjit nënkupton epërsinë e ligjit në raport me vetë shtetin dhe qytetarët. Si rrjedhojë Gjykata Kushtetuese ka rol dominant në forcimin dhe konsolidimin e një shtetit juridik/ligjor.

Format e organizmit të gjykatave evropiane janë të bazuara në disa parime bazë të konstitucionalizmit juridik, pa marrë parasysh trajtat e qeverisjes, organizimi është bërë në bazë të parimeve të përgjithshme, me elemente të koncentruar të ndarjes së drejtësisë kushtetuese.

Hartimi i një legjislacioni të avancuar në përputhje me parametrat e legjislacionit evropian dhe miratimi i ligjeve në organet përfaqësuese që janë në harmoni me kushtetutën krijojnë stabilitet të rendit kushtetues që është bazament për konsolidimin e shtetit kushtetues. Filozofia kelsiane, potencon se “Gjykata Kushtetuese është ligjvënës negativ, ajo nuk mund të zëvendësojë organin ligjvënës, kontrolli i saj përqendrohet vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit” (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 24).

Roli i Gjykatës Kushtetuese në konsolidimin e shtetit kushtetues varet nga kontrolli që bartë ajo ndaj pushteteve shtetërore për t’i balancuar ato në vendimmarrje, për legjislativin kontrollin e ligjeve nëse janë në harmoni me kushtetutën, pastaj kontrollin e vendimeve të nxjerra nga autoritetet ekzekutive si p.sh. dekretet që do duhej të ishin në harmoni me kushtetutën dhe te pushteti gjyqësor kontrollin e vendimeve gjyqësore duke mos lejuar të shkelen procedurat gjyqësore e të drejtat fundamentale të njeriut që garantohen me kushtetutë.

Sa i përket ndarjes së pushteteve shtetërore, shteti i së drejtës realizohet duke pasur kujdes që të reduktohen konfliktet ndërmjet pushtetit gjyqësor, ekzekutiv dhe legjislativ. Kjo korrespondon me ndarjen sipas Lokut të pushtetit në legjislativ, ekzekutiv dhe "federativ", ndërsa Monteskej mbron ndarjen dhe balancimin e pushteteve shtetërore midis tre krahëve si mjet të garantimit të lirisë së individit (Olatunji, 2013, f. 73).

Për ndarjen e pushteteve shtetërore dhe nocionin e ndarjes së tyre, së pari shkroi filozofi grek Aristoteli në librin e tij "Politika" duke theksuar shkurtimisht se "në të gjithë qeverisjen ka tre pushtete themelore, i pari është ai që trajton çështjet e shtetit, i dyti është pushteti me të cilin ka nevojë të veprojë shteti, ekzekutivi, ndërsa i treti përfshinë pushtetin gjyqësor" (Zaganjori, 2002, f. 97). Në teorinë e praktikën kushtetuese të shteteve demokratike, teoria e ndarjes së pushteteve e Monteskeit do të kishte pozicion qendror (Montesquieu, 2000, f. 98).

Sa i përket sigurisë juridike është njëri prej elementeve më esenciale të shtetit dhe së drejtës që ngërthen "saktësinë, qartësinë e qëndrueshmërinë në tërësi të rendit juridik të një shteti" (Zagonjari, XH. et al., 2011). Gjykata kushtetuese herë pas here trajton edhe sigurinë juridike, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e garantuara me ligjet ekzistuese. Kushtetutat e vendeve iu mundësojnë individëve edhe një mekanizëm ligjor me shumë vlerë për mbrojtjen e kësaj të drejte themelore, që është kërkesa pranë Gjykatës kushtetuese.

7. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimi i saj në krijimin e praktikës gjyqësore

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) me seli në Strasburg bazën themeltare e ka në Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Borchardt, 2011).

Roli i kësaj gjykate në krijimin e praktikave gjyqësore është shumëdimensional, sidomos në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në rangun ndërkombëtar, njëkohësisht ka forcuar rendin kushtetues duke i korrigjuar e kontrolluar Gjykatat Kushtetuese të shteteve evropiane të cilat janë pjesë e saj përmes anëtarëve gjyqtarë të zgjedhur për ndarjen e drejtësisë kushtetuese në këtë gjykatë. Misioni i saj qëndron në zbatimin e Konventës për të siguruar se shtetet i respektojnë të drejtat e garantitë e

përcaktuar në konventë (Morina, 2013, f. 48). Gjykata e Strasburgut ka krijuar standard juridik evropian dhe është njëri prej produkteve më masive të jurisprudencës gjyqësore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008) brenda dispozitave të saj te neni 22 i pranon si pjesë të rendit juridik të shtetit të Kosovës nëntë konventa të cilat për bazë kanë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndërsa te neni 19, ka sanksionuar se këto konventa gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi, në rast të konfliktit me ndonjë prej dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Njëra prej akteve ndërkombëtare më të rëndësishme është KEDNJ (Idrizi, 2017), në bazë të së cilës është themeluar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Strasburgut. Gjykata cilësohet mjet përfundimtar për ndalimin e shkeljes dhe rivendosjen në vend të të drejtave të individit të dëmtuar, kjo duke e ditur se fushëveprimtaria kryesore e kësaj gjykate qëndron në mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe angazhimin e shteteve për reformimin dhe përmirësimin e sistemeve juridike të brendëshme. Jurisprudenca e GJEDNJ duhet të njihet dhe aplikohet nga shtetet anëtare në sistemet e brendshme kombëtare.

Fillimisht, sistemi i zbatimit i vendosur në KEDNJ përbëhej nga një Komision Evropian i të Drejtave të Njeriut dhe, në një fazë të mëvonshme, gjithashtu një Gjykatë për të Drejtat e Njeriut, i cili ishte subjekt i opsioneve vullnetare nga shtetet. Tani, për shkak të Protokollit të Njëmbëdhjetë të 1 nëntorit 1998, i cili bashkoi Komisionin Evropian të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut bëhet mekanizmi i vetëm i zbatimit i parashikuar nga Konventa. Kjo ka bërë që aplikantëve individual t'u jepet e drejta e veprimit para Gjykatës (Drzemczewski, 1999). Ratifikimi i konventës automatikisht nënkupton pranimin e përhershëm të juridiksionit të kësaj Gjykate, andaj palët në një çështje duhet të respektojnë vendimet e gjykatës e të ndërmarrin masat e nevojshme për t'iu përmbajtur atyre. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës mund t'u kërkojë palëve të japin shpjegime mbi mënyrën në të cilën ligji i tyre i brendshëm siguron zbatimin efektiv të konventës.

Përmbledhje: Në këtë kapitull është trajtuar lindja dhe evoluimi i shtetit të së drejtës që nga Athina e lashtë e ku fillimisht ky nocion është përpunuar nga filozofët e lashtë grekë. Duke vazhduar kështu me Platonin, i cili dha teorinë e parë racionale sa i përket shtetit juridik në veprën “Shteti”, ku ndërtimin e rregullimin e shoqërisë, sundimin e së drejtës i

shikonte në analogji me gjithësinë si botë të renditur e të rregulluar, ndërsa Aristoteli në veprën e tij “Politika”, ngre shumicën e pyetjeve themelore që kanë shoqëruar diskutimet e historisë evropiane mbi idenë e shtetit të së drejtës.

Traditën greke të Platonit dhe Aristotelit “Mbi Shtetin”, e vazhdoi Ciceroni me kryeveprën e tij e botuar në shekullin e parë para erës sonë. Më tej, është sqaruar edhe kuptimi formal i cili lidhet me veçoritë e hartimit e administrimit të legjislacionit dhe kuptimi përmbajtësor i shtetit të së drejtës që lidhet me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Po ashtu është trajtuar edhe koncepti modern i shtetit të së drejtës, në bazë të modelit gjerman, francez e anglo-amerikan, dhe njëherit është elaboruar edhe në sferën ndërkombëtare.

Në përfundim, është sqaruar shteti i së drejtës i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke filluar prej preambulës dhe duke vazhduar edhe në dispozitat themelore si vlerë kushtetuese e këtyre shteteve e deri te institucionet kushtetuese. Në veçanti është trajtuar edhe funksioni dominant i Gjykatës Kushtetuese në ndërtimin e forcimit të shtetit të së drejtës. Përveç rolit që ka Gjykata Kushtetuese është trajtuar edhe roli i GJEDNJ në drejtim të krijimit të praktikave gjyqësore është shumëdimensional, sidomos në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, e cila njëkohësisht ka forcuar rendin kushtetues duke i korrigjuar dhe kontrolluar Gjykatat Kushtetuese të shteteve evropiane të cilat janë pjesë e saj përmes anëtarëve gjyqtarë të zgjedhur për ndarjen e drejtësisë kushtetuese në këtë gjykatë.

KAPITULLI III

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS NË NJË VËSHTRIM HISTORIKO-EVOLUTIV DHE NDIKIMI I SAJ NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS

1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese në Kosovë

Duke vështuar ecurinë e konstitucionalizmit në Kosovë në kontekstin historik, dallojmë një zhvillim të ngadalshëm dhe ndryshim përmbajtësor në momentin e ndryshimeve revolucionare të regjimit politik, dhe arritjes së një ndryshimi demokratik të vendit.

Në përgjithësi, pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë është vërejtur krijimi i Gjykatave Kushtetuese te vendet ish-socialiste. Me përfundimin e një diktature, bëhej ristrukturimi i organeve dhe shtetet e tilla krijonin një gjykatë kushtetuese. Për këto kombe ish-socialiste, një organ juridik i përkushtuar ndaj kontrollit kushtetues konsiderohej një element përbërës i demokracisë. Megjithatë ideja e krijimit të një gjykate kushtetuese si organ shtetëror nuk është e re për kombet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Disa kushtetuta socialiste parashikuan historikisht një gjykatë kushtetuese, siç është Kushtetuta Jugosllave e vitit 1963 dhe Kushtetuta Çeke dhe Sllovake e vitit 1965, por në Jugosllavi, megjithatë, gjykata nuk arriti të fitonte ndikim të madh brenda strukturave ligjore kurse në Çekosllovaki, gjykata nuk u është krijuar kurrë (Hartwig, 1992, pp. 451-452).

Megjithatë në Jugosllavinë komuniste, ku rishikimi gjyqësor kushtetues është paraqitur në vitin 1963, Gjykatat Kushtetuese funksionuan në të dy nivelet federale dhe republike dhe ushtruan juridiksionin e tyre në mënyrë aktive dhe me angazhimin e mbështetjen e plotë të Partisë Komuniste (Ligji Kushtetues i KSAK, 1969). Në këtë drejtim, referuar rastit të Kosovës kur kishte statusin e njësisë federale në ish-Federatën Jugosllave, ka aplikuar “kontrollin e kushtetutshmërisë përmes Gjykatës Kushtetuese, edhe pse gjykata e parë kushtetuese në Jugosllavinë Federale ishte themeluar në vitin 1963, por si rezultat i pozitës politiko-shoqërore në Kosovë në vitin 1969 fillon zbatimi i kontrollit të kushtetutshmërisë” (Historiku-GJKRK, n.d.). Kjo pasi me Kushtetutën Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) dhe atë të Republikës së Serbisë u cenuan të drejtat

originere të Kosovës në ligjvënien e saj, në pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor dhe Kosova në këtë periudhë të pozitës së saj kushtetuese juridike ishte kategori Republikane e jo Federative (Susuri, 2019, f. 43), respektivisht ishte shndërruar pozita e subjektit federativ në atë të subjektit në kuadër të Republikës së Serbisë.

Baza kushtetuese-juridike për trajtimin më adekuat të Kosovës në kuadër të ish-Federatës Jugosllave ishte përcaktuar me amendamentet kushtetuese të vitit 1968, 1971 dhe 1972 në Kushtetutën e RSFJ të vitit 1963, ku ndryshimi kryesor qëndronte te rikthimi i atributit “konsitutiv” sipas të cilit Kosova (sikurse edhe Vojvodina), përsëri caktohej si pjesë konstituive e strukturës federative të ish-Jugosllavisë (Bajrami, 2011).

Dega e Posaçme Kushtetuese-Gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë në Kosovë ishte konsituar me “Ligjin Kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK)” të vitit 1969 (Historiku-GJKRK, n.d.). Ndryshimet kushtetuese të vitit 1971 gjithnjë e më tepër në mënyrë konstitucionale e kanë forcuar pozita e krahinave autonome, të KSAK në ato vite (Susuri, 2019, f. 154). Duhet potencuar se u bë zgjerimi i funksioneve legjislative të Krahinës andaj në vitin 1972 themelohet Gjykata Kushtetuese e Kosovës, si “organ i pavarur për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, me funksion dhe pozitë identike me ato të gjykatave kushtetuese në republikat e Federatës Jugosllave” (Historiku-GJKRK, n.d.).

Edhe në Kushtetutën e Kaçanikut të vitit 1990, ishte sanksionuar institucioni i Gjykatës Kushtetuese me funksion të njëjtë të garantimit dhe mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë, por asnjëherë nuk është konstituar si rrjedhojë e suprimimit të autonomisë së Kosovës. Vendosja e Kosovës nën administrimin e OKB pas luftës së vitit 1999 bëri që edhe me “Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (KKVVK)” të 15 majit 2001, të parashikohej themelimi i të ashtuquajturit “Kolegj i Veçantë i Gjykatës Supreme mbi Çështjet e Kornizës Kushtetuese” (United Nation-Mission in Kosovo, 2001). Pra, në këtë rast nuk ishte konstitucionalizuar Gjykata Kushtetuese si organ i kontrollit të kushtetutshmërisë, por në vend të saj ishte institucionalizuar Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe se ky institucion nuk është themeluar dhe nuk ka funksionuar gjatë periudhës së Kosovës me sistem politik nën administrimin e përkohshëm të OKB, pasi edhe në aspektin juridik të funksionimit të këtij institucioni kishte zbrazëtira të theksuara, që e kanë pamundësuar themelimin e funksionimit të tij.

1.1. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës së Lartë të Kosovës – Dega e Posaçme Kushtetuese-Gjyqësore nga viti 1969

Në nenin 1 të Ligjit Kushtetues të KSAK të vitit 1969, përcaktohej se “Krahina Socialiste Autonome e Kosovës ishte pjesë e Republikës Socialiste të Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë” (Ligji Kushtetues i KSAK, 1969). Më tej, ky ligj sanksiononte se mbrojtja e konstitucionalizmit dhe ligjshmërisë në KSAK ishte kompetencë e Gjykatës së Lartë të Kosovës, e cila siguronte përputhshmërinë e ligjeve krahinore me ligjin kushtetues dhe përputhshmërinë e dispozitave të tjera krahinore me ligjin kushtetues dhe ligjet krahinore (Ligji Kushtetues i KSAK, 1969).

Kuvendi i KSAK dhe Këshilli Ekzekutiv Krahinor mund të fillonin procedurën para Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Serbisë për të vlerësuar konstitucionalizmin dhe ligjshmërinë, këtë të drejtë po ashtu e gëzonte edhe Gjykata e Lartë e Kosovës gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, kjo pasi Kosova në atë kohë kishte statusin e krahinës në nivel të Republikës të Serbisë dhe asaj të Jugosllavisë (Ligji Kushtetues i KSAK, 1969).²

Gjykata e Lartë e Kosovës në Degën e Posaçme Kushtetuese-Gjyqësore referuar nenit 147 të Ligjit Kushtetues të KSAK kishte këto kompetenca: të vendoste mbi përputhshmërinë e ligjeve krahinore me Ligjin Kushtetues të Krahinës Autonome, përputhshmërinë e dispozitave të tjera krahinore, dispozitave komunale dhe akteve të përgjithshme të organizatave punonjëse dhe organizatave të tjera vetëqeverisëse me ligjin kushtetues dhe ligjin krahinor dhe i përcillte me interes dukuritë për realizimin e konstitucionalizmit dhe ligjshmërisë dhe në bazë të kësaj i jep Kuvendit Krahinor mendime dhe propozime për nxjerrjen e ligjeve krahinore dhe për marrjen e masave përkatëse.

Më tej, neni 148 i Ligjit Kushtetues të KSAK përcaktonte se palët e autorizuara të cilat mund të referonin çështje në këtë gjykatë ishin: Kuvendi Krahinor, Këshilli Ekzekutiv Krahinor, Gjykata e Lartë e Kosovës nëse çështja e konstitucionalizmit dhe ligjshmërisë shfaqet në procedurë para gjykatave të tjera, kuvendi i komunës, organizata punonjëse ose organizatat e tjera vetëqeverisëse, prokurori publik krahinor, dega e posaçme kushtetuese-gjyqësore *ex-officio* (Ligji Kushtetues i KSAK, 1969). Ndërsa me ligjin krahinor përcaktoheshin

² Neni 78.

edhe organet shtetërore të tjera, organizatat dhe qytetarët dhe kushtet të cilat duhej t'i përmbushnin që të inicionin rast në këtë degë.

Sipas nenit 151 të Ligjit Kushtetues të KSAK, dega e posaçme kushtetuese në përbërjen e saj kishte gjithsej pesë (5) gjyqtarë, respektivisht kryetari dhe katër (4) gjyqtarë me mandat tetëvjeçar dhe me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.

1.2. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës Kushtetuese sipas Kushtetutës të KSAK të vitit 1974

Në Kushtetutën e KSAK të vitit 1974, Kosova vazhdonte të mbante statusin e krahinës socialiste autonome në kuadër të RSFJ dhe të Republikës Socialiste të Serbisë (Kushtetuta e KSAK, 1974).³

Referuar nenit 222 të Kushtetutës së KSAK, “bartëse për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ishte Gjykata Kushtetuese e Kosovës”, me këtë ndryshon organizimi i organit i cili do të mbronte kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, pasi me kushtetutën paraprake ky organ ishte në kuadër të Gjykatës së Lartë respektivisht ishte degë e posaçme kushtetuese gjyqësore ndërsa në vitin 1974 ky funksion i është atribuuar ekskluzivisht organit që u quajt Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Palë të autorizuar për të iniciuar vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë sipas nenit 382 ishin: Kuvendi i KSAK dhe kuvendi i komunës, kryesia e KSAK, Këshilli ekzekutiv i Kuvendit të KSAK, etj si dhe këtu duhet përmendur edhe Gjykatën Kushtetuese ex officio.

Kushtetuta e KSAK në nenin 378 sanksiononte përbërjen e kësaj gjykate, e cila kishte kryetarin dhe gjashtë (6) gjyqtarë që zgjedheshin nga Kuvendi i KSAK me mandat tetëvjeçar dhe pa të drejtë të rizgjedhjes.

Kështu bazuar në elaborimin e mësipërm të dispozitave kushtetuese të KSAK të vitit 1974 konstatoj që ka dallime të dukshme sa i përket organizimit, kompetencave dhe palëve të autorizuara të cilat ishin zgjeruar për dallim nga Ligji Kushtetues i KSAK i vitit 1969. Kështu, Gjykata Kushtetuese e KSAK ishte pavarësuar plotësisht në fazën e Kushtetutës të KSAK të vitit 1974 dhe u barazua me Gjykatat Kushtetuese të Republikave të tjera Socialiste e edhe me atë të Republikës të Serbisë që vendoste jashtë saj në pavarësimin e plotë të

³ Neni 2

Gjykatës Kushtetuese të KSAK nga elementi i Republikës të Serbisë e që e përfaqësonte autoritetin e vetëm dhe të pavarur në KSAK si gjyqësi kushtetuese ekskluzive e KSAK si njësi dhe element konstitutiv i ish-RSFJ-së.

1.3. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjyqit Kushtetues në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (RK) e vitit 1990 solli transformime te statusi i Kosovës pasi tani kjo e fundit ishte shtet demokratik dhe anëtare e Bashkësisë së Jugosllavisë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 1990).⁴ Pra, Kosova më nuk ishte krahinë por ishte shtet demokratik i pavarur.

Sa i përket kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, sipas nenit 17 të Kushtetutës ajo mbrohej nga Gjyqi Kushtetues i Kosovës.

Neni 131 i Kushtetutës të RK i vitit 1990 i referohej palëve të autorizuara që mund të inicionin vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, e cila mund të iniciohej nga secili, por këtë procedurë mund ta inicionin edhe organet shtetërore dhe Gjyqi Kushtetues kishte mundësi *ex officio* ta fillonte procedurën.

Ndërsa, sa i përket organizimit neni 129 i Kushtetutës të RK të vitit 1990 përcaktonte se Gjyqi Kushtetues përbëhej nga shtatë gjyqtarë me mandat tetëvjeçarë dhe të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.

Vlen të veçohet se dispozitat e kësaj kushtetute në këtë periudhë ishin gati kopje e dispozitave të Kushtetutës së KSAK të vitit 1974.

1.4. Organizimi, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Gjykatës Supreme- Kolegjit të Veçantë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë të vitit 2001

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (KKVP) është akt i veçantë pasi u shpall përmes Rregullores së UNMIK-ut (United Nations Mission in Kosovo), e cila hyri në fuqi pas shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Hans Haekkerup më 15 maj 2001 dhe është aplikuar si kushtetutë për shtatë vite. Nuk kishte pasur proces të legjitimuar demokratik për hartimin e saj, nëpërmjet ndonjë konvente

⁴ Neni 1 dhe 2.

kushtetuese. Kështu dokumenti kishte themel ndërkombëtar me kontributin (apo në rastin e komunitetit serb, me inkuadrimin e mundshëm) e ekspertëve që i përfaqësonin partitë kryesore politike (Weller, 2011, f. 303). Ndërsa edhe miratimi i saj nuk ishte bërë sipas formave të caktuara për miratimin e kushtetutës, pra në këtë rast nuk kishim miratim as nga Kuvendi Kushtetues, Parlamenti por as miratim të drejtpërdrejtë, me referendum.

Në dispozitat themelore të KKVPK përcaktohej pozita kushtetuese e Kosovës, “etnitet nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar” (Mjeku, 2020).

Me KKVPK ishin përcaktuar format dhe mënyrat kushtetuese për themelimin e institucioneve që ishin pjesë e pushteteve shtetërore, ushtrimi i funksioneve të këtyre pushteteve nga ndërkombëtarët si dhe pjesëmarrja e vendorëve në ushtrimin e tyre. Vetëqeverisja e tillë e përkohshme u kushtëzua nga fakti se Kosova ishte autonomi e përkohshme politike e territoriale nën OKB, e përcaktuar dhe e bartur te PSSP që ushtronte pushtetin shtetëror dhe njëkohësisht edhe sovranitetin e plotë në Kosovë.

PSSP kontrollonte punën e institucioneve dhe organeve shtetërore të themeluara në Kosovë dhe se realizimi i këtij funksioni kërkonte pëlqimin e detyrueshëm nga PSSP, pa pëlqimin e shkruar të cilit nuk mund të hynin në fuqi aktet juridike të përgjithshme të organeve shtetërore të nxjerra në bazë të Kornizës Kushtetuese dhe Rregulloreve të UNMIK-ut, akte me fuqi ligjore të pushtetit legjislativ, pra ushtronte pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, respektivisht cilësohej koordinuesi kryesor pa nënshkrimin e të cilit nuk mund të fuqizoheshin vendimet gjegjëse (Susuri, 2011).

Prandaj edhe Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës, funksionin e tij nuk arriti ta realizonte për arsye të statusit që kishte Kosova si etnitet nën Kombet e Bashkuara si dhe për arsye të kompetencave të PSSP, të cilat shtriheshin edhe në pushtetin gjyqësor, konkretisht ai kontrollonte kushtetutshmërinë e rregulloreve të UNMIK-ut, të ligjeve që i nxirrte Kuvendi i Kosovës e akteve të përgjithshme juridike. Mbrojtja e kushtetutshmërisë de jure ekzistonte dhe i përkonte Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, por de facto ajo nuk materializohej nga ky kolegji.

Ndonëse kreu i nëntë i Kornizës Kushtetuese kishte sanksionuar organet që i përkasin pushteteve shtetërore, konkretisht në pjesën katër pasqyrohej sistemin gjyqësor. Sipas këtij akti kushtetues mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ishte në kompetencë të Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme për çështjet e Kornizës Kushtetuese. Pra, në këtë periudhë ishte adoptuar modeli i kontrollit dhe mbrojtjes së

kushtetutshmërisë nga gjykatat e zakonshme për faktin se ky kolegji i veçantë vepronte në kuadër të Gjykatës Supreme e cila ishte pjesë e sistemit gjyqësor.⁵

2. Themelimi i Gjykatës Kushtetuese dhe statusi i saj në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

Shteti i së drejtës ngërthen kushtetutshmërinë dhe kufizimin e pushteteve shtetërore (Sadushi, 2012, f. 99). Gjykatat kushtetuese ndryshojnë ndërmjet tyre përgjatë periudhës në dimensionet vijuese, ndër të tjera (Horowitz, 2006):

- gamën e juridiksionit të tyre;
- palët e autorizuara në këto gjykata;
- mënyra e zgjedhjes ose emërimit të gjyqtarëve;
- mandati i gjyqtarëve;
- efekti i vendimeve gjyqësore që konstatojnë antikushtetutshmëri;
- lehtësinë ose vështirësinë e prishjes së vendimeve të gjykatës kushtetuese (f. 128).

Kolegji i veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës ka shërbyer si bazë themelore për t'u zgjeruar dhe ngritur në Gjykatë Kushtetuese të Kosovës me përcaktimin definitiv të statusit politik. Ky përcaktim i statusit politik ndodhi më 17 Shkurt 2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur. Përcaktimit të statusit politik të Kosovës i kishte paraprirë, i dërguari special i OKB, ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari, i cili përgatiti "Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës", përgjithësisht i njohur "Plani i Ahtisaarit", që mes të tjerash përcaktoi parimet dhe mekanizmat që do të ndërtonin Kushtetutën e re të Kosovës. Njëra prej dispozitave kyçe të tij ishte edhe rekomandimi për krijimin e Gjykatës së re Kushtetuese të Kosovës (Mansfield, 2013). Pra, nga kjo konstatoi se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës u krijua me përcaktimin definitiv të statusit politik të Kosovës. Me Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, shteti i Kosovës do të ishte ligjërisht i obliguar të plotësojë ndër të tjera edhe obligimet e tij nga Plani i Ahtisaarit (Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 2008).

⁵ Struktura e gjykatave ishte: Gjykatë Supreme, Gjykata e Qarqeve, Gjykata Komunale dhe Gjykata për Kundërvajtje.

Prandaj, në përputhje me Deklaratën e Pavarësisë edhe Kushtetutën e miratuar në prill të vitit 2008, dhe cila hyri në fuqi në qershor të po atij viti (Ahmeti, 2021), kishte inkorporuar të gjitha dispozitat e Pakos së Ahtisarit. Një risi për Kosovën është tanimë edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, së cilës i kushtohet Kapitulli VIII i Kushtetutës (Omari, 2009, f. 30).

Meqë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës u hartua sipas Pakos së Ahtisarit, atëherë Kapitulli VIII i Kushtetutës kishte përfshirë në përmbajtjen e tij dispozitat e këtij dokumenti ndërkombëtar lidhur me Gjykatën Kushtetuese, por vetëm e kishte zgjeruar juridiksionin e saj dhe palët e autorizuar duke përfshirë edhe “Kuvendin, Presidentin e Republikës së Kosovës, Qeverinë si dhe Avokatin e Popullit, si dhe referimin incidental të iniciuar nga gjykatat”. Gjykata Kushtetuese në Republikën e Kosovës është organ të cilës i është besuar garantimi dhe respektimi i kushtetutës, si e tillë nuk është pjesë e asnjërit nga pushtetet shtetërore.

Pas miratimit të Kushtetutës, në maj të vitit 2008 ishte formuar grupi punues për themelimin e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, Kapitulli VIII i Kushtetutës u implementua përmes miratimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (GJKRK) Procesi i hartimit të këtij ligji është veçuar pasi morën pjesë përfaqësues nga Kosova, respektivisht ishin përfaqësuesit e Qeverisë, Zyrës së presidentit, Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe ekspertët e pavarur ligjor, si dhe përfaqësues ndërkombëtarë të cilët ishin ekspertët ligjorë nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO), Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Institutit të Menaxhmentit East-West (EWMI), si dhe përfaqësuesit e Këshillit të Evropës (Mansfield, 2013). Nga radhët e përfaqësuesve nga Kosova, që ishin pjesë e grupit punues të cilët i kam intervistuar ishin Prof.Dr. Visar Morina nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës, përfaqësues nga Qeveria që në atë kohë ishte zëvendëskryeministër Z. Ramë Manaj, ndërsa nga përfaqësuesit ndërkombëtar nga USAID Z. John Allelo, këshilltar i lartë për sundimin e ligjit, si dhe Z. John Tunheim kryetar në Gjykatën e Qarkut në Minesota të ShBA-së që ishte ndërmjetës midis zyrtarëve qeveritarë dhe udhëheqësve të opozitës dhe ndihmoi në rishikimin e draftit të Kushtetutës së shtetit të Kosovës.

Se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në përmbajtjen e saj ka Pakon e Ahtisarit, këtë e konfirmon edhe njëri nga kontribuesit në hartimin e saj, Prof.Dr. Visar Morina, i cili ka theksuar se “I gjithë procesi i hartimit të kushtetutës 90% është bazuar te Pakoja e Ahtisarit,

që njëherit ka shërbyer si dokument kryesor edhe për përpilimin e ligjit të Gjykatës Kushtetuese, por në mesin e tyre ka qenë edhe modeli gjerman, kryekëput jemi mbështetur në përvojën shqiptare, gjithashtu kemi analizuar edhe kushtetutat e Ballkanit Perëndimor, sepse ideja ka qenë të identifikojmë shtetet që Kosova ka ngjashmëri institucionale, të qeverisjes, të traditës kushtetuese” (Morina, 2021).

Edhe ish-zëvendëskryeministri, Z. Ramë Manaj, ka qenë anëtar i komisionit për hartimin e Ligjit për GJKRK, ka potencuar se “Sikundër edhe për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, janë shqyrtuar, krahasuar, analizuar e konsultuar ligje kushtetuese të dhjetëra vendeve, të cilat legjislacionin e kësaj fushe e kanë më të konsoliduar dhe më konsistente në praktikat juridiko-kushtetuese” (Manaj, 2021).

Në takimin e parë në korrik 2008, është marrë vendimi për të hedhur poshtë Projektligjin fillestar të Ministrisë së Drejtësisë, i cili nga shumica e pjesëmarrësve ishte vlerësuar si me mangësi të dukshme, si dhe u hartua korniza e projektligjit të ri që do të hartohet nga grupi punues (Mansfield, 2013), ky i fundit punoi në mënyrë efikase për të finalizuar projektligjin për më pak se gjashtë muaj, i cili i është prezantuar Kuvendit në dhjetor të vitit 2008 dhe u miratua pa ndonjë ndryshim.

Megjithatë kryetari i Gjykatës Supreme në ShBA, Z. John Tunheim, ka vlerësuar se “Ligji për themelimin e Gjykatës Kushtetuese nuk ishte analizuar mjaftueshëm kur është hartuar. Do të kishte qenë shumë më mirë të vazhdohej puna e grupit punues edhe për një mandat shtesë në mënyrë që të hartohet një ligj i cili do të siguronte qëndrueshmëri për dhjetë viteve para të Gjykatës Kushtetuese gjatë interpretimit kushtetues” (Tunheim, 2021).

Ndërsa sa i përket themelimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuesi tjetër ndërkombëtar që ishte i kyçur në këtë proces Z. John Allelo veçon se “Projektimi dhe krijimi i një Gjykate Kushtetuese që kishte juridiksion dhe fuqi kushtetuese adekuate përbënin pjesën më kritike për qëndrueshmërinë afatgjate të këtij organi në shtet” (Allelo, 2021).

3. Përbërja, zgjedhja, mandati, imuniteti dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

3.1. Zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

Kur themelohet një gjykatë e re kushtetuese, është një pyetje themelore ku duhet fokusuar, konkretisht kush dhe si mund të bëhet anëtar i saj. Në të vërtetë, kjo pyetje përbëhet nga dy elemente: së pari, kush mund të bëhet gjyqtar, d.m.th. kërkesat që duhen plotësuar; së dyti, si mund të bëhet gjyqtar, d.m.th. procedura që duhet të ndiqet për të caktuar një gjyqtar të ri (Kelemen, 2013). Nga kjo, rrjedhë se procedura për zgjedhjen apo emërimin e gjyqtarëve kushtetues përbën një nga elementet thelbësore të një modeli të drejtësisë kushtetuese.

Njëlloj është vepruar edhe me GJKRK, ku Kushtetuta përcakton përbërjen, organizimin dhe mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve të gjykatave kushtetuese (Bajrami, 2007, f. 165). Zakonisht, emërimi i gjyqtarëve kushtetues bëhet me pjesëmarrjen e “parlamentit, ekzekutivi dhe presidenti” (Traja, 2000, f. 77).

Rast specifik ishte mënyra e emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtar në GJKRK në momentin e themelimit të saj, ku Kushtetuta e Republikës së Kosovës në dispozitat kalimtare të saj në nenin 152 kishte sanksionuar “Përbërjen e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese”, që në përbërjen e saj të kishte “nëntë gjyqtarë, gjashtë gjyqtarët e parë do të emëroheshin nga presidenti i Republikës së Kosovës, me propozim të Kuvendit ndërsa tre gjyqtarët e tjerë do të ishin ndërkombëtarë dhe do të emëroheshin nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil (PNC), pas konsultimit me kryetarin e GJEDNJ”. Kjo strukturë përbërëse e Gjykatës Kushtetuese zgjati deri më 7 shtator 2012, kur edhe u bë ndryshimi i kushtetutës sa i përket përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Amendamentet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2012).

Prandaj, prej vitit 2012, me dispozitat kushtetuese përcaktohej që Gjykata Kushtetuese të kishte në përbërjen e saj nëntë gjyqtarë vendorë, “të cilët emërohen nga presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Është zgjedhur figura e presidentit, për emërimin e gjyqtarëve kushtetues ndoshta si njëra prej figurave neutrale të parashikuara në Kushtetutë (Anastasi, E drejta kushtetuese, 2004, f. 210).

E rëndësishme është të theksohet që gjuha juridike e përdorur në dispozitat ligjore për GJKRK konsiderohen jounike kjo meqë në dispozitën e cila e rregullon procedurën për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, përdoret shprehja emërim, e cila shprehje në paragrafët e tjerë të po së njëjtës dispozitë substituhet me shprehjen zgjedhje, dhe në këtë mënyrë shkaktohet kontradiktë në këtë nen.

Shprehja *zgjedhje* nënkupton “caktimin e dikujt me anë të votimit për të kryer një detyrë shtetërore” (Konstallari, A. et al., 1981, f. 2237), ndërsa *emërim* nënkupton “caktimin e dikujt në një punë apo detyrë zyrtare” (Konstallari, A. et al., 1981, f. 426). Përdorimi i termit emërim konsideroj se nuk do të duhej të aplikohet në këtë dispozitë ligjore, kjo duke e ditur që emërimin e gjyqtarëve e bën presidenti dhe do të ishte e arsyeshme në të ardhmen të bëhen ndryshime në këtë drejtim dhe të unisohet gjuha juridike e aplikuar në të gjithë paragrafët e nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ashtu që të përdorej shprehja zgjedhje si shprehje që korrespondon edhe me përmbajtjen e rregullimit që bën ky nen.

Ligji për GJKRK, në nenin 6 ka rregulluar detajisht procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, që nga publikimi thirrjes e deri te zhvillimi i intervistave dhe pregaditje e listës së ngushtë me kandidatët që i plotësojnë kushtet e cila i dërgohet Kuvendit. Duhet potencuar këtu se procedura e zgjedhjes së tyre dallon në pikëpamje të votimit në Kuvend, ku: “shtatë kandidatë për gjyqtarë propozohen nëse vendimi miratohet me 2/3 të votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe votojnë”; “dy kandidatë për gjyqtarë i përkasin komuniteteve dhe propozohen nëse vendimi miratohet me shumicën e votave të deputetëve të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë por votimi i tyre është i kushtëzuar edhe me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët i mbajnë ulëset e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve. Përfaqësimi i këtillë i komuniteteve në këtë institucion avokon me përfaqësimin e shqiptarëve, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që në këtë vend kanë statusin e pakicës (Bajrami, A. et al., 2012, f. 112).

Kështu, sipas rregullimit kushtetues dhe ligjor, kuptohet se procedura e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përfshin:

1. Fazën e propozimit/miratimit të kandidatëve nga Kuvendi - të cilës më e drejtë do të ishte t’i referohemi si fazë e zgjedhjes dhe
2. Fazën e emërimit nga presidenti.

Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetues përbën kompetencë të përbashkët të presidentit dhe të Kuvendit, e që në esencë nënkupton kooperimin e këtyre dy institucioneve, presidenti krahas emërimit e gëzon të drejtën edhe të refuzimit të kandidatëve të propozuar për gjyqtarë kushtetues nga Kuvendi, ndonëse refuzimi nuk parashikohet shprehimisht në kompetencat e tij, madje mossanksionimi me kushtetutë lë të kuptohet se ai mund ta ushtrojë edhe të drejtën e refuzimit, e cila arsyetohet pasi këto propozime vijnë nga një trup i cili nuk është profesional (Hasani, E., & Cukalovic, I., 2013, f. 408). Kjo vërtetohet edhe përmes situatës me gjyqtarin Radomir Laban i cili ishte propozuar nga Lista Serbe dhe ishte zgjedhur në Kuvend, megjithatë dekretimi i tij ishte shtyrë nga ana e ish-presidentit Hashim Thaqi, kjo për shkak të dyshimeve lidhur me të kaluarën e tij kriminale, për çka ish-presidenti kishte kërkuar verifikim shtesë nga organet e drejtësisë dhe sigurisë (Bislimi, 2021). Kjo e dëshmon faktin se Kuvendi është organ politik e përfaqësues por jo profesional në drejtim të vlerësimit të kandidatëve që duhet zgjedhur për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjithësi, presidenti i Republikës në këtë proces nuk ka rol bashkëvendimarrës me Kuvendin, kjo ngase në parim i emëron kandidatët që ky institucion ia propozon, andaj mund të thuhet se në këtë rast më tepër ka rol formal, ku vetëm i konfirmon propozimet të cilat më parë veçse filtrohen nga komisioni përkatës e më pas edhe nga institucioni i Kuvendit.

Në vitin 2011 kur presidentja Atfiete Jahjaga erdhi në pushtet, Gjykata Kushtetuese në përbërjen e saj kishte nëntë anëtarë. Por gjatë periudhës sa ishte në krye të shtetit, dy gjyqtarëve vendas u kishte mbaruar mandati trevjeçar, dhe konform aktit më të lartë kushtetues duhet të zgjidheshin dy gjyqtarë të tjerë vendas. Në fakt, presidentja kishte dekretuar vetëm emërimin e Arta Rama-Hajrizi⁶, pra kishte emëruar vetëm një gjyqtar në vitin 2012 dhe gjyqtarin tjetër e kishte emëruar gjyqtarin Bekim Sejdiu më 15 prill 2015, emërim ky që në fakt do të duhej të bëhej vite më parë.

Në ndërkohë, në qershor të vitit 2015 kishte mbaruar mandati i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Enver Hasani si dhe mandati i gjyqtarit Kadri Kryeziu (Hasani, E., & Brahimi, M., 2021, f. 508), të cilat u plotësuan më 30 dhjetor 2015 pas pranimit të propozimeve nga Kuvendi, presidentja Jahjaga kishte emëruar dy gjyqtarë të ri të Gjykatës Kushtetuese,

⁶ Dekretimi i saj është bërë nga presidentja Atifete Jahjaga, më 25 qershor 2012.

kështu duke e kompletuar përbërjen e përcaktuar me kushtetutë.⁷ Duke vazhduar më tej në shtator të vitit 2016 kur jep dorëheqje njëri prej tre gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe ajo periudhë e deri në vitin 2018 vendi ka mbetur vakant, kurse në qershor të vitit 2018 pritej zgjedhja e pesë gjyqtarëve të rinj, të gjithë vendor. Kjo pasi dy gjyqtarëve të mbetur ndërkombëtarë u skadoi kontrata në qershor të vitit 2018 dhe më nuk kishte asnjë gadishmëri nga autoritet vendore për ripërtëritje të mandatit të tyre, andaj nga qershori 2018 nisi ripërtëria e thellë dhe e parë e Gjykatës Kushtetuese që nga zgjedhja e gjeneratës së parë të gjyqtarëve kushtetues në maj të vitit 2009 (Hasani, E., & Brahimi, M., 2021, fv. 508-509).

Sidoqoftë, duhet të theksohet procesi i zgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (pas përbërjes së parë) është përcjellë me sfida të konsiderueshme pasi Kuvendi disa herë ka dështuar në përmbushjen e detyrimit kushtetues për të siguruar plotësimin e vendit vakant për anëtarë në Gjykatën Kushtetuese (Morina, 2013, f. 93), dështim i cili erdhi si pasojë e mosekzistimit të konsensusit politik që t'i sigurojë votat e nevojshme për zgjedhjen e kandidatëve të propozuar. Meqë nuk ekziston ndonjë instrument kushtetues për të detyruar Kuvendin që të vendosë për kandidatin apo kandidatët e propozuar (Mushkolaj, Gj., & Morina, V., & Johan, V. L., 2014, f. 81), kjo Gjykatë nga qershori i viti 2012 e deri në prill të vitit 2015, përbëhej nga vetëm tetë gjyqtarë, më konkretisht kishte shqyrtuar çështje e kishte marrë vendime pa përbërjen e kushtetutëzuar me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore. Funksionimi me përbërjen prej tetë gjyqtarëve përbënte rrezik potencial që gjatë vendosjes votat pro dhe kundër të ishin të barabarta dhe në këtë mënyrë të stagnonte procesi i vendimmarrjes. Nuk ka asnjë dilemë se dështimi i Kuvendit për të plotësuar vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese vë në rrezik pavarësinë dhe funksionalitetin e kësaj Gjykate.

Sfidë për këtë institucion është plotësimi i vendeve të lira të punës brenda afatit ligjor, e cila prodhon pasoja direkte në paaftësinë e funksionimit të saj pasi vendimmarrja realizohet përmes kuorumit. Është e vështirë të imagjinohet një sanksion efektiv që mund ta kufizojë parlamentin ose organet e tjera për ta caktuar një gjykatës të ri brenda afatit ligjor dhe pasi nuk ka një sanksion të tillë në panoramën evropiane, e vetmja zgjidhje ligjore që është gjetur për këtë problem deri më tani ka qenë institucioni i të ashtuquajturës zgjatje e

⁷ Presidentja kishte dekretuar emërimin e Gresa Caka-Nimani dhe Selvete Gërxhaliu.

mandatit (latinisht: *prorogatio*) që do të thotë se gjyqtarit që i ka përfunduar mandati vazhdon dhe mbetet në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij (Kelemen, 2013). Bazuar në situatën faktike të elaboruar më sipër në zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues në Kosovë, ku kuorumi prej "2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë" është i vështirë të sigurohet në mungesë të një konsensusi politik kjo do të përbënte zgjidhje të përshtatshme që do të duhej të realizohej përmes ndryshimeve ligjore. Konkludoj se në sistemin parlamentar zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve kushtetues është proces i ekspozuar në mënyrë indirekte ndaj ndikimeve të politikës.

Në anën tjetër, Komisioni i Venecias rekomandon modelin e ndarë (ose, siç e quan atë, "model të përzier"), duke siguruar kompetenca zgjedhore ose emërimi për tre degët kryesore të pushteteve shtetërore, pasi ky model përfaqëson legjitimitet dhe është më demokratik (ECDTL, Compilation of Venice Commission opinions, reports and studies in constitutional justice, 2015). Ky model aplikohet përmes pjesëmarrjes së organeve të ndryshme të pushteteve shtetërore të cilët i zgjedhin gjyqtarët ose emërojnë kandidatët për gjyqtar, ndërsa vendimi përfundimtar merret nga Parlamenti (p.sh. në Letoni) ose nga kreu i shtetit (p.sh. në Spanjë). Në këtë grup krahas Letonisë dhe Spanjës, bëjnë pjesë edhe shtetet si Bullgaria e Italia. Thelbi i modelit është se fuqia e emërimit ndahet nga të tre degët e pushtetit shtetëror: ekzekutivi dhe legjislativi, dhe pushtetit gjyqësor. E veçanta e këtij modeli është se instalohet kuota, që nënkupton se një numër i gjykatësve kushtetues zgjidhen nga Parlamenti, një numër i tyre emërohen nga Qeveria dhe një numër i tyre nga Gjykata Supreme, ku zgjidhja më e zakonshme është t'i ndajmë këto kuotat në mënyrë të barabartë, kështu që numri i gjyqtarëve kushtetues zakonisht ndahet me tre (Kelemen, 2013). Aplikimi i një modeli të tillë edhe në Republikën e Kosovës do të shmangte bllokimin e zgjedhjes nga Kuvendi të kandidatëve, pastaj do të zvogëlonte ndikimin e politikës por njëkohësisht do të rriste edhe profesionalizimin në këtë gjykatë.

Kriteret për zgjedhjen për gjyqtarë kushtetues aktualisht në Republikën e Kosovës nuk përfshijnë një numër të gjerë të juristëve të cilët mund të zgjedhen në këtë pozicion. Njëherit, kushtetuta dhe ligji nuk përcaktojnë kriteret të qarta, objektive e të matshme në aspektin profesional të kandidatëve për gjyqtarë kushtetues.

Asnjë sistem i emërimit apo i zgjedhjes që gjyqtarëve kushtetues nuk është i përsosur, por efektiviteti i cilitdo sistem që ekziston kërkon një themel të fortë të sundimit të ligjit (Allelo, 2021).

3.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kohëzgjatja e mandatit të një gjyqtari kushtetues e kombinuar edhe me rizgjedhjen është shumë domethënëse për përbërjen e Gjykatës kushtetuese, kjo ka mundësi të ketë pasoja të ndikimit politik në gjykatë, pavarësinë e gjyqtarëve e stabilitetin institucional, prandaj nga një vlerësim i llojeve të mandateve të gjyqtarëve kushtetues, nëse nuk merren për bazë dallimet në sistemin ligjor në interes të krijimit të një modeli përgjithësisht të pranueshëm, modeli më i përshtatshëm duket se është një afat fiks dhe relativisht i gjatë, pa mundësi rizgjedhje, që përfaqësohet nga Franca, Bullgaria, Italia, etj. (ECDTL, The composition of constitutional courts, 1997). Modelin e tillë e ka përfaqësuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 114 par. 2 “emërohen nga presidenti i Republikës së Kosovës për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi rizgjedhje”.

Mandati i një gjyqtari mund të ndikojë në pavarësinë gjyqësore, pasi siguria e punës i fuqizon gjyqtarët të vendosin çështjet pa marrë parasysh mirëqenien personale të tyre dhe afatin kohor se sa do të shërbejnë në funksionin e gjyqtarit kushtetues. “Kufizimi i ndikimit në pavarësinë gjyqësore bëhet duke i dhënë gjyqtarëve një mandat të vetëm me pamundësi rrimërimi, me çka ata nuk do të jenë të varur nga sistemi politik” (Tunheim, 2021).

Sa i përket imunitetit, Kushtetuta në nenin 117 ka precizuar se “gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të veshur me imunitet nga ndjekja penale, paditë civile e shkarkimi nga detyra sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, mendimeve të shprehura dhe në tërësi veprimeve që i ndërmarrin gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit”. Në bazë të sanksionimit që i është bërë imunitetit në nenin 117 vërejmë se gjyqtarët gëzojnë edhe imunitet funksional që përfshin pjesën e vendimmarrjes së gjyqtarit kushtetues.

Kategoria e imunitetit funksional të gjyqtarëve në përgjithësi përfshinë edhe gjyqtarët kushtetues, i cili përbën një standard të përkrahur fuqishëm nga Komisioni i Venecias (Hasani, E., & Brahimi, M., 2021).

Gjykata Kushtetuese në rastin KO 98/11 ka interpretuar dispozitën kushtetuese për imunitetin ku ka saktësuar natyrën juridiko-kushtetuese dhe imunitetin funksional të funksionarëve të lartë shtetërorë në Kosovë, ndonëse ky rast nuk i referohet në mënyrë shprehimore me gjyqtarët kushtetues, por me presidentin, kryeministrin, anëtarët e Qeverisë dhe deputetët e Kuvendit, megjithatë interpretimi në fjalë *mutatis mutandis* vlen

edhe për vetë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, e cila si e tillë është për dy arsye: e para sepse dispozitat kushtetuese sa i përket imunitetit të funksionarëve të lartë shtetërorë të Kosovës dhe deputetëve të Kuvendit janë në tërësi të njëjta dhe përfshin dispozita për imunitetin e gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt dhe Avokatit të Popullit, e dyta gjyqtarët kushtetues gëzojnë statusin protokollar të ministrave të qeverisë dhe barazohen me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës kurse vetë kryetari i Gjykatës Kushtetuese gëzon rangun ceremonial dhe protokollar të kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit (Hasani, E., & Brahimi, M., 2021, fv. 533-534).

Rregullat e tilla referuar imunitetit të garantuar kanë për qëllim mbrojtjen e pavarësisë dhe neutralitetit të gjyqësorit duke e ndarë ligjin nga politika.

3.3. Shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese

Në përgjithësi, shtetet kanë nevojë për një mekanizëm shkarkimi, megjithëse një proces rigoroz i përzgjedhjes gjyqësore dhe standardet e larta të sjelljes etike mund të ndihmojnë në minimizimin e nevojës për përdorimin e këtij mekanizmi.

Pyetjet se si dhe në çfarë rrethanash një gjyqtar në detyrë mund të shkarkohet gjithashtu ndikojnë ndjeshëm në pavarësinë e gjyqësorit dhe në paanshmërinë. Për të ruajtur zbatimin e këtyre parimeve, gjyqtarët nuk duhet të kenë frikë nga shkarkimi ose transferimi arbitrar. Megjithatë, për shkak se sjellja e një gjyqtari në të vërtetë mund të justifikojë shkarkimin, shumë kushtetuta artikulojnë qartë rrethanat e kufizuara që do të justifikonin shkarkimin e tij (Hedling, 2011).

Sipas nenit 118 të Kushtetutës në shtetin e Kosovës, procedura e shkarkimit iniciohet “me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe shkarkohen nga presidenti i Republikës së Kosovës” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Gjyqtarët janë përgjegjës para Kushtetutës dhe ligjit të cilin duhet ta zbatojnë me ndershmëri, në mënyrë të pavarur dhe me integritet. Parimet e llogaridhënies dhe pavarësisë gjyqësore mbështesin “besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe rëndësinë e gjyqësorit si një prej tre shtyllave mbi të cilat mbështetet një qeveri e përgjegjshme” (Smit, 2015, f. 79).

4. Juridiksionet dhe palët e autorizuar në Gjykatat Kushtetuese

Evropiane

Sistemi i përqendruar i kontrollit gjyqësor, fillimisht është aplikuar nga shekulli i nëntëmbëdhjetë në shumë vende të Amerikës Latine, e pastaj edhe në Evropë pas ideve të Kelsenit të përcaktuara në kushtetutat e vitit 1920 të Çekosllovakisë dhe Austrisë bazuar në parimin e epërsisë së kushtetutës dhe garancitë e saj kryesore, ku si rezultat i propozimeve të Hans Kelsen dhe aplikimit të tyre në Evropë është zhvilluar sistemi i përqendruar i kontrollit gjyqësor, i cili atribuoi organeve kushtetuese të themeluara posaçërisht (Gjykata Kushtetuese, gjykata ose këshilla) të konceptuara përgjithësisht jashtë gjyqësorit me fuqinë për të anuluar të gjitha efektet e statuteve antikushtetuese (Brewer-Carías A. , 2011). Në të gjitha sistemet e kontrollit gjyqësor - qofshin ato të përqendruara apo të shpërndara, hibride apo të përziera, roli kryesor i gjykatave kushtetuese konsiston në interpretimin dhe zbatimin e Kushtetutës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e statuteve dhe kështu të ruajnë epërsinë e Kushtetutës. Prandaj, Gjykatat kushtetuese janë gjithmonë në *subordinim*/varësi të kushtetutës. Funkzioni i tyre thelbësor është të garantojnë epërsinë dhe integritetin e kushtetutës, ku të gjithë janë të detyruar t'i binden Kushtetutës (Brewer-Carías A. , 2011).

Andaj, Gjykatat Kushtetuese të stilit evropian theksohet se nuk janë një degë e gjyqësorit, por janë organe kushtetuese të ndara, *sui generis*, me fuqinë ekskluzive për të kryer kontrollin kushtetues të akteve legjislative (Sólyom, 2013, f. 135).

Në regjimet demokratike, të gjitha metodat e rishikimit gjyqësor kanë si qëllim kryesor garantimin e epërsisë së Kushtetutës, kështu kur gjykatat kushtetuese ushtrojnë kontroll kushtetues, ato kanë për detyrë të krahasojnë statutet ose legjislacionin primar me dispozitat e Kushtetutës dhe pikërisht kjo është arsyeja pse kontrolli gjyqësor është në thelb një kontroll kushtetues i legjislacionit ose ushtrim i kontrollit gjyqësor mbi kushtetutshmërinë e legjislacionit (Brewer-Carías R. A., 2010). Kështu edhe shteti i Kosovës si shtet demokratik përmes aplikimit të kontrollit kushtetues ka për qëllim garantimin e epërsisë së Kushtetutës.

Në përgjithësi, kompetencat e kontrollit kushtetues mund të ndahen në pesë kategori kryesore (Bumin, 2009):

- (i) kompetenca interpretuese;
- (ii) kompetenca për vlerësimin e kushtetutshmërisë së normave juridike;

(iii) kompetencat në lidhje me shpërndarjen e kompetencave ndërmjet autoriteteve publike; konfliktin e kompetencave;

(iv) zgjedhjet dhe partitë politike; dhe

(v) të drejtat e njeriut dhe liritë civile (f. 27).

Përveç ushtrimit të juridiksionit ekskluziv mbi çështjet kushtetuese, në fakt nuk ka kompetenca të përbashkëta për të gjitha gjykatat kushtetuese (një pjesë nga kontrolli kushtetues i legjislacionit, dhe madje edhe ky pushtet është i ndryshueshëm në aspektin e fushëveprimit dhe efektit) (Harding, 2017, f. 3).

Këto kategori të kompetencave të kontrollit kushtetues do t'i elaborojmë përmes kompetencave të Gjykatës Kushtetuese në rastin e Republikës së Kosovës në aspekt komparativ me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore.

5. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës

Gjykata Kushtetuese konsiderohet organ i veçantë kushtetues, të cilit i targetohet mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Fillimisht, në drejtim të juridiksionit, “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrton rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).⁸ Juridiksioni i saj sipas nenit 113 të Kushtetutës përfshinë këto kompetenca: interpretuese, vlerësimin e kushtetutshmërisë së normave juridike, konfliktin e kompetencave kushtetuese, të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut dhe zgjedhjet. Nga kompetencat kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës konstatojmë se kushtetutshmëria dhe ligjshmëria janë nën mbrojtjen ekskluzive të saj. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese është edhe “kontrolluese juridike dhe njëkohësisht garantuese e Kushtetutës, ndërsa ka funksionin e saj kushtetues edhe në interpretimin e Kushtetutës së Republikës” (N. Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë, 2010).

Ndërsa, objekt i kontrollit të kushtetutshmërisë mund të jenë ligjet dhe vendimet e Kuvendit, dekretet e presidentit dhe kryeministrit, pastaj edhe aktet me fuqi nënligjore të cilat i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë, akte të tilla janë: rregullorja dhe aktet e tjera të

⁸ Neni 113, par. 1

Qeverisë, si dhe statuti i komunës. Në këto raste Gjykata Kushtetuese ushtron kontroll normativ (abstrakt) të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë i cili realizohet në formën e kontestit abstrakt, sepse para Gjykatës Kushtetuese udhëhiqet kontesti midis normave të përgjithshme juridike (Shasivari, 2020, f. 380).

Kontrolli normativ apo abstrakt quhet gjithashtu edhe kontroll parandalues, pasi intenca e tij konsiston në filtrimin e ligjeve jokushtetuese para se ato të prodhojnë pasoja të dëmshme (Rosenfeld, 2012, f. 823). Lista e subjekteve që janë të autorizuar të fillojnë zyrtarisht kontrollin abstrakt ndryshon nga vendi në vend. Në shtetet e rajonit, presidenti ka fuqi të tillë dhe pothuajse të gjithë i japin kompetencë të ngjashme qeverisë ose kryeministrit, mirëpo shumë shtete gjithashtu lejojnë që procesi i rishikimit të fillohet nga grupe parlamentarësh, të cilët mund të caktohen edhe si një numër i veçantë (p.sh. një minimum prej 20 anëtarësh të Parlamentit Letonisht) ose një fraksion (p.sh. një e pesta e anëtarëve të Asamblesë Kombëtare të Bullgarisë ose një e treta në Slloveni) (Sadurski, 2014). Ky lloj i kontrollit sipas nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga “¼ e deputetëve të Kuvendit, presidenti, Qeveria, Avokati i Popullit⁹ edhe komuna”.

Duket qartë se te procesi i shqyrtimit të kushtetutshmërisë të një ligji në mënyrë abstrakte gjykata sjellet më tepër si një organ kuazi-ligjvënës sesa si organ gjyqësor, dhe se pasojat në raport me ndarjen e pushteteve shtetërore janë shumë më të mëdha sesa kur shqyrtimi është i kufizuar në gjykimin e çështjeve konkrete. Një nga arsytet për këtë është lloji i kontrollit abstrakt, kur (siç ndodh shpesh) drejtohet një ligj i miratuar së fundmi, e sjell gjykatën pikërisht në qendër të një polemike politike (Sadurski, 2008, f. 67). Përgjithësisht nga ky lloj i kontrollit normativ bëjnë amendamentet kushtetuese, pasi për nga fuqia juridike ato janë në nivel të Kushtetutës.

5.1. Kontrolli kushtetues i amendamenteve

Sa i përket kontrollit kushtetues të amendamenteve, Kushtetuta në nenin 113 par. 3 nënpar. 4, njeh dy mundësi: rastin kur kërkohet të shqyrtohet “nëse amendamenti kushtetues i propozuar është në përputhshmëri me marrëveshjet ndërkombëtare të

⁹ Në Evropë për herë të parë, Avokati i Popullit si palë e autorizuar për të iniciuar rast në Gjykatën Kushtetuese njihet me Kushtetutën e Spanjës të vitit 1978.

ratifikuara nga institucionet e Kosovës pra që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm dhe njëherit mund të kërkohej që të “verifikohet edhe nëse procedura e ndjekur për iniciimin e miratimit të këtij amendamenti është në përputhje me kushtetutën”. Këtë rast mund ta iniciojnë Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Duhet potencuar se në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë, por kontrollon ligjshmërinë ndërkombëtare të amendamenteve nëse janë në përputhshmëri me marrëveshjet ndërkombëtare kushtetuese. Njëherit, çdo amendament kushtetues i propozuar sipas nenit 113 par. 3 nënpar. 9 është e obligueshme të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim paraprak “që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë që garantohen në kapitullin II të Kushtetutës. Palë e autorizuar në këtë rast është kryetari i Kuvendit”.

Referuar praktikës kushtetuese që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese e deri në vitin 2019, këto kanë qenë rastet ku është vendosur lidhur me vlerësimin paraprak të amendamenteve të propozuara (GJKRK, Vendimet, 2009-2019):

- Rastet “nr. KO29/12 dhe KO48/12”; rasti “nr. KO61/12”; “nr. KO44/14”; “nr. KO13/15”; “nr. KO26/15”; dhe “nr. KO162/18”.

5.2. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare

Në drejtim të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e njeh një kontroll të kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare para apo pas ratifikimit të tyre. Kjo është dëshmuar edhe nga praktika e saj gjyqësore kushtetuese kur Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar se nuk ka kompetencë të vlerësojë pajtueshmërinë e ligjeve me marrëveshjet ndërkombëtare, në rastin “nr. KI 168/14” (Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen, 2015).

Mirëpo, duke e ditur se disa marrëveshje ndërkombëtare ratifikohen me ligj, atëherë ky i fundit sipas nenit 113 par. 5 pas miratimit mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues të iniciuar nga 10 (dhjetë) apo më tepër deputetë (Baza ligjore-GJKRK, n.d.). Kjo procedurë e vlerësimit të ligjit konsiderohet e natyrës pezulluese, që nënkupton se shpallja e ligjit nuk mund të bëhet përderisa Gjykata të vendos përfundimisht. Një situatë e tillë është paraqitur në vitin 2013 kur disa deputetë kishin referuar në Gjykatën Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit për ratifikimin e “Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të

parimeve që rregullonte normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë”, ku ajo këtë ligj e kishte vlerësuar vetëm sa i përket aspektit procedural ndërsa sa i përket përmbajtjes kishte konstatuar se nuk është kompetente pasi “asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së marrëveshjeve ndërkombëtare nga Gjykata Kushtetuese” (V. Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë, 2013).

5.3. Konfliktet kushtetuese për kompetencë ndërmjet organeve shtetërore

Konfliktet për kompetencë ndërmjet organeve shtetërore, sipas nenit 113 paragrafi 1 nënpagrafi 1 i zgjidh Gjykata Kushtetuese vetëm nëse referohen nga “Kuvendi, Presidenti dhe Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me kompetencat e tyre kushtetuese që i ushtrojnë”. Kushtetuta nuk e ka precizuar llojin e konfliktit nëse mund të jetë pozitiv apo negativ, atëherë nënkuptohet se cilido nga këto lloje të konfliktit të kompetencave që paraqitet Gjykata Kushtetuese duhet ta trajtojë. Një veçori tjetër, është se zgjidhja e konfliktit të kompetencave aplikohet vetëm në nivelin horizontal, pasi organet e lartpërmendura i përkasin nivelit qendror. Ndërsa, sa i përket konfliktit të kompetencave në nivel vertikal, nuk është sanksionuar me Kushtetutë. Në këtë situatë, Gjykata Kushtetuese na paraqitet si “mekanizëm për kontrollim të balancit kushtetues të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe të shefit të shtetit” (Hasani, E., & Cukalovic, I., 2013, f. 578).

5.4. Shkeljet kushtetuese gjatë procesit zgjedhor në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Sa i përket shkeljes së kushtetutës gjatë zgjedhjes së Kuvendit, Kushtetuta në nenin 113 par. 3 nënpar. 5 ka parashikuar si palë të autorizuar për të iniciuar këto shkelje Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kështu Gjykata Kushtetuese konsiderohet kompetente për të vlerësuar kushtetutshmërinë e zgjedhjeve vetëm për organin që ushtron pushtet legjislativ, Kuvendin. Ndërsa për zgjedhjet e organeve të tjera në nivel qendror dhe lokal kjo gjykatë nuk është kompetente, pra janë përjashtuar zgjedhjet për nivelet e tjera. Roli i saj është vendimtar vetëm për certifikimin e zgjedhjeve nëse ato janë referuar për shqyrtim, kjo dëshmohet nga “Ligji për zgjedhjet e përgjithshme” i cili në nenin 106 përcakton që Komisioni Qendror Zgjedhor t’i certifikojë rezultatet përfundimtare

të zgjedhjeve, vetëm atëherë kur ndër të tjera ka përfunduar edhe procedurat ankimore në Gjykatën Kushtetuese (Ligji nr. 03/L-073, 2008).

5.5. Praktikë e gjyqësisë kushtetuese në rastin e shkeljes nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kompetencë tjetër kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese është edhe gjykimi i presidentit nëse ka kryer shkelje serioze kushtetuese, e cila kompetencë ushtrohet vetëm nëse “tridhjetë e më shumë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës e iniciojnë këtë shkelje të pretenduar”, pasi sipas nenit 113. par. 6 të Kushtetutës konsiderohen si palë të autorizuar në këtë rast.

Me materializimin e kësaj kompetence, Gjykata Kushtetuese është sfiduar në vitin e parë të funksionimit, respektivisht në vitin 2010 kur tridhjetë e dy (32) deputetë kishin iniciuar pretendimin e tyre për shkelje serioze të kushtetutës të kryer nga presidenti i atëhershëm, Fatmir Sejdiu, shkelja konsistonte në mbajtjen e funksionit të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të pezulluar dhe njëkohësisht funksionit të presidentit të Republikës, veprim ky i cili ishte argumentuar se ishte e ndaluar me nenin 82 par. 2 të Kushtetutës (N. Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë , 2010). Ndonëse normat kushtetuese nuk e kanë sqaruar çka konsiderohet shkelje serioze e Kushtetutës, megjithatë me aktgjykimin e dhënë në këtë rast Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se ajo përfshin shkeljen e një norme kushtetuese e cila do të prodhojë konsekuenca në jetën e qytetarëve.

Një specifikë është se kjo procedurë e filluar nga deputetët si palë e autorizuar, nëse këta të fundit e tërheqin kërkesën, atëherë sipas rregullit 75 të Rregullores së GJKRK, presidenti i Republikës ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata vazhdimin e procedurës nëse kemi shkelje kushtetuese përmes aktgjyimit të lëshuar. Por, procedura e tillë mund të vazhdohet vetëm nëse kërkesa merr pëlqimin e votave të shumicës së gjyqtarëve. Një modalitet i tillë është paraparë pasi tërheqja e kërkesës ka mundësi të bëhet ndër të tjera edhe për shkaqe politike.

5.6. Format e ankesave kushtetuese në rastet e mbrojtjeve të të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi, si dhe në rastet e veçanta në Republikën e Kosovës

Gjykatat Kushtetuese në shumë vende evropiane (p.sh., Austria, Republika Çeke, Hungaria, Gjermania, Sllovenia, Spanja) kanë juridiksion për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (Brewer-Carías A. , 2011, f. 435).

Modeli meksikan i kontrollit kushtetues ishte dhe mbetet specifik. Ajo që e veçon kontrollin kushtetues në Meksikë është e ashtuquajtura procedura "*Amparo*" që ngjyrosi të gjithë sistemin gjyqësor të Meksikës (Kulić, 1969). Megjithëse mjete të ngjashme juridike u vendosën gjatë shekullit XX në vendet evropiane¹⁰ si Austria, Gjermania Spanja dhe Zvicra, ky mjet identifikohet si amerikano-latin (Brewer-Carías A. , 2009, f. 74). Protagonistët e parë të sistemit amparo u shfaqën në gjysmën e parë të shekullit XIX, midis tyre, dallohet si pararendësi i amparos Manuel C. Rayon, i cili zhvilloi idetë e tij për amparon në projekt-kushtetutën e shtetit të Jukatani në vitin 1840, i pasuar vite më vonë nga Mariano Otero që ishte gjithashtu një nga nismëtarët e sistemit amparo nga viti 1847, i njohur si "Acta de Reformas" (Kulić, 1969, f. 267). Amparo fillimisht u krijua si një mjet për mbrojtjen e të drejtave individuale të qytetarëve të garantuara me kushtetutë. Kështu, procedura amparo në kontrollin dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë para së gjithash presupozon ekzistencën e shkeljes së të drejtave kushtetuese të individëve si parakusht i saj themelor dhe i vetëm për nisjen dhe zhvillimin e procedurës. Padija amparo nënkupton se qytetari për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese të cenuar e paraqiti një kërkesë para gjykatës për ta sjellë situatën antikushtetuese në nivelin e kushtetutshmërisë (Kulić, 1969). Në këtë drejtim, procedura e amparos e parashikuar nga ankesa synon kthimin e të drejtës së cenuar të qytetarit në gjendjen paraprake. Kushtet themelore për ngritjen e një procesi gjyqësor amparo është që individi, të cilit i është shkelur e drejta kushtetuese, t'i ketë përdorur më parë të gjitha mjetet e tjera juridike që janë parashikuar me akte juridike. Njëherit një proces gjyqësor amparo nuk mund të iniciohet në ato raste kur akti juridik nuk prodhon efekt juridik, nëse për shembull, kjo padi është ngritur kundër një ligji ose akti të një autoriteti shtetëror që në

¹⁰ Austria dhe Gjermania e aplikojnë ankesën kushtetuese, kurse Kroacia dhe Sllovenia e aplikojnë padinë kushtetuese.

kohën e padisë amparo ka humbur efektin juridik ose ka pushuar të vlejë, ose nëse objekti me të cilin lidhet veprimi nuk ekziston më (Kulić, 1969).

Karakteristikat specifike të padisë amparo ndryshojnë shumë në vende të ndryshme, por në përgjithësi përkufizohen si instrument ligjor i përcaktuar në kushtetutën e vendeve të Amerikës Latine (Rios, 2009, p. 5), për të mbrojtur të drejtat individuale nga shkeljet nga autoritetet publike ose (në disa vende) nga aktorët privatë (Negretto, 2018).

Pavarësisht nga kjo larmi, një qëllim i përbashkët i amparos është t'i mbrojë, përmes vendimit gjyqësor, të gjitha ose një pjesë të drejtave të njeriut, qoftë në formë individuale apo në grup (Zamudio Fix, 1981, p. 366). Duhet të theksohet se përveç të qenurit një mbrojtje specifike për të drejtat kushtetuese, padia amparo mund të konsiderohet gjithashtu një veprim i përgjithshëm gjyqësor për të mbrojtur supremacinë e kushtetutës (Brewer-Carías A. , 2009, p. 86).

Actio popularis është ankimim tjetër që ka natyrë kushtetuese dhe shërben për mbrojtjen gjyqësore të drejtave në interes të publikut të gjerë dhe që drejtohet kryesisht ndaj një ligji kur pretendohet shkelja e një të drejte kushtetuese (Sadushi, 2012, f. 317).

Një formë e veçantë e ankimit kushtetues është edhe ankimi që përgjithësisht ushtrohet për një interes privat e që i referohet akteve të veçanta qofshin ato akte administrative ose vendime gjyqësore për dallim nga ankimimi popullor apo *actio popularis* që ushtrohet ndaj një ligji dhe për një interes publik (Sadushi, 2012, f. 317).

5.7. Disa nga rastet e cenimit të drejtave dhe lirive kushtetuese në Republikën e Kosovës

Në praktikën e gjyqësisë kushtetuese është çështje e diskutueshme se a mund qytetarët të kërkojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese të tyre para Gjykatave Kushtetuese (Bajrami, A. et. al., 2015), lidhur me këtë ekzistojnë dy praktika kushtetuese ku kërkesa individuale mund të ushtrohet për ta vënë në lëvizje gjyqtarin kushtetues dhe atë: drejtpërsëdrejti (modeli evropian) dhe incidentalisht ose prapësimi (modeli amerikan) (Bajrami, A., & Muçaj, F., 2018, f. 464).

Megjithatë gjyqtari kushtetues mund të vihet në lëvizje drejtpërsëdrejti nga individë në shumë vende të Evropës. Sa i përket rastit të Kosovës, në bazë të nenit 113 par. 7 të Kushtetutës, "Gjykata Kushtetuese obligohet t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut". Kështu, ajo ka kompetencë që të vendos për shkeljet që kryhen nga autoritet publike ndaj të

drejtave dhe lirive individuale të garantuara me kushtetutë, duhet potencuar se në këtë rast palë të autorizuar janë vetëm individët. Prandaj, mbrojtja kushtetuese e të drejtave dhe lirive të njeriut është e karakterit ndihmës.

Nga praktika kushtetuese në raport me referimin e kërkesave kushtetuese nga individët dëshmohet se “ka mjaft avancim në vetëdijësimin e palëve për nevojën e shterimit të mjeteve juridike para se të parashtrojnë ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, dhe për dallim kur në fillim Gjykata Kushtetuese refuzonte shumë raste për këtë pikë, tani më ato janë më të rralla! Kjo për shkak të praktikës dhe vetëdijesimit edhe të avokatëve që në fillim nuk kishin njohuri se çka nënkuptonte në praktikë shterimi i mjeteve juridike” (Rama, 2021).

Sa i përket nocionit individ, kushtetuta nuk e specifikon në këtë nen se kush konsiderohet individ që mund të ketë qasje në Gjykatën Kushtetuese, megjithatë përderisa “të drejtat dhe liritë themelore të garantuara sipas nenit 21 të Kushtetutës, vlejnë edhe për personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) atëherë edhe këta konsiderohen palë të autorizuar krahas personave fizikë, këtë vlerësim ka bërë edhe Gjykata Kushtetuese përmes jurisprudencës së saj, duke i dhënë të drejtë edhe personave juridikë që të paraqesin ankesë kushtetuese (AAB-RIINVEST L.L.C., 2010). Në rastin e mbrojtjes të drejtave dhe lirive kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ushtron kontroll konkret, ngase objekt kontrolli është akti konkret i autoritetit publik nga i cili derivon shkelja. Prandaj edhe kërkohet që pala e autorizuar domosdoshmërisht të qartësojë “pretendimin se cilat të drejta dhe liri janë shkelur dhe aktin konkret të autoritetit publik me të cilin është kryer kjo shkelje” (Ligji nr. 03/L-121 , 2008).

5.8. Mënyra e referimit incidental në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Modeli evropian i kontrollit ushtrohet në mënyrë të centralizuar, “me anë të pezullimit që gjykatat e rregullta i bëjnë çështjes në shqyrtim dhe dërgimit të saj në Gjykatën Kushtetuese” (Sadushi, 2012, f. 150). Një kontroll të tillë e ushtron edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ku sipas nenit 113 par. 8 të kushtetutës “gjykatat e rregullta mund të referojnë çështje për kushtetutshmërinë e një ligji të ngritur gjatë procedurës gjyqësore, nëse kjo e fundit është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për kushtetutshmërinë e këtij ligji dhe nëse vendimi i gjykatës referuese është i varur nga kushtetutshmëria e këtij ligji” (Baza ligjore-GJKRK, n.d.).

Ky lloj i kontrollit kushtetues quhet referim incidental. “Gjykata referuese e inicion këtë lloj të kontrollit ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në rast”¹¹ (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018). Të dhënat statistikore për periudhën 2009-2019, tregojnë se Gjykata Kushtetuese ka pranuar dhe shqyrtuar tre raste nga gjykatat e rregullta respektivisht, Gjykata Supreme dhe Komunale në Ferizaj, dega Shtërpcë në vitin 2011. Rastet ishin (GJKRK, Vendimet, 2009-2019): “nr. KO 04/11”, “nr. KI 158/11” dhe “nr. KO 157/18”.

Kërkesa e parë, në rasti nr. KO 04/11 ishte parashtuar ex officio nga gjykata referuese këtu Gjykata Supreme, ndërsa kërkesat e tjera si ajo në rastin nr. KI 158/11 dhe nr. KO 157/18 kanë qenë të parashtuara në Gjykatën Kushtetuese nga gjykata referuese me kërkesën e njëres nga palët në rast.

Si përfundim duhet potencuar se veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese është e rëndësishme në aspektin e së drejtës dhe në aspektin politik, sepse ajo kontrollon mënyrën se si pushtetet politike të shtetit, në radhë të parë ai ligjvënës, respektojnë Kushtetutën, e cila ka një karakter politik. Por të gjykosh një çështje e cila ka lidhje me politikën nuk do të thotë të gjykosh politikisht (Omari, 2011, f. 126).

6. Ndikimi i Gjykatës Kushtetuese në garantimin e parimeve të shtetit të së drejtës

“Demokracia, të drejtat e njeriut, shteti i së drejtës: tri shprehje që qëndrojnë së bashku si ajri, toka dhe uji”. Ato janë të ndërrvarura”. Siç ka thënë Lordi Woolf, një ish-kryeprokuror anglez (2008): “Të drejtat e njeriut vijnë me demokracinë, pavarësisht nëse qeveria i dëshiron ato apo jo”, dhe ata vijnë të mbështetur nga shteti i së drejtës (Cowdery, f. 1).

Gjykata Kushtetuese përmes kontrollit kushtetues garanton aplikimin e parimeve themelore nga të gjitha institucionet kushtetuese, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton disa prej elementeve të domosdoshme të demokracisë, pra të shtyllave që e përbëjnë shtetin e së drejtës (Hasani, E., & Cukalovic,

¹¹ Neni 77 par. 4.

I., 2013, fv. 23-24) si: “zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta për konstituimin e pushtetit”; “garancia kushtetuese e të drejtave dhe lirive themelore dhe mbrojtja e tyre” “ndarja dhe kufizimi i pushteteve shtetërore”; “pavarësia e gjyqësorit - siguria juridike dhe “nënshtrimi i pushtetit shtetëror ndaj kushtetutës dhe ligjit”. Është e rëndësishme që këto elemente që njëherit përbëjnë shtetin e së drejtës të zbatohen edhe në praktikë.

Në këtë drejtim sa i përket shtyllës së parë që ka të bëjë me “zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta”, veçohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese “nr. KO 84/18” dhe “nr. KO 72/20”.

Rasti “nr. KO 84/18”, kishte të bënte me zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, ku Gjykata kishte sqaruar se “ruajtja e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë në konstituimin e Kuvendit, të qeverisur nga sundimi i ligjit” që realizohet duke respektuar Kushtetutën e cila përcakton të drejtën për të propozuar kandidatë për tre pozita të nënkryetarëve u takon tre grupeve më të mëdha parlamentare (A. Kurti dhe 11 deputetë të tjerë, 2018).

Edhe në rastin “nr. KO 72/20”, Gjykata Kushtetuese jetësimin e shtetit të së drejtës në Kosovë e interpreton në raport me respektimin e pavarësisë së pushteteve shtetërore që përbën thelbin e parimit të ndarjes së pushteteve shtetërore. Më tej, ajo kishte elaboruar në përgjithësi vlerat kushtetuese, ku ndër të tjera përmend si vlerë kushtetuese edhe shtetin e së drejtës dhe se “kushtetuta përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës ku të gjitha pushtetet dhe bartësit e funksioneve publike, obligohen t’i kryejnë detyrat e tyre publike në shërbim të jetësimit të vlerave dhe parimeve kushtetuese përfshirë këtu edhe shtetin e së drejtës” (R. Selimi dhe 29 deputetë të tjerë, 2020, f. 152).

Sa i përket shtyllave të tjera përbërëse të shtetit të së drejtës në Kosovë që janë “garancia kushtetuese e të drejtave e lirive themelore” dhe “pavarësia e gjyqësorit-siguria juridike dhe mbrojtja e të drejtave” veçojmë në vijim disa nga rastet që i janë nënshtruar kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese.

Në rastin “nr. KO 61/20”, Gjykata Kushtetuese kishte sqaruar respektimin e vlerave themelore kushtetuese të lidhur me “ndarjen e pushteteve shtetërore, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, pavarësinë dhe autoritetin e Gjykatës Kushtetuese dhe mbrojtjen e sundimit të ligjit”, që përbëjnë detyrim kushtetues për të gjitha degët e pushtetit të Republikës së Kosovës (U. Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë, 2020).

Në rastin tjetër “nr. KI 08/09”, parashtruesit kontestonin aktvendimin e Gjykatës Komonale të Ferizajt, të datës 6 tetor 2008, pasi konsideronin që me këtë të fundit ishte bërë shkelje e “parimit *res judicata*” të garantuar me kushtetutë në përbërjen e “të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Kështu, Gjykata parimin *res judicata* e interpreton në lidhmëri me respektimin e parimit të sigurisë juridike, si rrjedhojë vendimet e plotfuqishme nuk ka mundësi të rishqyrtohen pasi ato do të krijonin pasiguri juridike dhe zbehnin besimin e opinionit të sundimi i ligjit (Sindikata e Pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut, 2010).

Në vijim në rastin “nr. KI 55/11”, parashtruesi me kërkesën e tij kushtetuese kontestonte kushtetutshmërinë e Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren me të cilin pretendonte se ishin shkelur parimet e përgjithshme kushtetuese si dhe “e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit”. Sipas Gjykatës Kushtetuese, sundimi i ligjit përbën një prej parimeve kryesore në një shoqëri demokratike, që ka lidhmëri me respektimin e parimit të sigurisë juridike në veçanti në rastin kur vendimet gjyqësore janë të formës së prerë janë të përmbarueshme dhe në këtë rast nuk kanë të drejtë të kërkojë rishikimin pasi do të ndikonte edhe në zvogëlimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor (F. Pireci , 2012).

Në rastin “nr. KO 43/19”, parashtruesit në kërkesën e tyre kushtetuese kontestonin se nuk ishin në përputhje me kushtetutën disa nene të “Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë.” Në anën tjetër Gjykata Kushtetuese kishte dhënë interpretimin e saj duke sqaruar se rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në vlerat demokratike të ndarjes së pushtetit dhe sundimit të ligjit, duke vazhduar më tej dhe duke sqaruar organet që ushtrojnë pushtetet shtetërore dhe se ligjin e kontestuar e kishte shpallur në papajtueshmëri me kushtetutën, pasi ndërhynte në formën e qeverisjes, ndarjen e pushtetit, si dhe cenonte vlerat demokratike dhe sundimin e ligjit (A. Haxhiu, D. Selmanaj dhe 30 deputetë të tjerë, 2019).

Elaborimi i sundimit të ligjit është bërë edhe në rastin “nr. KO 65/19”, ku është sqaruar nga Gjykata Kushtetuese se organi legjislativ ka autorizim kushtetues që t’i caktojë të drejtat dhe detyrimet, kjo njëherit nënkupton edhe autorizimin për të ndryshuar përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve, por obligohet t’i respektojë kërkesat e vendosura nga Kushtetuta, sidomos ato që rrjedhin nga parimi i sundimit të ligjit dhe ato me të cilat mbrohen të mirat dhe vlerat kushtetuese të caktuara (Avokati i Popullit, 2019).

Në rastin “nr. KI 214/19”, Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar se një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit ishte parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit res judicata, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore dhe se sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, duke vazhduar me elaborimin e njëjtë sa i përket sundimit të ligjit sikurse në rastin e mëhershëm “nr. KI 08/09” (M. Koka, 2020).

Në rastin “nr. KI 27/20” interpretimin e shtetit të së drejtës Gjykata Kushtetuese e kishte bërë duke iu referuar praktikës së GJEDNJ, sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut të cilat kanë për qëllim “krijimin dhe ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë të udhëhequr nga sundimi i ligjit” (Lëvizja Vetëvendosje, 2020).

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës, respektivisht nga rastet e elaboruara më sipër, dominojnë rastet që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si shtyllë e shtetit të së drejtës, ku objekt i kërkesave kushtetuese ishin kryesisht vendimet e Gjykatave Themelore, të Apelit dhe Supreme dhe kanë dominuar pretendimet për shkelje të sundimit të ligjit, sigurisë juridike, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore, e drejta për mjete juridike, barazia para ligjit, e drejta e pronës.

Shtyllë tjetër e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës është ndarja dhe kufizimi i pushteteve shtetërore që përfaqësohet me një nga vendimet më të rëndësishme ku Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar shkeljen e disa elementeve të shtetit të së drejtës ishte rasti “nr. KO 219/19” lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së “Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik” si rrjedhojë edhe kishte shpallur të pavlefshëm në tërësi këtë ligj, pasi kishte konstatuar se kishte probleme të nivelit kushtetues, ndër to ishte kundërshtimi me vlerat kushtetuese si “ndarja e pushteteve” dhe “sundimi i ligjit”, e që ndarja e pushteteve si parim thelbësor i nivelit më të lartë kushtetues është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit, por përveç kësaj, aty parashihen edhe “mekanizmat e kontrollit dhe balancit në mes tyre që përbëjnë thelbin e mënyrës se si këto pushtete duhet të kontrollojnë dhe balancojnë njëra-tjetrën” pa krijuar ndonjë “ndërhyrje” apo “varësi” kundërkushtetuese në mes tyre (Avokati i Popullit, 2020).

Andaj, si përfundim në forcimin dhe respektimin e parimit të sundimit të ligjit në Kosovë vërejmë se Gjykata Kushtetuese kishte rol me shumë vlerë, e cila përmes jurisprudencës së saj kushtetuese, ka arritur të identifikojë dhe përpunojë parime si

kushtetutshmëria, sundimi i ligjit, ndarja e pushteteve shtetërore, kontrolli dhe balancimi i pushteteve shtetërore, pavarësia e gjyqësorit, siguria juridike, besimi i qytetarëve në institucionet publike, demokracia kushtetuese dhe të drejtat dhe liritë e njeriut.

7. Llojet e vendimeve kushtetuese, opinionet e gjyqtarëve, efekti juridik dhe zbatueshmëria e tyre

7.1. Llojet e vendimeve

Teoritë e interpretimit kushtetues dhe gjykimit kushtetues kërkojnë të krijojnë një model të rishikimit kushtetues i cili u mundëson gjykatave t'u përgjigjen edhe çështjeve të vështira pa shkelur kufijtë e ushtrimit legjitim të pushtetit të rishikimit (Uitz, 2005, f. 1).

Gjithmonë gjykimi bëhet sipas metodës juridike, dhe roli politik i një Gjykate Kushtetuese që shprehet përmes garantimit e respektit të ligjit themelor, të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në qetësimin dhe normalizimin e jetës politike, duke zgjidhur mosmarrëveshjet midis pushteteve shtetërore si dhe midis maxhorancës dhe opozitës, sigurohet më mirë po të jetë sa më rigoroz dhe bindës arsyetimi juridik.

Për sa i përket shkrimit të opinionit, shumica dërmuese e gjykatave kushtetuese post-komuniste mbështeten në të ashtuquajturin model francez, i cili zakonisht nuk përfshin një deklaratë të hollësishme të arsyeve për vendimin. Për më tepër, megjithëse shumë gjykata zyrtarisht sanksionojnë votat dhe mendimet mospajtuese, ato shpesh nuk botohen dhe vetëm fakti se ka pasur mendim mospajtes shënohet në opinionin e shumicës (Bumin, 2009, fv. 30-31). Një model alternativ i shkrimit të opinionit, modeli gjerman/amerikan, përfshin një diskutim të hollësishëm të argumenteve dhe kundërargumenteve dhe arsyet e zbatueshmërisë të opinionit të shumicës, si dhe në mendimet kundërshtuese, por që shumë pak gjykata post-komuniste aktualisht ndjekin këtë model në praktikë (Bumin, 2009, fv. 30-31).

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese me sjelljen e saj, si gjatë marrjes së vendimeve, ashtu edhe më pas duke avokuar për vendime të tilla, ka bindur me sukses publikun se edhe pse njerëzit nuk mund të pajtohen me vendimet e saj, ata ende duhet t'i respektojnë ata. Në këtë kuadër, merita duhet t'i takojë të gjithë brezave të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm sa i përket forcimit të institucionit të Gjykatës Kushtetuese, por edhe

ndërgjegjësimi për vlerën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë - pra për forcimin e një shteti të sunduar nga ligji - por gjithashtu, shumë e rëndësishme për forcimin e kulturës ligjore.

Duke qenë se Gjykata thirret për të gjykuar mbi kushtetutshmërinë e ligjeve dhe akteve me fuqi ligjore nuk ka dyshim që nëse e vërteton antikushtetutshmërinë e tyre duhet ta deklarojë me vendim. Megjithatë si në gjykimin incidental ashtu edhe në atë kryesor, objekti i vendimit të Gjykatës është “çështja” siç ajo paraqitet nga palët dhe nga gjyqtari. Pra, Gjykata nuk i lejon zgjerorë sferën e gjykimit të saj por (parimi i përputhshmërisë mes asaj që kërkohet dhe asaj që shpallet) në shpalljen e vendimit, duhet t’i përmbahet asaj që i është kërkuar dhe të mos e zgjerorë “*thema decidendum*” përtej kufijve në të cilët është formuluar nga palët dhe nga gjyqtari, sipas një parimi të së drejtës procedurale (*ne eat iudex extra petita partium*) përkufizuar si “parimi i përputhshmërisë mes asaj që kërkohet dhe asaj që shpallet” (Martines, 2011, fv. 352-353).

Kështu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës sipas rregullit 59 të Rregullores së Punës GJKRK miraton: aktgjykime, aktvendime, vendime kur vendos për kërkesat për masë të përkohshme, vendime administrative dhe urdhra.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me aktgjykim vendos në bazë të meritave të një kërkesë ndërsa me aktvendim vendos për papranueshmërinë e kërkesës.

7.2. Disa prej opinioneve të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës

Rregullorja e Punës e GJKRK, në rregullin 58, 61 dhe 62 ka sanksionuar këshillimet dhe votimet, mendimet mospajtuese dhe ato konkurruese.

Gjykata do të mbledhet për këshillim lidhur me kërkesën sa më parë në rastet kur nuk paraqitet nevoja për dëgjim apo edhe shtyrje të seancës dëgjimore. Edhe këshillimet e Gjykatës Kushtetuese njëlloj sikurse këshillimet e Gjykatave Themelore, të Apelit dhe Supreme i karakterizon parimi i konfidencialitetit, pra nuk janë të hapura për publikun.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren “me shumicë të votave të gjyqtarëve”, ku gjyqtarët po ashtu i njihet e drejta që t’i shprehin mendimet e tyre mospajtuese dhe konkurruese.

Sa i përket mendimit mospajtues, gjyqtari e përgatit mendimin mospajtues me shkrim, të cilin duhet ta arsyetojë se përse nuk pajtohet me mendimin e shumicës së gjyqtarëve. Këtë mendim mospajtues e përgatit vetëm ndaj rasteve që përfundojnë me aktgjykim. Edhe “gjyqtarët e tjerë mund t’i bashkëngjiten mendimit mospajtues, por edhe këta të fundit duhet ta arsyetojnë mendimin e tyre mospajtues” (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018).

Krahas mendimit mospajtues, gjyqtari mund të japë edhe mendim konkurrues. Mendimi konkurrues jepet në rastin “kur gjyqtari pajtohet me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, por jo edhe me arsyetimin e dhënë”, të cilin e përgatit vetëm ndaj aktgjykimit të Gjykatës, i cili në këtë rast “voton njëjtë me shumicën, pra e përkrah aktgjykimin e Gjykatës por nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë, andaj ai duhet ta arsyetojë këtë përmes mendimit të tij konkurrues”. Edhe “gjyqtarët e tjerë mund t’i bashkohen mendimit konkurrues, por se duhet t’i sqarojnë arsyet pse nuk pajtohen me arsyetimin e dhënë nga shumica e Gjykatës” (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018).

Ndërsa në rastet që përfundojnë me aktvendim për papranueshmëri apo merret vetëm një vendim, vetëm potencohet se gjyqtari nuk është pajtuar me shumicën e gjyqtarëve ndërsa nuk ka të drejtë të përgatisë mendim mospajtues apo edhe konkurrues sikurse në rastet kur përfundojnë me aktgjykim.

Nga praktika kushtetuese veçojmë rastin “nr. KO 61/12”, në të cilin gjyqtari ndërkombëtar Robert Carolan kishte dhënë njëkohësisht mendim konkurrues dhe mospajtues lidhur në të njëjtin amendament, respektivisht mendim konkurrues kishte dhënë për amendamentin e propozuar 2 (Ndryshimi i nenit 108-përbëra e Këshillit Gjyqësor) dhe një pjesë të amendamentit 1 (Amnistia), ndërsa njëkohësisht mendim mospajtues kishte dhënë për fjalinë e parë të amendamentit të propozuar për amnistinë (R. Carolan-Mendim konkurrues dhe mospajtues, 2012) si dhe rastin KO 108/13, në të cilin gjyqtari Almiro Rodrigues kishte dhënë njëkohësisht mendim konkurrues dhe mospajtues.

Po ashtu, praktikën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës e kanë shoqëruar edhe rastet në të cilat gjyqtarët kanë shprehur mendimet e tyre mospajtuese të përbashkëta, këtu theksoj rastin “nr. KI 78/12” ku kishte mendim të përbashkët mospajtues nga tre gjyqtarë, Altay Suroy, Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova (A. Suroy, A. Rodrigues, S. Botusharova-Mendim i përbashkët mospajtues, 2013), pastaj rasti nr. KI89/13 ku gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi kishin

shprehur mendimin e tyre të përbashkët mospajtues (A.Rodrigues, A.Rama-Hajrizi-Mendim mospajtues, 2014), pastaj rastin nr. KO12/18 në të cilin kishte mendim të përbashkët mospajtues të gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Gresa Caka-Nimani (A. Rodrigues, G. Caka-Nimani-Mendim i përbashkët mospajtues, 2018) si dhe rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, 149/17 dhe 150/17 ku mendim të përbashkët mospajtues kishin dhënë gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova (A. Rodrigues, S. Botusharova-Mendim i përbashkët mospajtues, 2018).

Mendime mospajtuese janë dhënë ndaras nga gjyqtarët edhe në rastin e njëjtë, siç është rasti nr. KI 11/09, ku mendime mospajtuese sa i përket vendimit për masë të përkohshme u dhanë të arsyetuara ndarazi nga gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj (A. Rodrigues-Mendim mospajtues, 2009), (Gj. Mushkolaj-Mendimi mospajtues, 2009).

Dallohet rasti nr. KI 34/17, në të cilin njëkohësisht kishte mendim mospajtues nga gjyqtarët Altay Suroy dhe Bekim Sejdiu me arsyetimin e përbashkët (Mendimi mospajtues i gjyqtarëve Altay Suroy dhe Bekim Sejdiu ndaj aktgjykimit në rastin nr. KI 34/17, 2017) si dhe mendim mospajtues ndaras nga këta kishte dhënë edhe gjyqtarja Gresa Caka-Nimani (G. Caka-Nimani-Mendim mospajtues, 2017).

Për periudhën 2009-2019, mendime konkurruese u dhanë nga gjyqtari Almiro Rodrigues në rastet “nr. KO 01/09” dhe “nr. KI 52/12” dhe gjyqtari Robert Carolan në rastin “nr. KI 78/12”.

Në përgjithësi nga analiza e praktikës kushtetuese në Kosovë që nga themelimi e deri në vitin 2019 konkludoi se kanë dominuar mendimet mospajtuese në raport me ato konkurruese, dhe se në dhënien e mendimeve mospajtuese por edhe atyre konkurruese u dalluan gjyqtarët ndërkombëtarë si Almiro Rodrigues dhe Robert Carolan, të pasuar nga gjyqtarët vendorë.

Duhet potencuar edhe faktin se në rastin kur rezultati i votimit të gjyqtarëve të pranishëm në këshillim është i barabartë, atëherë kërkesa konsiderohet e papranueshme (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018).

7.3. Efektet juridike të vendimeve kushtetuese

Efektet juridike të vendimeve gjyqësore varen nga procedura para Gjykatës Kushtetuese. Nëse Gjykata vendos për vendimet administrative, efekti kufizohet te palët (efekti *inter partes*). Efektet e përgjithshme, *erga omnes* zbatohen për vendimet e Gjykatës Kushtetuese sa i përket anulimit të akteve legislative ose urdhëresave të përgjithshme administrative (Brewer-Carías A. , 2011, f. 257).

Ish-gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në Gjermani, Helmut Steinberger, sa i përket vendimeve kushtetuese dallonte tri lloje kryesore të tyre të cilat për nga efektet i klasifikonte në (Steinberger, 1994): “vendime me efekt të gjësë së gjykuar apo *res judicata*, vendime me efekt *erga omnes* (duke shkuar përtej efekteve të *res judicata*), si dhe vendime me efekt të barabartë me ligjet formale apo vendime që kanë forcën e ligjit”.

Sa i përket vendimeve me efekt të gjësë së gjykuar apo *res judicata*, ato prodhojnë efekt *inter partes*, prandaj si të tilla vlejné vetëm për individin i cili është palë në procedurën kushtetuese, po ashtu ky vendim ka edhe elementin ndalues i cili manifestohet në drejtim të ndalimit të gjykatës kushtetuese që të trajtojë përsëri çështjen të cilën e ka shqyrtuar dhe vendosur me vendim kushtetues (Steinberger, 1994). Nga këto karakteristika të vendimeve që prodhojnë efekt *res judicata*, theksoi se kjo vlen në rastin e kontrollit kushtetues konkret pasi vlen vetëm për individin që është palë në procedurë respektivisht ka efekt *inter partes*.

Ndonëse “Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nuk e përcakton fushëveprimin e parimit *res judicata*, respektimi i këtij parimi është institut i nënkuptuar për parimin e shtetit të së drejtës për të siguruar një shkallë adekuate të sigurisë dhe stabilitetit juridik në zgjidhjen e kontesteve juridike” (Morina, 2013, f. 114).

“Një atribut tipik i gjykatave kushtetuese, sipas modelit evropian, është efekti *erga omnes* i vendimeve të tyre” (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2017), që nënkupton se prodhojnë pasoja juridike ndaj të gjithëve. Ky atribut materializohet edhe në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës pasi “vendimet e saj janë të detyrueshme për zbatim për gjyqësorin, të gjithë personat si dhe institucionet e Republikës së Kosovës” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Këtu e vërejmë efektin *erga omnes* që e kanë vendimet i cili manifestohet te kontrolli kushtetues abstrakt. Njëherit, ato shpallen në Gazetën Zyrtare dhe hyjnë në fuqi në ditën e publikimit, pra publikimi është moment i rëndësishëm pasi nga aty fillojnë dhe vendimet prodhojnë pasoja juridike.

7.4. Zbatueshmëria e vendimeve të Gjykatës kushtetuese

Pas shpalljes në Gazetën Zyrtare vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohet. Por, “kur vendimi nuk zbatohet atëherë Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë aktvendim për publikim e tij në Gazetën Zyrtare në cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar” dhe zakonisht kjo mund të ndodh në dy situata (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018):

- e para është kur vendimi nuk është zbatuar dhe
- e dyta kur është vonuar dhënia e informacioneve për masat e ndërmarra për zbatim.

Kështu lind detyrimi i “sekretariatit që nën mbikëqyrjen e gjyqtarit relatues, të mbikëqyrë zbatimin e vendimit, dhe sipas nevojës, do t’i raportojë dhe rekomandojë Gjykatës marrjen e masave të nevojshme për të siguruar ekzekutimin e vendimit” (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018).

Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018, në rregullin 66 pika (7) përcakton që "Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar".

Në praktikën kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është sfiduar edhe me moszbatimin e vendimeve të saj nga organi i cili ka qenë i ngarkuar me detyrimin për zbatim. Edhe pse duhet potencuar fakti se nga themelimi e deri në vitin 2020 numri i aktgjykimeve që nuk janë zbatuar është i shumë i vogël, që nënkupton se me sukses Gjykata Kushtetuese ka arritur që vendimet e veta t’i materializojë edhe në praktikë nga subjektet që kanë qenë të obliguara t’i zbatojnë.

Vendimi i parë i Gjykatës Kushtetuese i cili nuk është zbatuar, ishte aktgjykimi në rastin nr. KO01/09, i cili ishte nxjerrë me dt. 18 mars 2010 dhe ku ishte konstatuar “shkeljen e të drejtave të komuniteteve joshumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre”, andaj edhe e kishte “urdhëruar komunën e Prizrenit të ndryshonte Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet joshumicë”, këtë ndryshim ta realizonte brenda periudhës “prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi”, krahas kësaj Gjykata kërkonte nga komuna e Prizrenit t’i raportonte asaj lidhur me zbatimin e këtij aktgjykimi të cilin raportim duhet ta bënte “para skadimit të periudhës prej tre muajve prej dorëzimit të këtij aktgjykimi” (Q. Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, 2010).

Si rrjedhojë, në prag të përmbushjes së afatit tremujor brenda së cilit komuna e Prizrenit duhej të raportonte lidhur me zbatimin e Aktgjykimit, më datë 7 qershor 2010 kryetari i Gjykatës Kushtetuese i drejtohet kryetarit të komunës dhe njëherit edhe ia tërheq vëmendjen lidhur me këtë raportim që duhej të bënte komuna (Urdhëra tjerë, 2010).

Prandaj, më 17 qershor 2010 kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, i kishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese një letër lidhur me zbatimin e aktgjykimit të mësipërm ku e njoftonte se ishin ndërmarrë masa përgatitore për zbatimin e tij, si dhe njëherit kishte kërkuar një periudhë shtesë prej 60 ditësh në mënyrë që ta realizonte zbatimin e aktgjykimit, për çka gjeti mbështetjen e Gjykatës Kushtetuese dhe periudha shtesë iu aprovua (Urdhër-Q. Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, 2010).

Moszbatim të vendimit kemi pasur edhe në rastin nr. KI 08/09, ku Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar “shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm dhe të drejtës për zgjidhje efektive, ku kishte urdhëruar që vendimi përfundimtar i Gjykatës Komonale në Ferizaj duhej të zbatohet nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit”. Këtë aktgjykim Gjykata Kushtetuese e nxjerri më 17 dhjetor 2010 dhe njëherit sipas rregullave procedurale i kishte “detyruar këto organe që të dorëzonin në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtëmujore, informacione lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi”.

Nga analizimi i veprimeve të ndërmarra në këtë rast konkludoi se kishin kaluar dy vite nga nxjerrja e Aktgjykimit dhe nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim sa i përket zbatimit të tij nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, prandaj edhe Gjykata Kushtetuese në vitin 2012 kishte vendosur ta publikojë vendimin për moszbatim të aktgjykimit të saj. Edhe ky i fundit nuk është se ndikoi në zbatimin e Aktgjykimit prandaj në bazë të kompetencave të saj kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, më 28 maj 2019 kishte njoftuar Kryeprokurorin e Shtetit për moszbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast (Njoftim për moszbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI 08/09, 2019).

Rasti tjetër ku kemi pasur mosekzekutim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ishte njoftuar edhe prokurori i shtetit, ishte rasti me “nr. KI187/13”.

Gjykata Kushtetuese në këtë rast kishte marrë aktgjykim më 1 prill 2014, dhe kishte gjetur “shkelje të Kushtetutës të KEDNJ dhe të Protokollit 1 të saj, prandaj edhe urdhëroi që vendimin “nr. KPCC/D/ A/114/2011”, duhet ta përmbaronte Agjencia Kosovare e Pronës” (N.Jovanovic, 2014). Kjo e fundit në afat prej 3 (tre) muajve, obligohej ta informonte

Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, të cilin obligim e kishte respektuar kjo agjenci dhe më 15 korrik 2014 kishte dorëzuar përgjigje lidhur me zbatimin e këtij aktgjykimi. Por, pas kësaj përgjigje më agjencia nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, edhe përkundër, përpjekjeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me zbatimin e këtij aktgjykimi Agjencia Kosovare e Pronës nuk tregoi gadishmëri, andaj në këto rrethana konform rregullit 66 § 7 (Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018, 2018), u informua kryeprokurori i shtetit për moszbatimin e aktgjykimit “KI 187/13” (Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13, 2015).

Theksoj se refuzimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese pengon ndërtimin e shtetit të së drejtës, andaj në rastin e Kosovës në raport me vendimet e nxjerra nga Gjykata Kushtetuese një pengesë të tillë nuk e kemi pasur të manifestuar shumë, kjo sepse gjatë praktikës kushtetuese vërejmë numër të pakët të rasteve ku nuk janë zbatuar vendimet e gardianit të Kushtetutës, respektivisht vetëm dy raste ku Gjykata Kushtetuese kishte publikuar vendimin për moszbatim të aktgjykimit të saj dhe një rast i natyrës më të rëndë i cili kishte përfunduar me njoftim të prokurorit të shtetit.

Vendimet gjyqësore, për nga natyra e tyre, mirëprehen nga njëra palë dhe refuzohen nga pala tjetër, në varësi të interesave të ndryshme. Kjo vlen veçanërisht për vendimet që merren nga një Gjykatë kushtetuese, që gjithmonë thirret që të vendosur mbi çështjet që dalin nga ideologjitë konfliktuale ose interesat politike ose shoqërore. Në këtë drejtim, një gjë nuk duhet të neglizhohet: pavarësisht nëse Gjykata kushtetuese e shpall një ligj jokushtetues, ose e gjen një ligj që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, vendimi i saj gjithmonë tregon përmbajtjen e Kushtetutës në terma më konkret.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës janë të formës së prerë dhe kanë efekt përfundimtar lidhur me një çështje, kjo pasi është ky institucion që e jep fjalën e fundit për zgjidhjen e çështjes kushtetuese. Por, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat janë të formës së prerë në momentin e hyrjes në fuqi kanë mangësi në formën e zbatimit të tyre në krahasim me vendimet e Gjykatave të tjera që janë pjesë e pushtetit gjyqësor të cilat e kanë të siguar përmbartimin përmes Gjykatës Themelore për çështjet përkatëse si dhe të përmbartuesit privat në rastet e përmbartimit të aktgjykimeve dhe aktvendimeve të formës së prerë. Ndërsa, te Gjykata Kushtetuese zbatimi i vendimeve të saja ka ngelur te vullneti i zbatimit nga organi i cili është përfshirë në vendimin kundërkushtetues, përkatësisht në vullnetin e “detyrimit” të organit kompetent që ta

zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Pra, këtu qëndron zbrazëtira juridike për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ngase me kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht ligjin përkatës, nuk është përcaktuar organi kompetent i cili e bën apo duhet ta bëjë ekzekutimin e vendimit të gjykatës kushtetuese.

Prandaj caktimi i organit përkatës për përmbarimin e jo zbatimin e vendimeve të Gjykatës kushtetuese ka zbrazëti të juridike e cila doemos duhet të zgjidhet.

Pra, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ekzekutohen por vetëm zbatohen me vullnetin e organit, vendimi i të cilit është vërtetuar kundërkushtetues, përkatësisht me formën më të fortë të zbatimit me nulshmërinë e dispozitës apo të ligjit kundërkushtetues në zbatueshmërinë e tij, ato cilësohen si të vetëzbatueshme.

Në këtë drejtim moszbatimi i aktgjytimeve kushtetuese nga disa njohës të së drejtës kushtetuese cilësohet edhe si vepër penale duke iu referuar Kodit Penal i Republikës së Kosovës, nenit 394 ku është sanksionuar “mosekzekutimin i vendimeve gjyqësore për të cilin ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, në rastin kur është shkaktuar shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore” (Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, 2019). Ndonëse kjo dispozitë juridike në Kodin Penal, respektivisht përgjegjësia penale nuk mund të aplikohet për vendimet kushtetuese, kjo duke e pasur parasysh statusin e gjykatës kushtetuese e cila nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor dhe nuk është as si organet e tjera kushtetuese, andaj mendoj se përgjegjësia penale vlen për vendimet gjyqësore të Gjykatave Themelore, Apelit dhe Supreme, kjo meqë Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor dhe si rrjedhojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin e Kosovës vetë ekzekutohen me vullnet në pajtueshmëri me parimin e supremacisë së kushtetutës. Si rrjedhojë dështimi për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje të pastër kushtetuese sipas nenit 116 par.1 të Kushtetutës së Kosovës (Morina, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), 2013, f. 119).

8. Historiku i themelimit të Komisionit të Venecias dhe anëtarësimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Ideja për ta themeluar një organ të përbërë nga avokatët/juristët më të shquar që ishin në dispozicion për të ofruar këshilla në çështjet kushtetuese ishte e Antonio La Pergola, themeluesi i Komisionit të Venecias dhe president i parë, i cili në këtë periudhë të themelimit të Komisionit të Venecias ishte Ministër i Punëve Evropiane të Italisë, ky funksion ishte vendimtar lidhur me mbështetjen e nevojshme për ta themeluar këtë organ, i cili ëndërronte për krijimin e një "shtëpie të përbashkët për gjyqtarët" ku konstitucionalistët do të takoheshin dhe do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi problemet e përbashkëta të së drejtës kushtetuese (Buquicchio G. &, 2018, p. 517). Po ashtu, ndër të tjera ishte edhe profesor i së drejtës kushtetuese me famë të jashtëzakonshme ndërkombëtare dhe kishte qenë gjyqtar dhe kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Italisë (Buquicchio G. &, 2018, p. 517).

Krahas kësaj, themelimit të këtij komisioni i kishin paraprirë në atë kohë edhe rënia e regjimit komunist në Poloni në vitin 1989, i pasuar nga rënia e Murit të Berlinit në nëntor të vitit 1989, dhe rrëzimi i qeverive komuniste në Çekosllovakë, Rumani, Bullgari dhe Shqipëri në dy vitet pasuese. Kështu, pas këtyre ndodhive La Pergola organizoi një konferencë në Venecia në janar të vitit 1990 në të cilën anëtarët e Këshillit të Evropës morën pjesë të plotësuar me anëtar vëzhgues nga disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore (Venice Commission, 1990). Ky njëherit ishte katalizatori për krijimin e Komisionit të Venecias, edhe pse marrëveshja fillestare ishte që të shërbente për dy vjet dhe anëtarësimi fillimisht ishte kufizuar vetëm për shtetet që ishin anëtare në Këshillin e Evropës (Venice Commission, 1990). Por me statutin e rishikuar në vitin 2002 i cili aktualisht është në fuqi, anëtarësimi në Komisionin e Venecias i mundësohet edhe shteteve që nuk janë anëtare në Këshillin e Evropës (Venice Commission, 2002). Pra, fillimisht objektivi kryesor i tij ishte të ndihmonte shtetet ish-komuniste në tranzicionin e tyre drejt "demokracisë dhe sundimit të ligjit", kështu gjatë njëzetepesë viteve të ekzistencës së tij, Komisioni u bë një "ndihmës kushtetues" për shtetet që ishin angazhuar në procesin e hartimit të kushtetutës së tyre apo edhe ndryshimit të saj (Velaers, 2016, p. 285).

Promovimi i drejtësisë kushtetuese ishte esenca e krijimit të "Komisionit të Venecias" apo "Komisionit Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit" (KEDL), i cili është një emër i parashikuar me Statut.

Statuti i rishikuar në vitin 2002 i Komisionit të Venecias në nenin 2 ka përcaktuar sa i përket përfaqësimit që çdo shtet përfaqësues zgjedh nga një ekspert të së drejtës kushtetuese si anëtar individual dhe zëvendës anëtarin, të cilët duhet të jenë ekspertë të shquar që kanë dhënë kontribut në forcimin e ligjit dhe zhvillimin e shkencave politike. Këta anëtarë individualë dhe zëvendësit e tyre nuk e përfaqësojnë Qeverinë e shtetit të tyre, por veprojnë në kapacitetin e tyre individual (Venice Commission, 2002). Për ta mbrojtur pavarësinë dhe për të shmangur ndonjë lloj presioni të anëtarëve, këta të fundit asnjëherë nuk veprojnë si raportues për të përgatitur opinionet për shtetet e tyre dhe as nuk votojnë për opinionet e tilla.

Sa i përket rastit të Republikës së Kosovës, anëtarësimi në Komisionin e Venecias kishte hasur në vështirësi, por insistimi i shteteve që e kishin mbështetur anëtarësimin konsistonte në faktin se autoriteteve të shtetit të Kosovës duhet t'i krijohej mundësia për të parashtruar vetë kërkesa andaj në vitin 2014 Kosova u anëtarësua në Komisionin e Venecias (Buquicchio G. , 2015). Konkretisht, në takimin e 1202-të, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës u shqyrtua dhe aprovua kërkesa e Kosovës për anëtarësim në Komisionin e Venecias dhe kështu Kosova u bë shteti i 60-të anëtar në këtë komision (Venice Commission, 2014).

Ky anëtarësim i shtetit të Kosovës në Komisionin e Venecias është vlerësuar si jetik dhe me shumë rëndësi (Morina, Intervistë përmes emailit, 2021).

9. Kompetencat e Komisionit të Venecias dhe opinionet e dhëna për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Fushëveprimi i Komisionit të Venecias sipas Statutit konsiston në: identifikimin, zhvillimin dhe promovimin e standardeve ligjore për institucionet demokratike, të drejtat e njeriut, ligjin zgjedhor dhe drejtësinë kushtetuese, po ashtu, ai jep opinione për kushtetutat dhe ligjet dhe opinione *amicus curiae* për Gjykatat Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Council of Europe, Revised Statute of the ECDL, 2002).

Roli i Komisionit është ofrimi i këshillave ligjore për shtetet anëtare, posaçërisht përgatit opinione për (draft) kushtetuta, amendamentet dhe legjislacionin e sferës kushtetuese përfshirë ligjet të cilat rregullojnë funksionimin e institucioneve shtetërore,

ndër të tjera që lidhen me Gjykatat Kushtetuese, ombudsmanin dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut, njëherit mund të jap edhe udhëzime për interpretimin e saktë të normave kushtetuese në fuqi në shtetet e caktuara (Council of Europe, Revised Statute of the ECDTL, 2002).

Mendime *amicus curie* mund të kërkojnë Gjykata Kushtetuese dhe Avokati i Popullit, ku Gjykata Kushtetuese kryesisht kërkon mendime *amicus curie* për çështjet kushtetuese në kontestuese, të cilat komisioni i analizon dhe sqaron nga perspektiva komparative apo ndërkombëtare, ndërsa në fund ia lë në diskrecion gjykatës referuese që të vendos, derisa disa gjykata kushtetuese kërkojnë opinione mbi interpretimin e së drejtës kushtetuese kombëtare, ndërsa të tjerat janë thjesht të interesuara në përputhshmërinë e ligjit të brendshëm me standardet evropiane të zbatueshme (Hoffmann-Riem, 2014, p. 592).

Lloji i fundit i veprimtarisë së Komisionit të Venecias është zbatimi aktual i parimeve dhe vlerave kushtetuese, dhe konsiston në bashkëpunimin me gjykatat kushtetuese kombëtare dhe gjithnjë e më shumë me shoqatat që i bashkojnë këto organe gjyqësore në baza rajonale ose gjuhësore (Council of Europe, Revised Statute of the ECDTL, 2002).

Palët e autorizuar për të kërkuar mendim nga ky komision përcaktohen në nenin 3 të Statutit ku ndër të tjera parashikohen edhe kërkesat nga shteti që mund t'i parashtrojnë: "Presidenti i Republikës, Parlamenti, Qeveria dhe organet shtetërore të tjera", pra shteti përfaqësohet nga organet e shtetit (Council of Europe, Revised Statute of the ECDTL, 2002).

Rregullorja e Punës e Komisionit të Venecias të amendamentuar në vitin 2018 në nenin 14 përcakton se "kur përgatitet një mendim, Komisioni i Venecias gjithmonë krijon një grup të vogël punues të anëtarëve të saj, i cili quhet raportues", të cilët kur është e mundur udhëtojnë në shtetin i cili ka parashtruar kërkesën për opinion ku takohen dhe diskutojnë me autoritetet përkatëse qoftë përfaqësues nga Qeveria, nga Parlamenti, nga gjyqësori apo edhe me shoqërinë civile (Venice Commission, Rules of Procedure, 2018). Rastet e tilla kur raportuesit kanë udhëtuar në shtetin i cili ka parashtruar kërkesë kemi edhe në Republikën e Kosovës, te disa kërkesa të cilat janë parashtruar nga institucionet shtetërore ndër vite, kështu duke filluar me kërkesën e parashtruar më 17 prill 2018 nga kryeministri lidhur me "Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike", ku lidhur me këtë projektligj që ishte në shqyrtim, një delegacion i Komisionit të Venecias kishte vizituar Kosovën për të shkëmbyer mendime me autoritetet e Kosovës, përfaqësuesit

e partive politike, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë (Venice Commission, 2018).

Kërkesa tjetër ishte parashtruar më 13 shkurt 2020 nga kryeministri, i cili kishte kërkuar opinion nga Komisioni i Venecias për “projekt-ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale”. Si pjesë e përgatitjes së opinionit, delegacioni i raportuesve të Komisionit të Venecias mbajti video-konferenca¹² me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe me organizatat e shoqërisë civile përfshirë akademik, e ndjekur nga një takim virtual edhe me anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare dhe video konferencat e tjera u mbajtën me kryetarin e Kuvendit, si dhe me anëtarët e gjyqësorit dhe prokurorisë në Kosovë (KOSOVO - forthcoming opinion-virtual meetings, 2020).

Edhe më 21 gusht 2020, kryeministri i Kosovës kishte kërkuar opinion nga Komisioni i Venecias mbi “Projektligjin për tubimet publike”, për çka gjatë përgatitjes së opinionit për këtë projektligj, raportuesit e Komisionit të Venecias mbajtën një sërë takimesh online me autoritetet kosovare dhe aktorët e tjerë (Venice Commission, 2020).

Më 26 tetor 2020 kryeministri i Kosovës kishte referuar kërkesë për opinion lidhur me “Projektligjin për Qeverinë”, ku Komisioni i Venecias, respektivisht raportuesit mbajtën takime online me autoritetet e Kosovës në kuadër të përgatitjes së projekt opinionit mbi këtë projektligj (Venice Commission, 2020).

Në rastin e Republikës së Kosovës ky rol i komisionit të Venecias në ofrimin e këshillave ligjore është evident pasi edhe Kosova si shtet anëtar synon që t’i përshtat strukturat ligjore me standardet evropiane, kjo dëshmohet nga neni 54 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku “projektligji, i cili paraqitet në Kuvend për miratim ndër të tjera duhet të përmbajë edhe deklaratën për përafrimin dhe për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me tabelën krahasuese me aktet të cilave u referohet”, andaj si rrjedhojë e këtij roli që ka Komisioni i Venecias u parashtruan kërkesat e mësipërme nga shtetet e përmendura.

Gjithashtu Komisioni ofron përvojë ndërkombëtare në “sferën e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit” (Buquicchio G. , 2015). Këtë përvojë ndërkombëtare e kanë shfrytëzuar në rastet e nevojshme edhe Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe

¹² Zëvendësimi i vizitave të raportuesve të komisionit me video konferenca dhe takimeve të tjera online rezultoi si rrjedhojë e kufizimit të lëvizjes për shkak të situatës me pandeminë Covid-19.

Maqedonisë së Veriut, kjo dëshmohet nga praktika kushtetuese e Gjykatave Kushtetuese që veprojnë në këto shtete.

Kështu kërkesat eksplicite të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, drejtuar Forumit të Komisionit të Venecias nga viti 2016-2020 janë (Dula, 2020): rasti “nr. K073/16”, “nr. K0142/16”, “nr. K012/18”, “nr. K084/18”, “nr. K0 79/18”, “nr. KI 01/18”, “nr. KI108/18”, “nr. K0219/19” dhe “nr. K072/20”.

Nga këto referime që i ka bërë Gjykata Kushtetuese në Komisionin e Venecias vërejmë se veçohet viti 2018 për nga numri më i madh respektivisht pesë kërkesa i janë parashtruar çka nënkupton se Gjykata Kushtetuese këtë vit ka qenë mjaft aktive në raport me Komisionin e Venecias, ndërsa viteve të tjera numri i referimeve ka qenë shumë më i vogël një deri në dy kërkesa.

Si përfundim në rastin e Republikës së Kosovës, shtet i ri me strukturë juridike dhe institucionale të re, opinionet e lëshuara nga Komisioni i Venecias të parashtruara nga shteti konkretisht organet shtetërore apo edhe Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit në cilësinë amicus curiae, ka ndikuar në avancimin profesional të praktikës kushtetuese-drejtësisë kushtetuese por edhe të hartimit të ligjeve të qarta dhe në harmoni me kushtetutën, dhe në këtë mënyrë është parandaluar referimi i ligjeve për kontroll të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që ka ndikuar edhe në fuqizimin e demokracisë kushtetuese si produkt i shtetit të së drejtës.

Sa i përket bashkëpunimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me Forumin e Komisionit Evropian, ky i fundit ka pasur impakt të vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese pasi ekzistojnë raste në të cilën është shfrytëzuar përvoja e tij për disa projektligje, si “Projektligji për Qeverinë”, “Projektligji për financimin e partive politike”, andaj edhe veçohet roli i jashtëzakonshëm i këtij komisioni në proceset e hartimit të legjislacionit në mënyrë të qartë (Morina, 2021).

Që nga anëtarësimi i Republikës së Kosovës në këtë komision bashkëpunimi është rritur dhe përmirësuar në disa aspekte, por ende ka hapësirë shumë që ky bashkëpunim të intensifikohet dhe saktësohet. Kryesisht Gjykata Kushtetuese ka kërkuar ndihmën e Komisionit të Venecias përmes trupës së quajtur Forumi i Komisionit të Venecias ku bëjnë pjesë Gjykatat Kushtetuese të vendeve anëtare, e ku secila ka mundësi të parashtrojë pyetje për punën, kornizën ligjore dhe praktikën e tyre në ndonjë aspekt që është në interes për gjykatën që bën pyetje, duhet shfrytëzuar më shumë mekanizmin ku kërkohen opinione

profesionale në raste të caktuara që mund të ofrojë Komisioni i Venecias dhe kjo duhet bërë me kalimin e kohës (Rama, 2021).

Njëheri opinionet e Komisionit të Venecias ndikojnë edhe në eliminimin e rrezikut për subjektivizmin eventuale gjatë marrjes së vendimeve nga gjyqtarët, pasi “jo vetëm Gjykata Kushtetuese, por edhe Gjykata e Strasburgut në disa raste është mbështetur në opinionin e Komisionit të Venecias dhe rasti i Kosovës nuk do të duhet të bëjë përjashtim sepse është një institucion brenda shteteve të Evropës, është jopolitik, është shumë profesional, gëzon reputacion shumë të lartë dhe në vitet e fundit ka dhënë kontribut të hatashëm në inxhinieringun kushtetues dhe se roli i komisionit është shumë i dobishëm në ngritjen e kualitetit të drejtësisë kushtetuese në nivel nacional” (Morina, Intervistë përmes emailit, 2021).

10. Vendimet e GJEDNJ, efektet në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës

Një numër gjykatash kushtetuese nuk hezitojnë t'i referohen shprehimisht në gjykimet e tyre Konventës dhe praktikës së Gjykatës së Strasburgut. Gjykatat e tjera kushtetuese rrallë tregojnë në gjykimet e tyre se nga e marrin frymëzimin. Megjithatë, vëzhguesit e punës së gjykatave sugjerojnë që gjykatat kushtetuese të marrin parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ (Velaers, 2016, p. 278).

Gjykatat Kushtetuese të shumicës së vendeve evropiane nëpërmjet zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut, në pajtim me praktikën e GJEDNJ, e kanë pranuar interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të kësaj Gjykate. Këtë formë të interpretimit të dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut në harmoni me praktikën e GJEDNJ e ka përfaqësuar edhe shteti i Kosovës përmes nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Komisioni i Venecias konsideron këtë “gatishmëri për të interpretuar dispozitat kombëtare kushtetuese në një mënyrë që është në favor të kërkesave që rrjedhin nga vendimet e GJEDNJ” si një mjet për të reduktuar mundësitë e konflikteve midis mbrojtjes evropiane dhe kombëtare të të drejtave të njeriut (Velaers, 2016, p. 273).

Gjykatat e të gjitha niveleve si dhe veçanërisht Gjykata Kushtetuese, gjatë praktikës kushtetuese në shumicës dërmuese të rasteve i janë referuar vendimeve të GJEDNJ për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut. Për ta dëshmuar këtë përmendim rastin “nr. KI 40/09”, ku Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte shqyrtuar shkeljen e supozuar të së drejtës së pronës, të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. Si rrjedhojë, gjatë shqyrtimit, Gjykata Kushtetuese i është referuar praktikës së GJEDNJ konform nenit 53 të Kushtetutës dhe kështu ka implementuar drejtpërdrejt efektet e vendimeve të GJEDNJ në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës (I.Ibrahimi dhe 48 ish punëtorë të tjerë , 2010).

Edhe në rastin “nr. KI 68/09”, parashtruesi i kërkesës pretendonte për cenimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe shkelje të imunitetit gjyqësor të garantuar me Kushtetutë, edhe këtu Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të pranueshmërisë së kërkesës i referohet praktikës së GJEDNJ gjatë arsyetimit të saj sa i përket shterimit të mjeteve juridike (E. Kastrati, 2010).

Në rastin “nr. KI 06/10”, parashtruesi pretendonte shkelje të lirisë së lëvizjes dhe të drejtës për mjete efektive juridike të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, ku gjatë shqyrtimit Gjykata edhe në këtë rast ishte referuar në praktikën e GJEDNJ gjatë argumentimit dhe konstatimit të këtyre shkeljeve, madje ndër të tjera referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ “organet administrative i koncepton si element i shtetit që e respektojnë sundimin e ligjit” (V.Bislimi kundër MPB, KGJK, MD, 2010). Gjykata Kushtetuese pranoi detyrimin e saj për t’iu referuar praktikës së GJEDNJ.

KEDNJ e ka elaboruar edhe pozicionin e praktikës së GJEDNJ, ku fillimisht neni 19 sqaron intencën e krijimit të GJEDNJ, që konsiston në “sigurimin e respektimit të zotimeve të ndërmarra nga palët e larta kontraktuese të Konventës Evropiane dhe Protokolleve të saj” dhe më detajisht sqarohet në nenin 46 që kjo “praktikë e kësaj gjykate është e detyrueshme vetëm për shtetin që është palë në atë çështje, pra vërehet efekti inter partes” (ECHR, 1950). Por, efekti “res interpretata” i vendimeve të GJEDNJ nënkupton që të gjitha autoritetet kombëtare, përfshirë gjykatat kombëtare, veprimtarinë e tyre duhet ta realizojnë në përputhje me Konventën siç shpjegohet nga GJEDNJ në praktikën gjyqësore të saj, dhe nëse shteti i tyre nuk ishte palë në çështjen në të cilën është dhënë vendimi apo interpretimi, çka ka për qëllim krijimin e një niveli minimal uniform të mbrojtjes së të drejtave themelore në të gjithë Evropën e cila mund të realizohet vetëm nëse të gjitha

gjykatat kombëtare janë të përgatitura që të miratojnë interpretimet e Konventës nga GJEDNJ (Gerards, 2014).

Më tej, KEDNJ ka përcaktuar edhe procedurën e ratifikimit të saj nga shtetet anëtare. Në këtë drejtim, përjashtim bën Kosova e cila nuk e ka ratifikuar këtë Konventë sikurse shtetet e tjera por ajo gjen zbatim të drejtpërdrejtë, realisht kjo nënkupton që shteti ynë nuk është palë në këtë Konventë dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka edhe përgjegjësi ndërkombëtare për ta respektuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ.

Nga një perspektivë më e gjerë, disa autorë pohojnë se nuk ekziston një “e drejtë evropiane e njeriut”, por vetëm e drejta universale dhe se ekziston sistemi “evropian” i mbrojtjes së këtyre të drejtave” (Boyle, 2009). Andaj, në ndërlidhje me këtë dispozitat e KEDNJ, janë të përfshira dhe të aplikueshme në rendin nacional juridik të Republikës së Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës. Ndërsa veçmas nga dispozitat e KEDNJ, rregullohet te neni 53 i Kushtetutës që e përcakton pozitën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ në rendin juridik të Kosovës, ku interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara bëhet në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me çka nga ky rregullim kushtetues pasqyrohet raporti që ekziston GJEDNJ dhe i Gjykatës Kushtetuese në Kosovës, dhe i referon në mënyrë të detyrueshme gjykatat kosovare në praktikën gjyqësore të GJEDNJ një propozim thelbësor në lidhje me marrëdhënien e ligjit të brendshëm kosovar me të drejtën evropiane për të drejtat e njeriut. Duke qenë se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe për shkak të mosratifikimit të KEDNJ sipas njëres nga mënyrat e caktuara në Kushtetutë, atëherë konsideroj se shteti ynë nuk ka obligim ndërkombëtar që t'i referohet jurisprudencës së GJEDNJ, por e ka obligim nacional që e ka caktuar përmes aktit më të lartë juridik dhe politik të vendit. Gjykata Kushtetuese pranoi detyrimin e saj për t'iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ, por nuk e gjeti veten të detyruar të ndiqte vendimet e GJEDNJ.

Kështu përmes aplikimit të instrumenteve ndërkombëtare si dhe interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në harmoni me praktikën e GJEDNJ, mundësohet ndërkombëtarizimi i kushtetutës edhe pse këto akte ndërkombëtare nuk janë kushtetuta, megjithatë ato janë të barasvlershme me normat kushtetuese. Gjyqtarët kushtetues konsultohen me vendimet e GJEDNJ për qëllimet e konfirmimit të jurisprudencës përkatëse, po ashtu edhe për zgjerimin e njohurive profesionale gjyqësore për çështjen në fjalë.

Edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka inkorporuar përvojën jurisprudenciale të GJEDNJ gjatë interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në kushtetutë përmes Pakos së Ahtisarit dhe si rrjedhojë e aspektit krahasimor të shumë Kushtetutave si ajo e Shqipërisë p.sh. që vendimet e Strasburgut janë obligative për autoritetet publike. Pra, “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës siguron se është në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ dhe tani që Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës por ka mundësi të ratifikojë konventën, dhe si rrjedhojë duhet të sigurohet një mundësi që gjykatat e rregullta përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese të bëjnë interpretimin në harmoni me politikat dhe interpretimin që ndjek Strasburgu” (Morina, 2021).

Andaj “GJEDNJ ka ndikim në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe duhet të ketë, por përjashtimit praktikat procedurale të saj nuk duhet të kenë ndikim në punën e Gjykatës Kushtetuese” (Tunheim, 2021).

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e drejta ndërkombëtare ka status të veçantë dhe është shumë të avancuar.

Përmbledhje: Në këtë kapitull është trajtuar aspekti historik i zhvillimit të Gjykatës Kushtetuese nëpër etapa të ndryshme duke filluar që nga koha kur Kosova ishte njësi federale në ish-Federatën Jugosllave e deri në përcaktimin definitiv të statusit politik të Kosovës në vitin 2008 kur Kosova u shpall shtet i pavarur e me këtë u themelua në vitin 2009 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, është sqaruar edhe zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që përbën kompetencë të përbashkët të presidentit dhe të Kuvendit, e që në esencë nënkupton kooperimin e këtyre dy institucioneve. Sfidë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është plotësimi i vendeve të lira brenda afatit ligjor, e cila prodhon pasoja direkte në paaftësinë e funksionimit të saj, pasi vendimmarrja realizohet përmes kuorumit. Në anën tjetër, Komisioni i Venecias rekomandon modelin e ndarë, duke siguruar kompetenca zgjedhore ose emërimin për tre degët kryesore të pushteteve shtetërore. Aplikimi i një modeli të tillë në Republikën e Kosovës do ta shmangte bllokimin e zgjedhjes nga Kuvendi të kandidatëve, pastaj do ta zvogëlonte ndikimin e politikës por njëkohësisht do ta rriste profesionalizimin në këtë gjykatë me çka ky model do të përfaqësonte legjitimitet dhe do të ishte më demokratik. Gjyqtarët kushtetues shërbejnë për një mandat nëntëvjeçar pa të drejtë rizgjedhje, model ky që cilësohet si më i përshtatshëm që ndikon drejtpërdrejt në pavarësinë gjyqësore, si dhe ata gëzojnë edhe imunitet funksional.

Është sqaruar se Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar që i targetohet mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton elementet që e përbëjnë shtetin e së drejtës si dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës, hasim raste të trajtuara që përfshijnë secilën nga këto elemente, ku dominojnë rastet që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konkretisht pretendimet për “shkelje të sundimit të ligjit, sigurisë juridike, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mohimi i mbrojtjes gjyqësore, e drejta për mjete juridike, barazisë para ligjit, e drejta e pronës”. Në fuqizimin dhe respektimin e parimit të shteti të së drejtës në Kosovë vërejmë se ka luajtur rol të rëndësishëm Gjykata Kushtetuese, e cila përmes jurisprudencës së saj kushtetuese, ka arritur të identifikojë, përpunojë dhe mbrojë parime si kushtetutshmëria, sundimi i ligjit, ndarja e pushteteve shtetërore, kontrolli dhe balancimi i pushteteve shtetërore, pavarësia e gjyqësorit, siguria juridike, besimi i qytetarëve në institucionet publike, demokracia kushtetuese dhe të drejtat dhe liritë e njeriut.

Po ashtu, janë elaboruar edhe llojet e vendimeve kushtetuese, opinionet e gjyqtarëve, efekti juridik i tyre dhe sfidat që i shoqërojnë në zbatimin e këtyre vendimeve. Njëkohësisht është analizuar edhe anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias dhe ndikimi i opinioneve të Forumit të Komisionit të Venecias në avancimin profesional të praktikës kushtetuese-drejtësisë kushtetuese në Kosovë. Gjykata Kushtetuese e ka pranuar detyrimin kushtetues për t’iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ, sa i përket interpretimit të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe këtë edhe e ka materializuar në vendimet e saj.

KAPITULLI IV

ROLI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË NË FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS

1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Në Shqipëri, në projektkushtetutën që iu paraqit Kuvendit Popullor në prill të vitit 1991, parashikohet për herë të parë në historinë e vendit krijimi i një Këshilli Kushtetues, që ishte në fakt një Gjykatë Kushtetuese, që u pranua vetëm pjesërisht dhe normat e miratuara që përbënin ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese” nr. 7491/1991, në të cilin nuk ishte përfshirë drejtësia kushtetuese, por pas një viti, më 4 prill 1992 me ligjin kushtetues nr. 7561 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese” u vendos kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve nga ana e Gjykatës Kushtetuese (Pepa, E., & Gera, A., 2015, f. 89).

Më 21 tetor të vitit 1998 Parlamenti shqiptar miratoi projektin përfundimtar të kushtetutës, që u votua në referendum kombëtar më 22 nëntor të vitit 1998 dhe u shpall me dekret të presidentit të Republikës nr. 2260, dt. 28.11.98 (Kurti, f. 101).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, sanksionoi përfundimisht konsolidimin e Gjykatës Kushtetuese sipas të njëjtit model që ishte miratuar edhe në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ndërsa një apsket tjetër pozitiv është edhe miratimi nga Kuvendi i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” nr. 8577 datë 10 shkurt 2000.

Gjykata kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk bën pjesë në sistemin gjyqësor të zakonshëm (Zagonjari, XH. et al., 2011). Ajo ka për juridiksion të veçantë “kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative, ndërsa garanton respektimin e kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj” (Ligji nr. 76/2016 , 2016). Ndër parimet themelore kushtetuese, është edhe garantimi i shtetit të së drejtës, ku njërin prej roleve e veçanta për forcimin e këtij parimi e ka edhe gjykata kushtetuese nga praktika e saj gjatë viteve që nga themelimi aty nga viti 1998, kjo e fundit ishte njëra prej evenimenteve më të rëndësishme postkomuniste, duke e konsideruar njërin prej tempujve të një shteti

juridik që ndan drejtësi themeltare për të gjithë qytetarët në vija lineare të barabarta pa bërë dallime politike klasore e oligarkike (Zagonjari, XH. et al., 2011).

Më tej, ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 prekën edhe aspektet e organizimit, funksionimit dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, të cilat u reflektuan si në dispozitat kushtetuese, ashtu edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e saj (Historiku-GJKRSH, 2019).

2. Evoluimi i kompetencave të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë prej miratimit të Kushtetutës së vitit 1998 deri në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016

Duke i marrë për bazë praktikat jurisprudenciale të gjykatave më eminente kushtetuese si p.sh. asaj të Italisë, Gjermanisë e Greqisë, Parlamenti i Shqipërisë miratoi një kapitull të veçantë të quajtur “Organizimi i drejtësisë dhe i Gjykatës Kushtetuese”, i cili shpallte parimin e pavarësisë dhe ndarjes së pushtetit gjyqësor dhe krijimin e Gjykatës Kushtetuese që gëzonte një pushtet vendimtar “për interpretimin e ligjeve dhe për pajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën, qe një hap i rëndësishëm për përforcimin e rendit juridik demokratik” (Krisafi, K., & Aubert, G., & Ordolli, S., 2002, f. 20).

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë sipas Kushtetutës së vitit 1998 ishte kompetente të shqyrtonte vetëm “ankimimet kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor” duke e kthyer këtë në njërën prej kompetencat më të rëndësishme të saj, pavarësisht kësaj Gjykata nuk arriti të përfshinte në juridiksionin e saj edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së “të gjitha akteve normative të pushtetit publik që cenonin të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në KEDNJ” (Historiku-GJKRSH, 2019). Për këtë arsye, u parashikua, midis të tjerave, edhe zgjerimi i ankimit kushtetues individual, i cili ka si qëllim t’i ofrojë mbrojtje më të madhe individit ndaj akteve të pushtetit publik që është realizuar në vitin 2016, ku i garantohej mbrojtje kushtetuese e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016).

Në funksion të kompetencave të Gjykatës, është me rëndësi të theksohet se një ndryshim ka pësuar edhe rrethi i subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues

(Historiku-GJKRSH, 2019). Sipas nenit 134, të Kushtetutës së Shqipërisë, veç subjekteve të parashikuara më parë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me ndryshimet kushtetuese në vitin 2016 janë shtuar edhe “disa subjekte që kanë si thelb të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut siç janë komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”. Këto ndryshime kushtetuese përbëjnë bazamentin e një reforme të thellë edhe në aspektin ligjor dhe institucional, që si rrjedhojë forcojnë shtetin e së drejtës në Republikën e Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol kruciale për forcimin e shtetit të së drejtës, në përmasat e kontrollit të pushteteve shtetërore e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut të garantuara me kushtetutë. Bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, veçojmë rolin e saj “të pazëvendësueshëm në vendosjen dhe respektimin e parimeve kushtetuese, si: ndarja dhe balancimi i pushteteve, shteti i së drejtës, demokracia, hierarkia e akteve normative dhe supremacia e kushtetutës, respektimi i të drejtave të njeriut, siguria juridike” etj. (Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë, 2015).

3. Përbërja, zgjedhja, mandati, imuniteti dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës

3.1. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese dhe zgjedhja e gjyqtarëve

Gjykatat Kushtetuese, sidomos ato që janë krijuar më vonë dhe kryesisht në vendet postkomuniste, kanë në përbërjen e tyre nëntë gjyqtarë (Sadushi, 2012, f. 122). Si vend postkomunist, një përbërje të tillë prej nëntë gjyqtarëve ka përfaqësuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, përbërje kjo e njëjtë me atë në Republikën e Kosovës.

Sa i përket emërimit të gjyqtarëve kushtetues, Sokol Sadushi thekson se (2004) “gjyqtarët emërohen nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit” (f. 38), por në praktikë vihen re hezitime dhe keqkuptime të skemës emëruese.

Përvoja e zbatimit të kësaj procedure kushtetuese deri në ndryshimin e kushtetutës në vitin 2016 dëshmoi për mosfunksionim si duhet për shkak të mungesës së bashkëpunimit institucional midis Presidentit dhe Kuvendit, andaj problematika e procedurës së zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe atyre të Gjykatës Kushtetues, solli në rend të ditës edhe rishikimin kushtetues të mënyrës së zgjedhjes së tyre (Historiku-GJKRSH, 2019).

Referuar kësaj situate, bazuar në ndryshimet kushtetuese të 2016, Gjykata Kushtetuese ka një formulë të re të zgjedhjes së anëtarëve të saj, ku (Ligji nr. 76/2016 , 2016, f. 2): “tre anëtarë i emëron Presidenti i Republikës”; “tre anëtarë zgjedhen nga Kuvendi” dhe “tre anëtarë zgjedhen nga Gjykata e Lartë”.

“Anëtarët përzgjedhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi”, ndërsa “Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998). Një model i tillë i zgjedhjes së gjyqtarëve do të rekomandohej që të adaptohet edhe zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e cila do të mundësonte zgjedhje e gjyqtarëve brenda afateve ligjore dhe njëherit do të parandalonte mundësinë e mosfunksionimit të kësaj gjykate si rrjedhojë e pamundësisë së zgjedhjes së gjyqtarëve.

3.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve kushtetues

Sa i përket mandatit, “gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për nëntë (9) vjet, pa të drejtë riemërimi” kurse përbërja e Gjykatës Kushtetuese “përtërihet çdo tre (3) vjet me një të tretën e saj” (Ligji nr. 76/2016 , 2016).

Njëherit është precizuar edhe fillimi i detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe afatet kohore të zgjatjes së mandatit të tij. Respektivisht, “gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pra mandati i tij fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta e parashikon ndryshe”, specifike tjetër është se “gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij” (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016).

Sa i përket imunitetit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri fillimisht potencoj se një numër konventash ndërkombëtare ku ka aderuar edhe Shqipëria, i caktojnë një sërë të drejtash gjyqtarëve të cilat duhet të garantohen edhe me dispozita kushtetuese dhe të shtjellohen në legjislacionin e zakonshëm të shteteve aderuese. Të tilla janë, ndër të tjera, mbrojtja e gjyqtarëve nga ndjekjet eventuale abuzive, duke u siguruar imuniteti i tyre.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 është garantuar imuniteti “për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998), në këtë rast përmes imunitetit sigurohet edhe pavarësia dhe paanësia në punën e gjyqtarëve kushtetues në Shqipëri. Ai nuk ka mundësi të “ndiqet penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese, ndalimi apo arrestimi i tij mund të bëhet vetëm nëse kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij, por edhe në këtë rast Gjykata Kushtetuese duhet të japë pëlqimin brenda 24 orëve për dërgim në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, në të kundërtën organi është i obliguar ta lirojë” (Sadushi, 2012).

3.3. Përfundimi i mandatit dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën

Kushtetuese të Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar rastet e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues dhe ato të shkarkimit të tij, ku në nenin 127 ka paraparë se “mbarimi i mandatit të gjyqtarit bëhet me vendim të Gjykatës Kushtetuese” ndërsa përmes enumeracionit taksativ ka numëruar rastet kur mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron, të cilat janë: “kur e mbush moshën 70 vjeç; përfundon mandatin 9-vjeçar; jep dorëheqjen; shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës; vërtetohen kushtet e pazgjidhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit dhe vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998).

Kurse, sa i përket shkarkimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 128 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me ligjin nr.76/2016, të datës 22.07.2016, sanksionohet shkarkimi që mund të bëhet kur konstatohen: “shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të

mandatit apo kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998). Konkretisht, kjo nënkupton se veprimi i paligjshëm i atribuohet gjyqtarit, që në mënyrë të vullnetshme ka vepruar në një mënyrë të caktuar (Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, 2015, f. 26).

Përderisa në rastin e parë kërkohet nga organi që të bëjë një verifikim dhe njëherit vlerësim të shkëlqes së rëndë profesionale dhe etike, rasti i dytë, që shërben si shkak për shkarkim, është vetëm një konfirmim për faktin e ndodhur.

Në krahasim me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës ky shkarkim i gjyqtarit në bazë të nenit 118 të Kushtetutës bëhet “nga Presidenti i Republikës pas propozimit nga 2/3 e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave”.

Po ashtu, vlen të përmendet edhe reforma në drejtësi e cila mbetet prioritet në agjendën politike dhe institucionale në Shqipëri, kryesisht për shkak të presionit ndërkombëtar për reforma. Reforma përbëhet nga tre komponentë: baza kushtetuese dhe ligjore, procesi i rivlerësimit dhe krijimi i strukturave të reja të sistemit të drejtësisë (Instituti i studimeve politike, Mars-Gusht 2018).

Thelbësor në zbatimin e reformës në drejtësi është çmuar procesi i vetingut i cili ndikon në vendosjen e shtetit të së drejtës në vend. Për shkak të procesit të vetingut, ishin paraqitur vështirësi në funksionimin e institucioneve të drejtësisë por edhe në Gjykatën Kushtetuese. Në veçanti këtu e elaboroi situatën e stagnimit të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese kjo për shkak të faktit se në tërësi nga nëntë gjyqtarët që i ishin nënshtruar procesit të vetingut, vetëm dy gjyqtarë ishin konfirmuar, katër gjyqtarë kushtetues ishin shkarkuar, një tjetër kishte dhënë dorëheqje në fillim të vitit 2018, kurse dy anëtarë të tjerë, Vladimir Kristo e Sokol Berberi kishin dhënë dorëheqje shumë kohë më parë për shkak të mbarimit të mandatit. Kështu gardiani i kushtetutës kishte mbetur pa përbërjen e nevojshme për funksionimin e tij (Instituti i studimeve politike, Mars-Gusht 2018).

Duke filluar nga qershori 2018, Gjykata Kushtetuese nuk kishte mundësi të merrte vendime në seanca plenare, pra nuk kishte mundësi ta ushtronte funksionin e saj të vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjeve në Shqipëri. Nga korriku 2018, gjykata përbëhej vetëm nga një anëtar dhe atë me mandat të skaduar. Ndërsa në nëntor 2019, tre anëtarët e rinj u emëruan sipas procedurave të reja të parashikuara me legjislacionin e reformës në

drejtësi (ENNHRI, 2020, p. 8). Prania e kuorumit minimal të nevojshëm që Gjykata Kushtetuese të fillojë e të ushtrojë një pjesë të konsiderueshme të funksioneve të saj, u verifikua vetëm në fund të dhjetorit 2020, kur u emërua në detyrë gjyqtari i gjashtë, megjithatë, mbeten ende tre gjyqtarë për t'u emëruar. Pra, Gjykata Kushtetuese nuk funksionoi për gati tre vjet.

Tabela 1. Pasqyrim i shkarkimeve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë pas fazës së parë të vetingut

INSTITUCIONET E REJA	KONFIRMOHEN	SHKARKOHEN	DORËHEQJE	NË PROCES	TOTAL
GJYKATA KUSHTETUESE	2	4	1	0	7

Burimi: (Instituti i studimeve politike, Mars-Gusht 2018)

4. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë në vështrim krahasues me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës

4.1. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë

Gjykata Kushtetuese garanton “aplikimin e parimeve themelore nga tërë organet kushtetuese, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës, këtë mision ajo e realizon përmes kontrollit kushtetues” (Vorpsi, A. et al. , 2019). Kështu, rezulton se kontrolli kushtetues ka ndikim në forcimin e shtetit të së drejtës. Disa Gjykata kushtetuese thjesht gjykojnë kushtetutshmërinë e legjislacionit, të tjerët autorizohen të vendosin për një larmi pyetjesh shtesë, disa prej tyre politikisht mjaft të ndjeshme, ku përveç funksionit thelbësor për të vendosur çështjet kushtetuese, një numër Gjykatash kushtetuese në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë juridiksion në çështjet që lidhen me “zgjedhjet, referendumin, fajësimin e presidentit dhe ligjshmërinë e partive politike” (Horowitz, 2006).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 131 të Kushtetutës të saj rregullon juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me “kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit, të akteve normative të organeve qendrore e vendore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës ndërmjet pushteteve shtetërore, me kushtetutshmërinë e partive politike e kontrollin e veprimtarisë që ato

ushtrojnë, me verifikimin e zgjedhjeve e të referendumëve, të çështjeve të zgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të presidentit të Republikës e të deputetëve dhe në veçanti me sferën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individëve” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998). Një rregullim i veçantë me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 i ofrohet ankesës kushtetuese individuale e cila mund të ushtrohet “ndaj çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave” (Ligji nr. 76/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, 2016). Kjo pasi më parë Kushtetuta e vitit 1998 garantonte vetëm mbrojtje për të drejtën e procesit të rregullt ligjor, ideja (e gabuar) ka qenë se përmes mbrojtjes së kësaj të drejte, sigurohen edhe të drejtat e tjera (Kryeziu, 2022, f. 104).

Nga trajtimi i mësipërm i juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë vërejmë se ka dallime në raport me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës në drejtim të “kontrollit të marrëveshjeve ndërkombëtare nëse janë në përputhje me Kushtetutën para ratifikimit të tyre, kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike e të veprimtarisë së”, të cilat kompetenca nuk i ka Gjykata Kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Objekt kontrolli i kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ndër të tjera mund të jetë edhe (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998): “vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës; vendimi për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë¹³ dhe vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kryetarëve të komunave ose bashkive¹⁴”.

Me ndryshimet kushtetuese të realizuara me “Ligjin nr. 137/2015”, në nenin 3 të këtij të fundit është zgjeruar juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në të drejtë të shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë përveç “me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, edhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre”. Ka dispozita kushtetuese të tjera, “kur pas verifikimit që Gjykata Kushtetuese kryen duhet të shprehet për kushtetutshmërinë e procedurave hetimore të kryera nga organe të ndryshme

¹³ Neni 140/4

¹⁴ Neni 115.

shtetërore” (Vorpsi, A. et al. , 2019, f. 117) siç janë rastet: “kur Gjykata konstaton papajtueshmërinë në ushtrimin e detyrës së deputetit,¹⁵ kur vërteton një nga kushtet e pazgjidhshmërisë së deputetit,¹⁶ kur verifikon procedurat e zgjedhshmërisë ose të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës,¹⁷ kur vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë së Presidentit të Republikës për të ushtruar detyrën për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë,¹⁸ kur deklaron shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra, si rrjedhojë e vërtetimit të fajësisë së tij,¹⁹ kur shkarkon nga detyra anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor,²⁰ Prokurorin e Përgjithshëm, anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë,²¹ Inspektorin e Lartë të Drejtësisë²²” etj. Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 127 të Kushtetutës, edhe “deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues” është një lloj tjetër gjykimi, i cili bëhet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Te të gjitha këto raste të lartpërmendura Gjykata Kushtetuese nuk shfuqizon ndonjë normë juridike.

Vëmendje duhet kushtuar ndryshimeve kushtetuese të miratuara në vitin 2016, ku me Ligjin nr. 76/2016 është precizuar situata kur Gjykata Kushtetuese “vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi”, që kufizohet dhe ushtron kontroll vetëm në respektimin e procedurës së parashikuar me Kushtetutë.

4.2. Palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë në vështrim krahasues me palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës

Si rregull, procedurat para Gjykatës Kushtetuese janë të bazuara në kërkesën përkatëse të paraqitur nga një subjekt i veçantë kushtetues ose nga kërkues që duhet të provojnë legjitimitetin e tyre (Sadushi, 2012, f. 64).

Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me ndryshimet kushtetuese të realizuara në vitin 2016, ka zgjeruar numrin e palëve të autorizuar të cilat me kërkesën e tyre mund ta aktivizojnë Gjykatën Kushtetuese, të cilat në tërësi janë: “organet shtetërore si

¹⁵ Neni 70 par. 4.

¹⁶ Neni 69.

¹⁷ Neni 87, 94 dhe 131/e.

¹⁸ Neni 91 par. 2.

¹⁹ Neni 90 par. 3.

²⁰ Neni 147/c.

²¹ Neni 149/c.

²² Neni 147/e.

Presidenti i Republikës; Kryeministri; jo më pak se një të pestës së deputetëve; Avokati i Popullit; kryetari të Kontrollit të Lartë të Shtetit; çdo gjykatë, çdo Komisionari të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, organet e qeverisjes vendore”, ndërsa palët e autorizuar të tjera janë edhe “organet e bashkësive fetare; partitë politike; organizatat dhe individët” (Ligji nr. 76/2016 , 2016). Me ndryshimet kushtetuese janë shtuar vetëm “Komisionari i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta” dhe kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të cilët më herët nuk kanë qenë të paraparë me normat kushtetuese të miratuara në vitin 1998.

Në raport me palët e autorizuar që janë të sanksionuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, vërejmë se ka dallime në drejtim të: “Kryetari të Kontrollit të Lartë të Shtetit, çdo Komisionari të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, organeve të bashkësive fetare, partive politike dhe organizatave”. Njëherit karakteristikë e përbashkët është se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ajo e Kosovës nuk e njohin mënyrë e fillimit të gjykimit kushtetues, që është nisma (*proprio motu*) e institucionit, i cili është ngarkuar për të përmbushur funksionin e drejtësisë kushtetuese, në rastin konkret inicimin nga Gjykata Kushtetuese *ex-officio*.

Megjithatë, bazuar në “zgjidhjet kushtetuese që ofron Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka hapësirë të mjaftueshme për të gjitha palët e mundshme që të parashtrijnë ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese pasi t’i përmbushin kushtet e caktuara” (Rama, 2021).

Tabela 2. Palët e autorizuar të përbashkëta dhe dalluese sipas Kushtetutës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë

Palët e autorizuar të përbashkëta sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë	Palët e autorizuar dalluese sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë
- Presidenti i Republikës; - Qeveria/kryeministri; - Kuvendi/deputetët; - Avokati i Popullit; - Komuna/organet e qeverisjes vendore; - Gjykatat; - Individët.	- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; - Çdo Komisionari të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelor; - Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë; - Organet e bashkësive fetare; - Partitë politike;

Burimi: (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) dhe (Ligji nr. 76/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, 2016).

Presidenti i Republikës, Kryeministri, një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Populli janë bartës të interesit publik, konkretisht interes i tyre është “mbrojtja e sistemit normativ dhe parimeve shtet-formuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj. të shpalosura në Kushtetutë, që nuk kushtëzohet nga vërtetimi i ekzistencës së interesit për çështjen në shqyrtim” (Vendim nr.18, 2008) Tipari dallues i një kërkesë që inicohet prej cilitdo nga bartësit e funksionit publik të lartpërmendur është se kemi kontroll abstrakt dhe objektiv të ligjit, që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese dhe me funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës (Vendim nr.18, 2008).

Ndërsa sa i përket subjekteve të tjera, përfshirë këtu “kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; çdo gjykatë, çdo Komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare; partitë politike; organizatat dhe individët” i kushtëzon të drejtën e subjektit për të paraqitur një kërkesë me pasjen e një interesi konkret kushtetutshmërisht të mbrojtur (Vorpsi, A. et al. , 2019). Më tej, me norma ligjore është rregulluar në mënyrë të detajuar ku është paraparë për secilën nga palët e autorizuara procedura që zhvillohet pranë Gjykatës Kushtetuese e cila përfshinë objektin e ankimit, kriteret që duhet të plotësohen nga secila palë, dhe shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016).

Sa për elaborim, në rastin ku Kushtetua e Shqipërisë ka paraparë si palë të autorizuar para Gjykatës Kushtetuese individët, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” në nenin 71 ka konkretizuar se “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike....”, ku duke vazhduar më tej parashikon se objekt ankimi mund të jetë “ligji, akti normativ apo vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, si dhe duke precizuar edhe kriteret që duhet të plotësohen në këtë rast për ushtrimin e ankimit individual kushtetues, e duke

sqaruar edhe shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, "Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH", 2016).²³

Në këtë drejtim në aspektin komparativ me individët që i ka paraparë si palë të autorizuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me norma ligjore ka përcaktuar se "Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike..." (Ligji nr. 03/L-121, 2008)²⁴ pa e saktësuar se kush mund të jetë individë.

5. Llojet e vendimeve, procedura e vendimmarrjes, efekti juridik dhe ekzekutimi i tyre

5.1. Llojet e vendimeve

Akti juridik përmes të cilit Gjykata Kushtetuese shpall përfundimin e një gjykimi kushtetues e quajmë vendim (Sadushi, 2012, f. 376).

Gjykata Kushtetuese merr vendime të cilat në varësi të fazës procedurale kur merren, të problematikës që zgjidhin ose efekteve juridike që sjellin njihen me emërtime të ndryshme si vendime pranimi, rrëzimi, refuzimi, pushimi, pezullimi, vendime për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës ose për interpretimin dhe plotësimin e vendimit të Gjykatës, vendime për kalimin ose moskalimin e çështjes në seancë plenare, etj. (Sadushi, Kontrolli kushtetuese, 2004).

5.2. Procedura e vendimmarrjes

Aspekti procedural i vendimmarrjes rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjin organik për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë të ndryshuar në vitin 2016. Akti kushtetues në nenin 133 par. 2 përcakton që "vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj" (Procesi vendimmarrës-GJK, 2021). Ligji nr. 99/2016 në nenin 72 par. 2 e saktëson se abstenimi nuk lejohet, pra gjyqtarët me këtë rast duhet të votojnë për ose kundër. Edhe në rastin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një lloj si në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës aplikohet njëri nga parimet e gjyqimit kushtetues siç është parimi i kolegjalitetit.

²³ Neni 71/a, 71/b.

²⁴ Neni 47.

Më tej, ligji i lartpërmendur në nenin 72 vazhdon dhe elaboron në detaje procesin e vendimmarrjes ku “bisedimet dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë si dhe për shpalljen e tij njoftohen pjesëmarrësit në proces”. Parimisht “vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar”, por në raste të veçanta që kanë të bëjnë me “çështje të rëndësishë publike, Gjykata Kushtetuese mund të njoftojë dispozitivin e vendimit menjëherë pas marrjes së tij dhe shpall vendimin e arsyetuar brenda pesë (5) ditëve” (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016).

5.3. Efekti juridik i vendimeve kushtetuese në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar se “vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sa i përket momentit që ato fillojnë të prodhojnë pasoja juridike, janë dy llojesh (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998): “vendimi i cili hynë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare”, apo “me urdhër të Gjykatës Kushtetuese vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, mund të hyjë në fuqi në një datë tjetër”.

Në rastin e parë parashikohet kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare (Ligji nr.8577 për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH, 2000). Pra, publikimi i vendimeve në Fletoren Zyrtare është moment që shkakton lindjen e të drejtave apo detyrimeve për subjektet.

Në rastin kur “vendimi sjell pasoja për të drejtat kushtetuese të individit, atëherë Gjykata Kushtetuese mund të vendos që ai të hyjë në fuqi ditën e shpalljes së tij” dhe jo si zakonisht në rastet e tjera ditën e publikimit të tij, pra ky lloj hynë në kategorinë e vendimeve që hyjnë në fuqi në një datë tjetër, respektivisht në ditën e shpalljes nga Gjykata Kushtetuese, ku në këtë rast “vendimi shoqërohet me një arsyetim të përmbledhur shkurt, kurse vendimi i arsyetuar plotësisht publikohet brenda tridhjetë (30) ditëve”.²⁵

Në parim, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastin e Shqipërisë nuk kanë efekt prapaveprues me përjashtim të këtyre rasteve (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016): “ndaj një

²⁵ Neni 26.

dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar”; “ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë” dhe “ndaj pasojave ende të pazezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar”.²⁶

5.4. Ekzekutimi i vendimeve kushtetuese

Parimisht, sikurse te çdo Gjykatë Kushtetuese ku vendimet kanë efekt detyrues apo imperativ, kjo gjen zbatim edhe në rastin e vendimeve kushtetuese në Shqipëri.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës, prandaj ligji nr. 8577 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, në nenin 81 ka caktuar “kompetent Këshillin e Ministrave që me anë të organeve përkatëse të administratës shtetërore të sigurojë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”. Po ashtu, në bazë të ligjit nr. 99/2016 neni 74 sqarohet se “Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit” (Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, “Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH”, 2016). Një model të ngjajshëm të cilin e aplikon Shqipëria për ekzekutimin e vendimeve kushtetuese duhet shqyrtuar në të ardhmen si mundësi aplikimi edhe në rastin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përmes ndonjë organi të caktuar.

Pra, nuk konsiderohet e rëndësishme vetëm vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese por edhe veprimet që organet përgjegjëse i ndërmarrin për ekzekutimin e vendimeve kushtetuese.

Në anën tjetër, është paraparë edhe “moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese²⁷ dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal”, respektivisht “pengimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatës dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet” ndërsa moszbatimi i vendimit të gjykatës i cili sipas Kodit Penal sanksionohet si vepër penale e quajtur “mosekzekutimi pa shkaqe të përligjura i vendimit të

²⁶ Neni 76 par. 7.

²⁷ Neni 81 i Ligjit nr. 99/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, 2016

gjykatës dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre” (3) vjet²⁸ (Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 2021).

6. Roli i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë në forcimin e shtetit të së drejtës në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës

Gjykata Kushtetuese në vazhdimësi ka evidentuar vlerat kushtetuese përmes interpretimit të saj. Kështu, gjatë njëzet (20) vjetëve të veprimtarisë së saj, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë “ka ndikuar pozitivisht në funksionimin e shtetit të së drejtës, krahasuar me shumë organe të tjera të sistemit të drejtësisë” (Vorpsi, A. et al. , 2019, f. 59).

Shtetin e së drejtës në “Vendimin nr. 26”, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e ka interpretuar duke iu referuar doktrinës të së drejtës kushtetuese, respektivisht përmes kësaj të fundit ajo sqaron se ndër elementet e shtetit të së drejtës është siguria juridike, e cila përfshin ndër të tjera besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara (Vendimi nr. 26, 2005).

Edhe sipas “Vendimit nr. 34 ” siguria juridike është trajtuar si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, i cili ka si kërkesë që ligji në tërësi apo dispozitatat e caktuara ligjore, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë “të qartë, të përcaktuar dhe të kuptueshëm” (Vendimi nr. 34, 2005).

Sipas “Vendimit nr. 20”, shteti demokratik mbështetet në parimin e shtetit të së drejtës, ky i fundit përfshin “sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të sigurohet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike” (Vendimi nr. 20, 2006). Sipas jurisprudencës shqiptare, “parimi i ndarjes së pushteteve shtetërore, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike”, përbëjnë disa nga elementet e shtetit të së drejtës (Zagonjari, XH. et al., 2011).

Po ashtu, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, parimi i shtetit të së drejtës është trajtuar si parim universal e bazë për tërë sistemin ligjor në Shqipëri. Ky parim i cili

²⁸ Neni 320

gjendet i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shumicën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është elaboruar në lidhje të ngushtë me “preambulën e Kushtetutës, ku ndër të tjera shprehet vendosmëria e popullit shqiptar për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social” (Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020), 1998).

Më tej, në “Vendimin nr. 9” është sqaruar se element thelbësor i parimit të shtetit të së drejtës është siguria juridike, prandaj edhe “sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat e nevojshme për materializimin e tyre duhet të synojë përmirësimin e rritjen e standardeve të të drejtave”, kështu edhe forcimin e shtetit ligjor (Vendimi nr. 9, 2007).

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në “Vendimin nr. 11” ka vlerësuar cenimin e të drejtave të fituara dhe diskriminimin e një grupi të popullsisë si shkelje të parimit të siguri së juridike, ky i fundit përbën njërin nga elementet e shtetit të së drejtës, pra me këtë rast është shkelur edhe parimi i shtetit të së drejtës (Vendimi nr. 11, 2007). Ky vendim lë të kuptohet se “parimi i siguri së juridike bashkëvepron edhe me parime të tjera kushtetuese”.

Po ashtu, për shtetin e së drejtës në një vendim tjetër të saj ka elaboruar të lidhur me të drejtën për gjykim ku konkretisht nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, “buron e drejta e cilitdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj” (Vendimi nr. 17, 2009). Sipas interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese si përfundim vërejmë se “parimi i shtetit të së drejtës nuk gjen shprehje në Kushtetutë literalisht, por atë e gjejmë të nënkuptuar” (Vendimi nr. 17, 2009).

Pra, përmes veprimtarisë vendimmarrëse, Gjykata Kushtetuese në rastin e Shqipërisë ka dhënë kontribut në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve drejt përmbushjes së elementeve të parimit të shtetit të së drejtës dhe respektimit të këtij parimi.

Andaj, specifikoj se kontrolli kushtetues që realizohet përmes Gjykatës Kushtetuese është element thelbësor që ka ndikim në ndërtimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ka identifikuar dhe interpretuar shumë parime kushtetuese, ndër to edhe shtetin e së drejtës dhe elementet përbërëse të tij. Sipas jurisprudencës shqiptare, parimi i shtetit të së drejtës është trajtuar si parim universal dhe është elaboruar në lidhje të ngushtë me preambulën e Kushtetutës. Më tej janë sqaruar edhe elementet përbërëse të shtetit të së drejtës që sipas jurisprudencës të

Gjykatës Kushtetuese të trajtuara mësipër janë: “parimi i ndarjes së pushteteve shtetërore, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike”. Shteti i së drejtës si parim universal i garantuar me kushtetutë dhe elementet e ngjashme të mësipërme i ka evidentuar edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës, ndonëse duhet përmenduar se në aspektin kohor të themelimit këto Gjykata dallojnë, prandaj Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka një veprimtari më të gjatë sa i përket konstituimit e forcimit të shtetit shqiptar në raport me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës të themeluar në vitin 2009.

7. Ndikimi i jurisprudencës së GJEDNJ në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë në krahasim me Republikën e Kosovës

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë më 13 korrik 1995 kishte miratuar ligjin nr. 7959 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Statutin e Këshillit të Evropës”, me vetëm dy nene, i pari përcaktonte aderimin e shtetit shqiptar në Këshillin e Evropës, ndërsa neni i dytë përcaktonte hyrjen e menjëhershme në fuqi të këtij ligji (Ligji për aderimin e RSH në Statutin e KE, 1995).

Asambleja Parlamentare në opinionin e saj me “nr. 189 në vitin 1995”, pas shqyrtimit të kërkesës së Shqipërisë për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe vizitave që kishte bërë në Shqipëri kishte vlerësuar se në kuptimin e Nenit 4 të Statutit, ky shtet ishte i gatshëm të përmbushë kushtet për anëtarësim në Këshillin e Evropës, sikurse përcaktohen në Nenin 3 të Statutit, kushte këto që kishin të bënin me pranimin e parimeve të shtetit ligjor (Parliamentary Assembly, 1995).

KEDNJ së bashku me disa protokolle është ratifikuar në vitin 1996 nga Shqipëria, e cila solli ndryshime pozitive në rendin kushtetues dhe ato hapën rrugën “drejt forcimit të shtetit ligjor, përmes sanksionimit të drejtave dhe liritë themelore të individit dhe krijuan mjetet e nevojshme për të garantuar ushtrimin efektiv të tyre”, ku u përfshi edhe Gjykata Kushtetuese (Kristo, 2007).

Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, ato janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik në Shqipëri dhe kjo përbën një garanci të përgjithshme. Kushtetuta e

Republikës së Shqipërisë në nenin 122 ka përcaktuar se “ato zbatohen drejtpërdrejt me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji të ri”. Më tej neni 116 dhe 122 par. 2 ka sqaruar pozicionin që e kanë marrëveshjet ndërkombëtare në hierarkinë juridike, ku saktësisht janë inferiore në raport me Kushtetutën ndërsa superiore në raport me ligjet. Pra, në këtë rast vërejmë pozicionin e njëjtë që kanë marrëveshjet ndërkombëtare edhe në krahasim me hierarkinë e akteve juridike në Republikën e Kosovës.

Po ashtu në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut, duket tepër qartë se në këtë drejtim Kushtetuta shqiptare është ndërtuar në mënyrë simetrike me nenet përkatëse të KEDNJ e cila nuk përbën vetëm një përfitim teknik por është mënyra më efikase për të transmetuar në realitetin shqiptar parimet e praktikës së Gjykatës së Strasburgut dhe kjo simetri bën që gjyqtarët shqiptarë të mund të gjykojnë p.sh. një çështje lidhur me lirinë dhe sigurinë e individit parashikuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe të zbatojnë kufizimet e përfshira në nenin 5 të Konventës, sepse të dy nenet janë formuluar në të njëjtën mënyrë, por ka edhe nene kushtetuese të cilat janë formuluar ndryshe pra janë jo simetrike me dispozitat e KEDNJ (Traja, Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, 2002).

Shtetin e së drejtës KEDNJ e trajton duke filluar nga preambula e saj, të cilin e shpall si trashëgimi të përbashkët të shteteve kontraktuese. Në bazë të KEDNJ, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut i shqyrton çështjet shtetërore dhe kërkesat individuale. Duke qenë se KEDNJ që në preambulë sqaron se qeveritë nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës, që i referohet si palë kontraktuese e ku bën pjesë edhe shteti i Shqipërisë, i sigurojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë dhe protokollet e saj dhe njëherit i nënshtrohen edhe juridiksionit mbikëqyrës të GJEDNJ (ECHR, 1950). Andaj, Shqipëria mund t’i drejtohet GJEDNJ si palë kontraktuese apo edhe nga çdo person, grup i individëve apo edhe organizatë joqeveritare, por vetëm pasi t’i kenë shtjerrë mjetet e brendshme ligjore.

Referuar trajtimit të parimit të shtetit të së drejtës nga GJEDNJ, do të elaboroj mëposhtë ndër të tjera dy nga rastet ku është konstatuar shkelja e këtij parimi nga shteti shqiptar.

Në “Çështjen Driza kundër Shqipërisë” jurisprudenca evropiane ka sqaruar parimin e sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës i cili kërkon mbi të gjitha që kur gjykatat për një çështje të caktuar vendosin me një vendim i cili merr formë të prerë, atëherë si rrjedhojë e sigurisë juridike këto vendime nuk duhet të vihen në dyshim

pasi duhet të respektohet parimi i gjësë së gjykuar (Çështja Driza kundër Shqipërisë, 2007). Si përfundim kishte gjetur ndër të tjera shkelje të “parimit të sigurisë juridike, mungesë të paanësisë subjektive nga kryetari i Gjykatës së Lartë dhe mungesë të paanësisë objektive të Gjykatës së Lartë, moszbatim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe jo efektivitet të mjeteve juridike të parashikuara me ligj”, andaj edhe kishte obliguar shtetin shqiptar për të kryer dëmshpërblimin.

Jurisprudenca e GJEDNJ të “Çështja Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, ka sqaruar kushtet që duhen përmbushur për të ekzistuar shteti i së drejtës në një shoqëri demokratike, e ku si kusht ndër të tjera kërkohet që të respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me KEDNJ. Ndërsa kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara mund të bëhet në një shtet të së drejtës vetëm nëse është arritur “një balancë e drejtë midis kërkesës së interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit”, kjo lidhet me situatën sapo konstatohet se ndërhyrja konkrete ka plotësuar kërkesën e ligjshmërisë dhe nuk ka qenë arbitrare (Çështja Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë, 2018). Prandaj në këtë rast kishte gjetur se shteti shqiptar kishte shkelur disa të drejta të garantuar me KEDNJ dhe protokollet e saj në veçanti kur kishte bërë kufizimin e këtyre të drejtave dhe lirive dhe kishte obliguar Shqipërinë që për këto shkelje të paguante dëmshpërblimet e caktuara për secilin kërkues, dhe se me shkeljen e këtyre të drejtave të garantuara ishte shkelur edhe parimi i shtetit të së drejtës, sepse nga jurisprudenca e GJEDNJ rezulton se ky parim është i lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNJ.

Kështu, midis KEDNJ dhe të drejtës së brendshme ka një lidhje të ngushtë, e cila shprehet në drejtim: “të zbatimit të normave, të shterimit të mjeteve të brendshme, të interpretimit të normave, të efekteve të zbatimit të Konventës në të drejtën e brendshme, të mënyrave të zbatimit të vendimeve të GJEDNJ në të drejtën e brendshme”, ku gjen shprehje në përgjithësi raporti në mes të Konventës dhe të drejtës së brendshme, pra kemi të bëjmë me dy rende ligjore në marrëdhënie midis tyre, ku Konventa përfaqëson “një rend juridik epror në fushën e të drejtave të njeriut, përderisa shtetet i nënshtrohen juridiksionit të GJEDNJ në këtë sferë të veçantë” (Puto A. , 2002, f. 18) në këtë rast kjo vlen edhe për Shqipërinë edhe për Kosovën të cilat i nënshtrohen juridiksionit të GJEDNJ. Pra, praktika e GjEDNJ-së paraqet rëndësi për vlerat orientuese të jurisprudencës të saj edhe për gjykatat në Shqipëri dhe në Kosovë.

Efektet e vendimeve të Gjykatës Evropiane vijnë si pasojë e aderimit të Republikës së Shqipërisë pranë institucionit të Këshillit të Evropës, nënshkrimit dhe ratifikimit të KEDNJ dhe Protokolleve të saj shtesë, më konkretisht nenit 46 të Konventës, i cili parashikon që “palët e larta kontraktuese do të marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë”. Ekzekutimi i këtyre vendimeve vjen si pasojë edhe e parashikimeve Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të cilat përcaktojnë hierarkinë e normave të së drejtës në Republikën e Shqipërisë, efektet e drejtpërdrejta dhe epërsinë e Konventës dhe të vendimeve të Gjykatës mbi normat e brendshme, të cilat bien në kundërshtim me to (Ministria e Drejtësisë , 2017).

Përpos GJEDNJ, Republika e Shqipërisë kishte referuar kërkesa për opinion në cilësinë “amicus curiae” në Forumin e Komisionit të Venecias, ky i fundit kishte dhënë këto opinione si mëposhtë (Venice Commission, 1995-2020):

1. Opinioni Amicus Curiae mbi “interpretimin e neneve 125 dhe 136 të Kushtetutës së Shqipërisë (Emërimi i Gjyqtarëve më të Lartë)”;
2. Përmbledhje Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë “mbi pranueshmërinë e një referendumi për shfuqizimin e Amendamenteve Kushtetuese”;
3. Opinion Amicus Curiae mbi “Ligjin mbi pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të Administratës Publike dhe Personave të Zgjedhur në Shqipëri”;
4. Përmbledhje Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë “mbi kthimin e pronës”;
5. Opinion-Përmbledhje e Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese për “Ligjin mbi Rivlerësimin Tranzitor të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji i Vettingut)”.

Sikurse në Kosovë edhe në Shqipëri ishin realizuar vizita nga raportuesit e caktuar nga Komisioni i Venecias në disa raste, të cilat do t’i veçoj mëposhtë.

Një delegacion i Komisionit të Venecias, respektivisht raportuesit kishin vizituar Shqipërinë në kuadër të përgatitjes së një opinioni mbi reformën e sistemit gjyqësor, përkatësisht mbi projekt-ndryshimet kushtetuese mbi integrimin evropian dhe gjyqësorin, ku kishin zhvilluar takim me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të bashkësisë ndërkombëtare të pranishëm në Shqipëri, kjo vizitë ishte realizuar si rrjedhojë e kërkesës për opinion në Komisionin e Venecias që e kishte parashtruar presidenti i Komitetit Parlamentar ad hoc përgjegjës për reformën kushtetuese (Venice Commission, 2015).

Kërkesë për opinion kishte parashtruar edhe nga ish-kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, lidhur me projektligjin për nismën legislative të qytetarëve, si rrjedhojë një delegacion raportuesish të Komisionit të Venecias dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nga Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) kishin vizituar Shqipërinë si pjesë e përgatitjes së opinionit të përbashkët mbi këtë projektligj (Venice Commission, 2018).

Gjatë vitit 2018 kryetari i parlamentit shqiptar, i kishte paraqitur kërkesën për opinion Komisionit të Venecias lidhur me projekt-ndryshimet kushtetuese që mundësonin verifikimin e politikanëve, përfshirë nëpërmjet vlerësimit të marrëdhënieve të zyrtarëve të lartë publikë me krimin e organizuar, andaj një delegacion i Komisionit të Venecias kishte vizituar Shqipërinë në kuadër të përgatitjes së një opinionit mbi këtë çështje ku ishin zhvilluar takime me përfaqësues të autoriteteve shqiptare, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që vepronin në Shqipëri (Venice Commission, 2018).

Sërish gjatë vitit 2018 kryetari i parlamentit shqiptar kishte kërkuar një opinion nga Komisioni i Venecias mbi kompetencat e presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve në një sistem parlamentar. Kështu për këtë qëllim një delegacion i Komisionit të Venecias kishte vizituar Shqipërinë në kuadër të përgatitjes së projekt opinionit mbi kompetencat e një presidenti për të caktuar datat e zgjedhjeve në një sistem parlamentar, i cili realizoi takime me autoritetet shqiptare që kishin lidhmëri me këtë çështje (Venice Commission, 2019).

Kërkesa tjetër ishte parashtruar nga presidenti i Shqipërisë në janar 2020 i cili kërkonte një opinion të Komisionit të Venecias për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, andaj një delegacion i raportuesve të caktuar nga ky komision për përgatitjen e këtij opinion në këtë rast kishin ardhur në Tiranë për të zhvilluar takime me akterë të ndryshëm institucionalë (Council of Europe, 2020).

Nga rastet e elaboruara të cilat iu drejtuan Komisionit Evropian në Shqipëri kanë dominuar rastet e referuara nga pushteti legjislativ, respektivisht kryetari i parlamentit shqiptar, ndërsa në raport me rastet e referuara nga Republika e Kosovës që u trajtuan në kapitullin paraprak, vërejmë se për opinion u referuan rastet kryesisht nga pushteti ekzekutiv qoftë nga kryeministri apo ministritë e caktuara.

Përmbledhje: Fillimisht është trajtuar zhvillimi historik i krijimit të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri dhe aktet juridike të cilat e kanë sanksionuar këtë organizimin e

funksonimin e saj si dhe amendamenti i kushtetutës dhe ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” në vitin 2016.

Po ashtu, është elaboruar edhe organizimi i këtij institucioni konkretisht përbërja dhe zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri, ku sa i përket përbërjes njëlloj si Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës edhe ajo e Shqipërisë, në përbërjen e saj ka nëntë gjyqtarë, por që bazuar në ndryshimet kushtetuese të 2016, Gjykata Kushtetuese ka një formulë të re të zgjedhjes së anëtarëve të saj, si dhe njëherit është zgjeruar numri i palëve të autorizuara që mund ta aktivizojnë Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa në raport me palët e autorizuara që janë të sanksionuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ka dallime të konsiderueshme.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka rol thelbësor në forcimin e shtetit të së drejtës, ku disa nga elementet e shtetit të së drejtës që i ka evidentuar jurisprudenca kushtetuese shqiptare janë në përgjithësi “siguria juridike, parimi i ndarjes së pushteteve shtetërore, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore”. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, parimi i shtetit të së drejtës është trajtuar si parim universal dhe bazë për tërë sistemin kushtetues e ligjor në Shqipëri. Pra, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, njëlloj sikurse Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka kontribuar përmes kontrollit kushtetues në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve drejt përmbushjes së elementeve të shtetit të së drejtës.

Sa i përket ndikimit ndërkombëtar, anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Evropës dhe ratifikimi i KEDNJ në Shqipëri sollën ndryshime pozitive në rendin kushtetues drejt forcimit të shtetit të së drejtës, ku rol të rëndësishëm kishte Gjykata Kushtetuese, përmes kontrollit të pajtueshmërisë së legjislacionit me standardet e KEDNJ. Obligimi për t’i zbatuar vendimet e GJEDNJ në çështjet ku Shqipëria është palë, vjen si pasojë e aderimit të Republikës së Shqipërisë pranë institucionit të Këshillit të Evropës, nënshkrimit dhe ratifikimit të KEDNJ.

Përpos GJEDNJ, Republika e Shqipërisë kishte referuar raste për opinion në cilësinë “amicus curiae” në Komisionin e Venecias, ku kanë dominuar rastet e referuara nga kryetari i parlamentit.

KAPITULLI V

GJYKATA KUSHTETUESE E MAQEDONISË SË VERIUT - HISTORIKU, JURIDIKSIONI KUSHTETUES DHE RELACIONI I SAJ ME SHTETIN E SË DREJTËS

1. Historiku i Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut

Gjykata Kushtetuese e parë, si institucion i veçantë i rendit kushtetues është inkorporuar në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë (RSM) në vitin 1963, ndërsa struktura kadrovike e organizative e saj, kompetencat dhe procedurat kushtetuese të punëve në kompetencë të saj u rregulluan me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë, i cili është miratuar kah fundi i vitit 1963, ndërsa ka hyrë në fuqi në 30 janar të vitit 1964 (Risteski, 2020, f. 6).

Me Kushtetutën e vitit 1974 të RSM dhe Ligjin për Bazat e Procedurës dhe Veprimet të Gjykatës Kushtetuese të vitit 1976 janë bërë ndryshime të vogla mbi kompetencën e Gjykatës dhe efektin juridik të vendimeve të saj, por pozita e saj në raport me pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv mbeti e pandryshueshme (Stojanovski, V., & Popçevski, K.L., & Shulevska, H., & Nikollovska, C.M., 2016, f. 9).

Pozita aktuale e Gjykatës Kushtetuese është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991 dhe me Rregulloren e punës së saj të vitit 1992 (Maksuti, 2010, f. 223). Kështu, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës, “Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ i Republikës që e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë”.

Kushtetuta e Maqedonisë Veriore ka sanksionuar nga neni 108-113, Gjykatën Kushtetuese, më saktësisht pozitën, përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve, mandatin e gjyqtarëve, juridiksionin e saj, imunitetin e gjyqtarëve, vendimet dhe efektin juridik të tyre.

Ndërsa, procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohet me akt të Gjykatës²⁹ respektivisht “Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, e cila rregullon organizimin dhe funksionimin e kësaj gjykate. Sa i përket organizimit ky akt

²⁹ Neni 113

juridik ka rregulluar zgjedhjen e gjyqtarëve, kryetarit të kësaj gjykate si dhe organizimin e brendshëm të saj. Kurse në aspektin e funksionimit ka rregulluar çështjet kushtetuese për të cilat kjo gjykatë është kompetente t'i shqyrtojë, palët e autorizuara, procedurën, që nga iniciimi nga palët e autorizuara, zhvillimi i procedurës e deri te vendimmarrja, duke vazhduar me efektin juridik dhe zbatueshmërinë e vendimit.

Parimisht në shtetet e tjera të Evropës Juglindore përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës dhe të Shqipërisë, procedura që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese, rregullohet detajisht me ligj e pastaj konkretizohen edhe me rregullore, megjithatë në rastin e Maqedonisë së Veriut kjo nuk është ndryshe pasi sipas nenit 113 të Kushtetutës, precizohet që “mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me akt të gjykatës” (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991), andaj edhe është nxjerrë Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese dhe si rrjedhojë rezulton që për shkak të kësaj ndalese nuk ka pasur Ligj për Gjykatën Kushtetuese që prej miratimit të Kushtetutës së fundit në vitin 1991.

Në përgjithësi me ligjin për Gjykatën Kushtetuese rregullohet statusi juridik i këtij institucioni në rendin kushtetues, zgjedhja, shkarkimi, imuniteti, juridiksioni kushtetues, palët e autorizuara, procedura e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese që nga iniciimi e deri në përfundim, vendimet kushtetuese dhe ekzekutimi i tyre, e që në rastin e Maqedonisë Veriore këto i sanksionon rregullorja. Zakonisht organizimi por edhe procedura në Gjykatën Kushtetuese rregullohet me akt të përgjithshëm në këtë rast me rregullore që bazohet në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias, në opinionin e tij që e kishte dhënë në 13 tetor 2014 lidhur me amendamentet e Kushtetutës së ish-Republikës Federale të Maqedonisë, ndër të tjera edhe për kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, sa i përket akteve juridike të Gjykatës Kushtetuese meqë mungonte ligji për Gjykatën Kushtetuese e vlerësonte këtë situatë mjaft të parregullt, andaj e rekomandonte si të dobishme miratimin e “një ligji të veçantë për këtë gjykatë” që do të rregullonte kushtet themelore për fillimin e procedimit në Gjykatën Kushtetuese, e çështje të tjera (Opinion N° 779 / 2014, 2014, p. 17). Por, për t'u implemtuar ky opinion i Komisionit të Venecias duhet fillimisht të bëhet amendamenti kushtetues që të modifikohet për lejin e nxjerrjes së një ligji për Gjykatën Kushtetuese, çka ende nuk ka ndodhur.

2. Përbërja, zgjedhja, shkarkimi, mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Veriore në aspekt krahësues me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë

2.1. Përbërja, zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë Veriore (RMV) është organ i veçantë dhe i pavarur në sistemin kushtetues të vendit, që pozicionohet jashtë kuadrit të gjyqësisë së rregullt. Në strukturën e vet përbërëse ka nëntë gjyqtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i RMV-së,³⁰ të cilën përbërje e ka edhe Gjykata Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe atë të Shqipërisë. Sipas amendamentit XV të Kushtetutës së RMV, Kuvendi zgjedh (Vendim për shpalljen e amandamenteve IV-XVIII , 2001)³¹: “gjashtë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të RMV me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, pra me shumicë absolute”, dhe “tre gjyqtarë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës duhet të ketë shumicë nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në RMV”.

Gjatë procedurës së propozimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese janë të kyçura më tepër organe, pasi nga dy gjyqtarë kushtetues i propozon Presidenti i Republikës dhe Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, pesë gjyqtarët e tjerë i propozon Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Risteski, 2020). Si konkludim rrjedhë se të gjithë gjyqtarët i zgjedh Kuvendi. Pra, RMV bën pjesë në grupin e shteteve ku Kuvendi e ka “pushtetin ekskluziv të centralizuar në zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo zgjidhja e tillë nuk është në frymën e duhur të parimit të ndarjes së pushtetit shtetëror” meqenëse nuk siguron garancinë e plotë nga ndikimet dhe presionet politike dhe partiake me rastin e zgjedhjes të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (Shasivari, 2020, f. 378).

Sa i përket kushteve që duhet përmbushur është se “gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar” (Kushtetuta e Republikës së

³⁰ Neni 109

³¹ Amendament XV

Maqedonisë, 1991).³² Kriteria të tjera nuk përcaktohen madje edhe ky kriter nuk është i qartë, pasi nuk precizohet se kush konsiderohet jurist i shquar dhe si pasojë e kësaj krijon mundësi për interpretime të ndryshme.

Në të drejtën kushtetuese komparative, në rastin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës përkufizimi i këtij nocioni është më i gjerë pasi kandidatët për gjyqtarë sipas nenit 114 ndër të tjera theksohet se “... duhet do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse”. Në këtë drejtim duhet përmendur që më mirë qëndron Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ndryshuar në vitin 2016, e cila ka përcaktuar detajisht kriteret objektive që kandidatët për gjyqtarë duhet t’i përmbushin për t’u zgjedhur gjyqtarë kushtetues, ku neni 105 paragrafi 4 dhe 5, saktëson se “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës”. Pra, ky nen përcakton përveç shkollimit të lartë, përvojës në punë edhe kategoritë të cilët mund të kandidojnë. Por, Kushtetuta e Shqipërisë vazhdon më tej, me qëllim të shmangies së politizimit të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, dhe parashikon si kriter edhe kufizimin e “mbajtjes së funksioneve politike në administratën publike ose pozicioneve drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”.³³ Por, jo vetëm në aspektin kushtetues që i ka sanksionuar gjerësisht kriteret për kandidatët për gjyqtarë kushtetues, ka vazhduar edhe në aspektin ligjor ku ka përcaktuar gjerësisht kriteret dhe kushtet për emërimin e gjyqtarit kushtetues. Andaj në këtë rast Kushtetuta e Shqipërisë duhet të shërbejë si model për Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe atë të Maqedonisë Veriore.

Shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga detyra, pa vullnetin e tij, mund të bëhet vetëm me përjashtim. Deri në këtë, sipas Kushtetutës, mund të vijë kur do të krijohen rrethana të caktuara objektive: nëse gjyqtari dënohet për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me dënim prej më së paku gjashtë muaj ose kur përgjithmonë do ta humbë aftësinë e ushtrimit të funksionit të tij (Risteski, 2020, f. 19).

³² Neni 109 par. 4.

³³ Kushtetuta e Shqipërisë.

2.2. Mandati dhe imuniteti i gjyqtarëve kushtetues

Mandati i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese zgjat nëntë (9) vjet, pa të drejtë për rizgjedhje, ndërsa kryetari i cili udhëheq me gjykatën ka mandat tre vjet, po ashtu pa të drejtë rizgjedhje (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991). Edhe në drejtim të mandatit ka ngjashmëri me rastin e Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë.

Sa i përket imunitetit, sipas nenit 111 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë Veriore, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet. Më tej, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të RMV, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet njëllë sikurse deputetët e Parlamentit të RMV të garantuar me Kushtetutë, kështu “sikurse deputeti edhe gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në Gjykatë” (Rules of procedure of the CCRM, 1992).³⁴ Më tej, me aktin nënligjor përcaktohet se gjyqtari “nuk mund të arrestohet pa pëlqimin e Gjykatës, përveç nëse kapet në kryerje e sipër të veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh”.

Pra, në aspektin e imunitetit, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të barabartë me deputetët e Kuvendit, pra në këtë rast neni 111 dhe 64 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë Veriore janë të njëjtë për nga garancitë që ofrojnë sa i përket imunitetit të funksionarëve publik dhe konkludoj se gjyqtarët gëzojnë vetëm imunitet funksional gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, e jo edhe për veprimet të cilat i ndërmarrin jashtë funksionit të tyre.

³⁴ Article 10

3. Juridiksioni dhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në vështrim krahasues me Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë

3.1. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë Veriore

Mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë sipas nenit 108 të Kushtetutës së Maqedonisë Veriore i atribuohet Gjykatës Kushtetuese në këtë vend (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991). Pra, në këtë drejtim vërejmë ngjashmëri sa i përket rolit që kanë Gjykatat Kushtetuese edhe në Republikën e Kosovës dhe asaj të Shqipërisë.

Për realizimin e rolit të saj kushtetues, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore niset nga siguri dhe mbrojtja e unitetit të rendit juridik hierarkik, i cili shtrihet në përmbajtjen e përgjithshme të Kushtetutës. Zbatimi i mbrojtjes “sui generis” të rendit kushtetues nëpërmjet praktikës juridike kushtetuese, ka ndikim në sigurimin e vlerave themelore të rendit kushtetues si shtetit të së drejtës, kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe respektimin e mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, të garantuara me Kushtetutë (Ristova-Ingilizova, 2004).

Ndërsa në nenin 110, taksativisht janë numëruar kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut e cila vendos: “për harmonizimin e ligjeve e akteve të tjera juridike dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën”, pra ushtron kontroll normativ mbi aktet e përgjithshme juridike; “e zgjidh konfliktin e kompetencave midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale; vendos për përgjegjësinë e Presidentit të Republikës; vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve dhe vendos për çështje të tjera të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut” (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991).

Konform kompetencës kushtetuese në lëmin e kontrollit normativ, “Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese si dhe të traktateve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën” (Kadriu, 2006, f. 326), kjo sepse e drejta ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë Veriore ka primatin ndaj të drejtës së brendshme. Ndonëse lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare,

Gjykata Kushtetuese bëri një presedan në vitin 2002, kur e shfuqizoi “Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes bilaterale midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë lidhur me ndërtimin dhe administrimin e naftës-jellësit”, e që përbën rastin kur kjo gjykatë shpallet kompetente për të vlerësuar akte të tilla juridike, që nuk janë të përcaktuar në Kushtetutë në kompetencën e saj (Maksuti, 2010, fv. 226-227).

Sa i përket mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë Veriore, Gjykata Kushtetuese parashikon mbrojtje vetëm të disa lirive dhe të drejtave të njeriut dhe jo të të gjitha lirive dhe të drejtave të cilat me Kushtetutë i garantohen qytetarëve të Republikës. Pra, me këtë Gjykata Kushtetuese ka përfaqësuar mbrojtjen restriktive të lirive dhe të drejtave dhe atë vetëm të: “lirisë së bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimit dhe veprimit politik dhe ndalimit të diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike” (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991).

Vërehet qartë kompetenca e kufizuar e Gjykatës për të mbrojtur vetëm disa liri dhe të drejta të karakterit personal dhe politik, ndërsa kategoritë e tjera të drejtave dhe lirive socio-ekonomike dhe kulturore të njeriut mbrohen nga subjektet e tjera shtetërore të përcaktuara me kushtetutë. Kjo dispozitë e kufizuar e ngushton fushëveprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese sa i përket mbrojtjes e realizimit efikas të lirive dhe të drejtave. Pra, Kushtetuta e Maqedonisë Veriore garanton mbrojtjen e vetëm tri të drejtave dhe lirive përmes procedurës në Gjykatën Kushtetuese, të cilës i mungon baza ligjore që kjo Gjykatë të jetë garantuese dhe mbrojtëse e vërtetë e të drejtave të njeriut. Nevoja për këtë garanci është evidente për kuptimin dhe karakterin e aspekteve procedurale dhe materiale të Gjykatës në sistemin kushtetues dhe ligjor të vendit.

Sa i përket kompetencës kushtetuese për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës më gjerësisht është rregulluar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, e cila specifikon në nenin 62 se Gjykata Kushtetuese vendos për “zgjidhjen e konfliktit të kompetencës midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale”.

3.2. Palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në aspekt krahasues me ato në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë

Palët e autorizuar janë të sanksionuara në Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese, ku në rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së ligjit ose të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm nënligjor secili mund të paraqesë iniciativë për fillimin e kësaj procedure të vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (*actio popularis*) përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese që me aktvendim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) mund të iniciojë procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit (Risteski, 2020), për shqyrtimin e imunitetit të Presidentit të Republikës Gjykata Kushtetuese vendos me propozimin e organit kompetent para të cilit paraqitet kërkesa për ngritjen e kallëzimit penal, në rastin e konfliktit për kompetencë palë e autorizuar është secili prej organeve ndërmjet të cilave ka lindur konflikti, për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut palë e autorizuar është çdo qytetar që pretendon se i është cenuar e drejta ose liria e garantuar me Kushtetutë (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991). Sa i përket inicimit të rasteve sipas detyrës zyrtare, “instalimi i saj në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk rekomandohet pasi Gjykata është një arbitër neutral, në të kundërtën gjykata rrezikon të etiketohet si partiake dhe respekti për të do të mungonte” (Tunheim, 2021).

Në rastin e palëve të autorizuar në raport me Republikën e Kosovës vërejmë se numri i palëve të autorizuar është shumë më i vogël, dallimi thelbësor konsiston në të drejtën e Gjykatës Kushtetuese që sipas detyrës zyrtare të iniciojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose aktit të përgjithshëm.

Tabela 3. Palët e autorizuar sipas Kushtetutës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore

Palët e autorizuar sipas:		
Kushtetutës së Republikës së Kosovës	Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë	Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë Veriore
- Presidenti i Republikës; - Qeveria; - Kuvendi i Kosovës; - Dhjetë (10) dhe tridhjetë (30) a më shumë deputetë; - Avokati i Popullit; - Komuna; - Gjykatat; - Kryetari i Kuvendit; - Individët,	- Presidenti i Republikës; - Kryeministri; - Jo më pak se një e pesta e deputetëve; - Avokati i Popullit; - Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; - Çdo gjykatë, - Çdo Komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive; - Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe i Prokurorisë; - Organet e qeverisjes vendore; - Organet e bashkësive fetare; - Partitë politike; - Organizatat; - Individët.	- Gjykata Kushtetuese ex-officio; - Secili mund të paraqesë iniciativë për fillimin e procedurës të vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (actio popularis); - Organi kompetent para të cilit paraqitet kërkesa për ngritjen e kallëzimit penal; - Secili prej organeve ndërmjet të cilave ka lindur konflikti për kompetencë; - Çdo qytetar.

Burimi: (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008); (Ligji nr. 76/2016 , 2016) dhe (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991).

4. Llojet e vendimeve kushtetuese, procedura e vendimmarrjes, efekti juridik dhe ekzekutimi i tyre

4.1. Llojet e vendimeve kushtetuese

Në realizimin e kompetencës së saj Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut merr dy lloje aktesh: vendime dhe aktvendime. Dallimi midis tyre konsiston në atë se Gjykata miraton vendim kur vendos në mënyrë meritore për vetë çështjen (vetë esencën e kontestit), kurse, e miraton aktvendimin vetëm për ngritjen ose ndërprerjen e procedurës, që domethënë se aktvendimi ka natyrë procedurale (Shasivari, 2020, f. 383).

Në bazë të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë Veriore, në nenin 69 sqarohet se kjo gjykatë nxjerrë vendime, aktvendime dhe konkluzione, ku në nenin 70 të saj numërohen taksativisht çështjet kur kjo Gjykatë vendos me vendim si p.sh. në rastin e shfuqizimit ose anulimit të ligjeve ose dispozitave ligjore, për zgjidhjen e konfliktit për kompetencë, etj.

Ndërsa sipas nenit 71 të Rregullores me aktvendim vendos për çështjet procedurale siç janë: refuzimi i iniciativave, propozimeve dhe kërkesave për fillimin ose ndërprejen e procedurave kushtetuese, etj.

Dhe sipas nenit 72 të Rregullores, Gjykata Kushtetuese nxjerrë konkluzione për aktivitetet që ndërmerren gjatë procedurës.

Në aspektin komparativ me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë ka ngjashmëri pasi edhe ajo vendos në mënyrë meritore dhe merr vendim, ndërsa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në këtë situatë vendos me aktgjykim ndërsa me vendime vendos për masë të përkohshme apo për çështje të tjera administrative.

4.2. Procedura e vendimmarrjes

Aktet e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Veriore miratohen në seancë me votimin e gjyqtarëve. Vendimet miratohen me votim, ku për miratimin e vendimit nevojitet shumica absolute, që nënkupton se në tërësi nga nëntë gjyqtarë, së paku duhet të votojnë pro gjashtë prej tyre, nëse nuk sigurohet një shumicë e tillë atëherë konsiderohet se vendimi nuk është nxjerrë. Kjo nënkupton se vendimet nxirren duke e respektuar parimin e kolegjalitetit.

Gjyqtari i cili ka mendim tjetër nga shumica, i lejohej që mendimi i tij të veçohet dhe publikohet në “Gazetën Zyrtare” ashtu si edhe botohen vendimet e tjera të Gjykatës Kushtetuese konform nenit 78 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mendimi mospajtues i gjyqtarit kushtetues shërben si garanci për pavarësinë e gjyqtarëve gjatë punës së tyre nga ndikimet e jashtme dhe ndikimet nga gjyqtarët e tjerë.

Në praktikën kushtetuese nga viti 2003-2011 janë dhënë më shumë mendime mospajtuese në total njëzet e nëntë (29), sesa në periudhën ndërmjet themelimit të Gjykatës në vitin 1964 deri në vitin 2003 që në total janë dhënë gjashtë (6) mendime mospajtuese, gjë që përbën një trend shumë pozitiv (Spirovski, 2011).


4.3. Efekti juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtetuta e RMV ka sanksionuar në nenin 112 efektin që kanë vendimet e saj dhe nga analizimi i kësaj dispozite kushtetuese rezulton se Gjykata Kushtetuese, vendimet me karakter abrogues apo shfuqizues, i nxjerrë atëherë kur do të abrogojë ose shfuqizojë “ligjin, rregullin, aktin e përgjithshëm, marrëveshjen kolektive, statutin apo programin e partisë politike ose të shoqatës, nëse konstaton se të njëjtat nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose me ligjin”.

Efekti juridik i vendimit qoftë abrogues apo edhe shfuqizues qëndron në faktin e shfuqizimit të aktit apo rregullës që ka qenë objekt kontrolli nga Gjykata Kushtetuese. Respektivisht në rastin e një vendimi abrogues të aktit juridik, i cili nuk prodhon efekt juridik vetëm në të ardhmen, pro futuro, vendimi kushtetues abrogues vepron ex nunc, nga momenti i miratimit të këtij vendimi (Kadriu, 2006, fv. 330-331).

Ndërsa anulimi i aktit juridik do të thotë jo vetëm që nuk ka më efekt juridik në të ardhmen, pra nuk vlen më, por Gjykata vendos edhe për pasojat që ka krijuar si akt prej momentit të miratimit të tij dhe gjatë kohës sa ka qenë në fuqi (Maksuti, 2010, f. 228).

Grafikoni 1. Numri i lëndëve të zgjidhura sipas llojit të aktit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë Veriore për periudhën 2015-2019



Burimi: (Risteski, 2020)

Nga grafikoni i mësipërm konstatoj se viti 2018 i punës së Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut është dalluar për nga numri më i lartë i vendimeve me karakter shfuqizues në raport me ato me karakter anulues. Ndërsa në përgjithësi që nga vitit 2015-2019, kanë dominuar në numër të lartë aktvendimet për mosngritje të procedurës dhe aktvendimet për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës në raport me numrin e vendimeve shfuqizuese dhe anuluese, që dëshmon se palët e autorizuara nuk kanë njohuri të mjaftueshme se në cilin stad mund t'i drejtohen këtij institucioni për çështjet e sanksionuara me Kushtetutë. Në këtë drejtim ndikon edhe mungesa e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili po të ekzistonte do të ndikonte në ngritjen e cilësisë për zgjidhjen e çështjeve kushtetuese, palëve të autorizuara e procedurave kushtetuese dhe më këtë do të prodhonte edhe konsekuenca në uljen e numrit të aktvendimeve për mosngritje të procedurës dhe aktvendimeve për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës.

Sipas nenit 112 të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut “vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme” që nënkupton se kundër këtyre vendimeve nuk ka të drejtë ankese dhe si rrjedhojë edhe ekzekutohen menjëherë pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Këto vendime kanë efekt të njëjtë juridik sikurse vendimet e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë.

4.4. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sipas nenit 86 të Rregullores, vendimet e Gjykatës Kushtetuese i ekzekuton miratuesi i ligjit, rregullores ose aktit tjetër të përgjithshëm, i cili me vendim të gjykatës është anuluar, ose shfuqizuar.

Vendimet me të cilat kjo gjykatë vendos për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, të caktuara me Kushtetutë, i ekzekuton organi ose organizata që e ka miratuar aktin e veçantë i cili me vendim të gjykatës është anuluar, përkatësisht organi ose organizata që e ka ndërmarr veprimin të cilin Gjykata Kushtetuese me vendim e ka ndaluar. Ndërsa neni 87 i Rregullores ia cakton “Gjykatës Kushtetuese detyrën për monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të veta dhe njëherit sipas nevojës të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta sigurojë ekzekutimin e tyre”.

Gjithsesi duhet të përmendet një instrument i fuqishëm për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë dispozitat e Kodit Penal i cili parashikon dënime të mëdha (pesë vjet burg) për moszbatimin e vendimit të gjykatës (Stojanovski, V. et al., 2016, f. 12).

5. Roli i Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë Veriore në forcimin e shtetit të së drejtës në vështirim krahasues me Republikën e Kosovës dhe të Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991 vendosi statusin e Gjykatës Kushtetuese si organ i Republikës me ndikim në sigurimin e vlerave themelore të rendit kushtetues, në ruajtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të drejtave dhe lirive të individit dhe qytetarit, parimin e shtetit të së drejtës dhe pjesëmarrjen në ndërtimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Pra, Gjykata Kushtetuese shërben si garanci për realizimin e shtetit të së drejtës dhe është edhe faktor real e social në realizimin dhe zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve (Goševa, 2014, p. 7).

Kontributi i saj në forcimin e shtetit të së drejtës vërehet prej vitit 1991 e në vazhdim, kur Gjykata ka nisur procedurat me iniciativën e saj në disa raste, d.m.th në situata kur miratuesit e aktit janë përpjekur t'i shmangen rregullit për fillimin e procedurës duke

miratuar një akt të ri me përmbajtje të njëjtë apo kur me ligj për referendum përcaktoheshin kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, pra gjykata ndërhynte për të mbrojtur pozicionin e saj kushtetues; ose kur Gjykata është dashur të zbatojë një ligj për nxjerrjen e vendimit të saj dhe ka vlerësuar se ai nuk është në përputhje me Kushtetutën, raste këto ku iniciativa e realizuar sipas detyrës zyrtare e Gjykatës mund t'i shërbente vetëm krijimit dhe forcimit të shtetit të së drejtës (Spirovski, 2011).

“Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror” përbën njërin nga elementet e shtetit të së drejtës, i cili do të materializohej nëse pushteti shtetëror do të ishte i ndarë dhe i ekuilibruar në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Rast konkret i cili është referuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë ishte në vitin 1994, kur u paraqit konflikti në mes të kryetarit të Republikës dhe Ministrisë së Mbrojtjes lidhur me të drejtën e udhëheqjes së Armatës së Republikës së Maqedonisë, pra kishte konflikt të karakterit pozitiv pasi të dyja organet konsideronin se janë kompetente për këtë çështje. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjes vendosi se kryetari i Republikës është kompetent që të udhëheqë me Armatën e Republikës së Maqedonisë sepse sipas dispozitave kushtetuese ai është komandat i forcave të armatosura në Republikën e Maqedonisë (Maksuti, 2010, f. 226).

Duhet potencuar rastin në vitin 2016, kur Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore lidhur me vendimin për shpërndarjen e Kuvendit brenda tre muajve gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së këtij vendimi kishte nxjerrë dy vendime kundërthënëse për këtë çështje, respektivisht më 18 janar 2016 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë Veriore kishte miratuar vendimin për shpërndarjen e tij, që duhej të hynte në fuqi më 24 shkurt 2016, por ky vendim u kontestua në Gjykatën Kushtetuese për shkak të efektit të tij shtyrës, por kjo e fundit nuk e pranoi këtë iniciativë me arsyetimin se ky vendim përbënte akt dhe veprim konkret që nuk përmban normë juridike të përgjithshme sepse nuk i rregullonte marrëdhëniet në mënyrë të përgjithshme pasi rregullonte situatën konkrete në këtë rast shpërndarjen e Kuvendit, pas kësaj më 23 shkurt 2016 ishte ndryshuar hyrja në fuqi e vendimit për shpërndarjen e parlamentit ku vendimi do të hynte në fuqi më 7 prill 2016 dhe jo më 24 shkurt 2016 (Shasivari, 2020). Ky vendim filloi të prodhonte pasoja juridike më 7 prill 2016 kur edhe Parlamenti u shpërnda dhe u shpallën zgjedhjet e parakohshme, mirëpo shteti ndodhej në një krizë të thellë politike dhe nuk kishte kushte për organizimin e zgjedhjeve demokratike dhe të lira. Prandaj, në këto rrethana u parashtrua kërkesa në

Gjykatën Kushtetuese për shtyrjen e zgjedhjeve dhe më 18 maj 2016 ajo vendosi njëzëri se kishte kompetencë për të vendosur lidhur me vendimin për shpërndarjen e Parlamentit, sepse ky “vendim ka karakter juridik të përgjithshëm” dhe si rrjedhojë e kësaj i anuloi të dy vendimet për shpërndarjen e parlamentit me efekt shtyrës (Shasivari, 2020, f. 388).

Vërehet qartë mosstabiliteti i Gjykatës Kushtetuese për shkak të qëndrimeve të ndryshme lidhur me çështjen e njëjtë, çka dëshmon për mungesë të konsistencës në qëndrimet e saj, mungesë të arsytimit dhe profesionalizimit dhe njëherit edhe mungesë të pavarësisë në punën e saj. Kjo ndikon edhe besimin e qytetarëve në këtë autoritet shtetëror.

Shtyllë qendrore të një shteti të së drejtës paraqet edhe garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut. Sistemi kushtetues i Maqedonisë Veriore është unik sa i përket normës juridike që parashikon instrumentin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e që për sistemin kushtetues maqedonas është gjithashtu i pazakontë për nga emri i tij, kjo pasi në të drejtën krahasuese nuk ekziston asnjë mekanizëm tjetër juridik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i cili emërtohet me termin e përgjithshëm administrativ “kërkesë” (Jovanovska K. Tanja., & Saveski D., 2021, p. 6). Kështu meqë Gjykata Kushtetuese përfaqëson mbrojtje restriktive të drejtave dhe lirive të njeriut, atëherë edhe nga praktika kushtetuese dëshmohet numri shumë i vogël i lëndëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut para Gjykatës Kushtetuese, respektivisht në periudhën kohore nga 1 janari 2010-31 dhjetor 2019, në total janë trajtuar 148 kërkesa të tilla, të cilat janë shqyrtuar dhe është marrë vendim vetëm për tre (Constitutional Court of the Republic of NM, 2010-2020) ndërsa 145 të tjera “janë refuzuar si të pabaza ose janë hedhur poshtë” mbi baza të ndryshme. Këto tre vendime janë si mëposhtë:

1. Më 10 shkurt 2010, Gjykata Kushtetuese, me vendimin U.nr. 84/2009, vendosi se mospranimi i kandidaturës për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale cenonte të drejtën e përkatësisë politike të parashtruesit të kërkesës Xhavid Rushini (Decision U.no.84/2009, 2009).

2. Më 27 qershor 2018, Gjykata Kushtetuese nxori vendimin U.nr. 116/2017 ku kishte konstatuar shkelje të “lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë politike”, ku parashtruesit e kërkesës me pretendimet e cekura pretenduan se me veprimin e një zyrtari nga Ministria e Brendshme, iu shkel e drejta për protestë paqësore (Decision U.no.116/2017, 2018).

3. Më 29 maj 2019, Gjykata Kushtetuese nxori vendimin nr. 57/2019 ku konstatoi shkelje “të lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit” dhe anuloi aktet përfundimtare me të cilat ishte shqiptuar gjobë, ku parashtuesit e kërkesës pretendonin se me vendosjen e gjobës gjatë një procedure gjyqësore, u cenohej liria e lartcekur që iu garantohej me Kushtetutë (Decision U.no.57/2019, 2019).

Tabela 4: Numri i kërkesave sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore në periudhën kohore 2010-2019

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej kërkesa të pranuar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut	9	23	25	22	13	13	8	5	11	19

Burimi: (Constitutional Court of the Republic of NM, 2010-2020)

Numri i madh i kërkesave të refuzuara ose të hedhura poshtë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nga numri edhe ashtu i vogël i kërkesave të paraqitura dërgon në konkluzionin se qytetarët janë pamjaftueshëm të informuar me kushtet se kur mund të kërkohej kjo lloj mbrojtje, si dhe me natyrën juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (Risteski, 2020, f. 32).

Mungesa e ankesës kushtetuese si dhe kufizimi i mbrojtjes vetëm të disa të drejtave dhe lirive të njeriut, janë ndër shkaktarët kryesor për këto pak kërkesa të paraqitura për periudhën e lartcekur gati një dekadë.

Edhe Komisioni i Venecias gjithashtu konstatoi se numri i vogël i të drejtave të mbrojtura nga Gjykata Kushtetuese ishte shkaku i një sërë ankesash kundër Maqedonisë Veriore në GJEDNJ (Venice Commission , Report of the TAIEX , 2018, p. 16), që nënkuptonte instalimin e një mjeti të ri juridik në nivel kombëtar i cili do ndikonte në rritjen e rasteve që do të duhej të vlerësoheshin nga Gjykata Kushtetuese.

Qasja restriktive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut kishte mundësi të evitohej dhe të ndryshonte përmes inkorporimit të mjetit juridik, ankesës kushtetuese në kohën kur u bën përpjekje që të miratohen amendamente të caktuara në Kushtetutë gjatë vitit 2014. Përmbajtja e këtyre amendamenteve parashikonte vendosjen e institutit të

ankesës kushtetuese megjithatë argumentet e dhëna nuk ishin të qarta dhe koncize, por përkundrazi u propozuan me arsyetim shumë të shkurtër, jodekuat dhe pabazë me çka prezantuan një gjendje të konfuzionit për mjete juridike efektive dhe efikase, andaj edhe si të tilla u vlerësuan negativisht (Stojanovski, V., & Popçevski, K.L., & Shulevska, H., & Nikollovska, C.M., 2016, f. 36). Dështimin e këtij amendamenti e kishte argumentuar edhe Komisioni i Venecias, i cili kishte vlerësuar se ishte riaplikuar metoda e përzgjedhjes diskrecionale të të drejtave për të cilat do të sigurohej mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese dhe se ky amendament i propozuar ishte një zgjidhje e dobët ligjore, asgjë veçse trillim se numri i të drejtave të mbrojtura ishte rritur (Venice Commission , Report of the TAIEX , 2018, p. 17).

Ndonëse Kushtetuta e proklamon si vlerë kushtetuese shtetin e së drejtës, në anën tjetër Gjykata Kushtetuese me vendimet e ndryshme të dhëna ndër vite për çështjet e njëjta, dhe me dominimin e aktvendimeve për mosngritje të procedurës e aktvendimeve për hedhjen poshtë të iniciativës/kërkesës përfshirë këtu edhe kërkesat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, konsideroj se ky organ kushtetues nuk ka kontribuar mjaftueshëm në krijimin e forcimit të shtetit të së drejtës në Maqedoninë e Veriut, pra baza juridike ekziston jo e plotë për garantimin e shtetit të së drejtës dhe mungon pavarësia e profesionalizimi i Gjykatës Kushtetuese për ta implemtuar këtë vlerë kushtetuese. Andaj, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore ka nevojë imediate për reforma thelbësore strukturore dhe procedurale.

6. Ndikimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fuqizimin e shtetit të së drejtës në Maqedoninë Veriore në aspekt krahasues me Republikën e Kosovës dhe Shqipërisë

Republika e Maqedonisë Veriore është pranuar me anëtarësim të plotë në Këshillin e Evropës më 9 nëntor 1995 (Statute of the Council of Europe, 1949).

Ndonëse Maqedonia Veriore ishte anëtarësuar në Këshillin e Evropës, megjithatë ndikimi evropian në ndërtimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës është realizuar përmes aplikimit të praktikës së GJEDNJ nga Gjykata Kushtetuese e RMV, aplikim ky që erdhi me vonesë nga ana e autoriteteve maqedonase.

Andaj, një moment pozitiv i cili duhet të përmendet është qasja evolutive e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me praktikën e GJEDNJ në Strasburg, kur në vitin 2006 Gjykata në “rastin Ubr.31/2006”, vendos të aplikojë praktikën e Strasburgut, kështu që në vendimet e mëpasshme e zgjeron rrethin e burimeve të të drejtës në RMV, përmendim këtu “rastin Ubr.28/2008”, “Ubr.104/2009”, etj. (Stojanovski, V. et al., 2016, f. 11).

Megjithatë, bazuar në faktin se anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Këshillin e Evropës është bërë në vitin 1995, ky aplikim i praktikës së Gjykatës së Strasburgut bëhet dhjetë (10) vjet pas ratifikimit të KEDNJ në Maqedoni, përbën tregues negativ për kulturën juridike dhe ngadalshmërinë e transformimit të saj.

Po ashtu, duhet potencuar se praktika modeste e Gjykatës Kushtetuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut rezulton jo vetëm si rrjedhojë e natyrës kufizuese të rregullave kushtetuese dhe procedurale, por edhe i stagnimit të Gjykatës Kushtetuese në ndjekjen e praktikës së GJEDNJ.

Mbrojtja e të drejta dhe lirive të njeriut përbën njërin nga elementet e shtetit të së drejtës, në Maqedoninë Veriore, qytetarët gëzojnë mbrojtje edhe në aspektin evropian në këtë drejtim, e që në përputhje me rregullin për shterimin e të gjitha mjeteve juridike të sistemit juridik vendas, është logjike të konkludohet se përpara se të paraqitet një ankimim (apel) në GJEDNJ, është e detyrueshme të kërkohet mbrojtje në Gjykatën Kushtetuese të RMV (Report of the Constitutional Court of the former Yugoslav RM).

Nga praktika e GJEDNJ, referuar nga individët maqedonas për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut veçoj rastin “Tasev kundër Maqedonisë së Veriut”, që kishte të bënte me një njoftim që ishte publikuar në shtator të vitit 2012 për një vend vakant në Këshillin Gjyqësor Shtetëror për t’u përmbushur nga gjyqtarët në detyrë të zgjedhur nga radhët e tyre, e që etniciteti nuk ishte përfshirë te kërkesat e deklaruara për këtë vend. Kërkuesi, ishte një gjyqtar i cili ishte përpjekur të kandidonte si kandidat ku kishte kërkuar që etniciteti i tij në listën zgjedhore të ndryshohej nga bullgare në maqedone, por Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat e të dy shkallëve të gjykimit e refuzuan këtë kërkesë. GJEDNJ këtë refuzim për të regjistruar një ndryshim në etnicitetin e vetë-dekluar të kandidatit në një periudhë zgjedhjesh, pa bazë ligjore të parashikueshme e vlerësoi si “shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut duke e argumentuar se sipas praktikës të vendosur të GJEDNJ, shprehja "në përputhje me ligjin" kërkon që e drejta e brendshme duhet të tregojë me qartësi të arsyeshme shtrirjen e ligjit dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit përkatës që u jepet

autoriteteve publike” në mënyrë që t’iu sigurohet individëve shkallë minimale e mbrojtjes që atyre t’iu garantohej kjo e drejtë sipas parimit të shtetit të së drejtës (Tasev v. North Macedonia, 2019).

Në rastin tjetër “Latifi kundër Republikës së Maqedonisë” kërkesja në vitin 1999 u arratis nga Kosova për në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe këtu asaj i ishte dhënë azil në vitin 2005, ndërsa në vitin 2014 Ministria e Brendshme ia pushoi statusin e azilit, duke u shprehur se ajo përbënte thjesht një “rrezik për sigurinë (kombëtare)” dhe urdhëroi që ajo të largohej nga territori i shtetit të paditur nga marrja e vendimit përfundimtar dhe se gjykatat e brendshme e lanë në fuqi vendimin, duke theksuar që ky vendim me një vlerësim të tillë bazohej në një dokument të siguruar nga Agjencia e Shërbimeve të Fshehta, për të cilin dokument kërkesja nuk ishte njoftuar por nuk e morën parasysh këtë argument. (Ljatifi v. the Former Yugoslav RM, 2018). GJEDNJ kishte vlerësuar ndër të tjera se edhe në rastet kur siguria kombëtare është në rrezik, konceptet e ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike kërkojnë që masat e dëbimit që prekin të drejtat themelore të njeriut t’i nënshtrohen njëfarë forme të procedurave kundërshtuese përpara një autoriteti të pavarur ose një gjykate kompetente (Ljatifi v. the Former Yugoslav RM, 2018).

Rasti i rradhës është “Petreska kundër Republikës së Maqedonisë”, kërkesi ishte ankuar për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore për çka GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ, në argumentimin e saj lidhur me këtë shkelje, GjEDNJ rithekson se një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës është parimi i sigurisë juridike dhe vendimet kontraktore në çështje të ngjashme të dëgjua në të njëjtën gjykatë, e cila, përveç kësaj, është gjykatë e shkallës së fundit për këtë çështje, në mungesë të një mekanizmi që garanton konsistencën, mund të shkelë këtë parim dhe në këtë mënyrë të dëmtojë besimin e publikut në gjyqësor, që përbën një nga komponentët thelbësorë të një shteti të së drejtës (Petreska v. The Former Yugoslav RM, 2016).

Në përgjithësi ka edhe raste të tjera të cilat i ka trajtuar GJEDNJ kundër Maqedonisë së Veriut, andaj vërejmë se me praktikën e saj kjo gjykatë njëlloj si në Shqipëri edhe në Maqedoninë Veriore ka dhënë kontribut të theksuar në forcimin e shtetit të së drejtës, në veçanti duke trajtuar kërkesat e individëve lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të garantuara, për shkak të anëtarësimit të tyre në Këshillin e Evropës qytetarët e këtyre shteteve gëzojnë mbrojtje të avancuar, ndërsa përjashtim bën Republika e Kosovës e cila nuk

është anëtare e kësaj organizate ndërkombëtare dhe si rrjedhojë individët gëzojnë vetëm mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në nivel nacional.

7. Ndikimi i opinioneve të Komisionit të Venecias në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë Veriore

Anëtarësimi i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë apo Maqedonisë Veriore dhe i Shqipërisë është i hershëm dhe daton nga viti 1995, kjo dëshmohet nga neni 26 i Statutit të Këshillit të Evropës i ndryshuar së fundmi në vitin 2015, kur këto shtete u anëtarësuan në Këshillin e Evropës e me këtë rast edhe në Komisionin e Venecias sepse bëhet fjalë për periudhën kur ky komision ishte i hapur për anëtarësim vetëm për shtetet që ishin anëtare në Këshillin e Evropës (Statute of the Council of Europe, 1949).

Në raport me Komisionin e Venecias edhe Maqedonia e Veriut sikurse Kosova dhe Shqipëria kishte qenë aktive në referimin e rasteve nga ana e Gjykatës Kushtetuese në cilësinë e amicus curie në Forumin e këtij komisioni, i cili pas shqyrtimit kishte dhënë opinione, disa nga këto raste janë (Venice Commission, 2002-2020):

1. Maqedonia e Veriut, opinion për “Ligjin për përdorimin e gjuhëve”;
2. Maqedonia e Veriut, opinion për “Projektligjin për Këshillin Gjyqësor”;
3. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, opinion për “Projektligjin lidhur me ndryshimin e ligjit për Gjykatat”;
4. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Mendim për “Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”;;
5. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Opinion për “Ligjin për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve”;
6. Ish-Republika Jugosllave të Maqedonisë-Opinion për “shtatë amendamentet e Kushtetutës për Këshillin Gjyqësor, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe zonat e veçanta financiare”;
7. Amicus Curiae-Përmbledhje mbi Ligjin për përcaktimin e një kriteri për kufizimin e ushtrimit të funksioneve publike, qasjen në dokumente dhe publikimin, bashkëpunimin me organet e sigurimit të shtetit ("Lustration Law") të "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë";

8. Përmbledhje e Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë" për "ndryshimet në disa ligje që lidhen me sistemin e pagave dhe shpërblimeve të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar".

Referimi i kërkesave për opinion në Komisionin e Venecias u shoqëruan edhe me vizita nga raportuesit e këtij komisioni në shtetin e Maqedonisë Veriore, të cilat do t'i përmendi në vijim.

Kërkesa e ministrit të drejtësisë të "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë" i cili i kishte kërkuar Komisionit të Venecias të japë një opinion mbi shtatë amendamente të Kushtetutës, veçanërisht në lidhje me "Këshillin Gjyqësor, kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe Zyrën e Auditimit Shtetëror", andaj delegacioni i raportuesve të Komisionit kishte vizituar Maqedoninë Veriore dhe ishte takuar me autoritetet e shtetit për të diskutuar ato ndryshime, përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e partive opozitare, shoqatave profesionale dhe shoqërisë civile (Venice Commission, 2014).

Autoritetet maqedonase në dhjetor 2015 kishin kërkuar opinionin e Komisionit të Venecias mbi "Ligjin për mbrojtjen e privatësisë" dhe "Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve", prandaj një grup raportuesish të Komisionit të Venecias kishin vizituar Shkupin për të takuar palët e interesuara vendore për të diskutuar me ta dy ligjet e mësipërme të miratuara në vitin 2015 (Venice Commission, 2016).

Një delegacion i raportuesve të Komisionit të Venecias kishte vizituar Maqedoninë Veriore edhe në kuadër të përgatitjes së një opinionit mbi "Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi", i cili ishte takuar me përfaqësuesit të autoriteteve shtetërore e shoqërisë civile. (Venice Commission, 2018).

Kërkesa tjetër ishte parashtruar nga kryeministri i "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", i cili kërkonte një opinion të Komisionit të Venecias mbi "Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve", prandaj për këtë arsye një delegacion i Komisionit të Venecias vizitoi Maqedoninë Veriore për të shkëmbyer mendime me autoritetet dhe përfaqësuesit e komunitetet shumicë (Venice Commission, 2019).

Nga rastet e elaboruara të cilat iu drejtuan Komisionit Evropian, nga Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, vërejmë se e përbashkëta e Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut është se rastet për opinion u referuan kryesisht nga pushteti ekzekutiv qoftë nga kryeministri apo ministritë e caktuara, ndërsa në Shqipëri kanë

dominuar rastet e referuara nga pushteti legjislativ, respektivisht kryetari i parlamentit shqiptar.

Raportuesit e caktuar nga Komisioni i Venecias gjatë vizitave në këto shtete për rastet e referuara kanë zhvilluar takime me përfaqësues nga organet shtetërore si nga pushteti legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor dhe shoqërinë civile, përmes të cilave kanë arritur të gjenerojnë të dhëna reale sa i përket çështjes e cila ishte objekt trajtimi në këtë komision dhe në këtë mënyrë në opinionin e tyre gjatë hartimit të pasqyrojnë realitetin që mbizotëronte në shtetin e caktuar.

Përmbledhje: Gjykata Kushtetuese e parë, si institucion i veçantë i rendit kushtetues daton që nga Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1963. Ndryshime kushtetuese më të rëndësishme sa i përket pozitës së Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë janë realizuar me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Rregulloren e punës të nxjerrë në vitin 1992, të cilat kanë sanksionuar pozitën, përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve, mandatin e gjyqtarëve, juridiksionin e saj, imunitetin e gjyqtarëve, vendimet, efektin juridik të tyre dhe procedurën kushtetuese.

Është elaboruar edhe struktura përbërëse e Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë Veriore e cila ka nëntë gjyqtarë dhe janë trajtuar edhe palët e autorizuar në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në aspekt krahasues me ato në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë ku në raport me Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Kosovës vërejmë se numri i palëve të autorizuar është shumë më i vogël dhe dallimi konsiston në të drejtën e Gjykatës kushtetuese që sipas detyrës zyrtare të iniciojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose aktit të përgjithshëm, ndërsa në raport me palët e autorizuar në Republikën e Shqipërisë po ashtu qëndron i njëjti dallim dhe njëherit vërejmë se te kjo e fundit ka shumë më tepër palë të autorizuar në raport me Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991 vendosi statusin e Gjykatës Kushtetuese si organ i Republikës me ndikim në sigurimin e vlerave themelore të rendit kushtetues, ndër to edhe parimin e shtetit të së drejtës dhe pjesëmarrjen në ndërtimin dhe forcimin e shtetit ligjor. Shtyllë qendrore të një shteti të së drejtës paraqet edhe garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, ku nga praktika kushtetuese në Maqedoninë Veriore dëshmohet numri shumë i vogël i lëndëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut para Gjykatës Kushtetuese. Mungesa e ankesës kushtetuese si dhe kufizimi i

mbrojtjes vetëm të disa të drejtave dhe lirive të njeriut, janë ndër shkaktarët kryesorë për numrin kaq të vogël të kërkesave të dorëzuara.

Ndonëse Kushtetuta e proklamon si vlerë kushtetuese shtetin e së drejtës, megjithatë dëshmohet se ky organ nuk ka kontribuar mjaftueshëm në krijimin e forcimin e shtetit të së drejtën në Maqedoninë e Veriut, pra baza juridike ekziston jo e plotë për garantimin e shtetit të së drejtës dhe mungon pavarësia e profesionalizimi i Gjykatës Kushtetuese për ta implemtuar këtë vlerë kushtetuese, andaj përbën nevojë imediate një reformë kushtetuese e tërësishme në raport me Gjykatën Kushtetuese.

GJEDNJ ka dhënë kontribut në forcimin e shtetit të së drejtës përmes mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Maqedoninë Veriore, ndonëse duhet potencuar edhe faktin se Gjykata Kushtetuese në këtë shtet ka filluar t'i referohet praktikës së Strasburgut dhjetë (10) vite pas anëtarësimit të Maqedonisë Veriore në Këshillin e Evropës.

Në raport me Forumin e Komisionit të Venecias edhe Maqedonia e Veriut sikurse Kosova dhe Shqipëria kishte qenë aktive në referimin e kërkesave nga pushteti ekzekutiv, i cili pas shqyrtimit kishte dhënë opinionet e tij.

KAPITULLI VI

STUDIMI EMPIRIK

1. Instrumentet e hulumtimit

Gjatë realizimit të këtij studimi janë shfrytëzuar disa metoda e teknika hulumtuese që ndërlidhen me qëllimet e punimit por ka dominuar metoda empirike e kërkimit sasior dhe cilësor.

Metoda sasiore është realizuar përmes anketës, ku anketimi si teknikë është përdorur me qëllim që të sigurohen të dhëna primare, të cilat e plotësojnë punimin e diplomës së doktoratës edhe me opinionin e qytetarëve për shtetin e së drejtës në Republikën e Kosovës, elementet e shtetit të së drejtës dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, duke pasqyruar kështu realitetin ekzistues të zhvillimit të tij.

Për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, realizimi i anketës është bërë përmes programeve të internetit që ofrojnë mundësi të tilla, prandaj në bashkëpunim me mentorin kemi diskutuar dhe përpiluar anketën e cila pastaj i është shpërndarë qytetarëve në Republikën e Kosovës për plotësim.

Anketa për pjesëmarrësit ka ofruar konfidencialitet dhe anonimitet të plotë, duke siguruar se informatat dhe opinionet e pjesëmarrësve, janë objekt i përdorimit vetëm për qëllime të studimit.

Kampioni në këtë studim përbëhet vetëm nga qytetarët e Republikës së Kosovës, pra kampioni ka qenë i rastit pasi kryesisht anketimit është realizuar me studentë, profesorë të universiteteve publike e kolegjeve private në Kosovë, e individë të profesioneve të tjera. Delimitime ka pasur vetëm në drejtim të moshës dhe vendbanimit, te kjo e fundit potencoj se realizimi i anketimit ka qenë i kufizuar vetëm në shtetin e Kosovës.

Prandaj, është formuluar pyetësori, që në përmbajtje kishte 21 pyetje. Pyetësori ishte i ndarë në dy pjesë, në pjesën e parë gjenerohen informacione të përgjithshme rreth pjesëmarrësve në hulumtim, ndërsa në pjesën e dytë gjenerohen të dhëna sa i përket njohurive, vlerësimeve si dhe qëndrimeve të qytetarëve në shtetin e Kosovës sa i përket

elementeve të shtetit të së drejtës, përfshirë këtu garantimin e supremacisë së kushtetutës, ndarjen dhe kufizimin e pushteteve shtetërore, dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Duke pasur parasysh që rolin e mbrojtësit të elementeve të shtetit të së drejtës e ka Gjykata Kushtetuese në përgjithësi. Andaj, në veçanti në rastin e anketimit në Republikën e Kosovës, qytetarët kanë shprehur mendimet e tyre edhe rreth këtij institucioni dhe kontributit të tij. I tërë materiali i përdorur në procesin e anketimit ka qenë në gjuhë shqipe. Pjesëmarrja në plotësimin e pyetësorit ka qenë vullnetare.


Sa i përket metodës cilësore, kam përzgjedhur mostrën e qëllimshme sepse tema kufizohet vetëm në institucionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, prandaj kam përzgjedhur aktet institucionale me rëndësi, përfshirë këtu këshilltarë kryesor ndërkombëtar që kanë qenë pjesëmarrës në procesin e hartimit të Kushtetutës dhe themelimin e Gjykatës Kushtetuese, ish-kryetaren e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës, hartues të “Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, e të “Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës”, profesorë të kësaj fushe si dhe njëherit përfaqësues të shtetit të Kosovës në Komisionin e Venecias me të cilët kam zhvilluar intervista gjysmë të strukturuar në gjuhën shqipe e angleze. Për shkak të kufizimeve si rrjedhojë e pandemisë, intervistat janë zhvilluar online, kryesisht përmes e-mailit, kurse disa përmes audio incizimeve, në gjuhën shqipe dhe angleze. Informatat e gjeneruara nga këto intervista janë inkorporuar në studim.

2. Rezultatet dhe analiza e të dhënave nga anketa me qytetarët e Republikës së Kosovës

2.1. Analiza e të dhënave demografike nga anketimi i qytetarëve në Republikën e Kosovës


Pjesa e parë e anketës përmban të dhënat demografike për gjininë, moshën, shkollimin, vendbanimin dhe përkatësinë etnike.

Grafikoni 2. Gjinia e qytetarëve të anketuar




Në këtë grafikon është paraqitur gjinia e qytetarëve që i janë përgjigjur anketës, ku nga rezultati vërehet se dominon gjinia femërore me 76.4%, e pasuar nga ajo mashkullore me 23.6%.

Grafikoni 3. Grupmoshat e qytetarëve të anketuar




Grafikoni paraqet moshën e qytetarëve, ku janë klasifikuar në pesë (5) kategori të grupmoshave, nga të cilat konstatojmë se ka dominuar grupmosha 18-25 vjeç me 83%, pastaj grupmosha 26-30 vjeç me 7.7%, grupmosha 31-40 vjeç me 7.4%, grupmosha 41-50 vjeç me 1.4% dhe grupmosha mbi 50 vjeç me 0.6%.

Grafikoni 4. Shkollimi i qytetarëve të anketuar




Përmes këtij grafikoni është paraqitur niveli i shkollimit të qytetarëve, ku vërehet se 85.50% e tyre janë me shkollim universitar në nivelin Bachelor.

Grafikoni 5. Vendbanimi i qytetarëve të anketuar




Sa i përket vendbanimit, konstatoj se më tepër se gjysma e qytetarëve, respektivisht 62,8% janë nga Prizreni, pasuar nga Gjakova me 7.4%, Peja me 4.8%, dhe pjesëmarrës edhe nga qytetet e tjera e që rezultojnë se anketimi ka qenë gjithëpërfshirës në shumicën e qyteteve të Kosovës.

Grafikoni 6. Përkatësia etnike e qytetarëve të anketuar




Nga pjesëmarrësit në këtë anketë, mbizotërojnë ata me përkatësi etnike shqiptare, pastaj komuniteti boshnjak dhe komunitetet e tjera përfshirë këtu romë, ashkali, egjiptian, ndërsa pjesëmarrës nga komuniteti turk nuk kemi.

Grafikoni 7. Profesionet e qytetarëve të anketuar



Sa i përket profesionit, nga përgjigjet e gjeneruara dominojnë juristët me 51.4%, pastaj ekonomistë me 5.1%, gazetarët me 0.9% dhe 42.6% i përkasin profesioneve të tjera.

Grafikoni 8. Përgjigjet e qytetarëve në pyetjen se a janë të punësuar




Pjesëmarrësit në këtë anketë janë rreth 60.5% studentë, kurse pjesa tjetër janë profesionistë në marrëdhënie pune 21.9% dhe 17.6% janë të papunë. Kjo ka relevancë edhe

me pyetjet e mësipërme si mosha dhe edukimi i të anketuarëve, pasi dominonin kryesisht grupmosha 18-25 vjeç dhe ata me shkollim në nivelin Bachelor.

2.2. Gjetjet dhe analiza e të dhënave nga anketa e realizuar me qytetarët e Republikës së Kosovës

Pyetjet e anketës në vijim i referohen elementeve të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës dhe rolit të Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës.

Grafikoni 9. Përgjigjet e qytetarëve rreth procesit të miratimit të ligjeve në Kosovë



Rol me rëndësi në zbatimin e shtetit të së drejtës si dhe funksionimin e duhur të demokracisë ka edhe legjislacioni. Qytetarët kontribuojnë në procesin e miratimit të ligjeve qoftë përmes demokracisë së drejtpërdrejtë apo asaj indirekte. Prandaj edhe duhet të kenë njohuri solide për legjislacionin. Në përgjithësi, procedurën e hartimit, shqyrtimit, miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit e shoqëron parimi i publicitetit dhe në këtë drejtim rreth ushtrimit të funksionit legjislativ të Kuvendit në shtetin e Kosovës, 52.6% e respondentëve vlerësojnë se procedurat për miratimin e ligjeve janë transparente dhe demokratike, kurse 17,8 % mendojnë të kundërtën.


Por, “Raportet e Progresit” për Kosovën të Komisionit Evropian nuk e japin të njëjtin vlerësim sa i përket ushtrimit të funksionit legjislativ nga Kuvendi. Respektivisht, Raporti i Progresit që përfshinte periudhën kohore nga marsi 2018 - mars 2019, ndër gjetjet e tjera ishte edhe ajo se “Nga 91 ligjet e miratuara gjatë periudhës raportuese, vetëm dy janë miratuar me procedurë të shpejtë. Megjithatë, në përgjithësi ende ekziston mungesa e debatit përmbajtësor ose konsultimit me akterët relevant mbi projektligjet” (Raporti për Kosovën, 2019).

Gjendjen më kritike e pasqyronte Raporti i Progresit që mbulonte periudhën kohore nga tetori 2016 - shkurt 2018, ndër gjetjet e ishte se “Procedura e përshpejtuar është përdorur shpesh (22 nga 115 ligje janë miratuar me këtë procedurë) (Raporti për Kosovën, 2018, f. 8). Kjo ka sjellë legjislacion që është miratuar pa ndonjë debat substancial apo konsultim të palëve me interes, duke përfshirë edhe ligjet me rëndësi jetike, si ai i buxhetit prandaj rekomandonte që “[...] transparenca e cilësia e ligjvënies duhen përmirësuar [...]” (Raporti për Kosovën, 2018, fv. 7-8).

Edhe Raporti i Progresit për periudhën kohore tetor 2014 - shtator 2015, vlerësonte se: “janë miratuar disa ligje të rëndësishme, përfshirë ligjet për gjyqësorin dhe për të drejtat e njeriut me procedurë të shpejtë. Kjo ka kufizuar mundësinë për debat parlamentar, që është një çështje shqetësuese” (Raporti për Kosovën, 2015, f. 7). Andaj, bazuar në gjetjet e Komisionit Evropian dhe rekomandimet e tij, Kosova në të ardhmen duhet të ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar ushtrimin e funksionit legjislativ në mënyrë transparent dhe demokratik.

Më tej, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në rastin “nr. KO 219/19” ka sqaruar se sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës udhëhiqet nga parimi i sundimit të ligjit pjesë e të cilit është edhe parimi i sigurisë juridike dhe ai i parashikueshmërisë si pjesë përbërëse e parimit të sundimit të ligjit, andaj “autoritetet publike, gjatë hartimit të ligjeve duhet të marrin parasysh këto parime bazë” dhe të synojnë të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme, që nënkupton se “norma ligjore duhet të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme” (Avokati i Popullit, 2020). Prandaj, meqenëse qytetarët janë pjesë e pushtetit legjislativ përmes përfaqësuesve të zgjedhur të cilët i përfaqësojnë ata, patjetër duhet të jenë të informuar edhe me përmbajtjen e ligjeve.

Grafikoni 9. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me përmbajtjen dhe qartësinë e ligjeve në fuqi




Gjendja faktike sa i përket kuptueshmërisë së ligjeve në fuqi në Kosovë, tregon se kemi një dallim të vogël rreth atyre që kanë deklaruar se ligjet janë të kuptueshme e që janë 53.1% dhe atyre që kanë deklaruar se ligjet kanë relativisht paqartësi që janë 44%. Kjo përqindje e lartë e perceptimit se ligjet kanë relativisht paqartësi vërtetohet edhe nga elaborimi i mësipërm nga gjetjet e Raporteve të Progresit për Kosovën lidhur me procedurën e miratimit të ligjeve, si rrjedhojë edhe lindin konsekuenca në drejtim të lëshimeve e paqartësive sa i përket përmbajtjes së ligjeve.

Parlamentet mbajnë përgjegjësi të veçantë dhe duhet të sigurojnë që ligjet të bëhen publike, të jenë të qarta dhe të qëndrueshme (The RWI of HRHL, 2012, p. 12). Qartësia nuk është vetëm çështje e formulimit të saktë, ajo gjithashtu kërkon konsistencë midis ligjeve të reja dhe dispozitave ekzistuese. Dispozitat e reja, sado të hartuara qartë, mund të rezultojnë konfuze kur interpretohen në lidhje me ligjet ekzistuese dhe me dispozitat ligjore që përmbajnë të njëjtat fjalë, por i përkufizojnë ato ndryshe. Për më tepër, qartësia mund të minohet edhe nga rregullimi i tepërt i sferave të caktuara me një mori ligjesh, pasi kjo i ngatërron lehtësisht qytetarët dhe zyrtarët shtetëror.


Prandaj, ligjet e qarta kërkojnë teknika dhe aftësi legislative adekuate nga hartuesit e tyre. Në një sistem ligjor i cili aspirojnë të respektojë sundimin e ligjit, është me rëndësi që personat e tillë të kenë trajnim adekuat dhe aftësi të mjaftueshme për të kryer punën e tyre, për më tepër, shkëmbimet e përvojave me parlamentarë dhe zyrtarë nga vende të tjera shpesh kanë rezultuar shumë të dobishme në përmirësimin e aftësive dhe teknikave legislative (The RWI of HRHL, 2012, p. 12). Madje, disa parlamente në vende të caktuara kanë institute trajnimi për hartimin e legjislacionit që ofrojnë trajnime në teknikat e hartimit të legjislacionit për hartuesit e tyre, një model i tillë do të ishte i rekomandueshëm edhe në rastin e Kosovës.

Grafikoni 10. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me implementimin e ligjeve në shtetin e Kosovës



Në drejtim të zbatimit të ligjeve në Republikën e Kosovës, rreth 79,5% e qytetarëve janë shprehur se ligjet nuk zbatohen mjaftueshëm, ndërsa 15.1% janë shprehur se ato zbatohen dhe rreth 5.4% mendojnë se nuk zbatohen.


Grafikoni 11. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor



“Parimi i shtetit të së drejtës është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor” (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 175). Sipas parimit të ndarjes së pushteteve shtetërore, pushteti gjyqësor është i pavarur nga dy pushtetet e tjera, por qytetarët në shtetin tonë mendojnë se ai kontrollohet nga pushtetet e tjera qoftë ai legjislativ apo edhe ekzekutiv, konkretisht 41.8% vlerësojnë se nuk është i pavarur dhe se kontrollohet nga pushteti ekzekutiv, kurse 34.4% e qytetarëve vlerësojnë se sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës është i pavarur.

Theksoj se kur besimi i qytetarëve në gjyqësorin fillon të zbehet, as gjyqësori si institucion dhe as gjyqtarët individual nuk do të jenë në gjendje ta kryejnë plotësisht këtë detyrë të rëndësishme, ose të paktën nuk do të shihet e lehtë për ta bërë këtë, dhe si rrjedhojë do të mungojë edhe garantimi i shtetit të së drejtës, pasi gjyqësori do të ketë mundësi që të ndikohet nga presionet politike që ekzistojnë në ndonjë moment të caktuar. Pra, pavarësia e gjyqësorit është e një rëndësie thelbësore për garantimin e shtetit të së drejtës.

Grafikoni 12. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë




Vetëm një gjyqësor i pavarur mund të jap drejtësi të paanshme në bazë të ligjit, duke mbrojtur kështu të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Kjo detyrë thelbësore të përmbushet me efikasitet, publiku duhet të ketë besim të plotë në aftësinë e gjyqësorit për të kryer funksionet e tij në këtë mënyrë të pavarur dhe të paanshëm (Bara, B., & Bara, J., 2017, p. 46).

Megjithatë, rreth 72.2% e qytetarëve kanë theksuar se publikimi i aktakuzave dhe i vendimeve nga gjykatat e ngrit besimin në sistemin e drejtësisë. Prandaj në këtë drejtim njëkohësisht është përcaktuar edhe publikimi i aktgjykimeve të gjykatave (Projekt-Kodi nr.06/L-151 i Procedurës Penale, 2019).³⁵ Publikimi i këtyre aktgjykimeve, do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e Gjykatave e kjo do të reflektojë edhe në ngritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Sfidë për demokracitë në zhvillim është të ndërtojnë besimin e publikut në gjyqësorin, sepse një gjyqësor i pavarur është një ndër faktorët më të rëndësishëm për ruajtjen e shtetit të së drejtës në një shoqëri të lirë dhe demokratike.

³⁵ Neni 373


Grafikoni 13. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive në Republikën e Kosovës



Rëndësi të veçantë paraqesin elementet e shtetit të së drejtës në kuptimin formal, mes të cilave: “detyrimi që ligjet e miratuara të jenë në përputhje me kushtetutën, parimi i ndarjes së pushteteve, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore, siguria juridike e të tjerë” (Zagonjari, XH. et al., 2011, f. 18). Pra, një nga elementet e shtetit të së drejtës është edhe garantimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, e në këtë drejtim qytetarët mendojnë se nuk iu garantohen mjaftueshëm të drejtat dhe liritë, ndonëse në aspektin kushtetues dhe ligjor situata nuk është e tillë, pasi përveç kapitullit dy dhe tre të kushtetutës që i garantojnë të drejtat dhe liritë, njëherit janë edhe nëntë marrëveshje apo instrumente ndërkombëtare që gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë në vendin tonë e të cilat i garantojnë të drejtat dhe liritë.

Pra, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të konsiderohet si element apo gurthemel vendimtar i aspektit përmbajtësor të shtetit të së drejtës dhe i konstitucionalizmit në tërësi.


Grafikoni 14. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me mundësinë e tyre të referimit në Gjykatën Kushtetuese dhe ndikimi i këtij referimi në punën e organeve të tjera shtetërore



Një ndër përparësitë e sistemit të ankesës kushtetuese në Kosovë është edhe mundësia e individëve që të parashtrojnë ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese, zgjidhje kjo që është bazuar në sistemin gjerman të gjyqësisë kushtetuese dhe tashmë është treguar shumë i suksesshëm dhe se kur flitet për efikasitet duhet pasur parasysh edhe parametrat e krahasimit dhe nëse shikohet përqindja e numrit të ankesave individuale, këto përbëjnë mbi 95% të ankesave kushtetuese dhe kjo tregon për vetëdijesimin lidhur me këtë mekanizëm. Natyrisht, kjo ankesë është jashtë piramidës së sistemit të rregullt gjyqësor dhe duhet të kalojë mjaft kohë për individët që të mund të sjellin ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, por kjo është edhe esenca e krijimit të këtij mekanizmi, që të vjen në shprehje në fund të procedurave pas sherrimit të mjeteve juridike (Rama, 2021).

Rreth 58.2% e qytetarëve kanë deklaruar se mundësia e referimit në Gjykatën Kushtetuese të cilën ia njih Kushtetuta në rastin e shkeljes së të drejtave të garantuara pas shterjes së mjeteve juridike ndikon në cilësinë e punës profesionale dhe përgjegjësisë më të madhe të gjyqtarëve dhe personave zyrtarë në administratën shtetërore, kjo pasi e kanë parasysh se vendimi i tyre në rastin e shkeljes së të drejtave dhe lirive përfundimisht mund të atakohet në Gjykatën Kushtetuese, prandaj kjo mundësi e individëve që të parashtrojnë ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese dëshmohe se përbën një nga përparësitë e sistemit tonë kushtetues.


Grafikoni 15. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me procedurën e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues



Në drejtim të zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, qytetarët kanë deklaruar se pjesëmarrja e Kuvendit si organ politik dhe e presidentit ndikon në politizimin e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë përfshirja e Parlamentit gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues është karakteristikë tipike për demokracitë parlamentare.

Në këtë drejtim edhe profesori Visar Morina në vitin (2013) potenconte se “...procesi i emërimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (pas përbërjes së parë) kohëve të fundit është përcjellë me sfida të konsiderueshme pasi Kuvendi i Kosovës si organ propozues disa herë ka dështuar në përmbushjen e detyrimit kushtetues për të siguruar plotësimin e vendit vakant për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka asnjë dilemë se dështimi për të plotësuar vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese vë në rrezik serioz pavarësinë dhe funksionalitetin e kësaj Gjykate” (f. 93).


Grafikoni 16. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me karakteristikat e procedurës së zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues në Republikën e Kosovës



Më tej, politizimi vërehet edhe nga institucioni i presidentit i cili për shkak të formulës së zgjedhjes në Parlament, nuk ofron garanci të mjaftueshme në drejtim të respektimit të pavarësisë, të paanshmërisë dhe të cilësisë në përbërje të Gjykatës

Kushtetuese. Nga analiza e dispozitave dhe praktikës lidhur me emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ka rezultuar si joefikas procesi i zgjedhjes/emërimit të kandidatëve për gjyqtarë kushtetues. Përveç vlerësimit të vendimeve gjyqësore, mbështetja e qytetarëve për gjykatat është rritur si rrjedhojë e perceptimit se gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre janë apolitikë dhe të paanshëm (Shapiro, 1981).


Grafikoni 17. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës



Sa i përket interpretimit kushtetues, 47% e qytetarëve kanë deklaruar se Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e mjaftueshëm të Kushtetutës, që nënkupton se ajo në vazhdimësi ka qenë aktive në ushtrimin e juridiksionit të saj. Nëse analizohen edhe raportet vjetore të Gjykatës Kushtetuese vërejmë suksesin që ka treguar me zgjidhjen e numrit të lartë të kërkesave të pranuar në baza vjetore, sa për elaborim gjatë vitit 2018 kishte pranuar gjithsej 299 kërkesa ku prej tyre kishte zgjidhur 133 kërkesa (Raport Vjetor 2018, 2019), ndërsa në vitin 2019 nga gjithsej 241 kërkesa sa kishte pranuar, kishte vendosur për 134 (Raport Vjetor 2019, 2020).


Për më tepër, jurisprudenca kushtetuese ka kontribuar në zbutjen e përplasjeve apo ngërçeve institucionale, në respekt të parimit të ndarjes së pushteteve si në nivel horizontal ashtu dhe vertikal.

Grafikoni 18. Përgjigjet e qytetarëve rreth ndikimit të grupeve parlamentare në vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës




Qytetarët me përgjigjet e tyre, rreth 37.2% kanë përshtypje se grupet parlamentare ndikojnë në marrjen e vendimeve në Gjykatën Kushtetuese. Ky rezultat ekziston si i tillë për shkak të mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues e cila shkakton dyshime në lidhje me paanshmërinë e pavarësinë e tyre, të cilët, gjatë kontrollit kushtetues të akteve normative të miratuara nga Parlamenti, mund të shfaqin një aktivizim politik në shenjë besnikërie ndaj shumicës që i ka zgjedhur.

Grafikoni 19. Përgjigjet e qytetarëve lidhur me publikimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese me një numër të kufizuar argumentesh




Rreth 67.6% e qytetarëve vlerësojnë se publikimi i menjëhershëm i dispozitivit të vendimit me një numër të kufizuar argumentesh nga Gjykata Kushtetuese në çështjet që kanë ndjeshmëri publike ndikon në rritjen e besueshmërisë së publikut në punën e këtij institucioni dhe eliminon mundësitë për keqinformim apo edhe abuzim nga mediat në lidhje me kuptimin e arsytimit të çështjes.

Grafikoni 20. Përgjigjet e qytetarëve sa i përket referimit të rastit në Gjykatën Kushtetuese lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive



Rreth procedurës së referimit në Gjykatën Kushtetuese në rastin kur do t'i shkelje një e drejtë e garantuar kushtetuese 58.5% kanë deklaruar se fillimisht në bazë të hierarkisë institucionale do t'i shtjerin mjetet juridike efektive para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, kjo nënkupton se qytetarët kanë informacione sa i përket referimit të rasteve në Gjykatën Kushtetuese dhe në këtë mënyrë ata do të evitojnë mundësinë që kërkesa e tyre të shpallet e papranueshme.

Grafikoni 21. Përgjigjet e qytetarëve sa i përket rolit të Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës



Gjykata Kushtetuese luan një rol të rëndësishëm në shumë vende, përfshirë Kosovën (Allelo, 2021). Pra, rezulton se Gjykata Kushtetuese në Republikën e Kosovës përbën faktorë të rëndësishëm në vendosjen dhe funksionimin e demokracisë sepse siguron respektimin e frymës dhe përmbajtjes së Kushtetutës përmes garantimit të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Si rrjedhojë, sundimi i së drejtës është pjesë edhe e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në rastin e Kosovës. Ajo në disa vendime ka

nënvizuar rëndësinë e “respektimit të sundimit të së drejtës në funksion të mbrojtjes së sigurisë juridike dhe lirive e të drejtave individuale”, njëherit edhe në rastet e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve Gjykata Kushtetuese e ka tërhequr vëmendjen për domosdoshmërinë e respektimit të këtij parimi nga legjislativi në procedurat e miratimit të ligjeve (Morina, 2013).

Sa i përket kontributit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në forcimin e shtetit të së drejtës, rreth 47.4% e qytetarëve kanë deklaruar se ajo gjatë kësaj dekade me veprimtarinë e saj relativisht e ka forcuar shtetin e së drejtës. Në këtë drejtim puna e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Kosovës vlerësohet se (Morina, 2021) “... është e kënaqshme, por sigurisht që Gjykata Kushtetuese ka mundësi të kontribuojë shumë më tepër në drejtim të avancimit të kushtetutës në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe nuk mund të konsiderohet që betejën e ka fituar me veprimtarinë e saj deri më tani. Kjo gjykatë duhet të jetë më aktive se që ka qenë deri më tani në mbrojtjen efektive të lirive dhe të drejtave dhe disiplinimin e autoriteteve të tjera kushtetuese në mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive”.

Njëherit “Gjykata Kushtetuese është dëshmuar si mbrojtëse e primeve dhe vlerave kushtetuese, duke nxjerrë vendime që kanë definuar shtetin, demokracinë dhe sundimin e ligjit në vend. Vendimet që ka nxjerrë Gjykata Kushtetuese, duke filluar nga definimi i kompetencave të bartësve të degëve të pushtetit, konfirmimi i pavarësisë së institucioneve të pavarura në raport me degët e tjera të pushtetit, anulimi i shumë dispozitave jokushtetuese në ligjet e ndryshme dhe shpallja e ligjeve në tërësi si kundërkushtetuese, kanë qenë kyçe në ruajtjen e frymës dhe vlerave të Kushtetutës sonë” (Rama, 2021).

Dhe si përfundim “Gjykata Kushtetuese përbën mekanizmin më efektiv për forcimin e shtetit të së drejtës”, vetëm nëse e ushtron kompetencat e saj në mënyrë të përgjegjshme dhe të pavarur ku përmes interpretimit konsekuent, serioz, e të qartë arrin të transmetojë te publiku bazën parimore të vendimeve dhe njëherit publiku e kupton se Gjykata Kushtetuese është interpretuesi përfundimtar i dokumentit më të rëndësishëm të kombit, të gjitha këto ndikojnë që Gjykata Kushtetuese të fitojë stabilitet dhe qëndrueshmëri institucionale (Tunheim, 2021).

PËRFUNDIME

Në këtë punim të disertacionit të doktoratës THELBI I ANALIZËS është FOKUSUAR Në rolin dhe fuqinë e Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës NË VËSHTRIM KRAHASUES ME ATË TË Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Punimi është përqendruar në shqyrtimin e doktrinë e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe relacionin e saj me tre pushtetet shtetërore dhe tendencën për ruajtjen e ekuilibrit të këtyre organeve shtetërore me motivacion për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë dhe njëkohësisht forcimin e shtetit të së drejtës. Potencoj se kushtetuta si akt juridik dhe politik, e vetme nuk mund të sigurojë qeverisje demokratike pa e ndihmuar edhe organet e zbatueshmërisë së saj, dhe në këtë mënyrë vjen në përballje Gjykata Kushtetuese si organ i koncentruar për interpretimin dhe ndarjen e drejtësisë kushtetuese. Një kombinim i tillë ndihmon në formulimin dhe strukturimin e shtetit të së drejtës dhe demokratik. Tranzicioni i njësive politike dhe territoriale në ish-Jugosllavi dhe ngritja e statusit të Kosovës në nivelin e shtetit me njohje ndërkombëtare apriori ka kërkuar edhe një tranzicion radikal të Gjykatës Kushtetuese duke ndryshuar mënyrën e funksionimit si në aspektin cilësor dhe numerik të gjyqtarëve.

Natyrisht, përveç të tjerave, Gjykata Kushtetuese konsiderohet edhe si mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të njeriut, që sot përbën funksionin themelor të drejtësisë kushtetuese. Historia jonë e jurisprudencës kushtetuese demonstroi se qytetaria e angazhuar është esenciale për shëndetin e rendit juridik-kushtetues. Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës, edhe pse e re në moshë, gjatë këtyre viteve ka lënë gjurmë të pashlyeshme në disiplinimin e organeve shtetërore dhe titullarëve e bartësve të tyre sidomos me dy ish-presidentët e Republikës së Kosovës. Konkretisht, në bazë të këtij studimi të realizuar, kam arritura në këto përfundime:

- Drejtësia kushtetuese është kategori jashtëzakonisht e rëndësishme në çdo sistem juridik e demokratik, për realizimin e standardeve evropiane, ku supremacia e kushtetutës, aplikimi i hierarkisë së akteve juridike të brendshme dhe ndërkombëtare, përbëjnë parakusht kyç për zbatimin e drejtësisë kushtetuese në shtetin e së drejtës. Supremacinë e kushtetutës e garantojnë Gjykatat Kushtetuese, të cilat sigurojnë funksionimin e mekanizmit kushtetues të ndarjes së pushteteve shtetërore në shtetin e së drejtës;

- Karakteristikat dhe parimet e përgjithshme të gjyqësisë kushtetuese janë unike, në vendet që kanë gjykatë të specializuar, gjykatë kushtetuese si institucion i veçantë dhe i rregulluar me kushtetutën e vendit dhe ligj specifik;
- Shteti i së drejtës në kuptim formal përfshin veçoritë e hartimit dhe administrimit të legjislacionit të qartë, publik e të qëndrueshëm që duhet të vlejë për të ardhmen, ndërsa në kuptimin përmbajtësor përfshin respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, këto njëherit përbëjnë edhe kërkesa që një shtet duhet t'i plotësojë *de facto* dhe *de jure*, në mënyrë që të konsiderohet shtet i së drejtës;
- Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore e kanë garantuar shtetin e së drejtës në aktin më të lartë juridik dhe politik të tyre;
- Gjykatat Kushtetuese në përgjithësi kanë rol dominant në konsolidimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës, e ndërlidhur këtu edhe me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila ka ndikim shumëdimensional në krijimin e praktikave gjyqësore, në veçanti në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, që ndikon në forcimin e shtetit të së drejtës në kuptimin përmbajtësor;
- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut forcon rendin kushtetues duke i "korrigjuar" dhe "kontrolluar" gjykatat kushtetuese të shteteve evropiane të cilat janë pjesë e saj, përmes vendimeve që jep për çështjet konkrete që i referohen;
- Në rastin e Kosovës, gjatë evoluimit historik si njësi federale e ish-RSFJ-së që nga viti 1969 e deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 në vazhdimësi të zhvillimit kushtetues kishte Gjykatë Kushtetuese si organ të pavarur jashtë sistemit të drejtësisë por edhe degë gjyqësore kushtetuese në kuadër të pushtetit gjyqësor;
- Në vitin 2009 Gjykatë Kushtetuese e Kosovës është themeluar me përcaktimin definitiv të statusit politik të Kosovës më 17 Shkurt 2008, kur Kosova u shpall shtet i pavarur nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, por ishte përcaktuar zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetues, autoritet përfundimtar e i veçantë kushtetues që i targetohet mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë;
- Kompetencat kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përcaktohen në pesë kategori kryesore dhe atë: kompetenca interpretuese; kompetenca për vlerësimin e kushtetutshmërisë së normave juridike; kompetencat në lidhje me vlerësimin e

konfliktit të kompetencave ndërmjet autoriteteve publike; zgjedhjet e organeve shtetërore dhe të drejtat dhe liritë e njeriut;

- Kushtetuta dhe Ligji nuk përcaktojnë kriteret të qarta, objektive e të matshme në aspektin profesional të kandidatëve për gjyqtarë kushtetues, andaj këto kriteret aktualisht në Republikën e Kosovës nuk përfshijnë një numër të gjerë të juristëve që mund të zgjidhen në këtë funksion;
- Zgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nuk ofron garanci të mjaftueshme në drejtim të respektimit të parimit të pavarësisë, të paanshmërisë dhe të cilësisë në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese;
- Sfidë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës mbetet plotësimi i vendeve të lira për gjyqtarë kushtetues brenda afatit ligjor, çfarë prodhon pasoja direkte në paaftësinë e funksionimit të saj, pasi vendimmarrja realizohet përmes kuorumit;
- Grupet parlamentare kanë mundësi të ndikojnë në vendimmarrje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, andaj kjo krijon dyshime në lidhje me paanshmërinë e pavarësinë e gjyqtarëve, të cilët gjatë kontrollit kushtetues të akteve normative të miratuara nga Parlamenti, mund të shfaqin një aktivizim politik në shenjë besnikërie ndaj shumicës që i ka zgjedhur;
- Në pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese drejtpërdrejt ndikojnë mandati i kufizuar dhe pamundësia e rizgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës në dispozitat e saj, garanton elementet që e përbëjnë shtetin e së drejtës që janë: zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta - mënyra e konstituimit të pushtetit shtetëror, baza dhe burimi i legjitimitetit të tij, garantimi dhe mbrojtja kushtetuese e të drejtave dhe lirive themelore, ndarja e pushteteve shtetërore, pavarësia e gjyqësorit - siguria juridike dhe mbrojtja e të drejtave si dhe nënshtrimi i pushtetit shtetëror ndaj kushtetutës dhe ligjit;
- Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, janë shqyrtuar raste që përfshijnë secilën nga elementet e mësipërme të shtetit të së drejtës por që kanë dominuar çështjet lidhur me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me objekt të kërkesave kryesisht vendimet e Gjykatave Themelore, të Apelit dhe Supreme dhe kanë dominuar pretendimet për shkelje të sundimit të ligjit, sigurisë juridike, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mohimi i mbrojtjes

gjyqësore, e drejta për mjete juridike, barazia para ligjit, dhe të drejtës së pronës, të gjitha këto vendime kanë pasur rol fundamental për shtetin demokratik me pushtete shtetërore të ndara, respektivisht në forcimin e parimit të shtetit të së drejtës në Kosovë;

- Në forcimin dhe respektimin e parimit të shteti të së drejtës në Kosovë, Gjykata Kushtetuese ka luajtur rol të rëndësishëm, e cila përmes jurisprudencës së saj kushtetuese ka arritur të identifikojë, përpunojë dhe mbrojë vlerat dhe parimet kushtetuese përfshirë këtu shtetin e së drejtës, kushtetutshmërinë, ndarjen e pushteteve shtetërore, kontrollin dhe balancimin e pushteteve shtetërore, pavarësinë e gjyqësorit, sigurinë juridike, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe shpalljen kundërkushtetuese të amendamenteve, normave juridike në ligje por edhe të ligjeve në tërësi gjatë kontrollit kushtetues të akteve juridike, duke nënvizuar rëndësinë e respektimit të këtij parimi edhe gjatë procedurës së nxjerrjes së ligjeve;
- Gjykata Kushtetuese në Kosovë ka kontribuar edhe në zbutjen e përplasjeve apo ngërçeve institucionale, duke e transformuar drejtësinë politike në drejtësi kushtetuese, në respekt të parimit të ndarjes së pushteteve shtetërore si në nivel horizontal ashtu edhe në atë vertikal;
- Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e mjaftueshëm të Kushtetutës, që nënkupton se ajo në vazhdimësi ka qenë aktive në ushtrimin e juridiksionit të saj. Nëse analizohen edhe raportet vjetore të Gjykatës Kushtetuese, vërejmë suksesin që ka treguar ku dominojnë vendimet për zgjidhjen e kërkesave në raport me numrin e kërkesave të pranura për shqyrtim në baza vjetore;
- Elementi tjetër i shtetit të së drejtës është mbrojtja e të drejtave dhe lirive kushtetuese, në rastin e Kosovës referimi në Gjykatën Kushtetuese të cilën e njeh Kushtetuta kur kemi shkelje të të drejtave të garantuara pas shterjes së mjeteve juridike ndikon në cilësinë e punës profesionale dhe përgjegjësisë më të madhe të gjyqtarëve dhe personave zyrtarë në administratën shtetërore, kjo pasi e kanë parasysh se vendimi i tyre në rastin e shkeljes së të drejtave dhe lirive përfundimisht mund të ataktohet në Gjykatën Kushtetuese;
- Rreth referimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin kur do t'i shkelej një e drejtë ose liri e garantuar qytetarëve ka rezultuar se kanë njohuri sa i

përket referimit të rasteve në Gjykatën Kushtetuese, pasi fillimisht në bazë të hierarkisë institucionale do t'i shternin mjetet juridike efektive para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese;

- Ushtrimi i funksionit legjislativ i Kuvendit të Republikës së Kosovës, procedurat për miratimin e ligjeve janë transparente dhe demokratike, por ligjet nga Kuvendi janë miratuar në procedurë të përshpejtuar, pa u konsultuar me palët me interes, prandaj konsekuencat janë se ligjet relativisht kanë paqartësi sa i përket përmbajtjes;
- Anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias dhe shfrytëzimi i opinioneve të Forumit të Komisionit të Venecias ka ndikuar në avancimin profesional të praktikës kushtetuese-drejtësisë kushtetuese në Kosovë, së bashku me këtë edhe në forcimin e shtetit juridik. Njëherit ato kishin ndikuar edhe në procesin e ligjvënies, konkretisht në hartimin e ligjeve më të qarta e në harmoni me kushtetutën, dhe në këtë mënyrë është parandaluar referimi i ligjeve për kontroll të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që ka konsekuenca edhe në fuqizimin e demokracisë kushtetuese si produkt i shtetit të së drejtës;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe e Shqipërisë, në përbërjen e tyre kanë nëntë gjyqtarë, por që bazuar në ndryshimet kushtetuese të 2016, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka një formulë të re të zgjedhjes së anëtarëve të saj që dallon nga ajo e Kosovës;
- Mosfunksionimi efikas nga pikëpamja organizative dhe në ushtrimin e kompetencave që Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri i janë njohur sipas Kushtetutës, imponuan ndryshimet kushtetuese në vitin 2016, përmes së cilave është zgjeruar numri i palëve të autorizuara të cilat me kërkesën e tyre mund ta vënë në “lëvizje” Gjykatën Kushtetuese;
- “Siguria juridike, parimi i ndarjes së pushteteve, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore”, janë disa nga elementet e shtetit të së drejtës të cilat i ka evidentuar jurisprudenca kushtetuese shqiptare;
- Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, njëlloj si ajo e Kosovës ka ndikuar pozitivisht në funksionimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës duke kontribuar përmes kontrollit

kushtetues në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve drejt përmbushjes së elementeve të parimit të shtetit të së drejtës si dhe respektimit të këtij parimi;

- Anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Evropës dhe ratifikimi i KEDNJ sollën ndryshime pozitive në rendin kushtetues shqiptar drejt forcimit të shtetit të së drejtës, ku rol të rëndësishëm kishte edhe Gjykata Kushtetuese përmes kontrollit të pajtueshmërisë së legjislacionit me standardet e KEDNJ;
- Në rastin e Republikës së Maqedonisë Veriore, gjykata kushtetuese e parë, si institucion i veçantë i rendit kushtetues për kontrollin e kushtetutshmërisë, është inkorporuar në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë në vitin 1963;
- Parimisht në shtetet e Evropës Juglindore përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës dhe të Shqipërisë mënyra e punës dhe procedura që zhvillohet në Gjykatën Kushtetuese rregullohet detajisht me ligj dhe me rregullore, megjithatë në rastin e Maqedonisë së Veriut Kushtetuta e përcakton se mënyra e punës dhe procedura në Gjykatën Kushtetuese rregullohen me akt të gjykatës, respektivisht me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese dhe si rrjedhojë rezultoi që për shkak të kësaj ndalese nuk ka pasur ligj për Gjykatën Kushtetuese që nga miratimi i Kushtetutës së fundit në vitin 1991;
- Palët e autorizuar për ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë Veriore në aspekt krahasues me ato në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë dallimi konsiston në të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë Veriore që sipas detyrës zyrtare të iniciojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit ose aktit të përgjithshëm;
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991 vendosi statusin e Gjykatës Kushtetuese si organ i Republikës me ndikim në sigurimin e vlerave themelore të rendit kushtetues, “në ruajtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë”, “lirive dhe të drejtave themelore të individit dhe qytetarit”, “parimin e shtetit të së drejtës” dhe “pjesëmarrjen në ndërtimin dhe forcimin e shtetit ligjor”;
- Kontributi i saj në forcimin e shtetit të së drejtës vërehet që nga viti 1991 e në vazhdim, kur Gjykata ndërhynte për të mbrojtur pozicionin e saj kushtetues ose rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare të Gjykatës të cilat i kanë shërbyer krijimit dhe forcimit të shtetit të së drejtës;

- Shtyllë qendrore të shtetit të së drejtës paraqet edhe garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, ku nga praktika kushtetuese në Maqedoninë Veriore dëshmohet numri shumë i vogël i lëndëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Gjykatën Kushtetuese, madje shumica janë refuzuar si të pabaza ose janë hedhur poshtë mbi baza të ndryshme. Mungesa e ankesës kushtetuese si dhe kufizimi i mbrojtjes vetëm të disa të drejtave dhe lirive të njeriut, janë ndër shkaktarët kryesorë për numrin kaq të vogël të kërkesave të aplikuara;
- Shqetësim përbën jostabiliteti i Gjykatës Kushtetuese edhe në këtë rast për shkak të qëndrimeve të ndryshme të saj lidhur me çështjen e njëjtë gjatë viteve, ka dëshmuar mungesë të konsistencës në qëndrimet e saj, mungesë të arsyetimit dhe profesionalizimit dhe njëherit edhe mungesë të pavarësisë në punën e saj. Kjo ndikon edhe në besimin e qytetarëve në këtë autoritet shtetëror;
- Praktika modeste e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë Veriore në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut rezulton jo vetëm si rrjedhojë e natyrës kufizuese të rregullave kushtetuese dhe procedurale të Gjykatës, por edhe i prapambetjes së Gjykatës në ndjekjen e praktikës së GJEDNJ e cila ka filluar t'i referohet dhjetë (10) vite pas anëtarësimit të Maqedonisë në Këshillin e Evropës;
- Nga kërkesat e adresuara në Forumin e Komisionit të Venecias, vërejmë se e përbashkëta e Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut është se rastet për opinion u referuan kryesisht nga pushteti ekzekutiv qoftë nga kryeministri apo ministritë e caktuara, ndërsa në Shqipëri kanë dominuar rastet e referuara nga pushteti legjislativ, respektivisht kryetari i parlamentit shqiptar.

Andaj, si përfundim Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore, karakteristikë të përbashkët kanë sistemin e qeverisjes që është parlamentar, Gjykata Kushtetuese është organ i posaçëm që qëndron jashtë të tri pushteteve shtetërore dhe aplikojnë sistemin evropian të drejtësisë kushtetuese dhe janë anëtare të Komisionit të Venecias.

Roli i Gjykatës Kushtetuese në këto tre shtete në forcimin e shtetit të së drejtës është manifestuar përmes kontrollit kushtetues abstrakt të akteve juridike, kontrollit kushtetues konkret, incidental duke e mbrojtur parimin e supremacisë së kushtetutës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve shtetërore, etj.

Republika e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë Veriore kanë miratuar standardet evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, çka përbën kauzë të përbashkët të Gjykatave Kushtetuese në këto shtete, andaj referencat në vendimmarrjen e GJEDNJ janë udhërrëfyes i domosdoshëm për veprimin e tyre.

Sistemi i KEDNJ dhe GJEDNJ kanë dhënë kontribut në forcimin e shtetit të së drejtës duke i vënë shteteve në dispozicion një sistem të garancive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, andaj referimi dhe aplikimi i jurisprudencës së GJEDNJ e ngre në nivel më të lartë jurisprudencën kushtetuese.

Edhe Forumi i Komisionit të Venecias me opinionet e tij, ka kontribuar në këto shtete që të ndërtojnë dhe forcojnë shtetin e së drejtës si dhe njëherit në ngritjen e profesionalizimit, paanshmërisë dhe pavarësisë së Gjykatave Kushtetuese duke eliminuar kështu edhe rrezikun e subjektivizmit gjatë marrjes së vendimeve, kjo për faktin se ky Forum është jopolitik dhe shumë profesional pasi në përbërjen e tij janë kryesisht ekspertë të së drejtës kushtetuese.

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese ka për detyrë të mbrojë shtetin e së drejtës dhe elementet e tij, atëherë në vendimmarrjen e saj përmes së cilës ajo e realizon këtë detyrë ndikojnë një numër i faktorëve të karakterit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe konsolidimin e forcimin e shtetit të së drejtës. Faktorët e brendshëm janë: pavarësia institucionale, funksionale, organizative e financiare, raporti me pushtetet e tjera shtetërore, mënyra e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues, përbërja heterogjene e Gjykatës Kushtetuese, mandati i gjyqtarëve dhe pamundësia e rizgjedhjes. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në Kosovë si dhe në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese e me këtë edhe në konsolidimin edhe forcimin e shtetit të së drejtës janë: statusi kushtetues i KEDNJ dhe GJEDNJ, ndërkombëtarizimi i të drejtës kushtetuese, ndërveprimi me GJEDNJ, ndërveprimi me Formonin e Komisionit të Venecias.

Trajtimi i kësaj teme në këtë disertacion të doktoratës më ka bërë të besoj se në të ardhmen Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj ashtu si deri më sot, do të vazhdojë ta zhvillojë dhe perfeksionojë veprimtarinë e saj në lidhje me problematikën e mosmarrëveshjeve midis pushteteve shtetërore duke dhënë ndihmë konkrete në njohjen dhe zbatimin e kushtetutës, vlerave kushtetuese përfshirë këtu edhe shtetin e së drejtës dhe njëkohësisht duke krijuar hapësirën e nevojshme në përmirësimin e legjislacionit.

Rekomandimet

Pas hulumtimit doktrinar se çfarë ndikimi ka Gjykata Kushtetuese për forcimin dhe përmirësimin e shtetit juridik, rekomandojmë se:

- Për të forcuar shtetin dhe të drejtën paralelisht duhet forcuar sistemin e drejtësisë kushtetuese, respektivisht gjyqësinë kushtetuese në shtetet të cilat janë në tranzicion si Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut;
- Përkundër faktit se parimet themelore të organizimit të shtetit demokratik janë të sanksionuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, imperativisht kanë avancuar me efektin e vendimeve të Gjykatave kushtetuese të këtyre tre shteteve;
- Kontrolli i balancimit të pushteteve shtetërore përbën garanci që Gjykata kushtetuese duhet ta realizojë për forcimin e e shtetit të së drejtës.
- Pavarësia, paanëshmëria e Gjykatës kushtetuese në marrjen e vendimeve profesionalisht të rishqyrtuara, ngrit edhe më lartë vlerat e një shteti demokratik dhe të së drejtës;
- Gjykoj se Gjykata kushtetuese duhet ta rris më tepër vigjilencën në momentin e zgjedhjeve të udhëheqësve shtetëror në Kuvend që domosdoshmërisht e forcon demokracinë dhe shtetin e se drejtës;
- Dështimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës disa herë për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues e paraqet të nevojshme ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së tyre me Kushtetutë dhe ligjin përkatës;
- Zgjidhja ligjore që mund ta kufizojë parlamentin ose organet e tjera për të caktuar një gjykatës të ri brenda afatit ligjor është institucioni i të ashtuquajturës zgjatje e mandatit (latinisht: *prorogatio*) që do të thotë se gjyqtari të cilit i ka përfunduar mandati vazhdon të mbetet në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij e cila do të ishte zgjidhje e përshtatshme edhe në rastin e Kosovës;
- Sa i përket zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues në Republikën e Kosovës, do të ishte i rekomandueshëm aplikimi i modelit të zgjedhjes të cilën e aplikon Shqipëria ose Maqedonia, ku do të siguroheshin kompetenca zgjedhore ose emërimi për tre degët kryesore të pushteteve shtetërore, pasi ky model do të

rezultonte më legjitim dhe demokratik. Aplikimi i modelit të tillë edhe në Republikën e Kosovës do të shmangte bllokimin e zgjedhjes nga Kuvendi të kandidatëve për gjyqtarë kushtetues, pastaj do të zvogëlonte ndikimin e politikës por njëkohësisht do të rriste edhe profesionalizimin në këtë gjykatë si dhe do të evitonte rrezikun e ndikimit në pavarësinë dhe funksionalitetin e kësaj gjykate;

- Gjatë ushtrimit të funksionit legjislativ transparenca e Kuvendit duhet rritur, përmes organizimit të debateve parlamentare dhe se procedura legislative duhet të zhvillohet sipas afateve kohore të caktuara dhe jo në procedurë të përsheptuar në mënyrë që cilësia e ligjvënies të përmirësohet. Rekomandohet edhe themelimi i institutit në kuadër të Parlamentit i cili do të ofrojë trajnime për teknikat e hartimit të legjislacionit dhe në mënyrë që legjislacioni të hartohet konform kërkesave formale dhe përmbajtjesore të shtetit të së drejtës;
- Publikimi i menjëhershëm i dispozitivit të vendimit apo pjesës operative nga Gjykata Kushtetuese në çështjet që kanë ndjeshmëri publike do të ndikonte edhe më tej në rritjen e besueshmërisë së publikut në punën e këtij institucioni dhe do të eliminonte mundësitë për keqinformim apo edhe abuzim nga mediat në lidhje me kuptimin e arsyetimit të çështjes;
- Parimi i shtetit të së drejtës është i lidhur ngushtë me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, i cili përbën një prej prerogativave më të rëndësishme të shtetit, përkundër se ekziston perceptimi se ky pushtet në Republikën e Kosovës ndikohet në marrjen e vendimeve, që është a contrario me Gjykatën kushtetuese;
- Publikimi i aktakuzave dhe i aktgjykimeve, si komponent do të ndikojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor, njëherit do të reflektojë edhe në ngritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor; të gjitha këto ndikojnë në rritjen e vlerave të një shteti juridik;
- Shqipëria me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në vitin 2016 ka arritur të avancojë bazën juridike për drejtësinë kushtetuese dhe në këtë rast duhet të shërbejë si model për Republikën e Kosovës dhe atë të Maqedonisë Veriore;
- Sa i përket Maqedonisë Veriore, mungesa e ligjit për Gjykatën Kushtetuese konsiderohet si vakum ligjor, i cili reflekton nga situata të parregullta dhe konfuze

andaj rekomandojmë miratimin e një ligji të veçantë për këtë gjykatë, çka do të reflektonte në përforcimin e shtetit ligjor;

- Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë Veriore konstatoj se nuk ka kontribuar mjaftueshëm në krijimin e forcimin e shtetit të së drejtës, kjo pasi baza juridike nuk është e plotë për garantimin e shtetit të së drejtës dhe mungon pavarësia e profesionalizimi i Gjykatës Kushtetuese, andaj përbën nevojë imediate një reformë kushtetuese e ligjore e tërësishme për përmbushjen e Gjykatës Kushtetuese;
- Në raport me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, rekomandohet të bëhet amendamenti i Kushtetutës dhe të inkorporohet ankesa kushtetuese si dhe të evitohet qasja restriktive e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, e cila do t'i garantonte individëve mbrojtje të avancuar nga Gjykata Kushtetuese si element bazik i garantimit të shtetit të së drejtës.

Nëpërmjet burimeve të shumta doktrinare kam paraqitur rolin e Gjykatës Kushtetuese në forcimin e shtetit të së drejtës duke e konsideruar si element relevant dhe pasurues të doktrineve konstitucionaliste dhe praktikave për ndarjen e drejtësisë kushtetuese në Evropën Juglindore. Ky studim mund të jetë pjesë e një vizioni të ri të funksionimit të shtetit të së drejtës. Andaj, përfundimet dhe rekomandimet e këtij punimi mund të shërbejnë për njohjen punës profesionale e të paanëshme dhe fuqisë kushtetuese të Gjykatave kushtetuese si dhe rolin e tyre në forcimin e shtetit të së drejtës dhe rendit kushtetues në Republikën e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

CONCLUSIONS

In this doctoral dissertation, the analysis is explicitly oriented to the role and power of the Constitutional Court in strengthening the rule of law in the Republic of Kosovo, Albania, and North Macedonia. The paper focuses on the review of the doctrine and jurisprudence of the Constitutional Court and its relationship with the three state powers and the tendency to maintain the balance of these state authorities with motivation for further development of democracy and at the same time strengthening the rule of law. I emphasize that the constitution as a legal and political act alone cannot ensure democratic governance without the assistance of its enforcement bodies, and thus confronts the Constitutional Court as a concentrated authority for the interpretation and delivery of constitutional justice. Such a combination helps to formulate and structure the rule of law and democracy. The transition of political and territorial units in the former Yugoslavia and the raising of Kosovo's status to the country level with a priori international recognition required another radical transition of the Constitutional Court by changing the way it functions both in the aspect of quality and number of judges.

Of course, among other things, the Constitutional Court is considered as a protector of human rights and freedoms, which today constitutes the basic function of constitutional justice. Our history of constitutional jurisprudence demonstrates that committed citizenship is essential to the health of the legal-constitutional order. The Constitutional Court of the Republic of Kosovo, although young, during these years has left an indelible mark of disciplining the state authorities and their incumbents, especially with the two former presidents of the Republic of Kosovo. Specifically, based on this study, I reached the following conclusions:

- Constitutional justice is an extremely important category in any legal and democratic system for the realization of European standards where the supremacy of the constitution, the application of the hierarchy of domestic and international legal acts, constitute a crucial precondition for the implementation of constitutional justice in rule of law. The supremacy of the constitution is guaranteed by the constitutional courts which ensure the functioning of the constitutional mechanism of separation of state powers in the rule of law;

- The characteristics and general principles of the constitutional judiciary are unique, in countries that have a specialized court, a constitutional court as a separate institution regulated by the country's constitution, and a specific law;
- The rule of law in the formal sense includes the features of drafting and administering clear, public and sustainable legislation that should apply to the future while in the substantive sense includes the respect and protection of human rights and freedoms, these also constitute the requirements that a state must meet de facto and de jure, to be considered rule of law;
- The Republic of Kosovo, Albania, and North Macedonia have guaranteed the rule of law in their highest legal and political act;
- Constitutional Courts, in general, have a dominant role in consolidating and strengthening the rule of law, including the European Court of Human Rights, which has a multidimensional influence in the establishment of case law, in particular in the protection of fundamental human rights, which affects the strengthening of the rule of law in the substantive sense;
- The European Court of Human Rights strengthens the constitutional order by "correcting" and "controlling" the constitutional courts of the European countries that are part of it, through its decisions on the specific issues referred to it;
- In the case of Kosovo, during the historical evolution as a federal unit of the former SFRY from 1969 until the declaration of Kosovo's independence in 2008, there was a constitutional court as an independent body outside the justice system but also constitutional judicial branches within the judiciary;
- In 2009, the Constitutional Court of Kosovo was established with the final determination of the political status of Kosovo on February 17, 2008, when Kosovo was declared an independent state under international administration, but the election and appointment of judges of the Constitutional Court were determined as the final and special constitutional authority, aimed at protecting constitutionality and legality;
- The constitutional competencies of the Constitutional Court of Kosovo are defined in five main categories: interpretative powers; competence to assess the constitutionality of legal norms; competencies related to the assessment of conflicts

of competence between public authorities; elections of state bodies and human rights and freedoms;

- The Constitution and the Law do not define the clear, objective, and measurable criteria in the professional aspect of candidates for constitutional judges, therefore these criteria currently in the Republic of Kosovo do not include a large number of jurists who can be elected to this position;
- The election and appointment of judges in the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, does not provide sufficient guarantees in terms of respect for the principle of independence, impartiality, and quality in the composition of the Constitutional Court;
- A challenge for the Constitutional Court of the Republic of Kosovo remains the filling of vacancies for constitutional judges within the legal deadline, which produces direct consequences in the inability of its functioning as decision-making is carried out through a quorum;
- Parliamentary groups have the opportunity to influence decision-making in the Constitutional Court of the Republic of Kosovo due to the formula of the election, specifically, therefore this raises doubts about the impartiality and independence of judges, who during the constitutional control of the normative acts adopted in the parliament, may show a political activation as a sign of loyalty to the majority that has elected them;
- Independence of the Constitutional Court is directly affected by the limited mandate and the impossibility of re-election of constitutional judges;
- The Constitution of the Republic of Kosovo, in its provisions, guarantees the elements that constitute the rule of law, which are free and direct elections - the manner of constitution of state power, the basis and source of its legitimacy, guarantee and constitutional protection of fundamental rights and freedoms, division of state powers, independence of the judiciary - legal security and protection of rights, and subjection of state power to the constitution and law;
- In the jurisprudence of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, cases have been reviewed that include each of the above elements of the rule of law but issues related to the guarantee and protection of human rights have dominated,

subject to the requirements, mainly the decisions of the Basic, Appellate and Supreme Courts and allegations of violations of the rule of law, legal certainty, the right to a fair and impartial trial, denial of judicial protection, right to legal remedies, equality before the law, and of property rights have dominated and all these decisions have played a fundamental role for the democratic state with separate state powers, respectively in strengthening the principle of the rule of law in Kosovo;

- In strengthening and respecting the principle of the rule of law in Kosovo, the Constitutional Court has played an important role, which through its constitutional jurisprudence has managed to identify, elaborate, and protect constitutional values and principles, including the rule of law, constitutionality, separation of state powers, control and balance of state powers, independence of the judiciary, legal security, human rights, and freedoms and unconstitutional promulgation of amendments, legal norms of laws but also laws as a whole during the constitutional review of legal acts, underlining the importance of respecting this principle even during the procedure of issuing laws;
- The Constitutional Court in Kosovo has also contributed to mitigating institutional conflicts or deadlocks, transforming political justice into constitutional justice, in respect of the principle of separation of state powers both on horizontal and vertical levels;
- The Constitutional Court has made a sufficient interpretation of the Constitution, which means that it has consistently been active in exercising its jurisdiction. If we analyze the annual reports of the Constitutional Court, we observe the success it has achieved as the decisions for resolving the claims dominate concerning the number of requests received for review on an annual basis;
- Another element of the rule of law is the protection of constitutional rights and freedoms, in the case of Kosovo the reference to the Constitutional Court recognized by the Constitution when there are violations of guaranteed rights after the exhaustion of legal remedies affecting the quality of professional work and greater responsibility of judges and officials in the state administration because they take into account that their decision in the case of violation of rights and freedoms can eventually be attacked in the Constitutional Court;

- Regarding the referral to the Constitutional Court of the Republic of Kosovo in the case when a guaranteed right or freedom would be violated, it was observed the citizens know regarding the referral of cases to the Constitutional Court since initially based on the institutional hierarchy they would exhaust effective remedies before going to the Constitutional Court;
- Exercising the legislative function of the Assembly of the Republic of Kosovo. The procedures for the adoption of laws are transparent and democratic, but the laws are adopted by the Assembly in an accelerated procedure, without consulting interested parties, therefore the consequences are that the laws are relatively vague in terms of content;
- Kosovo's membership in the Venice Commission and the use of the opinions of the Venice Commission Forum has influenced the professional advancement of the constitutional practice-constitutional justice in Kosovo, together with the strengthening of the state juridical. At the same time, they influenced the legislative process, namely the drafting of clearer laws in accordance with the constitution, and thus prevented the referral of laws to review the constitutionality in the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, which also has consequences in strengthening constitutional democracy as a product of the rule of law;
- The Constitutional Courts of the Republic of Kosovo and Albania are composed of nine judges but based on the constitutional changes of 2016, the Constitutional Court of Albania has a new formula for the election of its members that differs from that of Kosovo;
- Inefficient functioning from the organizational point of view and in the exercise powers recognized to Constitution Court of Albania according to the Constitution, through which the constitutional amendments of 2016, the number of authorized parties has been expanded which at their request can set in "motion" the Constitutional Court;
- "Legal security, the principle of separation of powers, the adoption of laws in accordance with the Constitution, the control of the administration, the guarantee of fundamental rights and freedoms" are some of the elements of the rule of law that have been identified by the Albanian constitutional jurisprudence;

- The Constitutional Court of Albania, like the one of Kosovo, had a positive impact on the functioning and strengthening of the rule of law through constitutional control to increase the responsibility of institutions towards fulfilling the elements of the rule of law principle and respecting this principle;
- Albania's membership in the Council of Europe and the ratification of the ECHR brought positive changes in the Albanian constitutional order towards strengthening the rule of law, where the Constitutional Court also had an important role, by checking the compliance of legislation with ECHR standards;
- In the case of the Republic of North Macedonia, the first constitutional court, as a special institution of the constitutional order for reviewing the constitutionality was incorporated in the Constitution of the Socialist Republic of Macedonia in 1963;
- In principle, in the countries of Southeast Europe, including the Republic of Kosovo and Albania, the manner of work and the procedure in the Constitutional Court is regulated in detail by law and regulations, however, in the case of North Macedonia, this is not the case because The Constitution stipulates that the manner of work and procedure in the Constitutional Court are regulated by a Court Act, respectively by the Regulation of the Constitutional Court and as a result, it turns out that due to this prohibition there has been no Law regarding the Constitutional Court since the adoption of the last Constitution in 1991;
- The parties authorized to put into motion the Constitutional Court of North Macedonia in a comparative aspect compared to those in the Constitutional Court of the Republic of Kosovo and Albania, the difference is the right of the Constitutional Court of North Macedonia to ex officio initiate the assessment of the constitutionality of the law or the general act;
- The 1991 Constitution of the Republic of Macedonia established the status of the Constitutional Court as a body of the Republic with the influence of ensuring the fundamental values of the constitutional order, “preserving the constitutionality and legality”, “freedoms and fundamental rights of the individual and citizen”, “the principle of the rule of law” and “participation in building and strengthening the rule of law”;

- Its contribution to the strengthening of the rule of law is observed from 1991 onwards when the Court intervened to defend its constitutional position or cases initiated ex officio of the Court that served the establishment and strengthened the rule of law;
- The central pillar of the rule of law is the guarantee and protection of human rights and freedoms, whereas the constitutional practice in North Macedonia indicates a very small number of cases for the protection of human rights and freedoms in the Constitutional Court and even the majority has been rejected as unfounded or rejected on various grounds. The lack of a constitutional complaint, as well as the restriction of the protection of only certain human rights and freedoms are among the main reasons for such a small number of applied claims;
- The instability of the Constitutional Court in this case as well is disturbing, due to its different positions on the same issue over the years, has shown a lack of consistency in its positions, lack of reasoning and professionalism, and at the same time lack of independence in its work. This also affects the citizens' trust in this state authority;
- The modest practice of the Constitutional Court of the Republic of North Macedonia in the field of protection of human rights and freedoms results not only due to the restrictive nature of the constitutional and procedural rules of the Court but also due to the lag of the Court in prosecuting of the case-law of the ECHR has begun to refer ten (10) years after Macedonia's membership in the Council of Europe;
- From the requests addressed to the Venice Commission Forum, we observe that the common denominator of the Republic of Kosovo and North Macedonia is that the opinion cases were referred mainly by the executive power either by the Prime Minister or certain ministries, while in Albania the cases referred by the legislative power, respectively the Speaker of the Albanian Parliament, have dominated.

Therefore, in the conclusion, the Republic of Kosovo, the system of the parliamentary government is a common feature of Albania and North Macedonia, Constitutional Court is a special body separate of the three state powers and apply the European system of constitutional justice and are members of the Venice Commission.

The role of the Constitutional Court in these three states in strengthening the rule of law is manifested through abstract constitutional review of legal acts, concrete, incidental

constitutional review by defending the principle of constitutional supremacy, the principle of separation, and balance of state powers, etc.

The Republic of Kosovo, Albania, and North Macedonia have adopted European standards for the protection of human rights and freedoms which is a common cause of the Constitutional Courts in these countries, so the references in the decision-making of the European Court of Human Rights are a necessary guide for their action. The European Court of Human Rights system and the ECHR have contributed to strengthening the rule of law by making available to states a system of guarantees for the protection of human rights and freedoms, so, the reference and application of the jurisprudence of the European Court of Human Rights raise the constitutional jurisprudence to a higher level.

The Venice Commission Forum, with its opinions, has contributed to these states to build and strengthen the rule of law and at the same time to increase the professionalism, impartiality, and independence of the Constitutional Courts, thus eliminating the risk of subjectivity in decision-making, this is because this Forum is non-political and very professional as it consists mainly of experts of constitutional law.

Since the Constitutional Court must protect the rule of law and its elements, then several internal and external factors influence its decision-making through which it performs this task as well as the consolidation and strengthening of rule of law. Internal factors are institutional, functional, organizational, and financial independence, relationship with other state powers, the manner of election and appointment of constitutional judges, the heterogeneous composition of the Constitutional Court, the mandate of judges, and the impossibility of re-election. External factors that have influenced Kosovo as well as Albania and North Macedonia in the decision-making of the Constitutional Court and thus in the consolidation and strengthening of the rule of law are the constitutional status of the ECHR and the European Court of Human Rights, the internationalization of constitutional law, interaction with the ECHR, interacting with the Forum of the Venice Commission.

The elaboration of this topic in this doctoral dissertation has led me to believe that in the future the Constitutional Court with its decisions as until now, will continue to develop and perfect its activity concerning the issue of disputes between state powers by providing concrete assistance in the recognition and implementation of the constitution, constitutional values, including the rule of law and at the same time creating the necessary space for the improvement of legislation.

Recommendations

After the doctrinal research on the impact of the Constitutional Court on the strengthening and improvement of the rule of law, we recommend that:

- In order to strengthen the state and the law in parallel, the system of constitutional justice should be strengthened, respectively the constitutional judiciary in the countries that are in transition, such as Kosovo, Albania and Northern Macedonia.
- Despite the fact that the basic principles of organizing a democratic state are sanctioned by the Constitution of the Republic of Kosovo, Albania and Northern Macedonia, they have imperatively advanced with the effect of the decisions of the Constitutional Courts of these three states.
- The control of the balance of state powers is a guarantee that the Constitutional Court must realize in order to strengthen the rule of law.
- The independence, impartiality of the Constitutional Court in making professionally reviewed decisions, further enhances the values of a democratic state and the rule of law.
- The failure of the Assembly of the Republic of Kosovo several times to elect constitutional judges makes it necessary to change the manner of their election by the Constitution and the relevant law.
- The legal solution that may restrict parliament or other bodies from appointing a new judge within the legal deadline is the institution of the so-called extension of term (Latin: *prorogatio*) which means that the judge whose term has ended remains in office until the appointment of his successor which would be an appropriate solution in the case of Kosovo.
- Regarding the election and appointment of constitutional judges in the Republic of Kosovo, it would be advisable to apply the election model applied by Albania or Macedonia, which would provide electoral powers or appointment to the three main branches of state power, as this model would turn out to be more legitimate and democratic. Applying such a model in the Republic of Kosovo would avoid blocking the election by the Assembly of candidates for constitutional judges, then would reduce the influence of politics but also increase professionalism in this court and would avoid the risk of influence in the independence and functionality of this court.

- During the exercise of the legislative function, the transparency of the Assembly should be increased, through the organization of parliamentary debates and that the legislative procedure should be conducted according to certain deadlines and not in an accelerated procedure in order to improve the quality of legislation. It is also recommended the establishment of an institute within the Parliament which will provide training on the techniques of drafting legislation and in order for the legislation to be drafted in accordance with the formal and substantive requirements of the rule of law.
- Immediate publication of the enacting clause of the decision or the operative part by the Constitutional Court in cases that have public sensitivity would further increase the public's confidence in the work of this institution and would eliminate opportunities for misinformation or even abuse by the media in regarding the meaning of the reasoning of the case.
- The principle of the rule of law is closely related to the independence of the judiciary, which is one of the most important prerogatives of the state, despite the perception that this power in the Republic of Kosovo influences decision-making, which is a contrario with the Constitutional Court.
- The publication of indictments and judgments, as a component will increase the transparency and accountability of the judiciary, will also reflect on increasing citizens' trust in the judicial system; all these affect the growth of the values of a state governed by the rule of law.
- Albania with the constitutional and legal changes in 2016 has managed to advance the legal basis for constitutional justice and in this case should serve as a model for the Republic of Kosovo and that of Northern Macedonia.
- Regarding Northern Macedonia, the lack of a law on the Constitutional Court is considered as a legal vacuum, which reflects from irregular and confusing situations, so we recommend the adoption of a special law for this court, which would reflect on the strengthening of the rule of law.
- Referring to the jurisprudence of the Constitutional Court in the Republic of Northern Macedonia, I find that it has not sufficiently contributed to the establishment and strengthening of the rule of law, as the legal basis for guaranteeing the rule of law is lacking and the independence and professionalism of

the Constitutional Court is lacking, therefore there is an immediate need for a comprehensive constitutional and legal reform for the fulfillment of the Constitutional Court.

- Concerning the protection of human rights and freedoms, it is recommended to amend the Constitution and to incorporate constitutional appeal as well as to avoid the restrictive approach to the protection of human rights and freedoms, which would guarantee individuals advanced protection by the Constitutional Court as a basic element of guaranteeing the rule of law.

Through numerous doctrinal sources and archives, I have presented the role of the Constitutional Court in strengthening the rule of law, considering it as a relevant and enriching element of constitutionalist doctrines and practices for the distribution of constitutional justice in Southeast Europe. This study may be part of a new vision of the functioning of the rule of law. So, the conclusions and recommendations of this paper can serve for the recognition of the professional and impartial work and the constitutional power of the Constitutional Courts as well as their role in strengthening the rule of law and the constitutional order in the Republic of Kosovo, Albania and Northern Macedonia.

REFERENCAT

- A. Haxhiu, D. Selmanaj dhe 30 deputetë të tjerë, KO 43/19 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 27, 2019).
- A. Kurti dhe 11 deputetë të tjerë, KO 84/18 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Dhjetor 24, 2018).
- A. Rodrigues, G. Caka-Nimani-Mendim i përbashkët mospajtues, KO 12/18 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 11, 2018).
- A. Rodrigues, S. Botusharova-Mendim i përbashkët mospajtues, KI146/17, KI147/17, KI148/17, 149/17 dhe 150/17 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 7, 2018).
- A. Rodrigues-Mendim mospajtues, KI 11/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Tetor 20, 2009).
- A. Suroy, A. Rodrigues, S. Botusharova-Mendim i përbashkët mospajtues, Rasti nr. KI78/12 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Shkurt 12, 2013).
- A. Rodrigues, A. Rama-Hajrizi-Mendim mospajtues, KI 89/13 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Maj 13, 2014).
- AAB-RIINVEST L.L.C., KI 41/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Janar 27, 2010).
- Ahmeti, B. (2021, Qershor 2021). Kosova me Kushtetutë tash e 13 vjet/Albanian Post. Prishtinë. Gjetur Korrik 2021, nga <https://albanianpost.com/kosova-me-kushtetute-tash-e-13-vjet/>
- Allelo, J. (2021, July 1). Interview via email. (D. Susuri, Interviewer)
- Amandamentet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës*. (2012, Shtator 7). Gjetur Janar 2021, nga Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 25: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
- Anastasi, A. (2004). *E drejta kushtetuese*. Tiranë: Pegi.
- Anastasi, A. (2008). Emërimi i gjyqtarëve si çështje e rëndësishme kushtetuese. “*Ligji mundësi zhvillimi për gratë*”. Gjetur Prill 2021, nga <https://www.qag-al.org/WEB/publikime/Kushtetuta%20per%20emerimin%20e%20gjyqtareve.pdf>

- Andreopoulos G., Barberet R. & Nalla M. (2014). Introduction: Rule of Law in an Era of Change – Challenges and Prospects. *The Rule of Law in an Era of Change* (fv. 1-14). Athens, Greece: Springer.
- Avokati i Popullit, KO 65/19 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Gusht 23, 2019). Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=22122>
- Avokati i Popullit, KO 219/19 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Korrik 9, 2020).
- Azizi, A. et al. (2009). *Fjalor-Shumëdimensional i termave dhe shprehjeve administrative, politike, sociale dhe të diplomacisë*. Shkup: Shtëpia botuese "Vatra".
- Bajrami, A. (2007). *Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e Kushtetutës)*. Prishtinë: Universiteti AAB.
- Bajrami, A. (2011). *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*. Prishtinë.
- Bajrami, A. et al. (2012). *Pozita kushtetuese dhe ligjore e pakicave kombëtare-aspekte krahasuese*. Prishtinë: Artini.
- Bajrami, A. et. al. (2015). *Doracak për përgaditjen e provimit të jurisprudencës*. Prishtinë. Gjetur në <https://www.scribd.com/document/369131464/Doracaku-komplet-2015-1-pdf>
- Bajrami, A., & Muçaj, F. (2018). *E drejta kushtetuese*. Prishtinë: Kolgji AAB.
- Bajrami, A., & Shala, Xh. (2015). Sistemi kushtetutes dhe organizimi i jurisprudences. Në *Doracak për përgaditjen e provimit të jurisprudencës* (fv. 1-62). Prishtinë: UNDP, Kosovë and Logic Plus.
- Bara, B., & Bara, J. (2017, June 20). Rule of Law and Judicial Independence in Albania. *University of Bologna Law Review*, pp. 23-48. Retrieved from <https://bolognalawreview.unibo.it/article/view/6960>
- Baza ligjore-GJKRK. (n.d.). Prishtinë. Gjetur Prill 2021, nga <https://gjk-ks.org/gjykata-kushtetuese/baza-ligjore/>
- Bislimi, B. (2021, Shtator 2). Gjyqtari i Kushtetueses përplas politikanët serb. Prishtinë, Republika e Kosovës, Republika e Kosovës.
- Bono, G. R. (2010, May). The significance of the rule of law and its implications for the European Union and United States. *University of Pittsburgh Law Review*, [72:229 2010], fv. 231-360.
- Borchardt, K.-D. (2011). ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit European-Integrimi në BE. Tiranë. Gjetur në <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp->

content/uploads/2020/04/3-ABC-e-s%C3%AB-Drejt%C3%ABs-s%C3%AB-Bashkimit-European.pdf

- Boyle, K. (2009, June). The European Experience: the European Convention on Human Rights. *Victoria University of Wellington Law Review*, pp. 167-176.
- Bradley W. A., & Ewing D. K. (2007). *Constitutional and administrative law* (bot. i Fourteenth edition). Malaysia: Pearson Education Limited.
- Brewer-Carías, A. (2009). *Constitutional Protection of Human Rights in Latin America: A Comparative Study of Amparo Proceedings*. New York: Cambridge University Press.
- Brewer-Carías, A. (2009). The Latin American Amparo Proceeding and the Writ of Amparo in the Philippines. *City University of Hong Kong Law Review*, 73-90. Gjetur në <http://dev.allanbrewercarias.com/wp-content/uploads/2009/11/621.-616.-Brewer-Amparo-Latin-America-Philippines-Hong-Kong-2009.pdf>
- Brewer-Carías, A. (2011). *In Constitutional Courts as Positive Legislators: A Comparative Law Study*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Brewer-Carías, R. A. (2010). *Dismantling Democracy in Venezuela. The Chávez Authoritarian Experiment*. New York: Cambridge University Press.
- Brzostek, P. (2018). 'In America, the law is king' – historical perspective on the Due Process of Law in the United States. *Warsaw University Law Review*, Vol. 17, No. 1/2018, pp. 5-24.
- Bumin, M. K. (2009). Viable institution, judicial power, and post-communist constitutional courts. *Viable institution, judicial power, and post-communist constitutional courts*. Lexington, Kentucky, Kentucky: University of Kentucky Doctoral Dissertations.
- Buquicchio, G. &. (2018). Constitutional Courts - the living heart of the separation of powers, The role of the Venice Commission in promoting Constitutional Justice. *Human Rights in a Global World* (pp. 515-544). Oisterwijk: Willen-Jan van der Wolf.
- Buquicchio, G. (2015, 10 16). Hapja e vitit gjyqësor të Kosovës-Fjalim nga zt. Gianni Buquicchio-kryetar i Komisionit të Venecias. *Hapja e Vitit Gjyqësor të Kosovës*, (fv. 1-6). Prishtinë. Gjetur në https://www.gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/Fjalimi_i_kryetarit_te_Komisionit_te_Venecias_Gianni_Buquicchio.pdf
- Clinton, R. L. (1989). *Marbury v. Madison and Judicial Review*. Lawrence : University Press of Kansas.
- Comella, V. (2004). The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization? *International Journal of Constitutional Law*,, 461-491.

- Constitutional Court of the Republic of NM. (2010-2020). *Review of the Work of the Constitutional Court of Macedonia for 2010-2019*. Retrieved from Преглед на работата на Уставниот суд на Република Македонија за 2010 година: <http://ustavensud.mk/?p=12528>
- Council of Europe. (2002, 2 21). *Revised Statute of the ECDL*.
- Council of Europe. (2020, February 13-14). *Venice Commission*.
- Cowdery, N. (2008). The rule of law—A general introduction. *14th ANNUAL PROSECUTORS CONFERENCE: Infringing the Rule of Law – What should prosecutors do in response?*, (fv. 1-10). Australia.
- Çështja Driza kundër Shqipërisë, Ankimimi nr.33771/02 (GJEDNJ Nëntor 13, 2007).
- Çështja Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë, Kërkesa nr.10613/16 (GJEDNJ 5 28, 2018).
- Decision U.no.116/2017, U.nr.116/2017 (Constitutional Court of the RNM June 27, 2018).
- Decision U.no.57/2019, U.no.57/2019 (Constitutional Court of the RNM May 29, 2019).
- Decision U.no.84/2009, U.no.84/2009 (Constitutional Court of the RNM February 10, 2009).
- Dedja, B. (2013). Juridiksioni Kushtetues kundrejt juridiksonit të zakonshëm-Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. *Fushëveprimi i vlerësimit të vendimeve të Gjykatës Supreme*, (fv. 1-18). Prishtinë.
- Deklarata e Pavarësisë së Kosovës*. (2008, Shkurt 17).
- Dicey, A. V. & Wade, E. C. S. (1950). *Introduction to the Law of the Constitution*. Macmillan, London: Liberty Classics.
- Drzemczewski, A. (1999). *The European human rights convention: Protocol no.11, entry into force and first year of application*. Council of Europe.
- Duhamel, O. (2004). *E drejta kushtetuese-Demokracitë*. Shkup: Logos-A.
- Dula, V. (2020, 9 15). Kërkesat e parashtruara nga GJKRK në Forumin e Komisionit të Venecias/Zyra për komunikim dhe informim e Gjykatës Kushtetuese. Prishtinë, Republika e Kosovës.
- E. Kastrati, KI 68/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 21, 2010).
- ECDL. (1997). *The composition of constitutional courts*. Strasbourg: European Commission.
- ECDL. (2015). *Compilation of Venice Commission opinions, reports and studies in constitutional justice*. Strasbourg: Venice Commission.

- ECHR*. (1950, 11 4). Gjetur në European Courts of Human Rights-Official texts.
- ENNHRI. (2020). *International accreditation status and SCA recommendations*. People's Advocate of Albania.
- F. Pireci , KI 55/11 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Korrik 16, 2012).
- Ferrioli, E. (2015). Rule of law and constitutional democracy. *The Turkish Yearbook of International Relations*, 46, 91-106. [Gjetur në file:///C:/Users/Admin/Desktop/temat%20phd/publikime/Rule%20of%20Law%20and%20Constitutional.pdf](file:///C:/Users/Admin/Desktop/temat%20phd/publikime/Rule%20of%20Law%20and%20Constitutional.pdf)
- G. Caka-Nimani-Mendim mospajtues, KI 34/17 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 12, 2017).
- Gerards, J. (2014). Chapter 2. The European Court of Human Rights and the national courts:giving shape to the notion of 'shared responsibility'. In J. F. Gerards, *Implementation of the European Convention on Human Rights and of the judgments of the ECtHR in national case-law-A comprative analysis* (pp. 13-94). Cambridge-United Kingdom: Intersentia Publishing Ltd.
- Gojar, S., & Fabr, R.S. (2010). E de vatel. E drejta e popullit. Në *Çështje të mëdha të filozofisë së drejtësisë* (fv. 27-29).
- Goševa, E. (2014). Contemporary Challenges of the Constitutional Judiciary. *Contemporary Challenges of the Constitutional Judiciary* (pp. 6-10). Skopje: Constitutional Court of the Republic of Macedonia .
- Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë. (2015). *Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri (Dokument analitik i sistemit të drejtësisë)*. Tiranë: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Gjetur në <http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2015/06/Analiza-e-Sistemit-t%C3%AB-Dreit%C3%ABsis%C3%AB.pdf>
- Gj. Mushkolaj-Mendimi mospajtues, KI 11/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Tetor 23, 2009).
- GJKRK. (2009-2019). Vendimet. Prishtinë, Republika e Kosovës.
- Harding, A. (2017, February). The Fundamentals of Constitutional Courts. *International IDEA Constitution Brief, February 2017*. Yangon, Myanmar.
- Hartwig, M. (1992). The Instituionalization of the Rule of Law: The Establishment of Constitutional Courts in the Eastern European Countries. *American University International Law Review* , 7(3), 449-470.

- Harutyunyan, G. (2009). Characteristics of constitutional justice in the countries of young democracies. *Communication at the Ibero-American Constitutional Conference*, (fv. 1-10). Merida, Mexico.
- Hasani, E., & Brahimi, M. (2021). *Gjyqësia kushtetuese*. Prishtinë: Botues: NTG "Blendi".
- Hasani, E., & Cukalovic, I. (2013). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës-Komentar*. Prishtinë: t (GIZ) GmbH. Gjetur në http://ius.igjk.rks-gov.net/487/1/Komentari_Kushtetuta_11_Shqip.pdf
- Hedling, N. (2011). A Practical Guide to Constitution Building: The Design of the Judicial Branch. *International Institute for Democracy and Electoral Assistance (International IDEA)*.
- Historiku-GJKRK. (n.d.). Gjetur në <https://gjk-ks.org/gjykata-kushtetuese/historiku/>
- Historiku-GJKRSH. (2019). Gjetur në http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php
- Hoffmann-Riem, W. (2014). The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact. *The European Journal of International Law* , Vol. 25 (No. 2), 579-597.
- Holzinger, G. (2016). The origins and development of Constitutional Jurisdiction in Austria. *Constitutional Court of the Republic of Slovenia 25 years*, (fv. 61-68). Bled, Slovenia.
- Horowitz, L. D. (2006, October). Constitutional Courts: A primer for decision makers. *Journal of Democracy*, 17(4), 125-137.
- I.Ibrahimi dhe 48 ish punëtorë të tjerë , KI 68/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 23, 2010).
- Idrizi, N. (2017). NDIKIMI I PRECEDENTIT NË SISTEMIN JURIDIK TË KOSOVËS. *West East Journal of Social Sciences*, fv. 1-10. Gjetur në https://www.researchgate.net/publication/341051375_NDIKIMI_I_PRECEDENTIT_N_E_SISTEMIN_JURIDIK_TE_KOSOVES
- Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Shkurt 6, 2015).
- Instituti i studimeve politike. (Mars-Gusht 2018). *Vetingu në drejtësi-bilanci, problematikat dhe pritshmëritë*. Tiranë.
- Jovanovska K. Tanja., & Saveski D. (2021). Constitutional Complaint and Macedonian Constitutional Court-regulation issues and its reflection in practice-. *12 Iustinianus Primus L. Rev. 1*, 1-14.
- Jr. Drake, N. W. (2016). The Common Law and the Rule of Law: An "Uncomfortable Relationship". *Stetson Law Review*, 45, 439-470.

- Kadriu, O. (2006). *Rregullimi kushtetues i Maqedonisë*. Shkup: Shtëpia botuese "FocusPrint".
- Kelemen, K. (2013). Appointment of constitutional judges in a comparative perspective-with a proposal for a new model for Hungary. *Acta Juridica Hungarica*, 5-23. Retrieved from <https://ssrn.com/abstract=222>
- Kelsen, H. (2007). *General theory of law and state*. (H. Wedberg, Përkth.) Cambridge-Massachusetts: Harvard Univeristy Press.
- Kelsen, H. (2013). *Teoria e përgjithshme e së drejtës dhe shtetit (Libër i përkthyer nga Prof.dr. Osman Ismaili)*. Prishtinë.
- Kelsen, H., & Urbinati, N., & Accetti, C. I. (2013). *The essence and value of democracy*. Lanham: Rowman & Littlefield.
- Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës*. (2019, Janar 14). Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 2.
- Konstallari, A. et al. (1981). *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Prishtinë: Redaksia e botimeve "Rilindja".
- KOSOVO - forthcoming opinion-virtual meetings*. (2020, May-June). Retrieved 2020, from Venice Commission: <https://www.venice.coe.int/webforms/events/?id=2941>
- Krisafi, K., & Aubert, G., & Ordolli, S. (2002). *Kushtetuta e re shqiptare, sfida e së ardhmes euroatlantike të Shqipërisë: takim mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Shtëpia botuese "Luarasi".
- Kristo, V. (2007). Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet e KEDNJ. *Përmirësimi i cilësisë të zbatimit të KEDNJ nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase* (fv. 1-12). Tiranë : Ministria e Punëve të Jashtme .
- Kryeziu, K. (2017). *E drejta kushtetuese e krahasuar*. Prizren.
- Kryeziu, K. (2022). *Drejtësia kushtetuese*. Prizren: Shtëpia botuese "Altera".
- Krygier, M. (2015). Rule of Law and Rechtsstaat. *International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences*, 20, fv. 780-787.
- Kulić, D. (1969). *Ustavno Sudstvo u svetu*. Beograd: Univerzitet.
- Kurti, T. (a.d.). *Mbi strukturën kushtetuese dhe veprimtaritë institucionale të Republikës së Italisë dhe të Republikës së Shqipërisë*. Tiranë.
- Kushtetuta e KSAK*. (1974, Shkurt 27). Gjetur në Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 4.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. (1990, Shtator 7).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2008, Prill 9). Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. (1991, Nëntor 17). Gjetur në Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut:

Kushtetuta e RSH (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, ..., nr. 115/2020, datë 30.7.2020). (1998). Gjetur në Qendra e Botimeve Zyrtare.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2017). *Reforma në sistemin e drejtësisë*. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë. Gjetur në <https://www.parlament.al/Files/Informacione/V%C3%ABllimi%20i%20par%C3%AB,%20pjesa%20e%20par%C3%AB.pdf>

Lee, E. R. (2000). *Vështrime të një Juristi për Kushtetutën*. (P. Plloçi, Përkth.) Tiranë: Shtëpia botuese "Nënë Tereza".

Lëvizja Vetëvendosje, KI 27/20 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Shtator 7, 2020).

Ligji Kushtetues i KSAK. (1969, 2 24).

Ligji nr. 03/L-073. (2008, Qershor 5). Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Prishtinë: Viti III / Nr. 31.

Ligji nr. 03/L-121 . (2008, Dhjetor 30). Gjetur në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 76/2016 . (2016, Korrik 22). Gjetur në Qendra e Botimeve Zyrtare.

Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. (2021, Maj 4).

Ligji nr. 99/2016 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, "Për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH". (2016, 10 6).

Ligji nr.8577 për organizimin dhe funksionimin e GJKRSH. (2000, Shkurt 10). Gjetur në https://www.gjk.gov.al/web/ligj_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_ku_shtetuese_2016_1667.pdf

Ligji për aderimin e RSH në Statutin e KE. (1995). Gjetur në Qendra e Botimeve Zyrtare.

Ljatifi v. the Former Yugoslav RM, No. 19017/16 (European Court of Human Rights May 17, 2018).

M. Koka, KI 214/19 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Gusht 24, 2020). /

Mabco Constructions dhe Eurokoha-Reisen, KI 168/14 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Gusht 28, 2015).

- Maksuti, M. (2010). *E drejta kushtetuese e Republikës së Maqedonisë*. Tetovë.
- Manaj, R.-I. z. (2021, Qershor 30). Intervistë përmes emailit . (D. Susuri, Intervistuesi)
- Mansfield, N. (2013). *Krijimi i Gjykatës Kushtetuese Mësimet nga Kosova*. New York: East West Management Institute. Gjetur Prill 2021, nga https://www.gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/Raporti_i_Institutit_EWMI_per_Gjykatën_Kushtetuese.pdf
- Martines, T. (2011). *E drejta kushtetuese*. Tiranë: UET Press.
- Medecigo, A. (2016). *Rule of law and fundamental rights-Critical Comparative Analysis of Constitutional Review in the United States, Germany and Mexico*. Berlin, Germany: Springer.
- Ministers Deputies-Council of Europe . (2008). *The Council of Europe and the Rule of Law - An overview*. Council of Europe.
- Ministria e Drejtësisë . (2017). *Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut për vitin 2016*. Tiranë: Shtëpia botuese "Onufri".
- Mjeku, L. (2020, Prill 9). Dita e kushtetutës/Të gjitha kushtetutat e Kosovës. Prishtinë . Gjetur Janar 2021, nga <https://www.portali.info/opinione/dita-e-kushtetuteste-gjitha-kushtetutat-e-kosoves>
- Montesquieu. (2000). *Mbi frymën e ligjeve*. (K. Hajdëri, Përkth.) Tiranë: Shtëpia Botuese "Luarasi".
- Morina, V. (2013). *Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore)*. Prishtinë: Instituti për studime kushtetuese dhe parlamentare.
- Morina, V. (2021, Qershor 30). Intervistë përmes emailit. (D. Susuri, Intervistuesi)
- Moroșteș A.F., & Stoicu, N.M. (2017). Constitutional justice. *Journal of legal studies*, 19 (33), 135-142.
- Mushkolaj, Gj., & Morina, V., & Johan, V. L. (2014). *Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës-Komentar*. Prishtinë: (GIZ) GmbH.
- N. Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë , Rasti Nr. KI 47/10 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Shtator 28, 2010).
- N.Jovanovic, KI 187/13 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Prill 16, 2014). Gjetur në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_187_13_shq.pdf
- Negretto, G. (2018). *Constitution-Building Processes in Latin America* . Stockholm: International IDEA Discussion.

Njoftim për moszbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI 08/09, KK 141/19 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës May 28, 2019).

Olatunji, F. O. (2013, December). Democracy and the Challenge of the Rules of Law in Developing Democratic Society. *Beytulhikme An International Journal of Philosophy*, 3(2), 68-79.

Olechowski, T. (2015). The beginnings of constitutional justice in Europe. *Law and the Formation of Modern Europe: Perspectives from the Historical Sociology of Law*, 77-95.

Omari, L. (2004). *Shteti i së drejtës*. Tiranë: Botimet "Elena Gjika".

Omari, L. (2009). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues*. Tiranë: Botimet "Dudaj".

Omari, L. (2011). *Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese* . Tiranë : Botimet "Elena Gjika" .

Omari, L., & Anastasi, A. (2010). *E drejta kushtetuese* . Tiranë: Shtëpia botuese ABC.

Opinion N° 779 / 2014. Strasbourg: Council of Europe. Retrieved from [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2014\)026-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2014)026-e)

Pajaziti, A. (2009). *Fjalor sociologjik*. Shkup: Logos-A.

Parliamentary Assembly. (1995, June 29). *Assembly public documents-Opinion*. Retrieved from Application by Albania for membership of the Council of Europe: <https://pace.coe.int/en/files/13928/html>

Pepa, E., & Gera, A. (2015). Nevoja për ndryshime kushtetuese në procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. *Punime akademike mbi nevojën për ndryshime kushtetuese*, 88-97.

Petreska v. The Former Yugoslav RM, No. 16912/08 (European Court of Human Rights July 21, 2016).

Platoni. (2016). *Shteti*. (N. S. Jorgji, Përkth.) Tiranë: Irisoft Education .

Procesi vendimmarrës-GJK. (2021, Shkurt). Tiranë, Republika e Shqipërisë. Gjetur në https://www.gjk.gov.al/web/PROCESI_VENDIMMARR_S_1832_1.php

Projekt-Kodi nr.06/L-151 i Procedurës Penale. (2019, Janar 25). Gjetur në Projektligjet: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/151Projekt-KodiiProceduresPenale_LbCmaFUwG6.pdf

- Puto, A. (2002). *Konventa Evropiane për të Drejtata e Njeriut në përqasje me Kushtetutën e Shqipërisë (Vështrim krahasues)*. Tiranë, Republika e Shqipërisë : Shtëpia botuese "Albin".
- Puto, E. (2008). *E drejta kushtetuese e krahasuar*. Tiranë: Shtëpia botuese "UFO Press".
- Q. Kurtishi dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit, KO 01/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Mars 18, 2010).
- R. Carolan-Mendim konkurrues dhe mospajtues, KO 61/12 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Tetor 31, 2012).
- R. Selimi dhe 29 deputetë të tjerë, KO 72/20 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 1, 2020).
- Rama, A. (2021, Korrik 2). Intervistë përmes emailit. (D. Susuri, Intervistuesi)
- Raport Vjetor 2018*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.
- Raport Vjetor 2019*. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.
- Raporti për Kosovën. 2019*. Bruksel: Komisioni Evropian.
- Raporti për Kosovën. 2015*. Strasburg: Komisioni Evropian.
- Raporti për Kosovën. 2018*. Strasburg: Komisioni Evropian.
- Report of the Constitutional Court of the former Yugoslav RM. (n.d.). *Conference of European Constitutional Courts XIIth Congress*, (pp. 1-16).
- Rios, J. (2009). Institutions for Constitutional Justice in Latin America. *Division De Estudios Politicos*, 1-28.
- Risteski, T. (2020). *Analiza funksionale e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut*. Shkup : Instituti për të Drejtat e Njeriut.
- Ristova-Ingilizova, L. (2004). Constitutional Protection-Current state of affairs and perspectives. *International Conference held on the occasion of 40th Anniversary of the functioning of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia*. Skopje : "OBNOVA" - Kocani.
- Roos, R. S. (2007, August). The "Rule of Law" as a Requirement for Accession to the European Union. *YEARBOOK ŠIPAN 2007*, fv. 1-13.
- Rosenfeld, M. &. (2012). *Comperative Constitutional Law*. New York: Oxford University Press.

Rules of procedure of the CCRM. (1992, November 9th). *Rules of Procedure*. Skopje, Republic of Macedonia: Constitutional Court of the Republic of Macedonia.

Rregullore e punës e GJKRK nr. 01/2018. (2018, Qershor 22).

Sadurski, W. (2008). *Rights Before Courts- A study of Constitutional Courts in Postcommunist States os Central and Eastern Europe*. Netherlands: Springer.

Sadurski, W. (2014). *Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts* (Second edition ed.). New York: Springer Dordrecht Heidelberg.

Sadushi, S. (2004). *Kontrolli kushtetuese*. Tiranë: Shtëpia botuese "BOTIMPEX".

Sadushi, S. (2012). *Drejtësia kushtetuese në zhvillim*. Tiranë: Botimet Toena.

Saliu, K. (2004). *E drejta kushtetuese*. Prishtinë: Shtypshkronja "TIMEGATE".

Sindikata e Pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut, KI 08/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Dhjetor 17, 2010). Gjetur në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_08_09_shq.pdf

Smit, J. v. (2015). *The Appointment, Tenure and Removal of Judges under Commonwealth Principles-A Compendium and Analysis of Best Practice*. London: The British Institute of International and Comparative Law.

Sólyom, L. (2013). The Role of Constitutional Courts in the Transition to Democracy With Special Reference to Hungary. *International Sociology, Vol 18(1)*, 133-161.

Spirovski, I. (2011). The Independence of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia: Guarantees and Challenges. *2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice* (pp. 1-13). Rio de Janeiro: Federal Supreme Court of Brazil and The Vennice Commission of the Council of Europe.

Statute of the Council of Europe. (1949, May 5).

Steinberger, H. (1994). Decisions of the constitutional court and their effects. *The role of the constitutional court in the consolidation of the rule of law* (pp. 65-90). Bucharest: European Commission for Democracy through law (Venice Commission).

Stojanovski, V. et al. (2016). *Gjykata Kushtetuese në presionin midis interesave politike dhe të drejtave të njeriut*. Shkup: Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i RM.

Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë. (2015, Korrik 24). Gjetur në Republika e Shqipërisë-Kuvendi-Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë:<https://rm.coe.int/strategjia-ne-refomen-e-sistemit-te-drejtjesise/16809eb53a>

- Susuri, H. (2011). *E drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Kolegji "Fama" Prishtinë.
- Susuri, H. (2019). *E drejta kushtetuese*. Prishtinë: Kolegji "Fama".
- Shapiro, M. (1981). *Courts: A Comparative and Political Analysis*. Chicago: University of Chicago Press.
- Shasivari, J. (2020). *E drejta kushtetuese* (bot. i Second Edition). Shkup: SHB "Furkan ISM".
- ShtetiWeb. (2021). Gjetur në Çfarë është Shteti i së drejtës?: <https://shtetiweb.org/2012/09/15/ceshte-shteti-i-se-drejtës/>
- Tamanaha, B. (2004). *On the Rule of Law: History, Politics, Theory*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Tasev v. North Macedonia, No. 9825/13 (European Court of Human Rights May 16, 2019).
- Traja, K. (2000). *Drejtësia kushtetuese*. Tiranë: Luarasi.
- Traja, K. (2002). Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. *Kushtetuta e re shqiptare sfida e së ardhmes euroatlantike të Shqipërisë* (fv. 57-76). Tiranë, Shqipëri : Instituti i studimeve bashkëkohore ballkanike .
- Tunheim, J. (2021, July 1). Interview via email . (D. Susuri, Interviewer)
- The RWI of HRHL. (2012). Rule of law-A guide for politicians. The Hague Institute for the Internationalisation of Law (HiIL).
- U. Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë, KO 61/20 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Maj 5, 2020).
- Uitz, R. (2005). *Constitutions, courts and history: historical narratives in constitutional adjudication*. Budapest, Hungary: Central European University Press.
- United Nation-Mission in Kosovo. (2001, Maj 15). Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme. Gazeta Zyrtare e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.
- United Nations-Security Council. (2004). *The rule of law and transitional justice in conflict and post-conflict societies-Report of the Secretary-General*. United Nations.
- Urdhëra tjerë, KO 01/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 7, 2010).
- Urdhër-Q. Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, KI 01/09 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Qershor 18, 2010).

V. Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë, KO 95/13 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Shtator 9, 2013).

V.Bislimi kundër MPB, KGJK, MD, KI 06/10 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Tetor 30, 2010).

Velaers, J. (2016). Constitutional Versus International Protection of Human Rights: Added Value or Redundancy? The Belgian Case, in the Light of the Advisory Practice of the Venice Commission. *Revue interdisciplinaire d'études juridiques*, 77, 265-295. [htt, 77, 265-295.](#)

Vendim për shpalljen e amandamenteve IV-XVIII . (2001, Nëntor 16). Gjetur në "Official Gazzete of the Republic of Macedonia" No.91/01.

Vendimi nr. 11, V-11/07 (GJKRSH 04 04, 2007).

Vendimi nr. 17, V-17/09 (GJKRSH 06 19, 2009).

Vendim nr. 18. V-18/08 (GJKRSH 07 29, 2008)

Vendimi nr. 20, V-20/06 (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë 07 11, 2006).

Vendimi nr. 26, V-26/05 (GJKRSH 11 02, 2005).

Vendimi nr. 34, V-34/20 (GJKRSH 12 20, 2005).

Vendimi nr. 9, V-9/07 (GJKRSH 2 26, 2007).

Venice Commission . (2018). *Report of the TAIEX* . Zagreb.

Venice Commission . (2018, October 22). *Rules of Procedure*. Retrieved from Council of Europe.

Venice Commission. (1990, Maj 10). Retrieved from Resolution (90)6 on a partial agreement establishing the European Commission for Democracy Through Law.

Venice Commission. (1995-2020). Retrieved from Documents-Albania-Opinions for "Albania".

Venice Commission. (2002, February 21). Retrieved from Resolution Res(2002)3 adopting the revised Statute of the ECDTL.

Venice Commission. (2002-2020). Retrieved from Documents-North Macedonia-Opinions for "North Macedonia".

Venice Commission. (2011). *Report on the rule of law*. Strasbourg: ECDTL.

Venice Commission. (2014, June 11). Retrieved from Members: <https://www.venice.coe.int/webforms/events/?country=243>

Venice Commission. (2014, September 8-10). Retrieved from "The former Yugoslav Republic of Macedonia" – forthcoming opinion on constitutional amendments - visit to the country.

Venice Commission. (2015, November 2-3). Retrieved from Albania – forthcoming opinion on judiciary reform - visit by the rapporteurs.

Venice Commission. (2016, February 8-9). Retrieved from The former Yugoslav Republic of Macedonia – forthcoming opinion - a visit of the delegation of the Venice Commission.

Venice Commission. (2018, May 14-15). Retrieved from Kosovo – forthcoming opinion – visit of the rapporteurs.

Venice Commission. (2018, September 19). Retrieved from Albania – Forthcoming opinion - Visit to the country.

Venice Commission. (2018, November 19-20). Retrieved from ALBANIA – forthcoming opinion – country visit.

Venice Commission. (2018, January 29-30). Retrieved from "The former Yugoslav Republic of Macedonia" – forthcoming opinion – visit to the country.

Venice Commission. (2019, September 10-11). Retrieved from ALBANIA – forthcoming opinion – country visit.

Venice Commission. (2019, September 5-6). Retrieved from NORTH MACEDONIA - Forthcoming opinion - country visit.

Venice Commission. (2020, September 14-15). Retrieved from KOSOVO – forthcoming opinion – video meetings.

Venice Commission. (2020, November 16-17). Retrieved from KOSOVO - forthcoming opinion – online meetings.

Vorpsi, A. et al. . (2019). *Komentar mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016)*. Tiranë: Instituti për studimet publike & ligjore.

Weller, M. (2011). *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*. Prishtinë: Botues "Koha".

Zaganjori, X. (2002). *Demokracia dhe shteti i së drejtës* . Tiranë : Luarasi.

Zagonjari, XH. et al. (2011). *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Shtëpia botuese "Adelprint". Gjetur në https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=726ef2ee-7a25-2477-3d07-a97bfeb4a8a7&groupId=252038

Zamudio Fix, H. (1981). The Writ of Amparo in Latin America. *University of Miami Inter-American Law Review*, 361-391.